



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16, 23 DHE 30 MARS 2018

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16, 23. I 30. MARTA 2018. GODINE

MARS - MART
2018

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupi Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari,
4. Shqyrtimi i Propozim-Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018,
5. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-015 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
11. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016,
12. Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosi të Pronave dhe
13. Emërimi i një (1) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Interpelacija premijera Republike Kosova Ramush Haradinaj, na zahtev PG Pokreta Vetëvendosje, u vezi nasilne smrti aktivista Pokreta Vetëvendosje, Astrit Dehari,
4. Razmatranje Predloga - programa rada Skupštine Kosova za 2018 godinu,
5. Prvo razmatranje Nacrta - poslovnika Skupštine,
6. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji Sporazuma o dugu između Republike Kosova i Evropske banke za obnovu i razvoj, o projektu autoputa Kijevo-Zahać,
7. Drugo razmatranje N/zakona br. 06/L-004 o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-094 o predsedniku Republike Kosova,
8. Drugo razmatranje N/zakona br. 06/L-013 o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-072 o kontroli i nadgledanju državne granice, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-214,
9. Drugo razmatranje N/zakona br. 06/L-014 o kritičnoj infrastrukturi,
10. Drugo razmatranje N/zakona br. 06/L-015 o carinskim merama i zaštiti prava intelektualne svojine,
11. Razmatranje izveštaja performancije javnih preduzeća za 2015 i 2016 godine,
12. Imenovanje dva (2) člana Komisije za proveru i određivanje imovine, i
13. Imenovanje jednog (1) člana Komisije za imovinske zahteve.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta.

Diskutimi në emër të Grupit Parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Bekim Haxhiu e ka fjalën.

Për korrektësi, pasi reaguat, tash edhe kjo gara e grupeve parlamentare, i pashë pesë emra, shumica janë të PDK-së, për atë e përmenda, dihet tashmë, ka dalë si grupi më i madh.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Jemi dëshmitarë se këto ditë në media vendëse dhe ndërkombëtare të një skandali, i cili ka plasur edhe në Evropë, e në veçanti në Belgjikë, për mish, i cili është tregtuar në Republikën e Kosovës. Sipas të dhënave të shtetit të Belgjikës, afro 200 mijë kilogramë mish janë eksportuar në Republikën e Kosovës, mish i vjetër 12 vjet, për çka fillimisht dua të falënderoj Agjencinë e Veterinës dhe të Ushqimit të Republikës së Kosovës se në vitin 2016 për herë të parë ka hasur në këtë mall të skaduar, të prishur, dhe prej aty kanë filluar hetimet pastaj edhe në shtetin e Belgjikës për këtë mish të skaduar.

Ky është një problem vërtet shumë serioz e shqetësues, sepse kur Kosova ka nënshkruar MSA-në obligimet dhe detyrimet janë të dyanshme, jo vetëm të Republikës së Kosovës ndaj partnerëve ndërkombëtarë, por edhe të atyre në raport me Kosovën, në veçanti ato që i kemi dëgjuar në media janë shumë shqetësuese.

Unë e falënderoj Qeverinë e Kosovës që e ka shfaqur një transparencë në këtë rast dhe ka bërë të ditur që nga viti 2016 nuk ka pasur një tregtim të tillë me këtë kompani në Republikën e

Kosovës, por është me rëndësi shumë të bëhen të ditur edhe publike se sa ka hyrë mall i tillë nga kjo kompani, VEVIBA, para vitit 2016.

Pra, Doganat e Kosovës e kanë për obligim të bëjnë publike e transparente, sepse një sasi prej 200 mijë kilogramësh është të paktën një milion e 200 mijë racione ushqimore dhe kjo paraqet një rrezikim të shëndetit në masë.

Po e potencoj këtë si problematikë, për arsye se është më se e nevojshme që të ndërhyhet edhe në përmirësimin e legjislacionit, e në veçanti të Kodit Penal, sepse duke e shprehur mirënjohjen time për ministrin e Drejtësisë, i cili ka filluar reformat në këtë sektor, dua të potencoj vetëm një fakt shumë të rëndësishëm.

Tregtimi, falsifikimi dhe keqpërdorimi apo tregtimi i paligjshëm i produkteve ushqimore dhe i produkteve farmaceutike dhe barnave, sipas Kodit Penal të Kosovës është i dënueshëm deri në tre vjet.

Falsifikimi i barnave gjithashtu është i dënueshëm deri në dy vjet, ndërsa falsifikimi i parasë është i dënueshëm 10 vjet.

Ne me Kodin Penal më shumë rëndësi i kemi kushtuar falsifikimit të parasë se sa falsifikimit të ushqimit dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Lumir Abdixhiku, në emër të Grupit Parlamentar, e ka fjalën. Le të bëhet gati Arbërie Nagavci, në emër të Grupit Parlamentar, po ashtu.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tashmë që nga dita e parë e kësaj Qeverie është bërë praktikë e zakonshme shpërndarja e parasë publike pa ndonjë kriter, pa ndonjë analizë, pa ndonjë vlerësim, arsyetimi kryesisht i tekeve dhe të rastit.

Dhe gjithçka kishte nisur me procesin e shpronësimit në Hade, kur pronat e shpronësuara ishin paguar shumëfish më lart se sa vlerësimi fillestar real.

Kishte vazhduar me faljen e 58 milionë eurove prodhuesve të ujit, ani pse një falje e tillë kërkonte aprovim parlamentar.

Kishte vazhduar edhe me dhënien e 280 mijë eurove për rastin e Kumanovës, e në fundvit kishte kulmuar me rritjen rekord të Kabinetit qeveritar, dhe më pas me dyfishimin e pagave për ta.

Një praktikë e tillë fatkeqësisht ka vazhduar edhe këtë vit, qindra-mijëra euro, miliona euro, jepen në vazhdimësi, krejtësisht në formë arbitrare.

Herë për rrymën e serbëve në veri, e herë për ceremoni përkujtuese.

Në mbledhjen e fundit të Qeverisë kryeministri i Kosovës kishte kërkuar ndarjen 950 mijë eurove për shënimin e 550-vjetorit të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Fillimisht një shumë gati njëmilionëshe, e kërkuar për shënim të një përvjetori gjysmëmilenial, në kohë kur spitalet e Kosovës janë ende pa barna e pa penj, është jashtë çdo konsiderate për gjendjen e rëndë ekonomike në vend.

Por, mbi të gjitha, një kërkesë e tillë shpërfaqë edhe gjendjen alarmante të rezervës së shtetit, në vetëm dy muaj ekzekutiv.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës shfaq shqetësimin e vet për mënyrën kaotike të shpenzimit të parasë publike, për vendimet e atypëratyshme, për mungesën e kriterëve dhe, mbi të gjitha, për vendimet e padrejta.

Jemi të shqetësuar me paralajmërimin e ministrit të Financave se vetëm në dy muaj kohë është shterur rezerva e sivjetme.

Rrjedhimisht në javën që vjen të dy komisionet e udhëhequra nga LDK-ja, ai për Buxhet dhe ai për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e kanë ftuar në raportim ministrin e Financave për të qartësuar shpenzimet në fjalë.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Çështja e transparencës së parasë publike është jetike për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të drejtë dhe, në këtë drejtim LDK ka përcjellë me shumë vëmendje raportimet dhe letrat e avokatit të mirënjohur britanik, Jeffry Nice, drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Këto raportime marrin veçanërisht peshë kur në njërin nga seancat e fundit kryeministri i Kosovës ka deklaruar publikisht se pagesa e parasë në të zezë është krejtësisht e zakonshme. Për LDK-në, pagesat e tilla janë gjithçka, veçse të zakonshme.

Në këto raportimet të fundit është bërë e qartë se Presidenca e Kosovës ka angazhuar në aktivitete lobuese me çmime jashtëzakonisht astronomike figura të ndryshme botërore, produktet e të cilëve nuk janë funksionalizuar asnjëherë, siç ishin menduar fillimisht.

Në këto angazhime kanë ndodhur edhe parregullsi, që kërkojnë vëmendjen tonë urgjentisht.

Nga raportimet e lartpërmendura në mënyrë të drejtpërdrejtë deklarohet se një pjesë të lobimit për Kosovën ka marrë karakter individual, pra është transformuar.

Pra, paratë në fjalë janë përdorur jo për të përmirësuar imazhin e Kosovës, po për të përmirësuar imazhin e politikanëve tanë në hall.

Pjesë e këtij raportimi është edhe kompensimi i biografisë fikzionale, të blerë e të porositur, të presidentit të Kosovës, autorët e së cilës janë kompensuar, po e citoj avokatin britanik në mënyrë të tërthortë.

Fillimisht LDK konsideron si institucione shtetërore të Kosovës mund dhe duhet të ndajnë buxhet për të dokumentuar viktimat, dhunën, dëmet e luftës në Kosovë.

Por, Kosova s' duhet të ndajë asnjëherë buxhet për të porositur e lustruar interpretime të historive personale, gjithsesi falëse, të politikanëve të Kosovës, siç është rasti me presidentin tonë. Këtë breng Kosova nuk e ka as s' mund ta ketë.

LDK-ja gjithashtu beson në bazë të raportimeve të dhëna se shuma marramendëse milionëshe vazhdojnë të jepen gjithandej edhe sot, për t'u përdorur më pas të njëjtat për qëllime ekskluzivisht individuale.

Thënë këtë, LDK paralajmëron sot në këtë seancë se do të kërkojë formimin e Komisionit Hetimor parlamentar për të dhënë dritë mbi të gjitha raportimet e dhëna deri më tani, mbi të gjitha paratë e shpenzuara e të kontraktuara deri më tash për çështjet e lobimit.

Nga sot ne do të nisim mbledhjen e nënshkrimeve për këtë Komision Hetimor dhe këtu ftojme secilin nga ju të mbështesë këtë nismë tonën.

LDK do të kërkojë zbardhjen e secilit cent, të secilës kontratë, të secilit angazhim të devijuar që mund të kenë ndodhur deri më tani për çështjet e lobimit.

Keqpërdorimet e tilla jo vetëm që paraqesin shkelje të rënda kushtetuese, por ato përmbajnë edhe akte penale në vete dhe të njëjta do të trajtohen në këtë dritë. Faleminderit!

KRYETARI: Arbërie Nagavci, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, le të bëhet gati Teuta Haxhiu.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Ashtu sikurse jeni në njohuri, një numër i madh i mësimdhënësve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore i janë përgjigjur kërkesës apo ftesës së sindikatës për grevë.

Kërkesat e mësimdhënësve kanë të bëjnë kryesisht me Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të viteve të ‘90-a.

Greva filloi me paralajmërim, me humbje të orës mësimore për një ditë, për të vijuar ditën e dytë me dy orë mësimore dhe më 12 mars me një grevë njëditore.

Dhe, për të paralajmëruar se nëse nuk përmbushen kërkesat e tyre, më 13 prill mësimdhënësit në të gjitha shkollat do të hyjnë në një grevë me afat të pacaktuar.

Sipas të dhënave të MASHT-it, në Republikën e Kosovës janë rreth 400 mijë nxënës në arsimin parauniversitar dhe nëse i llogarisim orët e humbura, pra kemi parasysh një ditë një orë, dy orë dhe pastaj mesatarisht pesë orë në ditë, janë më shumë se 3 milionë orë të humbura për dhjetëra-mijëra nxënës në shkollat e Republikës së Kosovës, shtuar këtu edhe humbjen në ligjërata dhe në universitete për studentët.

Nëse kësaj ia shtojmë faktin se për pak kohë nxënësit e klasave të fundit të niveleve të shkollimit parauniversitar do t’u nënshtrohen provimeve kombëtare të arritshmërisë dhe maturës shtetërore, atëherë s’ka asnjë dyshim për dëmtimin që po u bëhet nxënësve tanë pikërisht nga ata që kanë obligim të kujdesen e të punojnë për ta.

Kjo grevë do të mund të parandalohej nëse Qeveria do të binte në rend të ditës Ligjin për mësimdhënësit e viteve të ‘90 dhe të jepte dritën e gjelbër që ta sillte në këtë Kuvend dhe të na jepte mundësinë që ta votonim.

Por ky ligj, nisma për të cilën është marrë që në prill e vitit 2013, pas mbledhjes së 12 mijë nënshkrimeve të të punësuarve në arsim, ligj për të cilin u dhanë premtime për përkrahje që nga viti 2013, ende ka mbetur në sirtarë të Qeverisë.

Pra, për shkak të papërgjegjësisë totale të qeveritarëve tanë, të cilët premtojnë dhe nënshkruajnë marrëveshje në fushata zgjedhore dhe nuk marrin asnjë obligim në kohë të qeverisjes, pasojat po i bartin nxënësit dhe të rinjtë tanë.

Pra, ju po privoni fëmijët dhe të rinjtë tanë nga një e drejtë elementare. Nga e drejta për arsim, e garantuar edhe me Kushtetutë. Pikërisht për shkak të neglizhencës dhe papërgjegjësisë.

Duhet përmendur këtu edhe mosrespektimin e Kontratës kolektive, e nënshkruar në prill të vitit të kaluar, e ky mosrespektim është po ashtu i papranueshëm për mësimdhënësit.

Duhet sjell në vëmendje po ashtu edhe faktin që të gjithë mësimdhënësit që po i adresojnë kërkesat e tyre në gjykatë po i fitojnë ato, por vetëm se po maltretohen mësimdhënësit e pensionuar dhe po rëndohet buxheti i shtetit, sepse komunat obligohen të paguajnë edhe shpenzimet procedurale dhe taksa të tjera.

Ka edhe një varg raste të tjera nga ana e Qeverisë që po i detyrojmë mësimdhënësit të merren me këto çështje teknike e monetare, duke pamundësuar kështu fokusimin dhe përkushtimin e tyre të plotë në punë dhe në mësimdhënie.

Të drejtat që po kërkojnë sindikatat, nuk po arrijnë të jenë në raport edhe me përgjegjësitë e tyre.

Në këtë situatë askush s'po merret me cilësinë e mësimdhënies e mësimnxënies, me monitorimin e punës së mësimdhënësve dhe zyrtarëve të tjerë arsimorë.

E pasojat e betejës në mes të kërkesës së drejtë të mësimdhënësve dhe premtimeve të pambajtura të Qeverisë, po i bartin nxënësit dhe të gjithë ne, sepse nuk mund të presim as për së afërmi rezultate më të mira me këtë mendësi dhe në mënyrë të qeverisjes.

Tashmë rezerva e shtetit ka shkuar drejt fundit që në dy muajt e parë të kësaj qeverisjeje. Kemi parë se është kërkuar nga kryeministri vlera prej një milion euro për pagesën e rrymës së shpenzuar nga serbët e veriut, është kërkuar falje milionëshe e borxheve, janë kërkuar miliona euro për ceremoni e festa, por nuk po shohim veprime për rregullimin e statusit ligjor të punëtorëve të viteve të '90-ta, të mësimdhënësve që me sakrificën e tyre të lartë mbajtën gjallë arsimin shqip të Kosovës dhe nuk ka buxhet të planifikuar për ngritjen e rezultateve mësimore.

Qeveria e Kosovës sa më parë duhet të marrë masat e nevojshme për të përmbushur obligimin ndaj mësimdhënësve, e në të njëjtën kohë vëmendja dhe energjia e mësimdhënësve, e së SBASHK-ut, e Ministrisë së Arsimit, e Qeverisë dhe të gjithë neve duhet të orientohet drejt përmirësimit të cilësisë, mbështetjes së mësimdhënësve dhe mbikëqyrjes së punës së tyre, instrumenteve dhe mekanizmave për përmirësimin e kësaj gjendjeje të rëndë në sistemin e arsimit në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Teuta Haxhiu e ka fjalën. Të bëhet gati Frashër Krasniqi, në emër të grupit parlamentar.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Asnjëherë nuk është tepër të flitet për temat edhe prej grupeve të ndryshme parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar i kam dy tema. Tema e parë është pikërisht Ligji i viteve '90-ta, kërkesa e vazhdueshme e punëtorëve të arsimit dhe, mbi të gjitha, ditët e fundit dhe grevat e organizuara, qoftë një orë qoftë dy apo një ditë dhe paralajmërimet për greva të tjera nuk janë në interes as punëtorëve të arsimit, nuk janë në interes as të prindërve, e aq më pak të nxënësve, por ne duhet t'i lëmë punëtorët e arsimit jashtë politikës.

Ajo që ka ndodhur për vite të tëra, qysh në 2011-në kur për herë të parë u nënshkrua kontrata në mes të ministrit të Arsimit dhe kryetarit, aktualisht që është prapë i SBASHK-ut, zotit Jashari, më 22 mars të vitit 2011, Kontratën Kolektive për arsimin parauniversitar.

Tani, vendimet dhe rekomandimet që kanë dalë në Kuvend në vitin 2013 ishin edhe rekomandime të Komisionit për Arsim, por njëkohësisht edhe një debat parlamentar që u organizua në Kuvend dhe dolën rekomandime që Qeveria e Republikës së Kosovës, e udhëhequr në atë kohë nga zoti Mustafa, edhe pse u nënshkruan në vazhdimësi kontrata të ndryshme, edhe po nënshkruhen, fatkeqësisht nuk u bë asgjë, rekomandimi i Kuvendit është që brenda afatit prej tre muajve Qeveria do të duhej ta sillte këtë ligj në mandatin e kaluar.

T'ju them të drejtën, personalisht e kam ngritur këtë çështje të mos them me dhjetëra herë, por asnjëherë nuk është mjaft. Prandaj, e lus Qeverinë e Republikës së Kosovës që t'i japë fund nënshkrimeve të kontratave sa për televizor, sa për media, por të sjellë ligjin e punëtorëve të viteve '90-ta në Kuvend dhe t'i japim fund kësaj çështjeje dhe asnjëherë punëtorët e arsimit të mos merren me probleme të tilla për t'i lënë nxënësit në shtëpi, sepse mbi të gjitha, një arsim i shëndoshë, është edhe një shoqëri e shëndoshë.

Dhe, problemi tjetër ose tema tjetër të cilën dua ta ngre sot është problemi i furnizimit me energji elektrike.

Qeveria e Republikës së Kosovës, si asnjëherë më parë u mor që nga fillimi me problemin e energjisë elektrike, por problem kryesor mbetet rrjeti shumë i dobët elektrik i shpërndarjes dhe çdo herë shohim në WEB faqen e KEDS-it pra njoftime të ndryshme, të përditshme, që do të ketë ndërprerje të rrymës në këto fshatra, në këto komuna e gjetiu.

Po ndalem në veçanti në komunën e Gjakovës, pikërisht në fshatrat e Rekës së Keqe, më saktësisht në fshatin Dobrosh dhe në lagjen e "Kallavajt", kur shumë familje që nga paslufta kanë probleme skajshmërisht, po ju them, probleme të nivelit që ata detyrohen çdo ditë edhe për

ujë të pijes të shkojnë me kilometra larg për shkak të problemeve të energjisë elektrike. Pra, në atë anë varet edhe uji i pijes, sepse ujin e pijes e kemi nga bunarët, normalisht varem nga energjia elektrike.

Edhe tani, ky sistem dhe shtylla gjithandej të rrëzuara mbesin me muaj të tërë dhe asnjëherë nuk merren me këtë problem. Pra, ky rrjet i shpërndarjes dhe rrjeti shumë i dobët ndër vite është problem, edhe sot po mbetet problem, prandaj, faturat e rrymës kërkohet që të paguhen në afate kohore, se në të kundërtën do të shkyçen qytetarët.

Andaj, lus që të mos të kemi probleme të tilla në këto vite dhe në këtë kohë, kur ne presim të ecim përpara me zhvillim ekonomik, derisa i kemi nevojat më elementare të furnizimit me rrymë energjetike për sektorin e amvisërisë, e le më për sektorë të tjerë ose të ndërmarrjeve.

Prandaj, të dy temat nuk janë larg njëra-tjetrës, por edhe një herë e ftoj Qeverinë e Republikës së Kosovës që t'i japë fund nënshkrimit të kontratave mediatikisht sa për të thënë dhe ju lutem juve si grupe parlamentare që ta lëmë arsimin jashtë politikës, të mos e bëjmë politik, sepse deri sot të gjitha subjektet politike vërtet ndërhyjnë dhe bënë politikë me sektorin e arsimit. Faleminderit!

KRYETARI: Frashër Krasniqi, të deklarohet a flet në emër të grupit, Milaim Zeka le të bëhet gati, në emër të grupit parlamentar.

FRASHËR KRASNIQI: Unë sot prapë dola të përfundoj një fjalë që nuk m'u lejua, e që është për keqardhje që deputetët e LDK-së po bëjnë shaka për këtë punë, se e njëjta do t'ju ndodhë edhe juve shumë shpejt, kur nuk i konvenon kryetarit të Kuvendit, nuk ka problem për mua.

Problemi në këtë vend është që në raport me rastin tonë është që tash e dy vjet jemi duke u akuzuar për një rast për terrorizëm, në të cilin nuk ka pasur asnjë provë dhe asnjë dëshmi që do ta vërtetonte fajësinë tonë. Ndërkohë që është abuzuar dhe është folur për ne prej kësaj foltoreje, prej deputetëve, disa të PDK-së dhe disa të LDK-së, duke na akuzuar për terrorizëm dhe asnjëherë nuk u është ndërprerë fjala prej kryetarit të Kuvendit dhe për mua logjika është e thjeshtë në raport me këtë rast.

Kur gjykatat nuk vendosim për rastin tonë, deputetët e PDK-së, duke përfshirë edhe kryeparlamentarin Kadri Veseli dhe disa deputetë të LDK-së, na akuzonin që “ju jeni terroristë” dhe e bënë këtë punë me zell të madh këtu, nuk e merrnin në konsideratë fare se çfarë pasojash mund të ketë kjo, qoftë te familjet tona, qoftë te njerëzit e tjerë kur gjykatat vendosën të na dënojnë në mënyrë të padrejtë, pa asnjë fakt, pa asnjë argument. Atëherë deputetët nuk folën më, as Kadri Veseli, as deputetët e PDK-së, as të LDK-së, sepse për këta, sidomos për Kadri Veselin dhe deputetët e PDK-së, gjykatat ua kishin kryer punën tashmë dhe s'e ndjenin nevojën të flisnin.

Por, në momentin që Gjykata e Apelit vendosi të na lirojë dhe e ktheu rastin në pikën zero pikërisht për shkak të parregullsive, atëherë Kadri Veseli e ndjeu nevojën të na e ndalë fjalën, sepse tashmë gjykatat nuk ia kishin kryer punën qysh deshën dhe është e papranueshme që sot kryetari i Kuvendit sillet si shef në Kuvend, si ta kishte Kuvendin pronë të vetën. Kështu ka mundur të sillet sa ka qenë në SHIK, po sot është kryetar i Kuvendit, nuk mund të marrë vendime t'ia ndërpresë fjalën një deputetit pa e ditur çka do të thotë ai deputet, pa e thënë dhe as pa bërë asnjë shkelje të Rregullores. Shikoni çka keni bërë me rastin tonë, për dy vjet na i keni torturuar familjet duke na thënë terroristë. Çka do të thoni sot? Për dy vjet na keni torturuar herë në arrest shtëpiak, herë duke na mbajtur nëpër burgje në një proces të montuar politik.

E, tash qeshni e bëni hajgare, po pikërisht po qeshni, bëni hajgare sot, ju dhemb e vërteta faktikisht, sepse buzëqeshja dhe këto përqeshjet tuaja vijnë prej faktit që ju dhemb e vërteta, njësoj sikur kryeparlamentarit i dhemb e vërteta dhe u detyrua ta ndalojë fjalën herën e kaluar, ju dhemb e vërteta për shkak se e keni parë edhe ju çfarë rasti i montuar ka qenë ky, të cilin ju e keni shfrytëzuar për arsye politike prej kësaj foltore pa ju penguar askush. Çka doni të thoni ju sot? Çka doni t'i thoni familjes së Astrit Deharit sot? Se ia keni mbajtur djalin në burg pa asnjë provë, pa asnjë fakt, pa asnjë dëshmi. Sot ai do të ishte në mesin tonë pikërisht për shkak se po vërtetohet pafajësia. Normalisht që s'keni çfarë të thoni, normalisht që kjo ju pengon e sot përpiqeni ta ndaloni fjalën për këtë temë dhe që kjo ka për t'ju penguar, besoj unë, tërë jetën për shkak se është rasti më skandaloz i montimit politik të një procesi gjyqësor.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, po shoh reagime, në qoftë se ka mundësi çështjet e gjyqësisë më në këtë Kuvend të mos i trajtojmë. Nënkryetar, unë nuk po dëshiroj ta hap, se pastaj po hapet debat, thjesht po keqpërdoret kjo foltore shpeshherë, i është ndalur fjala për shkak të shprehjes “fytyrat”, tjetër kund i thotë ato dhe s'kam dashur ta lejoj, ky çdo ditë mund ta fyejë Kadri Veselin si kryetar, unë e lejoj, por deputetët s'e lejoj t'i fyejë. Kjo është ajo çka e kam bërë, prapë e bëj.

Çështjet juridike i lëmë jashtë sallës, të mos i keqpërdorim për arsye se ka fakte, s'ka fakte, kjo punë më së pakti neve na takon. Ne bëjmë interpretime, të cilat janë politike. Ju kisha kërkuar, nënkryetar, e vazhdojmë në bazë të rrjedhës, të mos kemi reagime se pastaj po hapet. Kisha kërkuar mirëkuptim, më së shumti u përmenda unë, dhjetë herë. Milaim, qëndron aty, atëherë nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, e ka si formë reagimi. Jo, nuk ke të drejtë, ke dëshirë, po jo, jo, Milaim. Milaim, të lutem se s'ka kuptim, se pastaj keqkuptohet.

Vazhdo, nënkryetar, ndërkohë Milaimit i kërkojmë të ketë respekt. Nënkryetar, fjala për ju!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar kolegë,

Unë do të përpiqem të jem specifik dhe do t'i referohem fjalës së kolegut Krasniqi. Unë mendoj që është e ndjeshme dhe problematike që për çështjet të asaj natyre ne të bisedojmë këtu.

E dyta, bëhet shumë më e ndjeshme kur ne flasim për biografitë tona, që do të thotë për autobiografitë dhe ju e patë një qëndrim tonin për çështjet e kësaj natyre. Ajo na vë besoj në pozitë të vështirë, sepse pastaj duhet të kthehemi dhe të flasim për personat dhe ne nuk jemi këtu të flasim për atë punë, por unë prapëseprapë ju do t'ju bëj një pyetje të drejtpërdrejtë, po së pari, edhe një sqarim. Me sa di unë, rasti juaj është kthyer në rigjykim, kjo i bie është edhe një argument më shumë që ne s' duhet të debatojmë fare. Nëse ju kërkoni që të mos ndërhyhet, duhet së pari që ju të mos ndërhyni dhe të mos hapni debat, kjo është logjika e kësaj dhe ky duhet të jetë raporti kushtetues i një deputeti me çështjet e drejtësisë, kështu e mendoj unë.

Tani, meqë thatë ju që ka dhe deputetë, kolegë të mi, të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që ju ose këdo në atë proces e ka quajtur "terrorist", a mund të më thoni si quhet ai ose ata deputetë, si e ka emrin? Me emër dhe mbiemër.

KRYETARI: Milaim Zeka, Dardan, nuk ke të drejtë. A ta përmendi emrin? S'ta ka përmendur. A e ke përmendur, Kujtim, emrin? Më të mos krijojmë, unë e thashë edhe një herë të mos e keqpërdorim këtë foltore, shkojmë në bazë të rrjedhës, Milaim Zeka e ka fjalën. Ju kisha lutur, mos e keqpërdorni këtë pjesë, po mundohemi ta mbajmë një seancë normale dhe shkojmë në rrjedhë. Milaim, vazhdo, bëhet gati Xhavit Haliti.

MILAIM ZEKA: Atëherë, a të flas, o kryetar?

Po le ta ndalë regjia, se s'mund të flas kështu, se mund të rrihen njerëzit.

KRYETARI: Milaim, vazhdo fjalën, se unë jam duke biseduar.

MILAIM ZEKA: Atëherë, të nderuar qytetarë të Kosovës,

Arsyeja pse dola këtu në foltore është pikërisht fjalimi i Lumir Abdixhikut. Unë nuk do t'i drejtohem, siç e kanë marrë një shprehje deputetët këtu ta gjuajnë një parti politike, një grup të deputetëve shkaku i gjithkujt që del këtu e thotë një fjalë e tani me të merren krejt deputetët.

Konkretisht, akuzat, të cilat i bëri Lumir Abdixhiku në emrin e Qeverisë së Kosovës, Qeverisë aktuale nuk qëndrojnë asnjë, duke filluar prej kontratës të zotit Hashim Thaçi me zotin Xhefri Najs. Kjo kontratë, nën një, nuk është bërë në emrin e asnjë qeverie, nën dy, ka qenë në mandatin e Qeverisë të Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe të Partisë Demokratike të Kosovës. Në qoftë se zoti Avdullah Hoti posedon ndonjë konto numër, sepse pagesat janë bërë përmes Thesarit, në qoftë se Avdullah Hoti mund të dalë në foltore dhe të argumentojë se është bërë ndonjë pagesë në emër të qeverisë ose ekziston ndonjë kontratë në emrin e Qeverisë në mes Hashim Thaçit dhe Xhefri Najs, atëherë unë dal dhe kërkoj falje.

Domethënë, ajo nuk qëndron fare. E dyta, sa i përket formimit të Komisionit Hetimor, ne si Grup i “Nismës” e mbështesim 100%. Por, dëshirojmë ta hetojmë edhe Fondin e 3%-shit, edhe Fondin “Vendlindja thërret”, edhe paratë me gabim të kujt, kush është shkaktar që s’iu kanë paguar në afat të caktuar “Bechtel Enkës”. Për çfarë arsye faturën e qeverisë së kaluar duhet ta paguajë Qeveria aktuale. Edhe për këtë duhet të japë sqarim zoti Avdullah Hoti. Kush janë ata fajtorë? Ne e dimë edhe një diçka, që në Qeverinë e Agim Çekut, në vitin 2006-2007, “Rinvest”-i i asaj kohe i ka vjedhur dhe i ka keqpërdorur 1.8 milionë euro para të DFID-it anglez dhe para të SIDA-s suedeze, të cilat janë dhënë për planin strategjik zhvillimor në atë kohë të qeverisë.

Prandaj, nuk është mirë këtu të dalësh e ta lëshosh një rafal e të dalësh prej salle, sa për të falur diçka për shkak se po e kritikojmë Qeverinë. Unë kam qenë deputeti i parë në këtë Parlament, në seancën e djeshme që i kam bërë thirrje Qeverisë së Kosovës t’i bëjë publike shpenzimet edhe për Epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, t’i bëjë transparente edhe harxhimet për dhjetëvjetorin e pavarësisë, t’i bëjë transparente edhe paratë që janë kërkuar për përvjetorin e Skënderbeut dhe këtu jemi plotësisht dakord dhe plotësisht në një linjë me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Për shembull, më habit fakti pse Lumiri nuk e lavdëron ministrin, zotin Bedri Hamza, i cili ka thënë që po harxhohet buxheti i Kosovës, rezervat e shtetit, dhe i ka ndaluar paratë. Atëherë, le të dalë zoti Hoti këtu në foltore e të na tregojë çfarë keqpërdorimesh janë bërë, ku janë pengesat e pagesave, a u pagua ndonjë kontratë, jo që po dua ta mbroj Hashim Thaçin, në qoftë se ai ka paguar para dhe ka kontratë dhe ka bërë kontrata jashtë ligjit me zotin Xhefri Najs, atëherë i bëjmë thirrje prokurorit ta çojë njeriun në burg. Në qoftë se dikush nuk shkon në burg këtu, ne veç do të vazhdojmë kështu të ‘vringëllatim’, ne akuzo juve, ju neve.

Prandaj, edhe një herë, ju bëj thirrje ta bëjmë Komisionin Hetimor, nënshkrimet e “Nismës” i keni, ta hetojmë procesin e privatizimit, ta hetojmë shkatërrimin e Postë Telekomit të Kosovës, t’i hetojmë ato para që i kanë vjedhur të DFID-it e të SIDA-s suedeze, ta hetojmë edhe 3%-shin e dilni këtu kallëzoni se nga pak këto qeveri po japin edhe për njerëzit tuaj para. Kanë dhënë para edhe për të sëmurët që u takojnë edhe partive tuaja dhe përpos kritikave, mësojuni nganjëherë edhe të lavdëroni ndonjë gjë, qysh unë shpeshherë e lavdëroj Lidhjen Demokratike të Kosovës, edhe PDK-në nganjëherë.

Prandaj, që ta përfundoj fjalën time, gjashtë votat e “Nismës” janë pro Komisionit Hetimor që doni ta formoni Lidhja Demokratike e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Xhavit Haliti e ka fjalën, a doni ta vazhdoni edhe gjysmë ore? E vazhdojmë, të mos i mbesin kurrkujt borxh.

XHAVIT HALITI: S’ka rend kur jam unë, jo s’keni rend. Nënkryetari i Kuvendit e ka rendin.

Unë dola sot për një çështje krejt tjetër, jo për të debatuar me askënd. Por, jam i shqetësuar që jemi në proces të integritimit në Bashkimin Evropian dhe mendoj se Qeveria duhet të ketë një qasje të veçantë sa i përket çështjes së ambientit. Dihet se të gjitha shteteve të cilat kanë hyrë në Bashkimin Evropian dhe janë në proces të tillë, kostoja më e madhja është ambienti. Shumica e ndërtesave ose një pjesë e madhe e ndërtesave të vjetra në qytetet e Kosovës, e në veçanti në Prishtinë, çatitë i kanë të mbuluara me lëndë azbesti dhe pjesën e ujësjellësit ose kanalizimet e ujërave të zeza i kanë me lëndë azbesti. Në krejt shtetet e Bashkimit Evropian çdo ndërtesë që ka pasur lëndë të tillë, është shkatërruar në tërësi, e kam parasysh ndërtesën më të bukur që ka qenë në Berlinin Lindor dhe për shkak se ka pasur tubat e shkarkimit të azbestit, është shkatërruar.

Azbesti është një lëndë që sjell sëmundje në Kosovë dhe kudo që është i përdorur, prandaj mendoj që duhet të nxirret një ligj sa i përket kësaj lënde, e cila është njëra ndër shkaktarët e tumoreve dhe të kancerit në Kosovë. Një ligj, i cili e mundëson heqjen në mënyrën e duhur, jo në mënyrën primitive, qysh e bëjmë ne nganjëherë, thua që jemi nga jo nga lëndë njerëzore, por nga lëndë të tjera, pra me rregullat që parasheh Bashkimi Evropian, të hiqen me urgjencë mbulesat e shtëpive, mbulesat e ndërtesave dhe tubat e shkarkimit të azbestit. Besoj që Ministria e Ambientit një, Ministria e Financave, dy dhe të gjithë ata që janë përgjegjës, duke përfshirë edhe Ministrinë e Integritimit Evropian, këtë çështje do ta shqyrtojnë bashkë me komisionet parlamentare dhe do të miratojmë një ligj, i cili e çliron realisht ambientin, i çliron qytetarët e Kosovës, i çliron qytetarët që jetojnë nëpër ndërtesa shoqërore ku ka përbërje azbesti nga kjo murtajë, po e quaj “murtajë”, sepse e tillë është dhe e tillë trajtohet në të gjitha vendet e civilizuar. Faleminderit!

KRYETARI: Emilija Rexhepi, bëhet gati Dardan Molliqaj, se ka insistuar ta marrë fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvalujem se predsedniče,

Poštovani predstavnici vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Koje puno puta do sada, i danas želim da govorim o magistralnom putu Prizren- Rečane-Prevalac koji se nalazi u jako teškom stanju gde je svakodnevno ugrožena bezbednost i sigurnost svih naših građana. Godinama u nazad razni političari, razni ministri grade svoju izbornu kampanju na ovom projektu, odnosno na nekoj izgradnjih tunela koji faktički ne postoji i možda u nekom mozgu političara i dalje, ja zahtevam od našeg premijera Vlade, posebno ministra za Infrastrukturu, g. Pala Lekaj da nam objasni situaciju kada ćemo krenuti sa tom izgradnjom puta, da li ćemo raditi kaskade i betonske stubove, ili ćemo i dalje pričati o nekom tunelu koji ne postoji i stalno vršiti obmane naših građana. Zahvaljujem!

KRYETARI: Dardan Molliqaj e ka fjalën, edhe Ganimete Musliu bëhet gati.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit!

Nuk është çështje insistimi, besoj që krejtësisht çështje e të drejtës, çka mendoj unë për ty, si kryetar i PDK-së është tjetër temë. Do të dëshiroja që marrëdhëniet në Kuvend sa u përket procedurave dhe udhëheqjes të jenë në mes të grupit, ose deputetit dhe kryetarit të Kuvendit.

Kur bëhen përjashtime për dikë, duhet të bësh përjashtime për të gjithë. Ajo çka kërkova unë është, precedentin që vetë e krijuat, ta respektoni edhe për grupin tonë, përkatësisht kërkesën time. Për temat e tjera politike, besoj që do të flasim prej pozicioneve të tjera.

Kujtim, para se t'i bësh pyetje Frashërit, është mirë t'u bësh pyetje deputetëve tuaj, ata janë aty, ndonjë ndoshta edhe nuk është zgjedhur. Nuk jam unë këtu për të thënë emra, pyeti deputetët e tu, mos bëni zhurmë, ekzistojnë videot, ekzistojnë fjalime në këtë Kuvend të deputetëve, një prej tyre, mbasi po doni një emër, një prej tyre është Besa Gaxherri, po ka edhe të tjerë, është Isa Mustafa, si kryeministër, kështu që kur t'i thoni akuzat, duhet të bëheni gati t'i merrni edhe përgjigjet, Kujtim, edhe të gjithë ju të tjerët.

Unë nuk besoj në këtë idenë që s'duhet të diskutojmë për sistemin e drejtësisë, kjo është budallallëk në vetvete, edhe për rastet gjyqësore, kudo nëpër botë, diskutohet, tjetër gjë është ndërhyrja në drejtësi, por me gjasë, disa ose s'e kuptojnë ose e keqpërdorin. Po, ky Kuvend ka diskutuar për rastin e sulmit ndaj Kuvendit dhe janë sulmuar aktivistët tonë, më së shumti nga PDK-ja, por edhe nga LDK-ja. Kur u mbajt dëgjimi i fundit parlamentar për këtë çështje, nuk foli gati kurrkush, as nga PDK-ja e as nga LDK-ja, sepse ishin të dënuar dhe ajo që tha Frashëri është e drejtë, atëherë kur gjykata po u kryen punë, ju nuk flisni, atëherë kur gjykata nuk po ju kryen punë, po këqyrni të flisni ose t'ua ndaloni njerëzve fjalën. Kështu që bëju pyetje deputetëve, kryeministrit, kryetarit të partisë, edhe ministrave të tjerë dhe ata të kallëzojnë çka kanë thënë për këtë rast.

KRYETARI: Nënkryetar, te foltorja, por kisha pasur dëshirë ta përfundojmë më shpejt. Ganimete Musliu bëhet gati.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe për pjesën e parë të fjalës të kolegut Molliqaj unë pajtohem, të gjithë kanë të drejtë të flasin, nëse flet njëri, por unë atëherë e kërkova fjalën si nënkryetar i Kuvendit dhe kam të drejtë në çdo rast. E dyta, fjala e kolegut Krasniqi i është drejtuar Grupit tonë Parlamentar. Prandaj, edhe unë u përpoqa të jem specifik.

Tani edhe një herë po saktësoj për ju që s'e kuptoni me të parën. Po them që nëse bën biografi dhe sidomos në rastet kur lidhet me çështje të drejtësisë, je minimalisht kredibil, sepse flet për vete. Kurrkush s'thotë jam fajtor dhe askush s'e gjykon veten, e para. E dyta, dhe kur flasim për tjerët, ne s'kemi të drejtë të flasim për fajtorë ose jo këtu, sepse ky është institucion i një natyre tjetër. E treta, as ata emra që i përmendët ju dhe asnjë prej kolegëve të mi s'e ka quajtur askënd

“terrorist”, por ka folur për një akt terrorist, jo për autorët. Nëse s’janë këta autorët, ajo s’është as çështje imja, as e grupit tim parlamentar, unë nuk e di kush është autori, por unë besoj që edhe ju si unë pajtoheni që ai ka qenë një akt terrorist, ky është kualifikimi. Nuk ka lidhje me njerëzit, të cilët akuzohen, sepse unë atë s’e di.

KRYETARI: Ganimete Musliu e keni fjalën. Ka shumë deputetë, por unë do të mundohem edhe nga një prej grupit dhe ta përfundojnë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fjalën time sot do ta ndaj në dy pjesë, jemi mësuar që në këtë foltore të dalim vetëm kur kritikojmë apo thjesht të gjykojmë punën e ministrave, por shpesh edhe të shajmë e të ofendojmë njëri-tjetrin dhe qytetarëve rrallëherë po u servojmë lajme të mira nga kjo foltore. Prandaj, sot në pjesën e parë time të fjalimit tim do ta përgëzoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zotin Kujtim Gashin, i cili, më 14 mars nënshkroi vendime, të cilat hapin rrugën e përfitimit të bursës për 10 (dhjetë) shpresat olimpike dhe paraolimpike.

Bursa me vlerë monetare prej 150 euro në muaj, në një periudhë njëvjeçare nga janari i vitit 2018 do t’u ndahen sportistëve Shpat Zeka, xhudo, Laura Fazliu, xhudo, Drenis Mala, shigjetari, Kreshnik Mahmuti, ping-pong, Leart Osmanaj, atletikë, Faton Shurdhaj, skijim, Erdonis Maliqi, boks, Shpejtim Bojku, boks, Drilon Syla, mundje dhe Yll Cenaj, karate. Është kjo një mbështetje direkte financiare nga ana e ministrisë për sportistët në fjalë, në mënyrë që ata të përgatiten dhe të avancohen në sportet me të cilat merren. Inkurajoj ministrin Gashi që të vazhdojë edhe më tutje mbështetjen e sportistëve kosovarë, të cilët në vitet e fundit Kosovën e përfaqësuan me krenari e dinjitet në arenën ndërkombëtare.

Të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës e dëshmuar më së miri se sporti dhe kultura hap dyer të cilat asnjëherë s’do të mund t’i hapte politika e Kosovës. Andaj, investimi në ta do të duhet të jetë permanent dhe i pakontestueshëm. Bursistëve u uroj suksese në çdo garë dhe të mos ndalen asnjëherë për të kërkuar të drejtën që u takon dhe mbështetjen nga shteti. Ndërsa, ministrit Gashi ia ofrojmë mbështetjen tonë të rezervë që të marrë sa më shumë iniciativa në këtë mandat katërvjeçar qeverisës.

Do të ndalem pak në pjesën tjetër për moralizimin, që u tha shumë për terrorizimin e familjeve që ua kanë bërë deputetët e PDK-së dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kur flasim për familjet, është mirë të mendohet mirë, a kishin familje Milaim Zeka, i cili u torturua live në studiot e Televizionit Klan? Si janë ndjerë vajzat dhe bashkëshortja e tij në ato momente, motrat dhe farefisi i Milaim Zekës? A kishte familje Petrit Selimi, kur në prani të bashkëshortes së tij u

sulmua nga aktivistët e “Vetëvendosjes”? A kishte familje Shasivar Haxhijaj, i cili u nxor nga vetura dhunshëm dhe u dhunua nga aktivistët e “Vetëvendosjes”?

Kam edhe shumë pyetje tjera për të bërë, por ju lutem shumë të mos moralizoni ju që nuk keni moral për të folur, as për familjen, as për shtetin dhe për asgjë tjetër. Thjesht, ju po të kishit forcë dhe fuqi më të madhe, jo që do të na grushtonit, jo që do të na i terrorizonit familjet, por sinqerisht e them nuk do të na linit ta marrim as ajrin e Kosovës.

KRYETARI: Armend Zemaj e ka radhën. Bëhet gati, ju lutem, Adem Mikullovc.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

E kisha dëgjuar një ditë kolegen tonë Blertën duke folur për një sëmundje të fëmijëve me fibrozë cistike. Të jem i sinqertë, nuk kisha dëgjuar më parë për diçka të tillë, sidomos në Republikën e Kosovës. Por, kam takuar prindër të brengosur pa mbështetje institucionale, me kushte të vështira ekonomike, të organizuar në një shoqatë, e të cilët flasin për një numër të konsiderueshëm të fëmijëve me këtë sëmundje, e cila është mistike dhe shumë e panjohur në Republikën e Kosovës.

Po e shfrytëzoj rastin, meqë e kemi edhe ministrin e Shëndetësisë këtu, kur ata kanë paraqitur edhe kërkesë për takim, por mbi të gjitha kanë paraqitur kërkesë për t’ua mundësuar që së paku barnat e tyre të jenë në Listën esenciale. Ballafaqimi i tyre me vështirësi edhe ekonomike, por edhe të sigurimit të këtyre medikamenteve, e vështirëson, përpos emocionit e asaj që prek si prind, edhe në varfëri, edhe në kushtet ekonomike.

Ju kisha lutur, zoti ministër, që ta shqyrtoni këtë kërkesë, duke marrë parasysh koston e këtyre medikamenteve. Njëherësh do të ishte obligim, jo vetëm i Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe i Kuvendit, që në Spitalin e Pediatriisë të rregullohen kushtet, sidomos të kenë një repart të veçantë. Pjesë tjera dhe mundësi tjera, besoj që shteti i Kosovës duhet të gjejë mundësi, edhe buxhetore, edhe financiare, që t’u ndihmojë këtyre njerëzve së paku në atë që quhet Lista esenciale e barnave. Edhe sot ishim të tronditur nga ata titujt bombastikë, kur operatorët ekonomikë mbizotërojnë apo fitojnë mbi çmimet që paraqet mundësia financiare e Ministrisë së Shëndetësisë. Me këto çështje duhet të merren edhe Prokuroria, edhe Hetuesia, dhe njerëzit që me të vërtetë dëshirojnë sundim të rendit e të ligjit në vend.

Kështu që, ministër dhe kolegë deputetë, si dhe anëtarë të Komisionit, sepse jam takuar me anëtarët e komisionit, jam takuar edhe me dy mjekët tanë që janë pjesë e Komisionit për Shëndetësi, të dy doktorë, dhe edhe nga aspekti profesional, por mbi të gjitha nga aspekti moral ju kisha lutur që ta merrni parasysh që këtë çështje ta trajtoni sa më shpejt, pasi është në shqyrtim edhe Lista esenciale e barnave, t’i jepni prioritet edhe kësaj kategorie. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Mikullovc, fjala për ju.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,
Kabinet qeveritar,
Deputetë të nderuar,
Medie,

Unë po dal me një propozim pak më tjetër. Po dal me kërkesën që edhe ne si shtet, si komb, si Republikë që jemi, të fillojmë ta ndajmë pensionin artistik dhe shtetëror.

Në të gjitha shtetet në rajon dhe në Evropë, është shprehur, është zakon, që njerëzve eminentë të kulturës, të artit, të shkencës, u japin beneficione pak më të avancuara, përkatësisht pensione. Kështu për shembull, kroatët i japin dy lloje: pensionin shtetëror, i cili u jepet fizikanëve, kimistëve e njerëzve të lëmenjve të ndryshëm, dhe pensionin artistik, njerëzve të krijimtarisë.

Shqipëria e ka ngritur pension në tri nivele: artist i merituar, artist i popullit dhe nderi i kombit.

Kështu që do të ishte rendi që edhe ne ta caktojmë një pension të tillë. Shikoni, fjala është për një shumë simbolike. Zakonisht këto pensione janë dyfishi i pensionit të rëndomtë, që do ta merrte ai pensionist, por është nder që shteti, Qeveria, po ia di atij krijuesi për faleminderit për veprat që ka krijuar. Po të kisha mundësi, sot t'i ndaj këto shpërblime, këtë lloj pensioni, për shembull do t'ia jepja Nexhmije Pagarushës, , Leze Qenës, Fahri Beqirit, Akil Kocit, Rexhep Qosjes, Sabri Hamitit... njerëzve që kanë lënë gjurmë në art, në kulturë e në shkencë në Kosovë.

Mendoj se nuk është harxhim i madh, ndërsa e kemi borxh ta bëjmë këtë. Nuk po e zgjas më tepër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë do ta filloja së pari prej jush, zoti Mikullovc. Është mirë të krijohet një iniciativë prej 6 deputetëve të grupit parlamentar, të jetë iniciativë ligjore, e pastaj me ministrin bashkërisht, ose nëpërmjet ministrit ta iniciojë ministria. Është në respekt të vetvetes kjo pjesë. Faleminderit!

Sali Salihu... pastaj Avdullah Hoti.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,
Të nderuar qytetarë,

Lidhur me temën që dua të diskutoj, pak u diskutua rreth mishit të importuar prej Belgjikës dhe në njëfarë mënyre u lavdërua pak si shumë Agjencia e Ushqimit, por thënë të drejtën mendoj se Agjencia e Ushqimit nuk është në funksion të kryerjes së detyrës së vet konform ligjit, për arsye

se kjo agjenci prej se ne e njohim dhe prej se është themeluar është ballafaquar me një varg skandalesh, duke filluar prej fidanëve të mjedris, sëmundjeve të kafshëve, grurit për ushqim të kafshëve, qumështit pluhur, vajit të palmës, e kështu me radhë.

Ne si Komision për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e kemi vizituar këtë agjenci. Ata ankohen se nuk kanë staf të mjaftueshëm. Edhe pse e kanë laboratorin të kushtueshëm rreth 5 milionë euro, laboratori nuk është funksional. Njëkohësisht, kur ka mungesë të inspektorëve dhe kur nuk ka staf të mjaftueshëm nuk ka mundësi të bëhet edhe kontrolli i ushqimeve që importohen nga vendet fqinje. Ndërkaq, unë po i përmend vetëm disa raste shumë të rëndësishme që, kohëve të fundit, për shembull, kam lexuar nëpër medie që e kemi rastin e importit të qumështit me antibiotik që do donte të hynte nga tregu i Maqedonisë në Greqi dhe është kthyer nga doganat e Greqisë dhe kurrë kurrkush nuk e di se ku ka shkuar ai qumësht, a është asgjësua në Maqedoni, apo është shitur në Kosovë. Gjithashtu, Kroacia e ka zbuluar një kontingjent me produkte pjekurina të grurit, konkretisht keksë, të cilat kanë elemente kancerogjene dhe gjithashtu nuk dihet se ku kanë shkuar këta keksë, a janë kthyer në poligonin ku s'ka kontroll, sikur është Kosova.

Për mendimin tim, Agjencia e Ushqimit është një ndër agjencitë më të rëndësishme, madje më e rëndësishme se AKI-ja, sepse kemi të bëjmë me shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës. Besoj se të gjithë e dini që shkalla e shtimit të vdekshmërisë nga kanceri në Kosovë është shumë e lartë dhe ende askush nuk ka ndonjë informacion, ndonjë statistikë se nga po vjen dhe pse është rritje kaq e madhe e kësaj vdekshmërie në Kosovë.

Do të kërkoja që Agjencia e Ushqimit, pasi është në kompetencën e Kryeministrit, t'i rritet përgjegjësia dhe të kontrollohet më mirë, t'i ndihmohet në shtimin e stafit, domethënë punëtorët për të cilët ata kanë nevojë - inspektorë, por njëkohësisht Agjencia e Ushqimit të raportojë dhe ta rrisë kontrollin në kufij. Kërkoj gjithashtu nga ministri i Shëndetësisë që të bëhet një analizë se ku janë vdekshmëritë më të mëdha nga kanceri për ta gjetur se nga po vijnë këto sëmundje. A janë në pyetje vatrat ku kemi industri, a është kjo shtrirje në gjithë Kosovën, apo nëse e kemi të njëjtën shkallë edhe në vendet në rajon, për shembull në Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi, për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Avdullah Hoti, pastaj Sami Kurteshi të bëhet gati.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Unë dëshiroj t'i jap disa sqarime për deputetin Zeka, i cili del në foltore dhe pa asnjë përgjegjësi për fjalën publike gjuan akuza nga më të ndryshmet.

E para, kur LDK-ja ka udhëhequr me fondin 3%, pra Qeveria e LDK-së gjatë viteve të '90-ta, nuk ka asnjë dëshmi më të voglën që është keqpërdorur një cent. Ta dini, atëherë nuk ka pasur një sistem kontrollues siç është tash Thesari i Shtetit, ose procedura tjera ligjore, por është udhëhequr plotësisht me rregullore të atëhershme dhe në mirëbesim të qytetarëve dhe të Qeverisë së atëhershme, i cili raport është aprovuar në Kuvendin e Kosovës menjëherë pas luftës.

E dyta, unë nuk e kuptoj zotin Zeka sesi gjuan akuza për një kontratë, që Riinvesti më 2005 apo 2006, kur as Lumir Abdixhiku, as Avdullah Hoti, asnjë prej deputetëve s'ka pasur lidhje me atë çështje. Edhe nëse ka një evidencë më të voglën që gjoja Riinvesti i paska keqpërdorur ato mjete, i ka rrugët ligjore, sepse thirret shpesh në ato procedura ligjore. Le t'i ndjekë ato dhe le t'u shkojë deri në fund këtyre çështjeve, por e lus që të mos gjuajë në ajër kështu fjalë të papërgjegjshme publike.

E treta, kur unë kam qenë ministër i Financave s'ka pasur mundësi, as zoti Zeka, asnjë ministër, asnjë zyrtar, t'i fusë duart në Buxhetin e shtetit. Nëse ndonjëherë është vendosur rregull, kjo ka qenë gjatë qeverisjes Mustafa. Pikë! Këtë e kanë aprovuar institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë FMN-në dhe Bankën Botërore. Edhe ligjin e patëm ndryshuar për t'u siguruar që asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet pa shkuar nëpër procedura të rregullta dhe pa u reflektuar plotësisht në Buxhet.

Ju e dini që kontrata për "Bechtel-Enka", që është nënshkruar në korrik 2014, është nënshkruar pa pasur buxhet të nevojshëm për ta realizuar atë kontratë dhe si rezultat ata që e kanë nënshkruar atëherë e kanë futur një nen të kontratës, i cili thotë që "në rast se Qeveria e Kosovës nuk i përmbush kushtet e kësaj kontrate, pra zgjatet kontrata. Çdo muaj zgjatje e kontratës është një penallti prej rreth 1 milion euro". Nëse ministri aktual i Infrastrukturës e ka nënshkruar tash një aneks-kontratë me x-milionë euro, është çështje e tij. Por, janë të specifikuar edhe penalltitë eventuale, që dalin nga kjo kontratë. Pse? Sepse, kontrata është nënshkruar, duke mos u reflektuar plotësisht në Buxhet dhe ata që e kanë nënshkruar kanë qenë të vetëdijshëm, që s'mund ta realizojnë. Prandaj, kanë futur nene që Qeveria e Kosovës të paguajë penallti.

E fundit, zoti Abdixhiku tha këtu para deputetëve për një kontratë të lobimit për aranzhim të ligjëratave për çështje private dhe, e dyta, me kërkesë të porositësve, gjoja ndihmesë për autorët e biografisë për të shkruar çështje që u kanë interesuar atyre që janë përmendur në biografi.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Sami Kurteshi e ka fjalën. Bëhet gati zonja Lirie Kajtazi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po e ngre një çështje që ka të bëjë me Rregulloren dhe me paraqitjen këtu në Kuvend, me procedurat.

Tash e vërej disa herë që nënkryetarët e Kuvendit paskan të drejtë të dalin e ta marrin fjalën sa herë të duan dhe sa të duan. Unë nuk e di ku shkruan kjo në Rregulloren e Kuvendit. Kjo nuk është e lejueshme, sepse nënkryetari i Kuvendit dhe kryetari i Kuvendit janë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sikur çdo deputet tjetër. Kur e marrin fjalën, duhet të tregojnë edhe se nga cila pozitë e marrin. Po, si nënkryetar i Kuvendit, si kryetar i Kuvendit, nuk ka të drejtë më shumë, as kohë më shumë, që ta marrë fjalën. Edhe nëse e merr fjalën për çështje të caktuara që diskutohen në Kuvend dhe nuk kanë të bëjnë me menaxhimin e mbledhjes, duhet të dalin në foltore këtu. Por, nuk është askund në Rregulloren e Kuvendit, me sa kam mundur unë ta vërej, dhe askund e specifikuar në ligj se kryetari apo anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, nënkryetarët, kanë të drejtë ta marrin fjalën për çështje që diskutohen në Kuvend nga pozita e tyre, sepse pozita është pozitë e menaxhimit të mbledhjes, por nuk është mandej pozitë prej nga bëhen komente dhe prej nga merret fjala për çështje që diskutohen këtu sa herë të duan.

Prandaj, është e caktuar foltorja, ku ata mund ta marrin fjalën për të gjitha çështjet që ngrihen në këtë Kuvend, por jo nga pozita e kryetarit dhe e nënkryetarit. Nënkryetari dhe kryetari, apo cilido qoftë anëtar tjetër i Kryesisë, e ka mundësinë dhe i ka kompetencat ligjore që këto çështje t'i kryejë në Kryesi. Këtë të drejtë ia njeh Rregullorja dhe ligji, por nuk e ka asnjë të drejtë specifike në këtë drejtim në sallën e Kuvendit, dhe jo nga pozita ku janë ulur. Nga pozita ku janë ulur anëtarët e Kryesisë, kryetari dhe nënkryetari, e kanë të drejtën dhe obligimin ligjor për menaxhimin e mbledhjes së Kuvendit, jo për komente politike që kanë të bëjnë me çështje që diskutohen në Kuvend.

Përndryshe, është mirë ta konsultoni edhe një herë Rregulloren, ta shohim. Ne mund ta ndryshojmë këtë, por në momentin e caktuar kjo mendoj se është e palejueshme, është edhe keqpërdorim i pozitës së anëtarit të Kryesisë, qoftë i kryetarit, apo i nënkryetarit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për këshillat, zoti Kurteshi! Sot e kemi Rregulloren dhe është mirë edhe t'ia kufizoni, edhe t'ia zgjeroni vetes si të doni të drejtat, dhe ne jemi të gjithë deputetë. Sot e kemi. Jo, jo, desha vetëm për vëmendje. Sot e kemi dhe e shikoni pastaj bashkërisht. Se po dëshiron të shtojë zoti Kurteshi, po dëshiron të plotësojë. A është kështu?

SAMI KURTESHI: Zoti kryetar!

Unë nuk e kam për atë se si do ta bëjmë Rregulloren. Rregulloren e bëjnë deputetët e Kuvendit. Unë mendoj që me Rregulloren e tashme, kjo çështje nuk i lejon këto ndërhyrje që po bëhen tani. Unë po flas për Rregulloren me të cilën jemi duke punuar. Se si e bëjmë rregulloren tjetër, jemi ne këtu. Kjo është çështja ime që po e ngre. Faleminderit!

KRYETARI: Për vëmendje, sot e kemi. Do ta kisha kërkuar kontributin e secilit, pikërisht në çështjen e Rregullores. Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Deputete,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Dje ishte 15 Marsi, Dita Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Konsumatorit, një ditë që kërkon më shumë vëmendje për ta mbrojtur konsumatorin, sidomos në një vend që në këtë drejtim ka shkarje të mëdha.

Meqenëse dy nga deputetët, zoti Salihu dhe zoti Haxhiu, shtruan çështje të tilla dhe unë isha edhe dje pjesëmarrëse në një tryezë të organizuar nga Forumi i Gruas i LDK-së, ku me të vërtetë e pamë një shqetësim të madh në këtë fushë, prandaj besoj se duhet të forcohet zëri për më shumë vëmendje institucionale për këtë problematikë.

Tani do ta sjell këtu një çështje që ka të bëjë me sigurinë nacionale, meqë seancat tona po shtyhen nga dita në ditë, e kam menduar ta prezantoj edhe më herët. Anëtari i Kryesisë së Bosnjë-Hercegovinës nga Republika Serbe, Mladen Ivaniq, më 5 mars 2018 i ka vizituar manastiret dhe kishat ortodokse në Republikën e Kosovës. Me këtë rast, në deklaratat publike që ka shprehur, ai thotë: “Kosova është dhe çdoherë duhet ta trajtojmë si tonën”.

Mendoj se në kohën kur ende kullon gjaku nga plagët e hapura nga barbaria serbe mbi popullatën e pafajshme të Kosovës, në kohën kur ne ende shënojmë përvjetorët e më se 11 mijë personave të vrarë, pjesa më e madhe e tyre me torturë, në kohën kur ne ende nuk po mund t’i rehabilitojmë rreth 20 mijë gra të dhunuara nga policia, ushtria, po edhe civilë serbë, në kohën kur shteti serb mban të fshehur vendin e më se 1 600 të zhdukurve, të vijë dikush dhe të pretendojë se Kosova duhet të trajtohet si “e jona”, është më tepër se skandal. Është përhapje e urrejtjes nga shtëpia e Zotit, nëse ka mbetur e Zotit? Është e njëjta retorikë me të cilën Kisha Ortodokse Serbe u bë vegël e politikës shfarosëse të Milosheviqit kundër popujve joserbë në ish-Jugosllavi.

Kërkojmë nga organet kompetente të Kosovës që këtë kategori që ka sjellje dhe deklarime armiqësore ndaj Kosovës dhe përhap urrejtje ndëretnike ta vendosë urgjentisht në listën e personave të padëshirueshëm për Kosovën dhe t’i marrë të gjitha masat që parasheh Kushtetuta dhe ligji për njerëz të tillë, të cilët përhapin urrejtje ndëretnike dhe cenojnë apo tentojnë ta cenojnë rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Atëherë, zonja Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe zoti Naser Rugova të bëhet gati.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në rrjetet e organizatave joqeveritare janë bashkuar shumë OJQ, duke përfshirë idenë që në ligj të përfshihen për qasjen e OJQ-ve në të drejtën e shfrytëzimit të tokës, apo pronës komunale.

Bazuar në burimet mediatike, këto OJQ e kanë dorëzuar kërkesën e tyre në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Mbi 50 organizata e kanë nënshkruar këtë propozim për t'u dhënë hapësirë veprimi subjekteve jofitimprurëse në tokat e pashfrytëzuara komunale. Ne si deputetë duhet ta shfrytëzojmë këtë propozim të OJQ-ve duke u dhënë mbështetje atyre. Pavarësisht kritikave që mund t'i kemi edhe në ndonjë veprim apo deklaratë të shoqërisë civile dhe partiakizimeve të mundshme apo edhe pavarësisht paragjyqimeve, që janë ushqyer për to, ne duhet të besojmë dhe të kemi si partnerë shoqërinë civile. Kusht për demokraci cilësore janë edhe organizatat joqeveritare.

Shumë OJQ mbeten pa hapësira të mjaftueshme të veprimit. Kjo lind nevojën e mbështetjes edhe nga shteti, edhe nga komunat, në të drejtën e tyre të shfrytëzimit të tokës së lirë komunale. Natyrisht, ne së pari u japim përparësi bizneseve që nxitin zhvillimin ekonomik, hapje të vendeve të reja të punës, por pse jo edhe mbështetjen e OJQ-ve. Ka shumë OJQ kulturore në komuna të Kosovës, kanë potencial, ka ide e projekte të mrekullueshme, kanë artistë dhe shumë të tjera, por nuk kanë hapësira apo objekte. Pse të mos shfrytëzohen pronat e lira të komunave për qëllime jofitimprurëse? Nëse pronat e lira të komunave shfrytëzohen, ato jo vetëm që ndihmojnë OJQ-të, por edhe e rritin vlerën e vetvetes si pronë.

Ne si deputetë duhet t'i përcaktojmë qartë kushtet, kriteret, kohëzgjatjen e shfrytëzimit të pronës komunale, sepse shpesh ka ndodhur kur njerëzit rrinë gjatë dhe e shfrytëzojnë një parcelë e krijojnë iluzionin se është pronë e tyre, vetëm pse kanë qëndruar kohë të gjatë në to. Por, me ligj duhet të precizohet qartë se si shfrytëzohen ato, për çfarë periudhash kohore dhe rreth pamundësive për të lidhur edhe më vonë kontrata apo konteste juridike.

Këto prona edhe më tutje duhet të mbeten të Komunës. Marrëveshjet me subjekte jofitimprurëse duhet të ripërtërihen më shpesh, e jo për dhënien e hapësirave publike të ripërtërihen më shpesh se dhjetë vjet. Këto hapësira duhet të jepen vetëm me qëllim të dobisë shoqërore e qytetare, nxitjes së demokratizimit të vendit, lirisë së shprehjes, aktiviteteve kulturore e tjerë. Në asnjë mënyrë me këto prona të Komunës apo OJQ-ve të mos e kenë rastin të përfitojnë nga to, pasi edhe me ligj duhet të rregullohet kjo, e këto prona për OJQ-të dhe org...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rugova e ka fjalën edhe Milaim Zeka.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Jemi dëshmitarë të gjendjes së rëndë në shëndetësinë e Kosovës dhe unë sot dua t'i ngre dy çështje.

Çështja e parë është prolongimi, stërzgjatja e procedurave për pacientët e Kosovës, që thjesht bëjnë kërkesë në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar për trajtim jashtë vendi dhe një papërgjegjësi edhe procedurale, por edhe menaxheriale, që këta njerëz për muaj të tërë sorollaten klinikave të SHSKUK-së dhe nuk marrin përgjigje adekuate.

Numri i kërkesave ka arritur deri tani mbi 2 000 që janë në pritje dhe jeta e një numri të madh të këtyre pacientëve që presin shërim jashtë vendit rrezikohet me prolongimin çdo ditë të kësaj problematike.

E dyta, zoti ministër i Shëndetësisë, kemi pasur një rast në medie dhe konsideroj që keni rënë pre e medieve për operimin e një të riu nga komuna e Istogut nga kirurgu dr. Enver Fekaj. Keni shkuar në shtëpinë e pacientit me ushtruesin e detyrës së drejtorit të SHSKUK-së dhe një vartës tjetër. Pacienti nuk ka pranuar që të operohet në Klinikën e Kirurgjisë së SHSKUK-së, është suspenduar kirurgu dr. Enver Fekaj, njëri nga studentët ndër më të mirët në 30 vjetët e fundit në Fakultetin e Mjekësisë. Po ky pacient pastaj shkon dhe operohet në spitalin privat turk, apo s'di kah kanë ardhur këto spitale, në "Milenium", ai i ka kërkuar falje dikush doktorit Enver Fekaj për denigrimin profesional, moral dhe çka u thotë ai fëmijëve të tij tani. Ju lutem, duhet këto gjëra t'i analizoni me kujdes.

Zoti ministër,

Prej se keni ardhur në post vetëm trafiku brenda Qendrës Klinike Universitare është rregulluar. Kam kërkuar buxhet shtesë, kam kërkuar mbështetje edhe politike, edhe institucionale. Unë e di që nuk është lehtë, shëndetësia kosovare është një vakum bukur i madh, por me qasjen që e keni filluar thjesht nuk po i këndohet këngë e mirë sistemit shëndetësor në vend.

Andaj, e keni marrë rolin e zjarrfikësit, vetëm të shuani zjarre, tani është koha e punës dhe jo e 'piarit' për 'selfi'...

KRYESUESI: Zoti Milaim Zeka, po vazhdoj me shkeljen, një minutë e ke. Në emër të grupit, tash në emrin tuaj, në rregull!

MILAIM ZEKA: Më së pari, profesor Avdullah Hoti, ju po mbani konferenca të shtypit çdo xhuma, edhe kur kam folur unë, ti ishe atje duke folur para gazetarëve, po mundoheni ta imitoni të ndjerin presidentin Rugova, kështu që rrini në sallë e dëgjoni çka fola. Asnjë akuzë nuk e kam bërë as ndaj teje, as ndaj Lumirit. Që është vjedhur në Fondin e 3%-shit, e di çdo njeri dhe ekziston një aktakuzë e ngritur, të cilën e ka ngritur njëri nga themelues dhe personaliteti më i madh i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Hafiz Gagica, nuk e kam bërë unë.

Këtu në sallë ka deputetë, po t'i them me emër, është Gani Dreshaj, i cili posedon çekun 25 mijë marka që i ka dhënë atë kohë dhe Fondi në emër të Drenicës ia ka dhënë çdo mërgimtari çekun nga 1000 marka dhe u kanë thënë se do t'ua kthejmë, e nuk janë kthyer asnjëherë, kjo nuk ishte akuzë. Unë thashë, po bashkohemi me ju për të bërë hetime.

Sa i përket "Riinvest"-it. Lumiri fare nuk ka qenë në atë punë kur i ka vjedhur "Riinvest"-i me Agim Çekun, ekziston dosja 3000-faqesh, pyeteni Bedri Hamzën, ka qenë zëvendësministër atë kohë, i kam krejt dosjet, krejt dokumentet, e kam letrën e Ambasadës së Suedisë që ka kërkuar t'u kthehen paratë mbrapsht. Prandaj, unë nuk e di me çfarë logjike mbroni hajninë, unë kam thënë gjithmonë bashkë keni vjedhur, nuk po them që ke vjedhur ti, se s'kam fakte, por si parti politike keni vjedhur bashkë.

Pse nuk u prek, për shembull Xhavit Haliti, kur thashë duhet të hetohet edhe fondi "Vendlindja thërret", se ky s'ka vjedhur, s'e kanë lënë të vjedhë, nuk ka qenë në 'qyngë' të parave. Ti kërceve në hava, jo po na akuzon, unë nuk di të akuzoj. Unë thashë e keni hapur, të bëjmë hetime, këqyr edhe këta të "Vetëvendosjes" qysh rrinë urtë se edhe këta s'kanë vjedhur, a po e sheh, s'ua kanë lënë rendin të vjedhin.

Prandaj, ju lutem, mos më akuzo për diçka që as nuk të fyej, as të akuzova, vetëm thashë t'i vazhdojmë hetimet, i hapim kartat, se kush do të dalë i përzier, ta përcaktojë prokuroria. Por, që ekziston një aktakuzë ndaj Fondit të 3%-shit, më fal, duhet ta hetojmë edhe mënyrën se si është shitur "Dardani Bankë" në Tiranë.

Po thashë de, fondi "Vendlindja thërret", po bashkë duhet të hetohet kush i ka vjedhur, Armend, ke shumë të drejtë, absolutisht. Unë hiq nuk prekna për atë punë.

Prandaj, hajde t'u hyjmë hetimeve e këqyrim kush po dalim gjysmë burra të mirë, se burra të mirë nuk dalim asnjë, por bile gjysmë dikush duhet të mbesë.

KRYESUESI: Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Vetëm një minutë!

Unë prita që deputeti Zeka do të sqarojë, faktikisht ai u distancau prej atyre që tha, nuk e di pse ka problem nëse në themi që me para publike janë organizuar ligjërata në Londër e poshtë e lartë nëpër Evropë, me para publike u është kërkuar personave të caktuar të ndihmojmë autorët e biografisë. Këtë dëshirojmë të sqarohet, tash ai mund të kthehet edhe para 100 vjetëve prapa, sepse po do t'i relativizojë çështjet. Po, ne jemi të hapen të gjitha kartat, pa asnjë problem dhe të ndahet shapi pre sheqerit, burrat e mirë e të këqij, sepse nuk qëndron ajo që të gjithë do të dalim ashtu, ka këtu burra të mirë, ka burra që duhet të japin përgjegjësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Drejtësisë, zoti Abelard Tahiri. Ministër, të kesh parasysh që kanë të drejtë në replikë në fjalën tënde.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Nuk e kam me askënd kësaj here.

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E mora fjalën që t'ju informoj se Ministria e Drejtësisë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka marrë përsipër të nxisë një analizë gjithëpërfshirëse të sektorit të sundimit të ligjit, e cila pritet të harmonizojë përfundimisht parimet, legjisllacionin dhe institucionet përgjegjëse në këtë sektor, në mënyrë që nga ky proces i rishikimit funksional dhe nga analizat gjithëpërfshirëse të formohen konturat e forcimit të bazës së sistemit të drejtësisë dhe të definohet zhvillimi i tij në të ardhmen, brenda një mendësie demokratike dhe progresive.

Pra, mbi këtë bazë, viti 2018 shënon vitin përcaktues, në të cilin institucionet dhe organet e drejtësisë po e hapin debatin për vlerësimin e sektorit të sundimit të ligjit.

Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit është i bazuar në disa prime të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mesin e të cilave janë:

Identifikimi dhe përcaktimi i objektivave strategjike për sundimin e ligjit, me fokus në rritjen e efikasitetit të institucioneve në zbatimin e tij.

Rishikimi i kornizës ligjore që rregullon sundimin e ligjit si dhe të proceseve të bashkëpunimit në mes të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë si dhe vlerësimi i strukturës dhe kapaciteteve të institucioneve dhe organeve me përgjegjësi në sektorin e sundimit të ligjit.

Të gjitha këto prime do të definojnë strategjinë kombëtare për sundimin e ligjit, e cila do të jetë rezultat, pra produkt i këtij procesi.

Për ta filluar një ndërmarrësi të tillë kusht i domosdoshëm është bashkëpunimi ndërinstitucional dhe përkushtimi i plotë i të gjitha institucioneve të përfshira në këtë fushë.

Pra, për këtë, më lejoni t'ju informoj që pjesë e këtij procesi do të jenë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave si dhe Universiteti i Prishtinës, në këtë rast Fakulteti Juridik. Pa dyshim mbështetje të madhe deri më tani kanë treguar Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komisioni Evropian në Kosovë.

Ky konglomerat institucionesh që të jetë pjesë e rishikimit funksional nuk përfaqëson vetëm simbolikën e domosdoshme për ta pasur një proces gjithëpërfshirës, por në radhë të parë përfaqëson përkushtimin e tyre të mirëfilltë që kjo ndërmarrësi të gjenerojë reformën më të madhe dhe më të rëndësishme që është ndërmarrë ndonjëherë në Republikën e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit.

Pra, rishikimi synim kryesor ka analizën e sektorit, në mënyrë që të shteren të gjitha debatet e nevojshme që në fund të këtij procesi ta kemi të qartë se çfarë duhet të bëjmë dhe të kemi përfundimisht një sistem të mirëfilltë të drejtësisë që u përgjigjet nevojat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, zoti Ismajli.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Po dua ta nis me deputetin Zemaj, që e foli çështjen e sëmundjes me fibro cistikë. Realisht më lejoni pak të njoftoj, ne kemi filluar një grup për të bërë një koncept dokument, i cili parasheh 'sëmundje të rralla' që u jep një kosto financiare për ta parë se sa kushtojnë.

Arsyeja kjo është që ne t'ju ofrojmë juve më pastaj, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, një mundësi që ju ta buxhetoni në mënyrë të qëndrueshme dhe ta votoni një buxhet, i cili me të vërtetë një herë e përgjithmonë e largon atë brengë.

Në mënyrën se si janë bërë tani, duke pasur ca kohë prej donatorëve ose duke i dhënë shpresa, ta them, që mund të ndodhë pa pasur një kosto financiare, pa e ditur se si do të ndodhë, ne veç jemi duke u dhënë familjarëve të ndryshëm informata të cilat nuk janë reale.

Andaj, të themi që unë di raste të ndryshme, të cilat përballen me këtë sëmundje, nuk është e lehtë, sepse flasim për familjarët e tyre, flasim për fëmijë të tyre, të cilët përballen me një kosto të madhe financiare dhe për të cilën për shumë kohë Ministria e Shëndetësisë, po i gjithë sektori i shëndetësisë nuk ka pasur mundësi, se s'ka pasur buxhet për t'u bërë zgjidhje.

Tani, jemi në një fazë kur jemi duke planifikuar të gjitha dhe jemi duke vendosur një rregull që financimi të jetë i qëndrueshëm, të mos jetë financim sezonal ose të mos jetë financim për disa persona, po të jetë financim për të gjitha familjet e prekura nga 'sëmundjet e rralla', sepse kështu quhen.

Prandaj, themi në vazhdon e reformave nënkupton edhe financimin e qëndrueshëm për të gjitha shërbimet mjekësore, të cilat janë të nevojshme.

Në këtë raport nuk do të jem i vetëm, do të jemi së bashku me juve si deputetë, pra do ta vendosim në këtë sallë të Kuvendit mbi ligjin e buxhetit për ndihmën financiare që do t'ua japim.

Sot për sot Ministria e Shëndetësisë nuk ka pasur mundësi ta rrisë atë kosto, sepse nuk ka pasur një koncept dokument, ai do të arrihet në gjashtëmujorin e parë dhe më pastaj, do të jemi të gatshëm që të dy palët të përballemi me këtë.

Sa u përket disa rasteve, të cilat i ngriti deputeti tjetër, në rastin e vizitës time në Istog duhet kuptuar drejt.

E para, pacientët kanë të drejtat e tyre, ju hyni në një institucion shëndetësor, i cili udhëhiqet nga personeli shëndetësor, por pacienti ka të drejtat e veta. Dhe, unë e kam mbrojtur etikën profesionale të mijëra profesionistëve shëndetësorë, të cilët çdo ditë kanë punuar dhe punojnë për të dhënë shërbime më të mira. Në qoftë se, çfarëdo lloj profesionisti shëndetësor thotë i kam kërkuar disa para, por kam bërë hajgare, këtu të gjithë profesionistët shëndetësorë i ka nxjerrë në pozitë të keqe, e le më në të gjitha institucionet shëndetësore.

Më lejoni veç pak, nuk ka mundësi të bëhet shaka, të thuash "ia kam lypë, nuk ia kam lypë. Ia kam lypë 3 500 euro, po s'ia kam lypë 3 500 euro". Më fal, ka familje, institucione të mëdha shëndetësore që mbahen me punën e këtyre profesionistëve shëndetësorë, nuk i takon askujt, është etikë profesionale të mos bëhet shaka me një diçka që është shumë serioze. Mënyrën e komunikimit me pacientë duhet pasur të rregulluar me një kod moral etik.

Dhe, unë do ta mbroj secilin pacient, qysh e kam mbrojtur secilin mjek, të cilit i denigrohet integriteti i tij. Unë, po ju tregoj diçka, nuk ka mundësi ta ngremë shëndetësinë duke konsideruar se jemi për një anë ose për tjetrën. Jemi për të dy palët, edhe për profesionistë shëndetësorë, por ata të cilët punojnë në mënyrë të ndershme. Ka disiplinë. Qysh ka mundësi për shërbim mjekësor kur nuk rri prej orës 7:00, rri deri në orën 13:00 e shkon në shtëpi. Jo, kam vënë disiplinë, është e vërtetë, jam marrë me atë punë e kam vënë disiplinë. Nuk ka shërbim shëndetësor pa disiplinë.

Unë e kam vizituar dje pas orës tre, thanë është ndrequr trafiku, po veç trafiku nëse është rregulluar është boll, e janë ndrequr edhe shumë sende, po shlyqyr bile atë trafik e paskemi ndrequr, pra.

Po, unë kam qenë po të ftoj shko në Kirurgjinë Invazive, dje kam qenë në orën 15:30-16:00, është futur një pacient, i cili në orën 16:00, duke u futur brenda familja e vet e falënderonte personelin shëndetësor, jo mua, që sot po jepet një shërbim, i cili nuk ka ekzistuar. Ndoshta ju duket pak, sepse pritjet janë të mëdha, edhe mua më duket pak, çdo mëngjes zgjohem, them ndoshta s'kemi bërë boll, të bëjmë edhe më shumë.

Edhe unë e di që ju jeni aleat i ndryshimit më të madh, gjithë këtu janë aleatë të ndryshimit më të madh. Mirëpo një mungesë e madhe e një sistemi të qëndrueshëm, një mungesë në gjithçka, na ka bërë të punojmë në secilën pikë, t'i hapim ndoshta 50 fronte, në mënyrë që të shohim një ndryshim më të madh, si në sistem të qëndrueshëm financiar, si në sistem të furnizimit të barnave, si në personel mjekësor, të gjitha këto investime do të shihen në muajt e ardhshëm.

Edhe një herë po ju them, do të jem i drejtpërdrejtë, do të jem shumë i qartë. Ju lutem, ta mbrojmë sistemin shëndetësor të gjithë. Nuk ka mundësi asnjë mjek, qoftë akademik, qoftë infermier ose punëtor çfarëdo tjetër, kur është themeluar QKUK-ja, më 1950 e satën, gjenerata e gjenerata kanë punuar aty, nuk i takon askujt të hedhën poshtë, unë kam mundur të isha studenti më mirë, mund të jetë personi më mirë, kirurgu më i mirë, nuk e njoh, nuk e kam njohur, nuk e kam bërë personalisht, nuk e njoh asnjë. Kam thënë se nuk ka reformë shëndetësore pa u ngritur pagat e punëtorëve shëndetësorë. Nuk kemi mundësi t'i lëmë në mënyrën qysh i kemi lënë, nuk ka mundësi. Të gjithë ne duhet të ngrihem i të themi nuk ka mundësi një mjek specialist që futet në operacion, rri tërë ditën në operacion, të paguhet 630 euro, është e padrejtë. Domethënë, jemi të ngritur për ta, për punëtorë shëndetësorë, për pacientë, për gjithë sistemin e shëndetësisë.

Në këtë synim tonin as nuk do të ketë lëkundje, as do t'i bëj favore askujt, po në anën tjetër, as nuk do ta toleroj askënd. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi tri kërkesa për replikë. E para është Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk do ta quaja replikë, duke marrë parasysh temën për çka po flitet.

Asnjëherë asnjë deputet nuk do ta kisha ngritur, po mos ta kisha kuptuar situatën e rëndë të atyre prindërve dhe mënyrën e trajtimit të deritanishëm. Nuk po flas sot, sot ju jeni ministër dhe kërkesat e fundit u janë adresuar juve.

Po më e pakta e mundshme çka mund të bëhet është që t'u sigurohet një repart i veçantë në Klinikën e Pediatrisë, më e pakta, domethënë edhe më e shpejta që do të ishte e mundshme.

Pjesa tjetër, zoti ministër, kur dëgjojmë çdo ditë që hidhen tonelata barna për shkak të kalimit të afateve, kur kemi dëgjuar dhe kemi ngritur nga ky Parlament me mijëra tonë që skadojnë për shkak të atyre kompromiseve që bëhen në mënyrë klandestine dhe korruptive nga ky sektor, atëherë me të vërtetë unë edhe një herë, vetëm nga ana humane po ju lus si prind që ta trajtoni këtë çështje brenda dite, është e vonshme brenda gjashtë muajve dhe përgatitja e koncept dokumenteve.

Tash m'u kujtua që kostoja mujore është 1000 deri 1600 euro për një familje dhe paramendoni cila familje mund ta përballojë në Republikën e Kosovës një kosto të tillë pa dorën e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri do sqarim shtesë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Armend, faleminderit së pari që po e ngre si çështje.

E para, arsyen kur e thashë është për sëmundje të konceptit, 'sëmundje të rralla', ngase ju e ngritët njërën ndër sëmundjet të cilat janë, arsyen pse e thamë është një koncept, për arsye se e ke një familje, domethënë për një sëmundje, mirëpo janë edhe sëmundjet e tjera. Ne duhet t'i trajtojmë në mënyrë të barabartë të gjitha, në mënyrë që t'ua bëjmë zgjidhjen të gjithëve.

Sot ju me siguri e keni një kërkesë nga shoqata, e di që Blerta Deliu po ashtu e ka ngritur para disa dite të njëjtën, mirëpo ka edhe sëmundje të tjera të rralla, të cilat ndoshta nuk kanë arritur ende te ju ose te Blerta ose te një deputet tjetër. Prandaj, na duhet në koncept dokument që t'u qasemi në një mënyrë sistematike të gjithëve, t'ua japim një shërbim që u mungon.

Koston të cilën ju e ngritët, është realitet në Kosovë, jo vetëm ajo kosto, çdo kosto mjekësore, e cila bëhet në Kosovë e ka varfëruar popullin e Kosovës për vite të tëra.

Po më vjen mirë që po e gjejmë një konsensus të përbashkët, ju po thoni që është koha e shkurtër, unë do të bëj çmos që ta zvogëloj atë kohë, po e marr si obligim ta zvogëloj atë kohë, do t'ju njoftoj sidomos juve dy deputetëve, të cilët jeni marrë me këtë çështje, po edhe shoqatën, ta shohim se si është mundësia që t'i qasemi në mënyrë të përbashkët, edhe Kuvendi, po edhe Qeveria, ta bëjmë zgjidhjen sa më shpejt që është e mundur.

Kështu që qëndroj në dispozicion dhe do t'ju njoftoj shumë shpejt për këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar ministër,

Unë si profesionist shëndetësor duhet t'ju them që punën që jeni duke bërë shpeshherë është punë që ndoshta nuk është në nivelin tuaj, ajo është në nivelin e menaxherëve, të shkoni t'i

vizitoni pacientët në shtëpi, të shkoni para dyerve të reparteve, tregoni qysh kanë filluar të bisedojnë me palë.

Nëse i lexoni detyrat tuaja, detyrat tuaja janë politikëbërja, janë strategjitë e shëndetësisë. Ju më së pakti jeni duke u marrë me strategjinë, kah do të jetë shëndetësia në katër vjetët e ardhshme, kah do të jetë shëndetësia në 10 vjetët e ardhshme.

Ju përfundimisht keni hequr dorë nga sigurimet shëndetësore, ajo që është reforma më e madhe në shëndetësi, përfundimisht keni hequr dorë.

Sistemi i informimit shëndetësor është para kolapsit, ju e dini shumë mirë që kanë qenë disa hapa në vitet e kaluara, nuk ka arritur të bëhet sa duhet, por tani sistemi i informimit shëndetësor është duke kolapsuar dhe faktikisht si hallkë e parë e sigurimeve shëndetësore, ajo po dështon.

Dhe tani po merreni me disa çështje të vogla, të cilat janë të rëndësishme, nuk janë të parëndësishme, por ato madhoret, ato reformat e mëdha të gjithmbarshme që duhet të angazhohemi si ju, si ne, si Komisioni Shëndetësor, si deputetë, si institucione shëndetësore, të gjithë që ta bëjmë atë reformën shëndetësore, është duke ngecur dhe kjo është ajo çështje për të cilën ju duhet të dilni dhe të na tregoni neve këtu, e të mos na flisni për disa raste individuale, të cilat janë të rëndësishme, nuk po thotë askush që nuk janë të rëndësishme, por janë dytësore para asaj për të cilën ju jeni të thirrur si ministër dhe si Qeveri që ta bëni, reformën e thellë shëndetësore. Reforma e thellë shëndetësore nuk do të ndodhë me këtë Qeveri, po shihet, sepse nuk i keni kapacitet edhe si Qeveri dhe nuk jeni të gatshëm ta merrni barrën e kësaj reforme për vitet e ardhshme...

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ose sqarim ministri.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Interesant shumë, reforma nënkupton ne të shkruajmë një dokument strategjik shumë të mirë, ta lëmë në raft, të vijmë këtu, të rrahim shuplakë dhe qytetari prapë të mos ketë barna, të mos ketë shërbime, prapë të endet prej barnatores në barnatore, nëpër klinika, më fal, nuk jam për asi reforme.

Unë jam për menaxhim të një sektori, nuk jam për reforma që prodhojnë dokumente e i lanë aty, nënshkruhen e çohet dora në mbledhje të Qeverisë ose ju këtu në Kuvend, e qytetarin prapë ta kemi me shpenzimet më të larta në rajon, shpenzimet më të larta në rajon. Çfarë reforme po të vyen tjetër? Çfarë reforme në qoftë se ti nuk ke krijuar një sistem të qëndrueshëm të furnizimit me barna, po thua ta bëj një koncept dokument të politikëbërjes. Jo!

Ministria e Shëndetësisë ka rënë në kolaps për shkak të mungesës së menaxhimit. Nuk e fajësoj një njeri, kurrë nuk e kam fajësuar një njeri, as sot nuk e fajësoj një njeri, sepse ka qenë zinxhirë

i shumë gjërave. Unë jam duke menaxhuar secilin zinxhirë, me aq sa më lejon kapaciteti im funksional e institucional. Dokumente na i kanë mbushur raftet, krejt dokumente e kam ministrinë.

A e di sa strategjia sektoriale është bërë, po ju punëtorë shëndetësorë, më lejoni një minutë, punëtorë shëndetësorë, ju që jeni këtu, nuk keni infuzione, nuk keni kanellë, nuk ke sistem, nuk keni asgjë, çka po flisni për reforma, çfarë reforme mua më vyen tjetër.

Të gjitha këto thashë i kemi ngritur, nuk kemi gjetur asnjë sistem. E përmende sistemin e informimit shëndetësor, shtatë vjet projekt, shtatë vjet projekt është, ende nuk u bë një hap.

Unë të paktën do të vendos ja andej, ja këndeje, shtatë vjet projekt, është bërë hapi i pilot projektit, pa një vendimmarrje...

KRYESUESI: Edhe një minutë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Fondi i sigurimeve shëndetësore duhet të kuptohet drejt. Nuk ka reformë në shëndetësi, është financim për njerëz, të cilët nuk kanë nevojë t'i marrin dhe Fondin e sigurimeve shëndetësore ju kam treguar që për dy vjet do ta bëj funksional, gjashtë muaj kanë kaluar, më ka mbetur edhe një vit e gjysmë. Domethënë të gjitha këto çka po i them do t'i shihni në praktikë, nuk do të vij me dokumente strategjike të mëdha, por do të punoj për atë popull, i cili sot paguan më së shumti nga xhepi i vet dhe, në anën tjetër, do të punoj edhe për të gjithë punëtorët shëndetësorë t'u rriten rrogat, t'u ndreqën kushtet në punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Konsideroj që edhe kjo çështje ka përfunduar. Zoti Pal Lekaj e ka kërkuar fjalën, më falni, edhe kryeministri. Tash me Palin mund të replikoni.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,

Kryeministër zoti Haradinaj,

Ministra,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Për çështje të ngritura së pari ju falënderoj, deputetë të nderuar, që ma jepni rastin t'ju përgjigjem. Deputetja Emilija Rexhepi e shtroi një çështje me rëndësi jetike për atë anë, rruga siç e quajmë ne në Ministrinë e Infrastrukturës, është ER 115 që ka gjatësi përafërsisht 30 kilometra dhe fillon nga Prizreni deri në Prevallë. Ajo që unë e kam trashëguar është e vërtetë dhe me të drejtë e thoni, që në fushata çdoherë kanë ardhur, kanë bërë tunele, kanë shtruar rrugë, e kanë sanuar gjendjen, mirëpo asnjë veprim nuk është bërë deri më sot. Ne jemi në procedurë dhe unë

shumë shpejt, tuneli lë për të dëshiruar, por ne do ta kemi një fizibilitet, një projekt të sanojmë rrezikun për qytetarët që të bëhet e përdorshme ajo rrugë dhe pa rreziqe për vozitësit.

Prandaj, të jeni të bindur që ne i kemi hyrë me përkushtim, nuk do të ketë tunel, por do të jetë me kaskada që me të vërtetë do të jenë në shërbim dhe do ta heqim rrezikun për qytetarët. Tjetra, po më vjen mirë që LDK-ja është në vendin ku vetëm mund të akuzojë, por që nuk mund të marr veprime që e dëmtojnë buxhetin e Kosovës, sikur që e kanë dëmtuar. E shtrove, zoti shef i grupit parlamentar, ish-ministër i Financave, një çështje që më ka djersitur prej ditëve të para. Jo që e kemi krijuar ne, por e kam gjetur në tavolinë për mosveprimet tuaja. Keni qenë edhe anëtar i Komitetit drejtues ndërministror, keni pasur shumë takime, por asnjëherë nuk keni marrë vendime. Dhe, të jeni të bindur që për çdo cent të taksapaguesve, të qytetarëve të Republikës së Kosovës do të jemi të vëmendshëm dhe asnjëherë nuk do të marr veprime që e dëmtojnë buxhetin e Kosovës apo e dëmtojnë atë bërthamën buxhetore, sikur e keni rrezikuar që buxhetit të Kosovës jo 14.8 milionë, jo 63 milionë, por shumë e shumë më tepër t'i kushtojë për mosveprimet tuaja që janë pluhurosur në sirtarët e Ministrisë së Infrastrukturës.

Dhe, për menaxhimin, po i shihni dëmet, pa përfunduar projekti në Veternik, shikoni muret qysh rrënohen. S'ka nevojë të ndërhyhet hiq, por me punën tuaj, me qeverinë tuaj, i keni këto dëmshpërblime që i kushtojnë miliona Kosovës. Shikoni rrugën në Koshare, pa e bërë një vit është shkapërderdhur. Shikoni murin duke shkuar për Kievë, shikoni dhe sa miliona për mosveprimet, për projektet shkel e shko, kemi ardhur në gjendje ta kolapsojmë buxhetin e Kosovës. Në këtë drejtim unë i kam gjetur të trashëguara, ne kemi 6 muaj qeverisje e projekti i "Bechtel Enkës" i autostradës "Arben Xhaferi", e kemi trashëguar, nuk i keni kryer obligimet për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Prandaj, mos u mundoni ta hidhni fajin diku tjetër, ja pafshi hajrin fajit, por unë nuk do të vër nënshkrim që t'i përmirësojë gabimet tuaja. Dikush do të merret me këto çështje, janë organet e drejtësisë që shumë shpejt do të merren. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Janë tri replika ose tri pyetje shtesë, zoti ministër. Është Haxhi Avdyli, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi dhe Lutfi Zharku. Fjalën e ka zoti Reçica!

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Përsëritje kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Desha ta shtroj një çështje që më bëri përshtypje gjatë këtij debati. Mendoj se u bë një debat shumë i rëndësishëm për shëndetësinë, besoj se ka qenë një debat shumë konstruktiv dhe mendoj që ka qenë një debat më i mirë se ato debatet, të cilat i organizojmë me nënshkrimin e gjashtë deputetëve ose 40 deputetëve.

Do të dëshiroja që edhe deputetët, edhe vetë ministri, zoti Ismajli, ta kenë parasysh këtë që duhet komunikuar me deputetët, por deputetët duhet të ofrojnë zgjidhje që janë të nevojshme për qytetarët. E kemi shëndetësinë ose e kemi pasur një gjendje të rëndë, të mos them shumë gjendje të keqe, ka lëvizje, por do të duhej ne të gjithë bashkarish, opozitë dhe pozitë, që t'iu ofrojmë atë çfarë është e mundur në mënyrë që të dalim nga kjo situatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući, Ja ću samo kratko da se zahvalim Ministru za infrastrukturu, gospodinu Palu, da se zahvalim Vladi Kosova što će ovaj put biti prioritet za naredni period a pre svega da se zahvalim što ste javno izneli podatke kako su, koji su bitni našim građanima da čuju, jer je put Prizren-Rečene-Prevalac zloupotrebljen od prethodnog ministra Rasima Demirija i prethodnog premijera gospodin Isa Mustafa u javnoj, odnosnoj izbornoj kampaniji, i naši su ljudi su bili zloupotrebljeni, a pre svega imajte na umu da stopiranje izgradnje tunela je prioritet, za to što je to erozivno zemljište i za to što su nonstop klizišta na tom području. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zharku e keni fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Ministra të nderuar,

Kryeministër,

Kolegë deputetë,

Vetëm disa sqarime për ministrin Lekaj, për çështjen e rrugës që e përmendi deputetja Rexhepi, gati, ministër, keni folur qysh kam folur unë para një viti, domethënë që kurrë, ato fjalë i kam thënë edhe unë, edhe ju, kështu që s'kemi shumë dallime në atë, përpos asaj që edhe unë kam thënë se do të mundohem dhe ti do të mundohesh, s'kemi kurrfarë dallimi në atë.

Por, çështjen e “Bechtel”-it e keni ezauruar aq shumë që nuk po dua të flas, po duket pyetjen e fundit për rrugë që po pretendoni që janë kryer keq. E para, nuk na ndodhin veç neve rrugët, kishte ndodhur edhe në Amerikë të rrëzohej ura, kishte ndodhur pas gjashtë ditësh të rrëzohet ura atje, është çështje tjetër, por as unë, as ti nuk kemi kompetenca teknike. Nëse duam ta drejtojmë këtë punë, e keni shumë thjesht, e urdhëroni sekretarin të qesë prej pune menaxherin e projektit, t'i shkarkojë apo t'i qesë prej pune anëtarët e Komisionit për pranim teknik, të qiten prej punës apo të suspendohen anëtarët e komisioneve që kanë bërë punë shtesë dhe, e fundit, natyrisht, kompanive që i kanë ndërtuar ato rrugë të mos u jepen kurrë tenderë, edhe kjo punë kryhet.

Ju e tregoni veten si ministër që zbatoni politika të duhura, por derisa ju nuk i merrni këto masa ndaj atyre që kanë faj, nuk keni të drejtë të ankoheni ndaj meje si ministër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Lekaj.

MINISTRI PAL LEKAJ: Zoti ish-ministër, nuk dua të replikoj, por të jeni të bindur që mua më vjen keq kudo që rrëzohen urat, rrugët, kudo edhe në Amerikë, edhe këtu. Por, ne kemi një dallim sa u përket procedurave dhe marrjes së vendimeve. Unë pajtoj dhe ne kemi ngritur komisionin prej ekspertëve dhe pasi të marr konkluzionet e tyre, unë do të marr veprime. Mirëpo, ajo që më ka shqetësuar, pa u pranuar rruga, duke u ndërtuar, po rrënohen muret dhe kjo është diçka një dallim shumë rrënjësor. Unë e di që ju nuk jeni marrë me çështje teknike, as unë nuk merrem, mirëpo duhet ta dimë që ne kemi përgjegjësinë si Qeveri e Kosovës që të kemi standarde tamam që përputhen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje, e keni fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Ja ću samo kratko, što se tiće puta za Rećane, hoću ovim putem javno da se zahvalim i bivšem ministru za kojem smo započeli kod koga smo odneli zahtev, i tadašnjem ministru koji je isto tako bio da se slika sa nama na putu, pre par meseci, to jeste od jedan naj rizićnijih puta ovde u Kosovu i zahtev moje koalicije i g. Rasim Demiri kao ministri stoji tamo već možda više od dve godine.

Idejni projekat je ministar završen, ja mislim da to znate, i za to smo zaslućni mi koji smo pravili polićićku prisiju i na prethodnu vladu, i na vas sad ovde, oćekujem od vas kako ste nam obećali da će taj put poćeti da se realizuje.

To što je do sada nije ništa realizovano, ne znaći da mi nismo bili aktivni, nego odgovor Vlade je bio takav kakav je do sada, znaći moja koalicija Vakati zajedno sa ministrom Rasimom Demirijom nikad nije prestao da traći taj put, ta inicijativa je bila naća i nadam se da ćemo uz vaću pomoć ovog mandata zavrćiti to. Hvala vam puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sali Zyba e ka fjalën.

SALI ZYBA: Përshëndetje!

Nga zoti Leka nuk kuptuam dallimin deri tash prej funksionimit qoftë të qeverisjes, qoftë investimeve kapitale, sidomos për autostradën që u përmend. Gjendja në autostradën ekzistuese nuk është e mirë për të krijuar investime, e sidomos investime të paqëlluara, në faktin që ka vazhduar e njëjta mendësi e qeverisjes, i njëjti investim, me shpenzime të shumëfishta, edhe më të mëdha ndoshta, në disa raste, e në veçanti me kompaninë e njëjtë dhe me mundësinë që nuk iu është dhënë konkurrentëve të tjerë. Andaj, zoti Lekaj, këtu pati një bisedë me LDK-në, por nuk

pati një sqarim për qytetarët çka është dallimi te autostrada juaj që po e ndërtoni, qoftë në secilin prej akseve, qoftë me gabimet që i ka bërë, e në veçanti po flas për mirëmbajtjen, për gjendjen që e ka, për sanimin e dëmeve që janë shkaktuar në autostradë.

Ndërsa, për ministrin e Shëndetësisë, i cili për rastin që ka qenë në KTV, që e përmendi kolegu më parë, ne e kemi parë edhe vizitën e tij te pacienti. Pacienti, i cili është trajtuar në mënyrën që është trajtuar, ne e kemi prej stories të KTV-së, kemi pamje, kemi deklarin e të dëmtuarit për mënyrën dhe për korrupsionin. Ndërhyrja apo vizita e ministrit te pala, në këtë rast, te pacienti, e kemi parë edhe atë publikisht, por na sqaron ministër, a ka procedurë zyrtare, meqenëse kolegu u ankua për pasojat që i ka pësuar në këtë rast profesionisti shëndetësor, por për palën nuk e dimë procedurën. A ka procedurë penale apo ndërhyrja juaj në këtë rast te pala është ndërhyrje edhe ligjore?

KRYESUESI: Ne nuk kemi hapur debat për të gjitha çështjet, ne ia kemi dhënë fjalën, për çështjet që i kanë ngritur ministrat, mund të bëni replikë, në qoftë se s'pajtoheni, por tash të hyjmë në debat, thirrini ministrin, thirrni ministrat në debat, është e drejta juaja dhe zhvillojmë debat. Thirrni në interpelancë, keni të drejtë edhe më shumë, sepse keni dy herë nga dhjetë minuta. Këto janë rregullat në Parlament, se e kemi tejkaluar çdo normë të asaj pikës së parë që e kemi të ndryshme, kështu që unë mendoj që mjafton me kaq. S'e di, Ganja, e ka edhe kjo një pyetje. Në rregull, Ganimete Musliu e ka një pyetje.

GANIMETE MUSLIU: Zoti kryesues,

Desha të them çfarë kuptimi ka që ne të bëjmë pyetje parlamentare me shkrim, kur prej një shkurti pres që t'ia drejtoj një pyetje ministrit, ndërsa ne po fillojmë sot me pyetje parlamentare direkt, tjetër herë nuk marrim mund të shkruajmë, po i pyesim direkt ministrat në seancë. Prej një shkurti prej që t'ia drejtoj një pyetje ministrit të Shëndetësisë.

KRYESUESI: A të ka ardhur ministri, po? A është këtu ministri? Atëherë, konsideroj që këto çështjet e ndryshme sot ishin të gjata, pothuajse për gati një orë e gjysmë më shumë kemi zhvilluar debat dhe kemi biseduar. Nganjëherë është mirë, ndoshta, kështu të bashkëbisedojmë, por me afat më të shkurtër, me minutazh më të vogël.

2. Koha për pyetje parlamentare

I dimë rregullat të gjithë, deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kryeministri nuk është këtu. A do ta presësh, ku është zonja Nagavci? As kjo s'është këtu!

Deputetja Drita Millaku, pyetje për zëvendëskryeministrin Behgjet Pacolli, zonja Millaku, a doni ta bëni pyetjen? Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Meqenëse nuk është ministri dhe zëvendëskryeministri, atëherë e lëmë në momentin kur të jenë këtu.

KRYESUESI: Në rregull! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Skender Reçica.

ISMAJL KURTESHI: Po i lexoj, se prej dhjetorit i kam këto pyetje, po u kalon aktualiteti.

Zoti ministër, shumë kontributdhënës që kohët e fundit po pensionohen, nuk po marrin pensione, sepse nuk i kanë 15 vjet të plota përvojë pune para lufte. Shumë prej tyre këtë kusht nuk po e plotësojnë për disa muaj, ka raste që u mungojnë vetëm disa ditë. Këtyre qytetarëve po u humbin 13, 14 e më shumë vjet kontribute për disa ditë. Pyetja ime është kjo: në cilin ligj po e bazoni mohimin e të drejtës për pension të këtyre qytetarëve që kanë paguar kontribute për shumë vjet?

KRYESUESI: Zoti ministër Reçica, e keni fjalën!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

I nderuar deputet Kurteshi, çështjen e pensioneve kontributpagues e kemi identifikuar menjëherë me të marrë mandatin, por para se të flas për masat që do të ndërmerren, po ju prezantoj në mënyrë kronologjike se si ka rrjedhur procesi i sistemit pensional në Kosovë, veçanërisht atij kontributiv.

Sistemi pension në Kosovë ka pasur ndërprerje të plotë në fund të vitit 1998, dhe deri në vitin 2001 pensionet në Kosovë nuk janë trajtuar me ndonjë ligj apo dhe rregullore të veçantë. Kështu që në dhjetor të vitit 2001 UNMIK nxjerr Rregulloren 2001/35 mbi pensionet në Kosovë, ku trajton vetëm pensionet obligative, të cilat kanë përfshirë dy forma të pensionit: pensionin bazë dhe pensionet e bazuara në kursimet individuale, në bazë të së cilit nuk është paraparë pension kontributiv ose nuk janë njohur kontributet e paraluftës. Në vitin 2007 është nxjerrë Udhëzimi Administrativ nr. 11/2007 për zbatimin e Vendimit nr. 13/277 të Qeverisë së Kosovës, i cili ka pasur për qëllim rritjen e shumës së pensioneve dhe në nenin 3, të këtij udhëzimi janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme për përfitim në rritje të pensionit bazë.

Shfrytëzuesit aktualë të pensionit bazë dhe personat, të cilët në të ardhmen do të aplikojnë për këtë pension, për të përfituar këtë rritje, sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 13/277 duhet përmbushur këto kushte dhe kriteret e përgjithshme, po citoj: “Parashtruesi i kërkesës duhet të ketë moshën 65 vjet dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional” dhe këtu ka qenë pikënisja e ndarjes së pensioneve në bazik dhe atë kontributiv. Gjithashtu, edhe Udhëzimi Administrativ 15/2009 për rritjen e pensioneve për zbatimin e Vendimit të Qeverisë nr. 02/51 neni 3, kushtet dhe kriteret

e përgjithshme për përfitim në rritje të pensioneve bazë, pika 1.1. po citoj: “Parashtruesi i kërkesës duhet të ketë moshën 65-vjeçare dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional”. Në vitin 2014 është aprovuar Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe po ashtu me këtë ligj, sipas nenit 3, pika 1.5. citoj: “Pensioni kontributpagues i moshës, pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar në Republikën e Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 1 janar 1999, sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor nr. 011-24/083...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe dy minuta ministrit.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Gazeta Zyrtare e KSAK-së numër 26/83, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj dhe neni 8, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës, pika 1, 1.1., 1.2. dhe 1.3., po i citoj: “Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: pika 1.1. ka mbushur moshën 65-vjeçare, pika 1.2., duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor numër 011-24/83 Gazeta zyrtare e KSAK-së 26/83 para datës 1 janar 1999 dhe pika 1.3., që ofrojnë dëshmi të vlefshme për pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor”, po e citoj përsëri Gazetën Zyrtare KSAK 26/83, para datës 1 janar 1999.

Sido që të jetë, ky kriter ka penguar shumë qytetarë të Republikës së Kosovës për të gëzuar pensionin kontributiv dhe këta qytetarë që këtë kriter nuk kanë arritur ta përmbushin për disa muaj, por ka edhe raste kur këtë kriter nuk kanë arritur ta përmbushin edhe për disa ditë. Si ministër kam takuar dhe kam marrë shumë shkresa nga qytetarët, kemi analizuar legjislacionin në fuqi dhe kemi vërejtur se vendit i duhet një reformë pensionale, ku do të përfshiheshin një ligj të përgjithshëm të gjitha skemat pensionale. Gjithashtu, në këtë reformë, për hir të rrethanave të kaluara dhe njohjes së kontributit të atyre qytetarëve, të cilët pa dëshirën e tyre kanë qenë pjesë e largimeve nga puna dhe nuk kanë mundur që për një periudhë të shkurtër të kenë 15 vjet kontribut të paguara ose sigurim pensional, ky prag të rivlerësohet, por janë duke u analizuar edhe modalitetet të tjera, së bashku me ekspertë të fushës dhe kjo do të konsiderohej një paqe e madhe sociale dhe një njohje e djersës së derdhur të pensionistëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zoti Kurteshi, pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, ministër, që m'i cituat të gjitha këto ligje, por esenca është kjo: Njerëzit që i kanë pa një ditë 15 vjet nuk ka të drejtë kurrkush t'ua mohojë kontributin dhe

kjo është shkelje e të drejtave të njeriut, është padrejtësi dhe këto ligje duhen të rregullohen dhe duhet t'u jepet njerëzve pension për atë që ka kontribuar. Ai që ka kontribuar 14 vjet, jepja për 14, ai që ka kontribuar për 8 vjet, për 8, por jo nëse ke kontribuar 15 e merr të plotë, nëse ke kontribuar 14 vjet e 364 ditë, nuk merr hiç! Kjo është diçka që duhet shpejt të eliminohet dhe kjo reformë duhet të ndodhë sa më shpejt, sepse njerëzit sidomos ata të moshës për të cilën po flasim, nuk kanë edhe shumë kohë të presin.

Prandaj, ministër, a po e kuptoni që në këtë formë po e shkelni një të drejtë elementare të njerëzve dhe po u bëni njerëzve padrejtësi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Zoti deputet,

Si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk po bëjmë asgjë, por po zbatojmë një ligj, i cili rregullon skemat pensionale të financuara nga shteti që është miratuar nga ky Kuvend në vitin 2014. Dhe, unë e them, ky Kuvend në vitin 2014 ka pasur mundësi këtë padrejtësi që ne sot bashkarish të gjithë po e kualifikojmë kështu ta përmirësojë, nuk është bërë. Ne e kemi trashëguar këtë situatë dhe me të marrë mandatin kemi filluar dhe kemi konkluduar tashmë që këtij vendi i nevojitet një reformë pensionale dhe nuk është e lehtë të bëhet kjo.

Ne në agjendën legjislative të këtij viti e kemi paraparë dhe jemi duke punuar, tashmë grupi punues ka mbajtur disa takime dhe kemi filluar të nxjerrim në tavolinë ide dhe analiza se si do t'ia bëjmë me reformën e sistemit pensional në Kosovë. E dimë që nuk është e lehtë, e dimë që është shumë punë për të bërë, por jemi duke punuar në këtë drejtim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Arbërie Nagavci, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti Haradinaj, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, më 22 janar 2018, e keni filluar me një minutë heshtje për vrasjen e Oliver Ivanoviçit në Veri të Mitrovicës dhe vdekjen e veprimtarit Jonuz Musliu.

Derisa Jonuz Musliu ishte veprimtar i njohur, komandat i Ushtrisë Çlirimtare në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc, Oliver Ivanoviç ishte i dënuar me nëntë vjet për krimet e luftës të kryera gjatë viteve 1999-2000, ndaj popullatës civile shqiptare. Pra, ishte një kriminel. A mund të na tregoni, zoti kryeministër, a ishit në njohuri të veprave për të cilat u shpall fajtor Oliver Ivanoviç, pra se ai kishte urdhëruar vrasjen e shqiptarëve civilë në Mitrovicë më 14 prill 1999

dhe, po ashtu a mund të na njoftoni se çfarë keni ndërmarrë për të zgjidhur rastet e personave të pagjetur kur dihet se akoma edhe sot mbi 1 500 shqiptarë janë të zhdukur.

Po ashtu, a mund të na tregoni, ju lutem, se sa këshilltarë keni në Kabinetin qeveritar dhe cili është profili profesional i tyre, sepse ishte dashur që së paku ata të ju këshillonin për veprimet tuaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar zonja Nagavci, deputete Nagavci, Në hapje të mbledhjes së Qeverisë së vendit, atë ditë e pushë një ngjarje tragjike, që e ka shokuar Kosovën, vrasjen e një kandidati për kryetar komune. Pra, në bazë të ligjeve në fuqi, të njëjtat ligje me të cilat ulemi edhe në këtë Parlament, edhe në komuna, me të njëjtat ligje është zgjedhur zoti Haskuka kryetar komune në Prizren, e zoti Oliver Ivanoviq ishte kandidat për kryetar komune. Kjo është e vërteta e ligjeve dhe e realitetit tonë. Sikur ai të kishte qenë i dënuar në shkallën finale, a të prerë, apo si quhet ajo, me siguri se s'do të mund të kandidohej.

Tani ne mund ta shohim nga cilado perspektivë, por realiteti është ky. Me këto ligje që i kemi në Qeveri, në Parlament, që jemi zgjedhur... në bazë të këtyre ligjeve ai ishte një kandidat komune, i vrarë në mënyrë tragjike. Ishte lajm tronditës për Kosovën, për opinionin ndërkombëtar, për komunitetet besoj, edhe sjellja e Qeverisë së vendit në këtë rast me një nderim për një kandidat për një kryetar komune që s'do të kishte fituar, nuk besoj se është ndonjë shkelje, ta quaj ashtu, e ndjenjës shqiptare, të traditës, respektit apo çfarëdo qoftë, ose të ligjeve, ose... Mund të jetë e pëlqyeshme apo e papëlqyeshme dhe ka çfarë të thuhet, se unë e di që ka pasur pikëpamje të ndryshme për sjelljen e tij në të kaluarën, ose për proceset gjyqësore të papërmbyllura dhe nuk po hyj më shumë në debat, por kjo është e vërteta pse e kemi bërë. Njëkohësisht, respekti i Qeverisë së vendit për zotin Jonuz Musliu nuk është praktikë e zakonshme, po ai e kaloi një periudhë të vështirë në shërim, e kërkoi ndihmën e Kosovës, ishte njëfarë periudhe e çuditshme dhe ishim të involvuar dhe ia dhamë atë kujdes atij. Mendoj se ajo është në rregull, dhënia e kujdesit dhe e nderimit, por nuk do t'i bënte analogji njërit dhe tjetrit, se janë perspektiva tjera.

Te numri i këshilltarëve, për besë nuk e di saktë sa janë, por me siguri në ueb-faqe të Zyrës së Kryeministrit janë të gjithë, profilin e kanë, nëse s'i kanë vënë në ueb-faqe do t'i obligoj t'i vënë. Disa janë këshilltarë me pagesë, disa janë pa pagesë, të jashtëm. Shumica e tyre janë njerëz të cilët e hetoj një interesim për t'i përkrahur agjendat e Qeverisë e të vendit. Është praktikë e qeverive për të marrë edhe këshilltarë të huaj, pra ekspertë e njerëz, por nuk kemi marrë ende. Mua më kujtohet kur në vitin 2004 kam pas huazuar njerëz prej USAID-it, prej UNDP-së, prej OSBE-së, pra Qeveria Amerikane ka pas paguar. Kësaj radhe ende jo, por e marrim përkrahjen e USAID-it, pra na këshillon USAID-i, na këshillojnë edhe mekanizmat tjerë. Pagat i kanë shumë

të ulëta, siç e dini, janë vërtet paga jo të dinjitetshme për ta këshilluar një kryetar qeverie me një pagë çfarë është, gati e pakuptimtë.

A ishin tri? A është e gjitha kjo? Më falni! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Nagavci? Regjia!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Zoti kryeministër,

Pyetja ime për këshilltarët kishte të bënte me faktin se edhe nëse ju nuk keni qenë i vetëdijshëm për veprimin që e keni ndërmarrë, është dashur të ju këshillojnë këshilltarët tjuaj. Pra, nuk kemi asgjë kundër. Mendoj se keni bërë mirë që e keni nderuar zotin Jonuz Musliu, por problemi është se nuk mund ta nderoni në të njëjtën kohë një veprimtar të çështjes kombëtare dhe një person të dënuar për vrasjet e shqiptarëve civilë në Mitrovicë.

Pyetja tjetër kishte të bënte me atë çfarë keni ndërmarrë për t'i zgjidhur rastet e personave të pagjetur, sepse akoma edhe sot mbi 1 600 shqiptarë janë të zhdukur dhe kjo asnjëherë nuk ka qenë temë e bisedimeve ndërmjet Qeverisë sonë dhe Qeverisë së Serbisë.

KRYESUESI: Zoti Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Më falni se pjesën për të zhdukurit nuk e përfshiva, sepse s'desha ta lidh në këtë kontekst. Thënë të drejtën, s'po di se si lidhet çështja e të zhdukurve, e këshilltarëve, e Ivanoviqit, edhe e Jonuzit. Ndoshta ti e di më mirë, zonja Nagavci. Unë e di çështjen e të zhdukurve, se jam i një zone ku ka shumë të zhdukur. Jam marrë me ta prej ditës një të asaj kohe deri sot, është detyrë e çdonjërit, jo vetëm e shqiptarit, por e çdonjërit që jeton në këtë vend. Për kohëzgjatje me ju sot, por s'jua kam sjellë atë raport, nesër me siguri jua prezantojnë. E kemi përgatitur një raport se çfarë ka ndodhur me çështjen e të pagjeturve. Zoti Jahja Lluka besoj që gjatë ditës së nesërme e prezanton. Është një punë intensive që po e bëjmë në këtë temë.

Ndoshta jeni në dijeni që ka plot mbetje mortore të pidentifikuara në Kosovë. Ministri është këtu. Po punojmë për aftësimin e Institutit për Forenzikë e gjumëçka tjetër.

Sa i përket kësaj të Oliverit dhe të Jonuzit, unë e respektoj çdo njeri që ka parime e bindje, veç falsin s'e marr vesh, për besë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelal Sveçla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër,

Deri më tani janë mbajtur katër mbledhje të përbashkëta ndërmjet qeverive të Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë. Nga mbledhja e fundit, e mbajtur në Korçë, më 27 nëntor 2017, ju njoftuat se u nënshkruan 12 marrëveshje. Pyetja ime është kjo: Deri ku kanë mbërritur përgatitjet për jetësimin e tyre dhe a mund t'ia përcillni për informim Kuvendit, deputetëve, tekstet e plota të këtyre katër marrëveshjeve dhe tetë memorandumeve, si dhe marrëveshjet e nënshkruara nga Qeveria Mustafa dhe Qeveria Thaçi me Republikën e Shqipërisë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kapaciteti qeverisës për të punuar bashkë me Republikën e Shqipërisë ekziston, por nuk është aq në zbatim. Nuk ka ndodhur mjaftueshëm në të kaluarën dhe mendoj se as tash jo. Ekziston një ndjenjë e mirë, ekziston një vullnet i madh, ekziston një... por, praktikisht, po e quaj ashtu, çalon në disa aspekte.

Të gjitha marrëveshjet që janë nënshkruar që atëherë e deri sot është dashur ndoshta, nëse s'kanë arritur deri tash, të arrijnë në Parlament që t'i ketë Parlamenti. Do të kërkoj që t'i drejtohen me shkresa që t'u vijnë deputetëve. Ndoshta kërkohet evaluim i brendshëm, se pse ngec zbatimi i të dy qeverive, nuk mendoj vetëm i Kosovës, edhe i Qeverisë së Shqipërisë, e do një vlerësim të brendshëm pse ngec zbatimi.

Është hapur shumë debat për heqjen e Doganës në Morinë dhe për vendosjen e saj në Durrës. Për shembull, nuk ka njeri që s'ka qejf që ketë sa më pak ndalesa, jo vetëm pse jemi shqiptarë andej e kënde, me respekt edhe për komunitetet që jetojnë këtu, edhe atje, por heqja e ndalesave ekonomike, e ka thënë në një rast kryeministri Rama, që janë qindra vjet pritjeje brenda një viti për ekonominë. Edhe ne jemi për, mirëpo kishte disa implikime buxhetore për Kosovën. Duhej të bëhej një përgatitje se si të mbulohen ato implikime, realisht humbje, mungesa e të hyrave, e duhet punuar. Por, mendoj se është në interesin e Qeverisë sonë, e deputetëve dhe të gjithë neve, që marrëveshjet e nënshkruara, ose rëniet dakord, t'i zbatojmë, por edhe të punojmë për marrëveshjet tjera. Në këtë kontekst, jemi duke e llogaritur edhe në një mbledhje me Qeverinë, tash po dal prej teme ndoshta, më falni, me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Ka interes të madh për të shkuar përpara në zbatim. Pra, nuk është se nëse thellohet bashkëpunimi Kosovë – Shqipëri, kjo nuk është e drejtuar kundër dikujt, qoftë në rajon, qoftë më larg. Përkundrazi, është në të mirën e të gjithëve sa më shumë që të ketë bashkëpunim Kosovë – Shqipëri dhe sa më shumë që fokusohen dy qeveritë në këtë bashkëpunim është në të mirën e gjithë rajonit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Sveçla?

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryeministër!

Republika e Shqipërisë e ka hequr lejen e punës për qytetarët e Republikës së Kosovës atje. Kur do ta bëni ju të njëjtën, për shkak se është një rezultat i marrëveshjeve që u përmendën më herët?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nuk kam arritur mjaftueshëm dhe kërkoj falje që s'kam arritur mjaftueshëm të hyj në thelb të kësaj që po diskutojmë, jo se s'më intereson, por ne morëm plot tema. Ajo që më ka bërë përshtypje shtetasit e Shqipërisë, qytetarët e Shqipërisë në Kosovë kanë edhe probleme të qëndrimit. Pra, më zor ishte të marrë njëfarë procedure të qëndrimit një shtetas i Shqipërisë se kushedi tjetër, gjë kjo që është bukur e pakuptimtë.

Kam pasur raste të shumta që i kanë shfaqur këto shqetësime, që është gati kundër të drejtave të njeriut, jo të drejtave të përkatësisë etnike, që jemi andej e këndeje, por është një absurd i madh dhe mendoj se brenda nesh edhe Ministria e Rendit dhe mekanizmat tjerë duhet t'i shqyrtojnë këto menjëherë. Ne e kemi të njëjtin problem edhe me qytetarët e Luginës. Edhe ata janë... pra kalojnë nëpër një terror, ta quaj ashtu, administrativ, për të mundur ta zgjidhin një problem të punës, a të biznesit apo të jetës, gjë edhe kjo që është pakuptimtë.

Mirëpo, mendoj se shumica e këtyre procedurave do të duhej të shkojnë me target, pra të mos merret një procedurë standarde, që për të gjithë të krijohet kategori specifike. Atyre kategorive të qytetarëve që jetojnë këtu, ose që operojnë, ose veprojnë, ose duan të punojnë këtu, pra të mund t'u krijohet një procedurë më efektive e që t'u zbatohet një e drejtë, pra e drejta në leje të punës, në leje të qëndrimit, ose edhe në shtetësi. Pra, kemi folur për këtë, meqenëse funksionojmë dy shtete, atëherë bën të aplikohet edhe kjo, pra t'i jepet shtetësia atij qytetari që do ta plotësonte një procedurë, por që nuk është e ekzagjuar.

Aktualisht janë procedura shumë të vështira, kohëzgjatja shumë e madhe, kalojnë nëpër shumë pengesa. Ke, për shembull, fëmijë të qytetarëve të Preshevës që kanë lindur në Kosovë, por për shkak se të dy prindërit i ka të Preshevës ka probleme të jashtëzakonshme në ekzistimin e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është Albulena. Deputeti Sami Kurteshi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

SAMI KURTESHI: Jo, Sami Kurteshi nuk ka pasur ndonjë pyetje, veç paska ardhur gabim.

KRYESUESI: Në rregull, unë e kam të regjistruar. Zoti Shemsi Syla, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është Shemsi Syla. Zonja Fitore Pacolli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është Fitorja. Deputeti Imet Rrahmani pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Ah, po, Fitore Pacolli. Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryeministër,

Në Marrëveshjen e 26 gushtit 2015, të nënshkruar në atë kohë nga ministri i Jashtëm Hashim Thaçi dhe ministri për Punë të Brendshme, Skënder Hyseni, shënohen të detajuara koordinatat e vijës kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës. Për këto koordinata dhe çështje të tjera, Komisioni Shtetëror, i drejtuar nga profesor Shpejtim Bulliqi, e ka paraqitur raportin, ku theksohet se ato koordinata janë të gabuara dhe se Republika e Kosovës humb 8 200 hektarë. Pyetja është: Cilat koordinata i njeh Qeveria aktuale e Republikës së Kosovës, ato të marrëveshjes së përgatitur nga Komisioni i drejtuar nga zoti Murat Meha, apo koordinatat të cilat janë paraqitur në raportin e Komisionit Shtetëror, të drejtuar nga Shpejtim Bulliqi? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, zonja deputete Pacolli!

Do të thotë, marrëveshja e parë, ju e dini ka hasur në kundërshtime të Komitetit të Ekspertëve dhe të ne disave në politikë. Për fat, me zhvillimet e mëtejme të Qeverisë është krijuar mundësia që të trajtohet edhe një herë, që është gati një precedent që të trajtohet edhe një herë materia. Komisioni Shtetëror i Republikës së Kosovës është i kryesuar nga Bulliqi, por ai s'është i Bulliqit, më duhet të them disa herë, është i Kosovës, është yni, i juaji, e ka përgatitur një raport me të gjetura, ose me aq sa ka mbërritur të bashkojë të dhëna për gjendjen reale të demarkimit, ose të shënimit të kufirit, për mundësitë që ky material i jep.

Tani kjo është edhe arsyeja pse Qeveria e vendit i ka propozuar Parlamentit, faleminderit për respektin tuaj, që kur e votojmë marrëveshjen në fjalë, të cilën ju e cekët dhe e cila është pjesë e ligjit, pra është i pari dokument, në pikën 3 e kemi të theksuar, që në pikën 2 po ashtu të këtij ligji, pra në pikën 2 të nenit 3, ose amendamenti 3, pika 1.2, të jetë edhe raporti i Komisionit Shtetëror. Mirë është që ky raport të respektohet, s'ka nevojë të zbehet fuqia e këtij raporti në këtë dokument. Nuk i bën sherr askujt, nuk bën dëme, vetëm e mundëson, nëse eventualisht, po them unë që po e zëmë që kanë pasur të drejtë nënshkruesit e marrëveshjes së parë, por nëse eventualisht ka të gjetura faktike, pse të mos ua lëmë mundësinë që të vijë në shprehje, dhe kemi marrëveshjen e dy presidentëve.

Tani, pyetja juaj është bukur precize, cila vlen për ne? Ne mendojmë se fakti që e kemi marrëveshjen e dy presidentëve, pra e kemi arritur njëfarë konsensusi që të gjithë bien dakord për korrigjim në drejtimin Çakorr dhe Kullë, pra në majat e larta, kjo është edhe arsyeja që ju lus

edhe ju, të nderuar kolegë deputetë, dhe vërtet e them këtë jo nga pikëpamja e një pushtetari, por nga pikëpamja e atij që nga dy pozicionet e ka parë këtë temë, atij që e ka kundërshtuar në vazhdimësi dhe atij që sot e paraqet para jush, që ta përkrahim këtë ligj.

Pse po ju them ta përkrahim këtë ligj? Janë dy argumente. Nën 1, baza e materies për korrigjim është sforcuar, ekziston, marrëdhëniet ndërkombëtare, praktikat qysh t'i korrigjojmë veprimet e së kaluarës janë bukur të limituara dhe këtu kemi materie, qoftë për korrigjim në bazë të vullnetit politik që kanë rënë dakord edhe Qeveria e Malit të Zi, por edhe nëse na ndodh ndonjë keqkuptim në të kaluarën, e di se ka dyshime. Plot njerëz dyshojnë se a do të ndodh korrigjimi, prapë ti e ke krijuar precedentin tënd për ta ndjekur në etapa tjera, ose në instanca tjera, qoftë ligjin ndërkombëtar të arbitrazhit, ose më shumë. Bazuar në këtë, kjo është një dalje reale nga një bllokadë, që e ka Kosova, nuk është bllokadë vetëm e vizave, e liberalizimit të vizave, por është bllokadë e proceseve shtetndërtuese, për shkak të cilave po vuan edhe ekonomia, e po vuan shumëçka në vend.

Apeloj te deputetët, ne do ta kemi të martën në diskutim edhe për votim ligjin, apeloj që ta përkrahni këtë ligj. Nuk mendoj që jemi kah bëjmë precedentë të gabueshëm në të drejtën në territor me këtë dhe nuk mendoj se jemi duke bërë tregti për ta votuar veç sa për viza, por e kemi mbërrirë një mes ku edhe e drejta në territor, por edhe e drejta e qytetarëve tanë që të lëvizin lirshëm, sepse besoni është bërë e rëndë edhe ajo, ama nuk po e bëjmë veç për atë, po prapë është bërë shumë temë. Shihni sa njerëz po rrinë te ambasadat. Nuk janë artificiale ato porositë që po na i dërgojnë, “na zhblllokoni, mos na lini të bllokuar, të ecim përpara”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Pacolli?

FITORE PACOLLI: Kryeministër,

Na thuaj saktë, koordinatat janë shifra, nuk janë interpretime. Cilat koordinata i njihni dhe mbi bazën e cilave koordinata do të bëhet korrigjimi?

KRYESUESI: Zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Në dokumentin, në deklaratën në marrëveshjen e presidentëve i kemi vendosur paraprakisht dhe besoni nuk është me dakordim të presidentit Thaçi, i kemi vendosur koordinatat e grupit të Komisionit tonë Shtetëror të zotit Bulliqi. Janë në dijeni të gjithë për këto koordinata, po figurativisht janë pjesë e raportit, sepse, ta kini parasysh, nëse ne po kërkojmë korrigjim në çka po e bazojmë korrigjimin, do të thotë në një raport të gjeturash, e ai raport është i Bulliqit, sepse të gjeturat e Komisionit “Meha” janë marrëveshje, janë në marrëveshjen e mëhershme.

Atëherë, të gjeturat, ta kini parasysh, se dikush mund të thotë se janë hedhur të gjeturat “Meha”, nuk janë hedhur, ato janë kushdo që beson se është ashtu ato janë marrëveshje dhe s’ka pse të mërzhitet ajo pjesë e njerëzve nëse kanë besuar ashtu. Mirëpo, edhe raporti shtetëror që ka hyrë në dokument, tani është e gjetura e fundit mbi të cilën ne kërkojmë korrigjimin dhe e bazojmë korrigjimin edhe në ato koordinata. Janë koordinatat, në fakt i kanë të dhëna preciz. Pse po ju them kështu? Ju kisha lutur deputetëve, për shembull, unë kam pasur një bashkëbisedim me kolegët e LDK-së, ta ruajmë këtë raport se nuk bën keq. Vetëm mund të bëjë ndonjë punë të mirë. Njëkohësisht, apeli im për ju është besoni, jo për shkak të dikujt që është një pushtetar që po paraqet diçka para jush, po si kolegë po ju lus konsiderojeni gjendjen reale, ndryshimin real, përmbajtjen që ka ligji.

Ligji nuk është më ai që dikur na ka ardhur në Parlament. Nëse s’duam ta vlerësojmë kështu, është tjetër gjë. Me leje, shikoni, të gjithë jemi këtu për t’ia dhënë vlerësimin të së vërtetës, por megjithatë një ligj që dikur e ka përmbajtur vetëm një marrëveshje, sot ai ligj e ka marrëveshjen, e ka raportin e Komisionit Shtetëror dhe deklaratën me toponimet gjeografike ku do të ndodhë korrigjimi. Tani nëse kjo s’mjafton, ku të marrim, ku të gjejmë më shumë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për sqarim, zoti Sami Kurteshi e keni pyetjen e bërë më 27. 2. 2018. E ke edhe një pyetje. Në fakt, janë edhe dy pyetje për zotin Haradinaj. Është deputeti Imet Rrahmani. Zoti Rrahmani, e keni fjalën.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Këtë çështje që dua ta ngre faktikisht e përmendët pak më herët në një përgjigje, që ia dhatë një kolegut tonë deputet, e para. Dhe, e dyta, e kam pas bërë edhe më herët dhe jam menduar shumë a do të ngre prapë, për dy arsye. Një, që është ngritur shumë herë nga shumë deputetë këtu në Parlamentin e Kosovës, problematika e qytetarëve shqiptarë të shpërngulur nga Bujanoci, Medvegja dhe Presheva, që s’po mund t’i realizojnë të drejtat e tyre dhe, e dyta, që kjo shpesh mund edhe të kuptohet që po e bëjmë vetëm për poenë politike, sepse regjionin e Anamoravës ka që janë krijuar edhe subjekte politike duke e shfrytëzuar këtë fatkeqësi të shqiptarëve të shpërngulur me dhunë nga këto tri komuna.

I nderuar zoti kryeministër,

E thatë edhe më herët se ata qytetarë po kalojnë nëpër një terror administrativ, për çka pajtohem edhe unë dhe meqenëse vij nga atje njoh edhe shumë familjarë të mi që kanë probleme të tilla, ju kisha lutur, a keni arritur që të ndërmerrni ndonjë hap, na e thoni, dhe cili është plani që t’u zgjidhet problematika e shtetësisë këtyre njerëzve, të cilët plot 18 vjet jetojnë në Kosovë, kanë krijuar biznese, kanë krijuar familje dhe kanë probleme të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Unë i kam kërkuar ministrit të Punëve të Brendshme dhe kam biseduar edhe me presidentin Thaçi dhe jemi duke e kërkuar një formulë, e cila do të ishte e drejtë. A është me një dekret presidencial që të bëhet evidenca e të gjithë atyre njerëzve dhe me një dekret presidencial të jepet shtetësia, pra jemi duke e kërkuar formulën, apo është në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nëpërmjet ndonjë, po e quaj ashtu, baze ligjore, një procedurë e posaçme. Atë që e thamë më herët, një kategori e caktuar, procedurë e posaçme, i nderuar deputet Imet.

Nuk ka qenë shumë thjesht të gjendet formula. Një koleg imi, tash po dalim te këshilltarët, zoti Selim Selimi është këshilltar ligjor, ai vjen vetë prej Presheve dhe ka edhe ndjenjë në këtë temë, është duke punuar intensivisht së bashku edhe me ministrin Abelard Tahiri, ministrin e Drejtësisë, dhe kolegë tjerë, se cila formulë është më adekuate në përputhje me praktikën e ligjit, jo veç nacional, po edhe të praktikave ndërkombëtare, që ai veprim të ketë kreditin e duhur. Por, nuk besoj që në pakufi do të shkojë kështu e t'i lëmë si i kemi lënë, se nuk bën. Në fakt, ne jemi duke e bërë edhe një çudi, Kosova, jemi duke ngecur në dhënien e dokumenteve të identifikimit në veri për qytetarët serbë, për shembull. Është bukur e pashpjegueshme pse Kosova s'po mbërrin t'u japë atyre atje, ose t'ua ofrojë mundësinë e letërnjoftimit, lejes së shoferit, dokumentit të udhëtimit, pasaportës në këtë rast. Janë disa anomali në sistem që ne duhet t'i trajtojmë me kujdes.

Në rastin konkret për qytetarët e Luginës, siç i themi ne, unë mendoj që ka bazë ligjore, ka dikush që ka jetuar këtu 20 vjet, siç e thatë ju, ose ka raste që kanë lindur këtu, ndërsa kanë problem për shkak se prindërit pastaj s'e kanë shtetësinë dhe ai vetvetiu është si të vijë një fëmijë i dikujt i dikujt që është larg, gjë që është tepër e pakuptimtë. Por, ju faleminderit për vëmendje, por duhet të jemi të gjithë të fokusuar derisa nuk e zgjidhim këtë temë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrahmani nuk dëshiron pyetje. Pyetja e fundit për juve, zoti kryeministër, është nga deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Është bërë një praktikë tejet negative, e pothuajse të gjitha institucioneve qeveritare që grupet punuese për hartimin e dokumenteve publike, qofshin ato projektligje, strategji apo të ngjashme, zakonisht punëtoritë i mbajnë jashtë Kosovës, kryesisht në Shqipëri dhe Maqedoni.

Kostoja për mbajtjen e një punëtorie të tillë shkon deri në 20 mijë euro, varësisht nga numri i pjesëmarrësve dhe ditët e punës që ata i bëjnë atje.

Përveç kësaj, kjo po shkakton problem edhe me organizata të tjera, do të thotë që dëshirojnë të marrin pjesë në proces të hartimit, gjegjësisht të bërjes së politikave, sepse ata nuk mund t'i mbulojnë pastaj shpenzimet, qoftë të udhëtimit, akomodimit apo të ngjashme.

Cili është plani juaj për adresimin e këtij fenomeni?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar deputete Pantina, E di se është një praktikë, ta quaj ashtu, 'workshop', po dalin në këto trajnime, tani duhet bërë një kalkulim i efektshmërisë, i kostos e i të gjitha këtyre proceseve që ndodhin. Në disa raste deri në Shqipëri e deri në Maqedoni transporti nuk është ndonjë kosto e tepërt.

Ndërsa qëndrimi, nëse ndodhin këto, edhe kur ndodhin në Kosovë, prapë kostoja është afërsisht e ngjashme, të paktën më kanë thënë që nuk është më shtrenjtë në Shqipëri se sa diku në Kosovë, të paktën kështu më është thënë.

Duhet disiplinuar një gjendje të tillë, përfshirë edhe vizitat, daljet jashtë vendit, duhet disiplinuar.

E kuptoj shqetësimin tuaj, besoj që nëpër etapa kohore do të mund të rikthehemi te kjo temë e të shohim sa ka ndodhur disiplinimi ose sa është vendosur një rregull në këtë aspekt.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

SHQIPE PANTINA: Kryeministër, shpenzimet më të mëdha, përveç të akomodimit e të udhëtimit, janë ato të mëditjeve, unë nuk desha të paragjykoj në fillim, po kam frikë se ky është qëllimi kryesor, pse këto punëtori nuk mbahen këtu, sepse edhe në Qeveri, edhe nëpër të gjitha ministratë ka zyra, ka salla të mira ku njerëzit mund të ulen e t'i shkruajnë ligjet. Pra, problemi është te mëditjet.

Dhe, nëse do ta zgjidhësh këtë problem, këtë e kanë zgjidhur organizatat e tjera, ta zëmë, projektet e Ambasadës Amerikane, gjegjësisht USAID-it, UNDP-së, e të ngjashme, kanë marrë vendim që për aktivitete që dedikohen në Kosovë, ato duhet të mbahen vetëm brenda Kosovës. Unë mendoj se Qeveria e ka shumë të lehtë ta nxjerrë një vendim të tillë. Pra, punëtoritë, sepse janë diçka tjetër vizitat studimore, janë diçka tjetër grupet e përbashkëta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Dakord! Faleminderit! Kryeministri i ka shterur të gjitha pyetjet e veta, tani po vazhdojmë për minutazhin që ka mbetur me ministrat që janë prezentë.

Zonja Millaku është deklaruar, zonja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Zonja deputete, e keni fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Gjimnazi i specializuar matematikor në komunën e Prishtinës ka filluar punën, respektivisht procesin mësimor më 7 tetor 2014.

Themeluesi i këtij gjimnazi është Ministria e Arsimit, sipas Vendimit numër 178/01B të datës 12 dhjetor të vitit 2013 dhe është i ndërtuar nga MASHT-i me vlerë mbi një milion e 500 mijë euro.

Funksionalizimit të kësaj shkolle i ka paraprirë marrëveshja e mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Arsimit, Universitetit Publik “Hasan Prishtina” dhe Komunës së Prishtinës.

Gjimnazi ka gjashtë paralele, me gjithsej 132 nxënës dhe të angazhuar janë 32 profesorë, nga ata 16 nga universiteti dhe 16 nga Komuna e Prishtinës, por ka vetëm një administrues dhe shumë pak personel tekniko-shërbyes.

Që nga themelimi i këtij institucioni i kam përcjellë problemet e shumta të aspektit financiar dhe ka pasur madje edhe ndërprerje të mësimit për shkak të grevave të mësimeve për arsye të mosmarrjes së pagës për punën e kryer.

Ndonëse sivjet është viti i katërt nga funksionalizimi i gjimnazit, i njëjti akoma nuk është paraparë në asnjë linjë buxhetore, po ashtu nuk është punuar asgjë në lidhje me konviktin për nxënësit, sado që ai ishte i paraparë.

A mund të na tregoni, zoti ministër, çfarë keni paraparë në lidhje me mirëfunksionimin e këtij gjimnazi matematik, i menduar dhe i planifikuar si gjimnaz i specializuar, ku do të vijonin mësimet nxënësit e talentuar nga e gjithë Republika e Kosovës dhe kur do të realizoni obligimet që i keni marrë përsipër si ministri në vitin 2014 për sigurimin e buxhetit të nevojshëm për këtë gjimnaz.

Po ashtu, kur do të bëhet pagesa e bursave të nxënësve sipas vendimit të ish-ministrit të vitit 2016 dhe kur do të sigurohen shujtat për këta nxënës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuar deputete,

Faleminderit për pyetjen,

Është një pyetje që vërtet ka një peshë të veçantë.

Siç e thanë edhe ju, gjimnazi i specializuar i matematikës është krijuar me një vendim të MASHT-it, por në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës me Komunën e Prishtinës, gjegjësisht Drejtorinë Komunale për Arsimit në Prishtinë dhe MASHT-i.

Në këtë memorandum MASHT-i kishte marrë përsipër sigurimin e pagave për mësimdhënësit dhe të themi në momentin unik kur e kemi marrë menaxhimin e ministrisë i kemi gjetur këto probleme, të cilat po shfaqet edhe sot, po për të cilat ne kemi marrë masa që të gjithë mësimdhënësve t'u kryhen pagesat, të cilat kanë mbetur deri në atë kohë.

Pra masa e parë ka qenë eliminimi i pagesave ndaj mësimdhënësve, të cilën e kemi arritur.

Mirëpo deri më sot ka munguar infrastruktura ligjore për rregullimin e gjimnazit të specializuar të matematikës, e për të cilët ne kemi marrë masa të menjëhershme, është ngritur një grup punues për ta përgatitur një draftim të Udhëzimit administrativ lidhur me funksionimin e këtij gjimnazi.

Tani ne jemi në fazën finale të draftimit të këtij udhëzimi dhe shumë shpejt do ta nënshkruajmë udhëzimin për gjimnazin e specializuar, ku do të qartësohet forma e funksionimit të këtij gjimnazi.

Pra, edhe pse kanë kaluar katër vjet nuk ka pasur një formë ligjore, pra infrastruktura ligjore ka munguar se si duhet të funksionojë ky gjimnaz, se kush duhet ta marrë përsipër edhe financime e tjera, jo vetë të pagave.

Konsideroj që me finalizimin e Udhëzimit administrativ do të qartësohet dhe secili do ta ketë rolin e vet për të vazhduar punën e një gjimnazi që vërtet ka dhënë rezultate, përkundër vështirësive të cilat i ka pasur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë ka zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Ministër, faleminderit!

Sa për informatën tuaj, ministria nuk kishte marrë qëndrim apo obligim vetëm pagesën e profesorëve, por sigurimin e buxhetit për funksionimin e gjimnazit.

Po flasim për një institucion edukativo-arsimor, i cili, e përsëris, është themeluar me vendim të Ministrisë së Arsimit dhe akoma nuk është ndërmarrë asgjë, pajtohem sa i përket bazës ligjore.

Komuna e Prishtinës ka marrë përsipër obligimet në mënyrë të vullnetshme vetëm që të sigurojë mirëfunksionimin e këtij gjimnazi, duke paguar 16 mësimdhënësit dhe duke marrë përsipër edhe shpenzimet për komunalitet dhe shpenzime të tjera, por kjo çështje është obligim i ministrisë që sa më parë të zgjidhë statusin juridik të këtij gjimnazi, sepse e përsëris, ishte menduar si një institucion që do t'u ofronte mësimet e specializuara nxënësve të talentuar të gjithë Republikës së Kosovës dhe ndonëse është marrë në kohë fushate, duhet të ndërmerri veprimet për të siguruar mirëfunksionimin e këtij gjimnazi.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E nderuar deputete,

Unë e theksova që në memorandum janë përcaktuar cilat janë obligimet të secilit institucion, po pajtohem që Ministria e Arsimit duhet të rregullojë infrastrukturën ligjore, sepse pa rregullim të infrastrukturës ligjore, ne nuk mund ta rregullojmë statusin e këtij gjimnazi dhe besoj që pas infrastrukturës ligjore, të cilat nuk mund të bëhen menjëherë, ne do ta rregullojmë edhe statusin e këtij gjimnazi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Edhe pse afati i fundit për regjistrimin e fakulteteve kolegje është 1 tetori, kolegjet private po e vazhdojnë regjistrimin e studentëve të rinj edhe në dhjetor. Kjo shkelje ligjore po bëhet hapur, kurse ministria që ju drejtoni nuk po ndërmerri asgjë për ta penguar këtë shkelje të rëndë ligjore.

Pyetja është: A keni ndërmarrë ndonjë masë me qëllim të pengimit të kësaj shkelje ligjore? Pyetjen e kam bërë më 18 dhjetor, kështu që është pak vonë, po megjithatë është aktuale.

KRYESUESI: Zoti ministër Bytyqi, fjalën e keni ju.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I nderuar zoti Kurteshi,

Deputetë të nderuar,

Në momentin kur ne e kemi marrë ministrinë, si ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, faktikisht e kemi gjetur një gjendje të tillë, pikërisht për shkak të mosrregullimit të infrastrukturës ligjore, sepse ministria ka data bazë të futjes së të dhënave që quhet SMIAL, Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsimin e Lartë, ku është i rregulluar në bazë të Udhëzimit administrativ dhe parasheh që më datën 30 shtator ky program duhet të mbyllet, pra

program online, të cilët edhe universitetet publike, por edhe kolegjet private janë të obliguar t'i futin të dhënat për studentët e regjistruar, për stafin akademik dhe stafin administrativ.

Mirëpo, për çudi, në fundin e gushtit është lëshuar një Udhëzim administrativ, tjetër nga ish-ministri i kaluar, ku e lë mundësinë që deri më datën 30 tetor, gjegjësisht 15 nëntor për nivelin Bachelor dhe Master të bëhet raportimi i të dhënave të studentëve të regjistruar.

Nuk ekziston në ligj absolutisht dhe as në udhëzime administrative se cila është data e fundit që kanë të drejtë kolegjet private dhe universitetet publike të regjistrojnë studentët.

Ne nga kjo situatë kur e kemi parë, kemi marrë veprime të menjëhershme, i kemi ndaluar të gjitha universitetet publike, sepse ka pasur kërkesë edhe nga universitetet publike për të vazhduar regjistrimi i studentëve dhe u jemi drejtuar me shkresë se nuk kanë të drejtë të regjistrojnë, pasi që viti akademik fillon më 1 tetor.

Pra, e vetnja mundësi ligjore kur kemi pasur të drejtë të thirrëmi është fillimi i vitit akademik, por jo në një datë tjetër.

Po ashtu sipas interpretimin tonë, pasi që jam njohës i mirë i interpretimit të ligjeve, e kemi quajtur 'data e raportimit' dhe jo 'datë e regjistrimit', siç ishte praktikë deri atëherë.

Me shkresë po ashtu u jemi drejtuar të gjitha kolegjeve private, ku i kemi njoftuar se data e regjistrimit duhet të jetë 30 shtatori. Ndërsa data e raportimit mund të jetë 30 dhjetori, por deri më 30 dhjetor do të keni të drejtë t'i prezantoni dhe t'i regjistroni vetëm studentët që janë regjistruar para datës 30 shtator. Këtë e kanë të qartë.

Tani ne e kemi formuar një grup punues që do të dalë t'i vlerësojë të gjitha kolegjet dhe universitetet publike për ta parë gjendjen dhe varësisht nga informacioni që do të na vijjë, ne do të marrim baza konform ligjit që parashihet dhe Udhëzimit administrativ.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: Po.

Për shkak të mungesës së ligjit, kjo po i bie se dikush mund të regjistrohet në vitin 2018 për vitin 2016, ose kështu diçka. Domethënë, disa gjëra kuptohen edhe pa ligje.

Ministër, unë e kam kuptuar që ju për situatën që e keni gjetur nuk keni qenë përgjegjës muajin e parë, të dytë e të tretë, veç tash kanë kaluar disa muaj dhe po ashtu e di që ministria ka kapacitete të bëjë një akt të përkohshëm, që po i quani 'udhëzime administrative' brenda një a dy dite e t'i pengoni këto çështje.

Edhe e treta, ajo që keni lejuar që të raportohen deri më 30 tetor është një farë mënyre tolerim prapë i shkeljes, sepse kjo nuk është e drejtë as e ministrisë, as juaja që të toleroni diçka që i dëmton studentët.

Unë kisha kërkuar prej jush që urgjentisht ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti, ministër.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Atëherë, sa për sqarim, ne nuk i kemi toleruar, i ka toleruar Udhëzimi administrativ i nënshkruar që ka mundësuar raportimin deri më datën 30 dhjetor, por ne kemi marrë masa, sepse i kemi informuar të gjitha kolegjet private dhe universitetet publike, sepse raportimi do të vlejë vetëm për studentët e regjistruar deri më datën 30 shtator. Ky ka qenë veprimi ynë, çdo shkelje që mund të rezultojë nga identifikimi që do të ndodhë në terren, do të merren masat adekuate.

Po, deputetë, ne jemi duke marrë masa, sepse edhe në Ligjin në arsimin e lartë, edhe në Udhëzimin administrativ, në të dy rastet ne do të përcaktojmë datë se deri kur mund të regjistrohen studentët, qoftë në universitetet publike, qoftë në kolegjet private. Kjo nuk ka qenë në ligj e përcaktuar dhe derisa nuk ka qenë në ligj, nuk mund t'i thuash asnjë institucioni të arsimit të lartë që ti ke bërë shkelje derisa nuk ka qenë e përcaktuar me ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Pyetja ime sa i përket ministrit Ismajli ka të bëjë me pirjen e duhanit në hapësira të mbyllura, konkretisht Ligji për duhanin.

I nderuar ministër,

A mund të na thoni, sa po zbatohet Ligji për duhanin, statistikat nga terreni nuk tregojnë një rezultat të kënaqshëm. Sipas informacioneve, edhe numri raportues në shumicën e rasteve është jashtë funksionimit.

Gjendja në terren nuk është e mirë, duke filluar nga institucionet shtetërore, siç është Kuvendi, Qeveria dhe zyrat e tjera të deputetëve, po edhe të ministrave dhe të gjithë atyre që janë përgjegjës për të zbatuar këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajli, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Përshëndetje,

Faleminderit!

Pikë së pari, besoj që të dytë jemi për atë që, unë e kam pasur këtë pyetje që një kohë, po s'na u ka dhënë rasti të përgjigjem.

Dihet se me synim të mbrojtjes së shëndetit publik të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike e mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për kontrollin e duhanit, të sponsorizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe i cili u votua me 72 vota për, 2 abstenime dhe asnjë kundër. Pra, ka pasur një kohezion në atë kohë që të votohet ky ligj.

Pra, ligji ndalon pirjen e duhanit në hapësirat publike, hapësirat e punës, mjetet e transportit publik si dhe në hapësira të hapura të përcaktuara sipas këtij ligji.

Çështja tjetër është se ky ligj është në përputhje të plotë me Konventën kornizë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për kontrollin e duhanit si dhe legjislacionin e BE-së.

Pra, pas një respektimi të mirë, model, në dy vjetët e para dhe të dyta të implementimit, në dy-tre vjetët e fundit ne kemi pasur një përkeqësim të situatës dhe për këtë besoj se janë ndoshta dy faktorë që mund t'i grupojmë më së shumti.

E para, janë një numër i konsiderueshëm i organeve mbikëqyrëse dhe të ekzekutimit për zbatimin e këtij ligji.

Pra, janë organet e ndara në shumë vende dhe do t'i cek disa nga ata: Inspektorati Sanitar, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati i Tregut, Inspektorati i Punës, Inspektorati i Arsimit, Inspektorati i Transportit, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Polica e Kosovës.

Pra, tregon një sërë inspektoratesh të ndryshme, të cilët janë të ndarë, shumë të fragmentuar, por që duhet ta bëjnë përcjelljen.

Pra, dhe në të gjitha këto inspektorate, si qendrore e komunale, pra të gjitha nuk duhet larguar përgjegjësinë edhe nga ne, por edhe nga ata komunalë, kanë treguar mangësi në rezultatet në bazë të kompetencës së caktuar me ligj.

Pengesat në zbatimin e këtij ligji janë të shumta, disa nga ata që ne duhet t'i diskutojmë dhe t'i flasim në mënyrë më të gjatë janë involvimi i ulët i inspektorateve komunale, resurset e kufizuara, involvimi i dobët i autoriteteve komunale në zbatim të ligjit, por edhe dëmtimi që i është shkaktuar nga disa figura publike, qoftë nga Qeveria, ose nga deputetë, të cilët nuk e kanë respektuar ligjin sa duhet për dhënie të një shembulli të mirë për të gjithë qytetarët.

Pa marrë parasysh, me gjithë këto probleme, mund të themi që ky ligj ka rezultuar në një progres, ka pasur progres nga ky ligj, ka krijuar hapësira 100% të lira nga pirja e duhanit, të paktën në aspektin legjislativ dhe ka pasur një respektim më të mirë sa u përket disa institucioneve publike dhe disa transporte publike.

Mirëpo, prapëseprapë sfidat na mbetin të mëdha, fillimin e këtij ndryshimi duhet ta nisim vetë ne, ata të cilët kemi përgjegjësi publike dhe të krijojmë një mekanizëm më të madh për koordinimin e të gjitha këtyre aktorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Ganimete.

GANIMETE MUSLIU: Po, ministër, po pajtohemi të gjithë se ky ligj nuk po gjen zbatueshmëri. Ligji është prefekt, është shumë i mirë në letër, por faktikisht nuk është duke u zbatuar në asnjë nen ose në asnjë paragraf, thashë duke u nisur nga Kuvendi e tutje.

Unë mendoj që një inspektor, i cili nuk ka guxim t'i shqiptojë një gjobë qoftë deputetit a kujtdo qoftë për thyerjen e këtij ligji, mendoj që ai inspektor nuk ka të drejtë të punojë dhe të marrë pagë prej shtetit të Kosovës.

Dhe, e dyta, unë kërkoj edhe nga Komisioni i Shëndetësisë që të merret me monitorimin e këtij ligji dhe të shikohet edhe një herë, të rishqyrtohet, ose ta bëjnë ndryshimin e ligjit, ose të kërkojnë zbatueshmërinë e ligjit.

Përndryshe, ky ligj unë e them me kuptimin e plotë të fjalës se është zero duke u zbatuar.

KRYESUESI: Zoti ministër.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Sa i përket zbatimit, nuk kisha thënë fare zero, sepse të paktën në disa vende kemi modele të ndryshme, hapësira të cilat tregojnë se nuk mund të pihet duhani.

Në institucione publike ka ndikuar për të mirë. Unë e mbaj në mend një kohë kur në mungesë të këtij ligji, ka pasur duhanpirje shumë të mëdha në institucionet publike, sot ka një disiplinë më të madhe. Mirëpo, sfidat mbetin reale.

E para, një fragmentim kaq i madh i përgjegjësisë, e cila nuk rezulton me një trup koordinues më të mirë, nuk lejon një energji më të madhe për ta implementuar ligjin.

E dyta, sa i përket guximit të inspektorëve, aty ne do të japim temë të qartë, por neve duhet ta kritikojmë një ministër ose një deputet, i cili e shkel ligjin, ne vetë ta mbajmë përgjegjës njëri-tjetrin në çfarëdo lloj hapësirash, qoftë të Qeverisë, qoftë të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Uran Ismajli, le të përgatitet edhe Besa Baftiu, është e fundit, sepse nuk ka kohë më.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Vërtet ka një periudhë kohore që është parashtruar kjo pyetje. Unë po dua ta lidh me një kronologji.

Ministër, janë dy gjenerata, drejtimi biokimi-fiziologji, janë gjenerata 2005/06, 2006/07, afërsisht janë sot 80 studentë të diplomuar.

Mirëpo, ende kanë ngelur në dorën e fatit, sepse nuk po mund të licencohen.

Në vitin 2009 është bërë një marrëveshje me rektorat për licencim të këtyre dy gjeneratave.

Më 2009 prapë kryeministri i atëhershëm, zoti Hashim Thaçi, ka nënshkruar vendim që këto dy gjenerata të licencohen.

Më 2015 janë dorëzuar në Ministri të Shëndetësisë dosjet për licencim. Bordi për licencim në Ministrinë e Shëndetësisë është arsyetuar se nuk janë profesionistë shëndetësorë dhe kanë kërkuar module shtesë, mirëpo rektorati e ka refuzuar. Mirë qenka që këtu sot me ne është edhe ministri i Arsimit, është shumë e pakuptimtë që këto dy gjenerata, gjegjësisht 80 të diplomuar të sorollaten rrugëve, së paku këto dy drejtime ose këto dy gjenerata janë hapur nga Ministria e Arsimit e atëhershme dhe shteti i Kosovës ka obligim ndaj këtyre 80 të diplomuarve, në mënyrë që edhe ata të gjejnë rrugën e vet, sepse me këtë po u pamundësohet edhe punësimi nëpër institucionet shëndetësore ose punësimi në cilindo institucion.

Dhe unë e di që kohëve të fundit këto gjenerata kanë protestuar para Ministrisë së Shëndetësisë dhe më pas nuk e di se cili është vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe çka do të bëhet me këta persona.

KRYESUESI: Zoti ministër i Shëndetësisë, e ke fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit, nënkryetar!

Faleminderit, e nderuar deputete Kadrijaj,

Të nderuar deputetë,

Komisioni i formuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në përbërje të përfaqësuesve të Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore, në mënyrë komplekse ka trajtuar problematikën e licencimit të diplomuarve në drejtimet e biologjisë aplikative dhe biokimi fiziologji dhe i ka propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës marrjen e vendimit për licencim të të diplomuarve në këtë drejtim.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të këtij komisioni ka nxjerrë vendimin më datën 07.05.2009, ku është përcaktuar mënyra dhe procedura e licencimit të të diplomuarve në drejtimet biologji aplikative dhe biokimi fiziologji.

Konform pikës 1. 2 të vendimit, Rektorati i Universitetit të Prishtinës ka përgatitur ciklin plotësues të lëndëve mjekësore kompatible me thirrjen e laborantëve të lartë mjekësorë, ku qartazi përcaktohet se të drejtë vijimi të këtij cikli plotësues kanë të diplomuarit në drejtim biologji aplikative apo inxhinierë të biologjisë dhe ata të drejtimet biokimi, fiziologji, që kanë titull Master.

Dhe, të gjithë të diplomuarit në këtë drejtim që kanë vijuar këtë cikël plotësues dhe kanë dëshmuar se kanë përfunduar me sukses studimet në përputhje me vendimin, janë licencuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Mirëpo, në Ministrinë e Shëndetësisë është paraqitur për licencim dhe një numër i konsiderueshëm i kandidatëve të drejtimet biokimi fiziologji me nivel Bachelor.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka pasur as mundësi, dhe as të drejtë të bazuar në ligje për ta licencuar këtë kategori të diplomuarish dhe të njëjtit i janë drejtuar me kërkesë për organizim të ciklit plotësues Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Mirëpo, Rektorati, pasi e ka shqyrtuar kërkesën e grupit të diplomuarve në nivelin e studimeve bachelor, në programin biologji aplikative dhe biokimi fiziologjike të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, e ka refuzuar kërkesën, duke u bazuar në vendimin e Qeverisë, ku përcaktohet qartë se të drejtë të vijimit të ciklit plotësues kanë vetëm ata që kanë titullin master të drejtimeve të lartcekura.

Pra, është vendimi i Rektoratit të UP-së. Kjo është arsyeja pse studentët që i kanë mbaruar studimet bachelor biokimi fiziologjik dhe e kanë marrë titullin “laborant i diplomuar” nuk janë licencuar nga Ministria e Shëndetësisë për laborantë mjekësorë. Megjithatë, për këtë problematikë, e cila është paraqitur në mënyrë kronologjike, të cilën e thashë edhe unë tani, unë prapëseprapë jam takuar me këtë grup laborantësh, kam biseduar edhe me ministrin e Arsimit, jemi në dakordim që ta hartojmë një draft-letër nga ne për te ministri i Arsimit dhe të njëjtin t’ia drejtojmë Rektoratit, në mënyrë që ta shohim mundësinë për krijimin e mësimeve ose moduleve shtesë, të cilat janë të përcaktuara për këta persona, në mënyrë që ta plotësojnë normën. Pra, e

kemi bërë një hap përpara nuk ka mundur Ministria e Shëndetësisë ta bëjë licencimin për arsye se ekziston mungesa e bazës ligjore për ta bërë një gjë të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë?

MINISTRI URAN ISMAJLI: Megjithatë, paskeni filluar me disa hapa, unë po mendoj që bashkërisht edhe me Ministrinë e Arsimit, me Rektoratin, por edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, së paku duhet të gjendet një rrugëzgjdhje për të gjithë këta, në mënyrë që edhe atyre t'u mundësohet edhe punësimi, por edhe të vazhdojnë të punojnë me të drejtat e tjera, sepse, në fund të fundit, është një drejtim që është hapur nga Qeveria e Kosovës, është hapur nga Ministria e Arsimit, dhe këta kanë të drejtë konform asaj që e kanë përfunduar të fillojnë të punojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Para se ta parashtroj pyetjen, më lejoni që t'i përgjigjem deputetes Musliu, e cila e bëri një kërkesë publike që ne si komision ta monitorojmë Ligjin për duhanin, kërkesë e cila ka qenë edhe në Komisionin tonë për Shëndetësi nga anëtari ynë i komisionit, doktori Haxhi Avdyli. Mirëpo, ne si komision e kemi parë të arsyeshme, duke pasur parasysh se Ligji për duhanin është e dukshme që po shkelet, siç thatë ju edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, andaj nuk e kemi parë të arsyeshme që ta monitorojmë, sepse një ligj duhet ta monitorosh nëse nuk e di sesi është duke u zbatuar.

Ndërsa, për sa i përket Ligjit të duhanit, është e ditur që Ligji për duhanit është duke u shkelur në çdo institucion. Ndërsa, sa u përket pyetjeve, unë i kam dy pyetje, po besoj që më përgjigjet ministri, pothuajse pyetjen e parë ministër e kam parashtruar më 6 shkurt, por pas këtu edhe deputetë që jo vetëm këtë vit, 2018, por kanë pyetje të parashtruara edhe në vitin 2017, e një gjë e tillë po ndodh, sepse seancat plenare, siç jeni dëshmitarë, jo që po vazhdojnë me ditë dhe me javë, por seancat plenare po barten nga muaji në muaj, dhe po na pamundësohet që ne si deputetë t'i parashtrojmë pyetjet, t'i ngremë shqetësimet e qytetarëve ashtu siç e kemi obligim edhe me Kushtetutë.

Nuk e di nëse kjo është strategji e Qeverisë që të punojë në këtë mënyrë që të na pamundësojë që të bëjmë pyetje, e kjo është arsyeja e vonësës së këtyre pyetjeve. Për këtë arsye, ministër, pyetja që e kam parashtruar është diskutuar edhe në seancën e fundit, kur është diskutuar për 100-ditëshin e Qeverisë, mirëpo është diskutuar edhe në Komisionin tonë për Shëndetësi, faktikisht Bordin e SHSKUK-së dhe ushtruesit të detyrës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, marrim pauzë deri në orën 14:45. A do të përgjigjesh? M'u duk që tha se "s'kam nevojë për...". Ajo u tërhoq prej pyetjeve. Zonja Baftiu, urdhëro!

BESA BAFTIU: Meqenëse pyetjen e parë thashë e kemi konsumuar dhe e dimë përgjigjen, kisha dashur në pyetjen e dytë lidhur me insulinat, ministër. E dimë se kohët e fundit, faktikisht këtë javë ka insulina, mirëpo nuk ka të mjaftueshme. Po jua jap vetëm një shembull: Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gjilan ka nevojë për 2 700 sosh, ndërsa numri faktikisht është vetëm 1 000 që janë dhuruar në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gjilan.

Situatë e tillë është edhe nëpër qendrat tjera të mjekësisë familjare, apo në tërë Republikën e Kosovës. Na shpjegoni pse kanë ndodhur këto vonesa deri më tani dhe pse nuk ka furnizim të plotë me insulinë? Faleminderit!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

E nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Buxheti i ndarë për barnat nga Lista esenciale për kujdesin parësor historikisht ka qenë i limituar krahasuar me kërkesat. Duke pasur parasysh se numri i pacientëve me diabet insulinë vartës është rritur, si dhe pacientët janë konvertuar nga pacientë të trajtuar me insulinë të tipit human në pacientë të trajtuar me insulinë analoge, pra kemi pasur një shpërputhje ndërmjet buxhetit të krijuar historikisht dhe kërkesave historike.

Mjetet buxhetore të planifikuara që kanë qenë në dispozicion dhe kërkesat që vijnë për këtë medikament janë një raport 1:4. Pra, kërkesat janë katër, ndërsa raporti i buxhetit ka qenë vetëm 1. Kontratat paraprake për furnizim me insulinë analoge janë ndërprerë shumë herët sesa që ishte planifikuar, pasi ka arritur vlerën 130%. Pra, kemi pas një tejkalim, është arritur sasia maksimale që mund të merret. Prandaj, kjo ka qenë arsyeja pse kemi pasur një kufizim të sasive të insulinave në këtë kohë. Mirëpo, që nga fundi i javës së kaluar ka filluar furnizimi i institucioneve shëndetësore të kujdesit primar me insulinë analoge.

Furnizimi është bërë në sasi proporcionale për këto institucione shëndetësore, bazuar në sasitë e insulinës nga stoku momental, ndërkohë që gjatë ditëve në vijim operatori ekonomik, i kontraktuar nga ministria, pra kemi nënshkruar një kontratë, do të vazhdojë me furnizime tjera.

Duke e trajtuar me prioritet të lartë furnizimin e pacientëve me këtë terapi, Ministria e Shëndetësisë dëshiron të theksojë se stabilizimi i furnizimit me insulinë, sipas planifikimit të institucioneve shëndetësore, pra këtu është me rëndësi sipas planifikimit të institucioneve shëndetësore, do të stabilizohet gjatë javëve dhe muajve në vijim. Po ashtu, dëshiroj të them se kjo e përbën atë përpjekjen e madhe që kemi filluar për të kontraktuar mbi 300 artikuj të

ndryshëm nga Lista esenciale për ta krijuar një stabilitet më të madh në gjithë furnizimin me produkte shëndetësore - me barna, si dhe produkte tjera shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e lëmë në 14:45, probabilisht e di që vonoheni pak, prandaj e lëmë kështu.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Ministra,

Po fillojmë pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Interpelancë me kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosjes”, zotit Astrit Dehari

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Propozuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në dhjetë minuta dhe në fund të debatit deri në pesë minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Kryeministri i ka 15 minuta në fillim dhe në fund pastaj sa të ketë nevojë dhe mund të diskutojë ndërmjet diskutuesve për t’u dhënë përgjigje dhe për të mbajtur qëndrime.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar është, si në vijim:

- Grupi Parlamentar i LDK-së, 27 deputetë, ka 40,5 minuta,
- Grupi Parlamentar i PDK-së, 23 deputetë, ka 34,5 minuta,
- Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, 19 deputetë, ka 28,5 minuta,
- Grupi Parlamentar i Pavarur, 12 deputetë, ka 18 minuta,
- Grupi Parlamentar i AAK-së, 11 deputetë, ka 16,5 minuta,
- Lista serbe, 10 deputetë, ka 15 minuta,
- “Nisma për Kosovën”, 6 deputetë, ka 9 minuta,
- Grupi “6+”, 6 deputetë, ka 9 minuta,
- Pa grup parlamentar, 6 deputetë, i kanë 9 minuta.

E ftoj zotin Albin Kurti, që në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si propozues i interpelancës, ta marrë fjalën.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,
Qeveri e kryeministër,

Më 29 gusht të vitit 2016, vetëm dy ditë para protestës së 1 shtatorit, kundër “Demarkacionit” të kufirit me Malin e Zi, e cila do të mbahej në ditën kur Qeveria e atëhershme kishte paralajmëruar ratifikimin e atij “Demarkacioni”, u arrestuan gjashtë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, në mesin e të cilëve edhe Astrit Dehari.

Dy muaj më vonë na vjen lajmi i kobshëm se Astriti ka vdekur. Komandanti i Policisë i rajonit të Prizrenit, Nexhmi Krasniqi, pak orë pasi vdiq Astrit Dehari, ishte i pari zyrtar i shtetit që foli, thua se Astriti vdiq në stacion të policisë e jo në burg. 68 ditë në burg Astriti nuk u mor në pyetje fare. Prokuroria nuk e merrte në dorë Astritin, disi ia kishte lënë policisë ani se po e mbante në burg. Prandaj, edhe Nexhmi Krasniqi ishte i pari që foli dhe jo vetëm që foli, por edhe gënjeu. Kështu, ishte kryepolici që deklaroi i pari e jo ndokush prej burgut të Prizrenit, i njëjti që i vazhdoi gënjeshttrat policore, të cilat qysh prej fillimit shpaloseshin nëpër konferenca shtypi të zyrtarëve të lartë të Policisë së Kosovës kundër gjashtë aktivistëve të “Vetëvendosje-s”.

Nexhmi Krasniqi tha që Astriti ka vdekur nga doza e tepërt e medikamenteve. Ai foli para se të flasë drejtori apo ndokush nga burgu, mjeku apo ndokush nga shëndetësia, dhe foli për medikamente të paqena, për teprime në medikamente të paqena. Në Burgun e Prizrenit, në qelinë A3, më 5 nëntor 2016, ka vdekur një qytetar i pafajshëm, i padënuar, i pagjykuar, i paaktakuzë, e i paintervistuar. Shteti ka gënjyer kur Astriti është arrestuar, shteti ka gënjyer pse Astriti ka vdekur.

Astriti nuk ka vdekur me medikamente të tepruara, ekspertiza ligjore ka konstatuar që për 11 lloje të medikamenteve janë zhvilluar teste dhe në asnjërin prej tyre Astriti nuk ka dalë pozitiv. 11 lloje të medikamenteve, kurrfarë medikamenti në të, trup plotësisht i shëndoshë fizikisht e

psikikisht. Raporti i autopsisë konstatoi se shkak i vdekjes është asfiksia mekanike, bllokimi i rrugëve të sipërme të frymëmarrjes nga mjete i fortë, një shishe e plastikës.

Pasi që u nxitua kryepolici Nexhmi Krasniqi duke gënjyer, u nxitua edhe Kryeprokurori i Gjykatës Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, i cili menjëherë konstatoi se Astriti ishte vetëvrasë ende pa u bërë e pa u kryer hetimet. Njësoj, edhe prokurori i rastit në Prokurorinë Themelore në Prizren, Metush Biraj, pa u mbyllur hetimet e udhëhequra nga ai, deklaroi se Astriti është vetëvrasë. Synimi i tyre ishte i qartë: të mbyllen hetimet sa më parë që praktikisht do të thotë të mos bëhen fare ato. Askush deri më tani nuk ka dhënë përgjegjësi për deklaratat e rreme. E, paraprakisht, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, teksa na drejtohej neve deputetëve të “Vetëvendosjes”, pati thënë “po e vritni veten”, pra vetëm disa ditë para se të mbytet Astriti: “Kujdes, se po e vritni veten!”, “Ruhuni, ishalla veç s’e vritni veten”, Veseli duhet të tregojë se për çka e kishte fjalën.

Drejtësia i nxjerr jashtë shoqërisë kriminelët dhe i fut brenda në burg, mirëpo në Kosovë, drejtësia dhe sistemi prej burgut tek gjyqësia, prej Qeverisë tek prokuroria e policia janë bërë vetë ato vende të krimit. Mbi Astrit Deharin është kryer krimi prej ditës kur është arrestuar e deri atëherë kur vdiq, më 5 nëntor. Atë ditë, pra me 5 nëntor të vitit 2016, Astriti ngelet katër minuta e gjysmë në qelinë A3 të burgut të Prizrenit pasi që e gjejnë të shtrirë aty. Për katër minuta njeriu vdes katër herë!

Vetëm 3 ditë pas vdekjes së Astritit, në Televizionin Klan dhe nga gazeta “Express” u emetuan skena nga video incizimet e bëra nga video kamerat e instaluar në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, me gjithë që detyrimi ligjor për ruajtjen e këtyre incizimeve si material sensitiv për hetim është dashur të respektohet. Si doli jashtë ky material? Pse mu te këto dy medie kur publikisht dihet qëndrimi redaksional e politik i tyre kundër Lëvizjes sonë?

Më 20 dhjetor 2016 kemi vendimin e Kuvendit për hetime ndërkombëtare, mirëpo menjëherë po atë ditë, pason letra e ish-ministres së Drejtësisë, zonjës Hoxha, dërguar kryeprokurorit të shtetit, Aleksandër Lumezi, nëpërmjet së cilës ajo kërkonte të kryhen hetime për keqpërdorimin e detyrës zyrtare ndaj avokatit Tomë Gashi dhe ndaj ekspertit të mjekësisë ligjore Besim Ymaj dhe patologut Besim Latifaj, të cilët kanë marrë pjesë në obduksionin e Astrit Deharit. Pra, vetëm një muaj e gjysmë pas mbyttjes së Astritit, kjo ish-ministre e Drejtësisë kërkon përndjekjen e atyre që dëshironin ta mësonin të vërtetën dhe ta zbardhnin atë.

Më 4 prill të vitit 2017, vdiq në rrethana shumë të dyshimta në burg, Naser Makolli, i burgosuri që kishte qenë në po atë qeli me Astritin në Prizren. Nuk ishte e rastësishme që e penguan me kaq shumë zell kaq gjatë çfarëdo hetimi të pavarur ndërkombëtar. Për shembull me pretekste banale se Zvicra nuk është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, andaj nuk mund të vijë hetuesit prej andej. Para tre muajsh, kur isha pesë javë në burg, në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan,

kam biseduar me të burgosurit e tjerë personalisht për Naser Makollin. Isha në po atë krah, unë në qelinë D-17 kurse Naser Makolli kishte qenë në D-7. Të burgosurit thoshin se ai ka ardhur i sëmurë dhe për çdo ditë ka humbur nga pak peshë deri sa vdiq një ditë. U vyshk e u fik dalëngadalë për një muaj. Gjatë asaj kohe, Naser Makolli kishte marrë rregullisht ilaçe për probleme me stomak, me lukthin, dhe në fund ka vdekur nga gjakderdhja masive, i ishte çarë aorta në zemër, pra jo nga lukthi. Ai ishte i pari që e ka parë Astritin në qeli kur ka ndodhur rasti.

Hetimi i pavarur ndërkombëtar që e rifillon shqyrtimin është i domosdoshëm. Për paaftësinë e mjekëve të mjekësisë ligjore flet edhe Raporti i fundit i Progresit i Komisioni Evropian për Kosovën nga viti 2016 i cili në faqe 21 thotë: “Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe laboratorët e saj kanë pajisje teknike të mjaftueshme për kryerjen e analizave përkatëse të mjekësisë ligjore. Staf i Agjencisë ka nevojë për trajnim rreth shërbimit dhe për ndihmë nga EULEX-i. Aftësia e saj për të ofruar patologjinë e duhur mjeko-ligjore mbetet shumë e dobët. Duhet të sigurohet financimi i vazhdueshëm i Agjencisë”, faqe 21 në Raportin e fundit të Komisionit Evropian të vitit 2016, sepse në 2017 nuk kishte do të jetë tjetri tash në prill të këtij viti.

Më 8 shkurt 2018, avokati i familjes ka pranuar vendimin e Prokurorisë në Prizren, për lejjimin e hetimit të pavarur nga Instituti Zvicëran i Mjekësisë Ligjore, sipas kërkesës së familjes Dehari. Kërkesat e plota të familjarëve dhe të shoqërisë civile, nëpërmjet peticionit me 23 774 nënshkrime të dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 29 nëntor 2016, kanë qenë për hetim të pavarur, por edhe për shkarkimin dhe vendosjen para përgjegjësisë të gjithë zinxhirit institucional lidhur me këtë rast, sepse ka zyrtarë shtetërorë që kanë interesa të forta që ta dëmtojnë një proces të tillë në të ardhmen, i cili është mbështetur e pranuar jo vetëm nga Kuvendi, por edhe nga Qeveria aktuale. Prandaj, ne propozojmë këtë:

Mocion për interpelancë

1. Realizimi pa vonesa i hetimit të pavarur ndërkombëtar, si dhe bashkëpunimi pa pengesa nga institucionet ligj zbatuese të Republikës së Kosovës.
2. Shkarkimi i menjëhershëm i zyrtarëve brenda Policisë së Kosovës përgjegjës për rastin në mënyrë që t'i hapet rrugë hetimit të plotë dhe pa pengesa.
3. Shkarkimi nga pozita e Ministres në Kabinetin Qeveritar, i zonjës Dhurata Hoxhës, si ministre nën udhëheqjen e së cilës dështoi përmbushja e detyrës zyrtare në lidhje me mungesën e mbarëvajtjes së institucioneve korrektuese dhe pengesën në hetime të pavarura.

Në një shtet demokratik, në një shtet të së drejtës, në burg njeriu e humbet lirinë, por do të duhej ta fitonte sigurinë. Burgu është vendi me sigurinë më të madhe për jetën e njeriut për çka se aty nuk ka liri. Burgu është vend më i sigurt për jetën, e politika është vendi më i pasigurt për

karrierën. Në një shtet demokratik, në një shtet të së drejtës, çfarë e duam Kosovën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me çështjen e ngrehur për interpelancë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Haliti!
I nderuar parashtrues i interpelancës, zoti Kurti dhe kolegë të “Vetëvendosjes”
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
Medie dhe qytetarë të vendit,

Është e vërtetë një ngjarje që i ka prekur besoj zemrat dhe ndjenjat e të gjithë njerëzve, jo veç të Kosovës, por të të gjithëve që kanë dëgjuar në atë kohë për vdekjen e Astrit Deharit. Tragjedia bëhet më e madhe, meqë është i dyti i familjes, po ashtu ngjarje tragjike dhe është një tragjedi që ka plot implikime ose plot dimensione dhe implikon e nxit një diskutim.

Kujdesin më të madh duhet ta bëjmë të gjithë, meqenëse është një ngjarje vërtetë e këtillë, pra ta bëjmë një kujdes që ta ruajmë këtë ngjarje në ato dimensionet e veta që i ka dhe ta trajtojmë po në ato dimensione reale të ngjarjes që ka ndodhur. Është më se e arsyeshme, ose më se i kuptueshëm dyshimi, dyshimi edhe i familjarëve, edhe i kolegëve të Astritit, edhe papajtueshmëria se e kemi humbur një koleg, ose një djalë tonin, dhe dëshira disi për të mos u pajtuar që kjo ndarje e këtillë është ndoshta edhe pa shkaktarë ose pa fajtorë, e unë e kuptoj këtë. Mendoj se është diçka e logjikshme dhe s’duhet të preket kurrkush, as ata që kanë qenë në pushtet atëherë, as sot, as dikush tjetër. E kemi rastin e të pagjeturve që janë të zhdukur, sa herë rrinë me familje, familjet kurrë s’duan ta pranojnë që ata s’jetojnë më dhe e kanë atë logjikë që mos ende dikush i pagjetur është gjallë, dhe kjo është njëfarë ndjenje që vërtet meriton, po e them ashtu, respekt në çdo parametër të kësaj.

Unë, për fat, ashtu dikur herët kam qenë koleg me prindërit e Astritit, i kam takuar një lëvizjeje, Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës, kam qenë në atë krahun më luftarak, jo fort politik e ideologjik, por kam qenë pjesë e saj, e kam ditur kush është kjo familje, i kam njohur edhe plot të tjerë si këta, njerëz që kanë dhënë gjithçka për lirinë. Dhe, në asnjë variant nuk kisha pas dëshirë që t’i hyj në hak kësaj familjeje, ose vetë Astritit të ndjerë. Ka diçka që prej që kam ardhur në Qeveri, që mund ta vlerësoj Albin, mund të ta thënë kam pasur bisedë me Kabinetin qeveritar për këtë temë, me partnerët politikë. Kanë qenë të hapur që të plotësohen kërkesat e familjes, dhe kërkesat e prindërve, që edhe një hetim, se kishte ndodhur një hetim paraprak ndërkombëtar, njëlloj vlerësimi i rastit, tash në detaje të mos zbres, por që të ndodhë edhe një, Qeveria është dakord. Në këtë rast edhe unë, edhe ministri i Drejtësisë, çdo anëtar i Kabinetit me

partnerë politike e me të gjithë, dhe kemi shkuar deri në atë shkallë sa ta pranojmë edhe Institutin e Forenzikës që e ka zgjedhur familja.

Kanë qenë disa pengesa ligjore se në njëfarë rezolute të mëhershme të Parlamentit kishte qenë që vetëm të jetë evropian, por ishte një pengesë në ato klauzola, megjithatë janë ndërmarrë veprimet nga ministri që institucionet e hetuesisë së vendit të mund të veprojnë që të përmbushet kjo kërkesë dhe s' do ta ketë asnjë pengesë nga institucionet e Kosovës, nga Qeveria, nga kushdo që të punojmë bashkë në këtë drejtim. Po ashtu, shpenzimet e parapara për këtë hetim i mbulon Qeveria, është detyrë, është obligim yni, edhe sikur të mos ishte e ndjeshme në ato dimensionet që i thashë, prapë do të duhej të ishte obligim i Qeverisë së vendit.

Dhënia e përgjegjësive - Te ne dhënia e përgjegjësive nuk është një standard, tani të themi të ka ndodhu ty kjo dhe japim përgjegjësi, kemi pasur raste në të kaluarën të tragjedive, nuk po dua t'i elaboroj cilat, nuk është paraparë ashtu. Unë atëherë kam qenë në opozitë, kam menduar që është pak e nxituar në atë kohë t'i kërkohej përgjegjësi ministres që sapo e kishte marrë detyrën, Dhurata. Jo që e njihja atëherë, as s'e kam pasur kolege, as nuk kam pasur ndonjë marrëdhënie profesionale me të, por ishte në fillim, më dukej si e ngarkuar. Problemi tjetër që e kemi dhe që unë e pranoj këtu edhe publikisht, para të gjithë juve, në sistemin korrektues kemi disa defekte. Janë disa vakume që duhet pasur në kujdes, janë disa probleme që janë shfaqur dhe është shumë me rëndësi që t'ia vëmë vëmendjen në nivel nacional. Po shpresoj që gradualisht do të mund ta sjellim punën që sistemi korrektues të mund t'i ndihmojë qytetarët e Kosovës që kalojnë nëpër sanksione ligjore që t'i kthehen jetës, t'i kthehen vendit, t'i kthehen shoqërisë, mundësisht sa më të përgatitur për jetën më tutje, edhe jashtë veprave që i kanë kaluar.

Mirëpo, aktualisht në sistemin korrektues pra ka disa vështirësi. Janë disa defekte, jemi në proces për ta zgjedhur një drejtor të burgjeve të Kosovës, e kemi ofruar veten për partneritet me amerikanët, me anglezët, me evropianët, që ky drejtor të zgjidhet me kriteret më të larta, me standardet më të lartë, që të mund të operohet.

Për fund, mendoj po ashtu që është me rëndësi shumë, që edhe t'i ndajmë pak, ose t'i respektojmë pushtetet e ndërsjella. Unë me këtë rast e di se jam Ekzekutivi, ju raportoj juve Parlamentit, edhe unë i kam kufizimet e mia në raport me Gjyqësorin, me Prokurorinë, me... janë disa, t'i quaj ashtu, kufij që s'guxoj t'i tejkaloj, e mendimet e pikëpamje e mia ndoshta kam të drejtë t'i shpreh në momente të caktuara, por s'kanë të bëjnë me ndërhyrje në procese të këtilla. Njëkohësisht, i kisha lutur edhe deputetët, për hir të shtetit ligjor, për hir që e drejta e secilit prej nesh, në mos sot, një ditë, të respektohet, e po ashtu ta ruajmë marrëdhënien ndërmjet Legjislativit dhe Gjyqësorit. Pra, të mos e kryejmë ne këtu në Parlament punën e Gjyqësorit, se mund t'i bëjmë dëme afatgjate vetes.

Unë e di që ky është vendi më i lartë vendimmarrës, këtu janë njerëzit e zgjedhur dhe temat që janë të ndjeshme për jetë duhet të trajtohen, por t'i ruajmë ato aspektet, ose të mos mbërrijmë deri në dimensione që të ndërhyjmë në punën e Gjyqësorit. Kam parë raste edhe në të kaluarën, nuk po e cek, atëherë kam qenë palë që direkt jam përfshirë, por ju kisha lutur që ta kemi edhe këtë fuqi. Po e diskutojmë këtu politikisht. Sa i përket aspektit ligjor, megjithatë, po ua lëmë institucioneve tjera.

Për bindjen time, rekomandimet e Kuvendit, si rekomandime që e obligojnë Qeverinë që ta zbardhë çdo aspekt të kësaj ngjarjeje të dhembshme, na keni prapa dhe nuk vendosim asnjë pengesë, si shpenzimet, si përcaktimin e familjes për cilin institucion, si dhënien e mundësive ligjore që kjo të ndodhë, e keni përkrahjen e kësaj Qeverie, timen, të ministrave e të gjithë të tjerëve.

Dhënien e përgjegjësisë për atëherë, unë e shoh disi jo si mundësi timen që sot të ju jap juve përgjegjësi për ato rrethana me këtë Kabinet, për shkak edhe të rrethanave çfarë janë të ndërtuara, janë përgjegjësi të ndryshuara, dhe edhe unë kam kritikë për mënyrën qysh kam menaxhuar me deklaratimet publike dhe mendoj që ka qenë joprofesionale, në mos kurrgjë tjetër, një nxitim me tërë ato deklaratat, njëri dil atje, njëri dil këtu, pak njëfarë paqartësie ka qenë prapëseprapë, që është shumë me rëndësi, ta gjejmë të vërtetën.

Nëse kjo e vërtetë, tash po them unë dhe e tregova rastin e atyre që i kanë të zhdukur, që edhe po t'ua çosh eshtrat e bijve të tyre, ende mendojnë se mos rastësisht diku e kanë të gjallë njeriun, unë e di që është shumë zor ta qetësosh zemrën e shpirtin e prindërve të Astritit, edhe të kolegëve besa, kush e ka pasur shumë afër, e të zonjës së tij, e të shumë tjerëve, por e kemi njëfarë përgjegjësie që nëse vërtet mbërrijmë te njëfarë fundi i kërkimit për të vërtetën, ndalemi diku se është edhe ndjenjë njerëzore, edhe e drejtë njerëzore, edhe ndihmesë besa njerëzore, kauzat për të cilat secili është munduar. Ato jetojnë. Por, prapëseprapë duhet t'i japim një epilog një momenti të caktuar njerëzor e tjetër, që realisht të mund ta kthejmë garën politike, nuk po dua të them që është gjithçka garë politike, por ta kthejmë garën politike ndoshta në instrumente tjera, në mekanizma tjerë.

Edhe një herë po them kështu prej anës njerëzore, shpreh respekt për familjen Dehari, për gjithë familjen, për kolegët e Astritit, për të gjithë, për qytetarët e vendit që kanë ndier dhe kanë ndjenjë për këtë ngjarje. Kjo Qeveri, po ju them, edhe partnerët qeverisës që jam me ta janë të gatshëm për t'i përmbushur kërkesat për t'u zbardhur e vërteta, çfarëdo që ka mbetur, edhe për t'i mbuluar shpenzimet, edhe për ta respektuar, po e them edhe një herë, një obligim që del para vendit tonë. Në të njëjtën kohë, do të kishim apeluar pra që, po ashtu, ta lëmë në binarë të kësaj të vërtete. Nëse ajo e vërtetë mua s'do të më pëlqejë, ta zëmë, për një arsye të caktuar, OK, ose dikujt tjetër, ose... s'ka e vërtetë që do të na pëlqejë, se megjithatë Astriti s'kthehet në jetë, por të paktën t'ia

lëmë një realiteti diku dhe t'i japim epilog një ngjarjeje, për hir, po them, të gjithë atyre që e meritojnë t'u pushojë ndjenja e kërkimit për një të vërtetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Të nderuar kolegë deputetë,

Vdekja tragjike e një të riu, përpos që është prekëse për familjen, dhe për shoqërinë sigurisht, sidomos kur krijohen dyshime, ajo që është dhembje e vërtetë bie mbi më të dashurit e tyre, që nënkupton prindërit dhe të afërmit tjerë. Pjesa tjetër është që krijohen dyshime për zbardhjen e së vërtetës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar kërkesën e Lëvizjes "Vetëvendosje" për këtë interpelancë dhe kërkojmë që organet e drejtësisë ta kryejnë punën e tyre në mënyrë efikase, profesionale, por, mbi të gjitha, në mënyrë të pavarur. Çdo tendencë për të ndikuar në punën e tyre është në kundërshtim me rregullimin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Edhe ne si Kuvend, si institucion më i lartë i shtetit, duhet ta ruajmë dhe ta sigurojmë pavarësinë në vendimmarrje të organeve të drejtësisë. Është fakt i pamohueshëm se organet e drejtësisë në Kosovë në raste jo të rralla janë vonuar në vendosjen e drejtësisë. Por, ne besojmë se këto organe, në fund të fundit, duhet të marrin vendim meritator. I ftojme kolegët deputetë ta respektojnë parimin e ndarjes së pushteteve, duke kërkuar që të vendoset drejtësia për të gjithë, pa përjashtim. Njëherësh bëjmë ftesë që Kuvendi të rezervohet në komentimin e vendimeve të organeve të drejtësisë, ashtu siç po ndodh jo rrallë nga foltoret e deputetëve dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë Parlamentar do të jetë shumë i zëshëm për të siguruar se procesi vendimmarrës në kuadër të organeve të drejtësisë të jetë i pavarur. Ne gjithashtu do ta mbështetim çdo argument që është i bazuar nga kushdo, edhe kur thotë se organet e drejtësisë nuk janë të pavarura, por ne bëjmë thirrje që të përdoren rrugët ligjore për t'i shqyrtuar rastet e pretenduara të cenimit të pavarësisë në procesin e vendimmarrjes së organeve tona të drejtësisë. Për konfirmimin e këtyre pretendimeve duhet të përdoret rruga ligjore brenda hierarkisë së organeve të sistemit tonë të drejtësisë.

Sigurisht se ka shumë punë për të siguruar sistem efikas të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Ka ende raste që nuk po zbardhen, e ndoshta edhe nuk po hetohen. Vrasjet me motive politike mbeten njolla më e zeze e drejtësisë së Kosovës së pasluftës dhe nuk e dimë se çfarë është ndërmarrë lidhur me rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmive brenda Policisë së Kosovës. Por,

ne e dimë se rastet e hetimeve që fillojnë me shumë pompozitet, përfundojnë me aktgjykime liruese. Nuk e vë në dyshim vendimin e organeve të drejtësisë për aktgjykime liruese, por e vë në dyshim motivin fillestar të nisjes së hetimeve dhe mbylljes së hetimeve.

Komisioni Evropian në strategjinë e re të zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor vlerëson se sfidat kryesore për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Kosovën, janë dhe lidhen me kapjen e shtetit nga struktura informale, kriminale, si dhe krimin e organizuar dhe korrupsionin në çdo nivel të qeverisjes dhe këto nuk paraqesin fakt të panjohur për të gjithë ne, por edhe kemi punë për të bërë si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës do të jetë iniciatore e reformave në drejtësi. Platforma jonë qeverisëse, që po përgatitet për Qeverinë e ardhshme, në fushën e drejtësisë përfshin: vetingun për të siguruar integritet të lartë të organeve të drejtësisë; krijimin e bazës ligjore për konfiskim të pasurisë që nuk mund të dëshmohet se është siguruar në mënyrë të ligjshme; definimin e qartë të kompetencave të organit të akuzës; transparencë të plotë në zinxhirin e organeve të drejtësisë dhe zbatimin e plotë të agjendës së reformave evropiane dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në fushën e drejtësisë.

Vendit i duhet qeveri e re proevropiane, me vizion të qartë, por mbi të gjitha që i ka duart e lira për t'i ndërmarrë këto reforma. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kush e dëshiron fjalën? Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo interpelancë sot është në vazhden e interpelancave dhe debateve, të cilat po tentojnë ta kthejnë Kuvendin e Kosovës në një autoritet gjyqësor, gjë që nuk është fare pjesë e përgjegjësiave tona si deputetë.

Interpelanca ndaj kryeministrit në rastin tragjik të vdekjes gjatë paraburgimit të Astrit Deharit po bëhet në kohën kur procesi gjyqësor i ndërlidhur me këtë rast ende nuk e ka marrë përfundimin e tij në gjykatat e Kosovës. Vetëm disa javë më parë ne e kishim një debat të ngjashëm në lidhje me rastin e sulmit me zollë ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe pothuajse tema e njëjtë, e besoj edhe me diskutime të njëjta, është debatuar tashmë. Shtrohet pyetja, cili është qëllimi i kësaj interpelance? A po kërkohet prej kryeministrit dhe Qeverisë, apo prej Kuvendit, që ta

marrë rolin e gjykatës, apo ndoshta qëllimi është që të rritet presioni politik ndaj Gjyqësorit në lidhje me këtë çështje.

Tani unë besoj pajtohem të gjithë që rasti “Dehari” duhet të marrë qartësimin e plotë ligjor nga autoritetet përgjegjëse dhe në këtë drejtim Ministria e Drejtësisë, Qeveria, tashmë i ka iniciuar të gjitha procedurat e kërkuara, duke përfshirë edhe ekspertizën ndërkombëtare pikërisht sipas kërkesës së familjes Dehari. Nëse kjo çështje tashmë ka hyrë në proces, atëherë çfarë mund të thonë deputetët e Kuvendit sot? Pse ka nevojë që gjithçka, përfshirë edhe një rast tragjik si ky, të politizohet dhe t’i rrisë tutje kundërshtimet politike ditore për interesa individuale, grupe ose partiake. Do të dëshiroja që ky të mos ishte qëllimi i interpelancës, por nisur nga debati i kaluar për temën e ndërlidhur pikërisht me këtë rast, unë nuk pres diçka tjetër.

Përndryshe, nëse dëshironi që vërtet Kuvendin e Kosovës ta kthejmë në arenë trajtimi të rasteve gjyqësore, të problemeve ditore të sistemit gjyqësor, si dhe të proceseve që aktualisht po trajtohen nga gjykatat dhe instancat përkatëse të sistemit të drejtësisë, atëherë secili mund të sjellim këtu raste e raste të ndryshme dhe t’i përdorim e t’i keqpërdorim ato ashtu, siç mund t’i konvenojë një, ose një grupi tjetër. Po kush mund të thotë pastaj se kjo nuk është ndërhyrje në sistemin e drejtësisë, apo ndikim në pavarësinë e Gjyqësorit. Kush?

Nëse skena politike e përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës sjell vendime dhe miraton rezoluta denoncuese, dënuese, si ajo e fundit që mori mbështetjen pikërisht në këtë Kuvend, unë besoj se vetëm do ta dëmtojmë edhe më shumë sistemin e drejtësisë në vend, edhe ashtu të dobët e të sfiduar me probleme të panumërta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJFCA: Unë mendoj që të gjithë ata që thonë se rasti po tentohet të politizohet, ose qëllimisht ia huqin temës, ose ata duan ta keqpërdorin për qëllime politike, sepse ky është një rast, i cili nuk ka të bëjë thjesht me kurrfarë përpjekje për ndërhyrje në drejtësi, por ka të bëjë me të drejta të njeriut, konsideroj unë. Kjo është temë e të drejtave të njeriut tipike. Temat e tilla i trajton Gjykata e Strasburgut, Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Evropë. Pra, pikërisht janë tema të ndjeshme, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe unë konsideroj që katër pika shumë të rëndësishme të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë shkelur me rastin e Astritit.

Është neni 2 i Konventës, përkatësisht e drejta për jetë dhe detyrimi i shtetit, thotë aty, për ta mbrojtur njeriun nga marrja e jetës, sidomos kur ai është nën juridiksionin e tij direkt. Ky është neni i parë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që është shkelur. Neni i dytë që është shkelur me Astritin, e drejta e çdokujt për të mos u keqtrajtuar, apo trajtuar çndershëm, apo ushtruar trajtim degradues në qendrat e paraburgimit dhe të dënimit. Edhe ky nen i Konventës

është shkelur. Është shkelur edhe neni 6, e drejta për një gjykim të pavarur dhe të drejtë, në të cilin shteti e garanton të drejtën e viktimës për një hetim të shpejtë dhe të pacenuar nga ndërhyrja politike, si dhe është shkelur neni 8 i Konventës, që është e drejta në respektim të privatësisë dhe të jetës private në kuptim që shteti ka detyrime për të mos i dhënë publikut informacione paragjyquese, që e ndryshojnë rrjedhën e procedurës penale kundër dikujt, para se ai të jetë i gjykuar në mënyrë të plotë dhe të pavarur.

Dikush do të thoshte, “po punë e madhe që janë shkelur këto nene”, ama mos harroni, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është e aplikueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Sipas Kushtetutës së Kosovës, meqenëse aplikueshmëria e saj është e drejtpërdrejtë, në këtë rast është shkelur Kushtetuta e Kosovës. Në rastin e Astritit, mënyra si ka vdekur, si e ka gjetur vdekjen ai, është pa dyshim shkelje e Kushtetutës dhe për këtë s’ka marrë kurrkush përgjegjësi në shtetin tonë. E ju thoni, “është politizim kjo punë”. Politizim është që s’ka dhënë kurrkush përgjegjësi.

A ma tregoni një person, prej kryeministrit deri te gardiani i dhomës në krahun e Astritit, kush ka dhënë përgjegjësi në këtë shtet për vdekjen e Astrit Deharit? Ma tregoni një person! Ky është politizim i sistemit gjyqësor, jo tema që po e trajtojmë sot këtu.

Duhet t’i kemi parasysh gjithmonë dhjetë fakte, kur flasim për vdekjen e Astrit Deharit dhe unë dua t’i rekapituloj.

1. Pista e hetimeve - nëpërmjet fabrikimit të provave është drejtuar qëllimisht drejt Lëvizjes “Vetëvendosje” nëpërmjet një akti politik.
2. Komandanti i Policisë së Prizrenit që e ka mashtruar opinionin publik, nuk është ndërmarrë asnjë masë ndaj tij.
3. Prokurori i rajonit Sylë Hoxha e ka shpallur vetëvrasje rastin e Astritit ende pa përfunduar autopsia, asnjë masë kundër tij.
4. Ekspertë të pavarur mjeko-ligjorë të dy që kanë qenë, Besim Latifaj dhe Besim Ymaj, në raportin e tyre kanë vlerësuar që skenari i vetëvrasjes në rastin e Astritit është i pamundshëm, sepse Astriti është gjetur në dhomën e tij me një shishe plastike thellë në fytn e tij.
5. Incizimet e dërguara të pamjes bash te dera e dhomës së Astritit, kamera e burgut që i ka kapur incizimet, është dërguar në institutin e pavarur në Austri, raportin e ka avokati mbrojtës, mund të shkoni t’ia kërkon, raporti thotë që ka pasur ndërhyrje në incizime. Kurrkush s’ka dhënë përgjegjësi për këtë.

6. Dëshmitari i parë që e gjeti Astritin, edhe ky e gjeti vdekjen, pesë muaj pas vdekjes së Astritit, asnjë hetim i pavarur, asnjë masë e marrë.

7. Prokuroria, në vend se t'i marrë në pyetje përgjegjësit që kanë çuar deri në vdekjen e Astritit, ministrja e Drejtësisë, ajo që tash është ministre e Integritimit Evropian, atë kohë ishte ministre e Drejtësisë, i bën thirrje drejtësisë dhe ju këtë nuk po e quani interferim politik, u ka bërë thirrje autoriteteve për të marrë masa ndaj avokatit mbrojtës dhe dy mjekëve të pavarur ligjorë. Në vend se të ndiqen kriminelët që çuan në vdekjen e Astritit, ministrja bën thirrje që të ndiqet avokati dhe ekspertët e pavarur ligjorë. Kjo është skandaloze.

8. Procesi gjyqësor, pjesë e të cilit ishte edhe Astriti, u kthye në fillim për shkak të gabimeve, asnjë provë materiale, procesi u rikthye në fillim.

9. Astriti u mbajt në burg 68 ditë pa aktakuzë, pa e marrë kurrkush në pyetje. Kurrkush s'po jep përgjegjësi për këtë. Dhe,

10. Astriti ishte në duart e autoriteteve shtetërore të sigurisë dhe në rrethana shumë të dyshimta u kthye në shtëpi me arkivol.

Kushdo që flet për Astritin duhet t'i ketë parasysh këto dhjetë fakte. E tash, kur gjykatat evropiane, ku ne po duam të bëhemi pjesë, i trajtojnë këto raste, i keni me dhjetëra e dhjetëra raste, e në këtë rast Gjykata e Strasburgut saktësisht, shiheni se çfarë vendimi ka marrë në rastin Anguelova kundër Bullgarisë. Ka qenë një rast, kur një qytetar i Bullgarisë e ka gjetur vdekjen në burg. Nëpërmjet vendimit, Gjykata e Strasburgut vendosi standardin që ta mbante përgjegjëse ndërkombëtarisht Bullgarinë, pra shtetin ku ndodhi kjo vdekje, që Bullgaria ta marrë përgjegjësinë dhe të akuzohet për shkak se dështoi të hetonte në mënyrë objektive dhe gjithëpërfshirëse faktorët që çuan në këtë vdekje, për të cilën përgjegjësitë i ka institucioni shtetëror. Ky standard është vendosur në Bashkimin Evropian, aty ku politika jonë dhe Qeveria po thonë se do të shkojmë, “po aplikojmë vlera evropiane në shtetin tonë”. Çfarë vlerash evropiane?

Një njeri e ka gjetur vdekjen në duart të institucioneve dhe kurrfarë hetimi i pavarur nuk lejohet. Bllokohet çdo iniciativë, dhe bllokuese është Qeveria, ministria dhe krejt aparati qeveritar.

Sa i përket një vendimi tjetër të Gjykatës së Strasburgut dhe, mos harroni, vendimet e Gjykatës së Strasburgut janë obligative për ne, ato zbatohen dhe respektohen sipas principit juridik “erga omnes”, për arsye se konventa mbi të cilën ne funksionojmë dhe aplikohet drejtpërdrejt në Kosovë, kjo gjykatë është e thirrur për interpretimin e asaj konvente dhe për marrjen e vendimeve gjyqësore, duke u nisur nga ajo konventë evropiane.

E keni tjetrën, për shembull, rasti Xhordan kundër Britanisë së Madhe. Vetëm njërin pjesë të vendimit po e marr, thuhet: “Procesi hetues duhet të nxjerrë të dhëna që mundësojnë atribuimin e përgjegjësisë së atyre që janë përgjegjës për shkaktimin e një vdekjeje të tillë”, e jo t’i shkatërrojnë të dhënat, duke e mbyllur praktikisht rastin, vendim i Gjykatës së Strasburgut.

Edhe një rast tjetër, sepse këtu është shkelur edhe ky neni nëpërmjet nxjerrjes edhe të pjesëve të caktuara dhe të provave. Kemi pasur nxjerrje të provave në publik. A është zbuluar personi i cili prej sistemit gjyqësor e ka bërë këtë shkelje? Ja, unë vetëm po jua jap rastin, nxjerrja e ditarit të Astritit, apo nxjerrja e pamjeve të burgut në medie. Kjo është drejtpërdrejt shkelje e njërit prej neneve më të rëndësishme të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Prandaj, këtu kurrkush nuk ka dhënë përgjegjësi. Këtu bile, shikojeni, sa i përket përgjegjësisë politike prej kryeministrit e deri te ai autoriteti i krahut të dhoma e Astritit nuk kanë dhënë përgjegjësi, përkundrazi ministrja, e cila atëherë ka pasur drejtpërdrejt përgjegjësi, prapë është shpërblyer, është bërë ministre. Në Polici, shiheni çka ka ndodhur, për shkak të ndërhyrjes së dhunshme në “Vetëvendosje”, Shpend Maxhuni edhe për pesë vjet tjera bëhet drejtor i Policisë; shiheni në Gjyqësor, Sylë Hoxha, që e shpall Astritin me vetëvrasje ngrihet në karrierë, bëhet prokuror i Prokurorisë Speciale, dhe sa u përket përgjegjësve të drejtpërdrejtë të burgut, asnjë përgjegjësi, as te një gardian i thjeshtë. Për shembull, e kemi një dokument këtu, i cili thotë: “në shëtitore duhet të dalin të gjithë të burgosurit, përpos atyre për të cilët vendos mjeku, apo në raste të jashtëzakonshme oficeri i krahut të burgut”. As ky nuk ka dhënë përgjegjësi. As kjo shkelje nuk është trajtuar në sistemin tonë korrektues, për të cilin tash e kemi përgjegjës ministrin tjetër këtu, që është i Drejtësisë.

Pra, ky është një rast i karakterizuar me shkelje të mëdha. Qeveria, thjesht jo vetëm që ka dështuar, Qeveria është bashkëpjesëmarrëse në krim, kështu që unë vetëm po e përfundoj fjalën time duke thënë: Me Astritin janë bërë dy vrasje. E para, vrasja e qytetarit, vrasja e individit, dhe e dyta - vrasja e drejtësisë prej institucioneve shtetërore dhe prej Qeverisë së Republikës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: Në shumëçka besoj, Glauk e kolegë, se të gjithë jemi njerëz, në fund të fundit, të këtij vendi.

Nuk besoj që është dikush në këtë sallë a diku që s’e di për çka jam duke folur, që është një situatë shumë e ndjeshme, e dhimbshme, edhe implikime të tjera që i folëm.

Tash, unë po ju bëj një pyetje juve për përgjegjësinë që po ma lypni, që të japim llogari. A vlejné këto të tjerat që i kemi bërë, për shembull, kemi rënë dakord që hetimi ndërkombëtar të ndodhë

prej institucionit që e ka zgjedhur familja me avokatin, është kjo diçka e mirë prej kësaj Qeverie, a ka peshë. Nëse është në rregull, mirë.

Kemi rënë dakord po ashtu që ne të mos nxjerrim pengesa ligjore, po mundësisht bashkë me ministrin që është këtu të ndërmarrim veprime që të mundësohet ky hetim ndërkombëtar, prej atij institucioni që do familja që mund ta gjejë të vërtetën.

Unë personalisht kam kërkuar ndihmë te autoritetet e atij shteti që të sqarohet e të rregullohet kjo punë.

E kuptoj, ju i keni radhitur ato pika, të gjitha kanë peshë, unë nuk po dua as t'i debatoj ato veç e veç a një nga një.

Mirëpo ajo që kisha sugjeruar, edhe Parlamentit, që në fund ta përkrahni këtë Qeveri, kjo Qeveri e sotme, me këtë orientim që e ka marrë, një orientim që ta përkrahë hetimin prej një institucioni të pavarur të huaj, jashtë çfarëdo ndikimi prej nesh, të cilin e ka përzgjedhur vetë familja dhe vetë avokati. Kjo është një pjesë.

Pjesën e përgjegjësive të gjithë do ta kemi të diskutueshme kush sa duhet të japë. Po për këtë pjesë, ju lus, ta jepni përkrahjen si Parlament, ta keni atë kurajë e të thoni: në rregull kjo, kjo nuk është në rregull, dy-tri punë, qoftë përgjegjësia, qoftë kjo, qoftë ajo. Po sa i përket kësaj pjese u japim përkrahje, çoni më tutje, kryeni këtë farë hetimi ndërkombëtar dhe ne diku duhet të ndaleni, dikujt duhet t'i besoni të gjithë. Edhe kjo është ajo që e kërkova fjalën prapë për shkak se vërtet nuk dua të kthehem në ndonjë kush kë po e mund me fjalë, në këtë rast, është rast ndryshe.

Vetëm po dua t'ju them që a jeni në rregull, për shembull, a është në rregull t'i japim këtë përkrahje, ta çojmë tutje, nuk e di çka del, nuk e dimë çka na vjen, po, e çojmë më tutje, të dalë çka të dalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Kurti!

ALBIN KURTI: Sigurisht që ne e mirëpresim çdo leje, bashkëpunim, ndihmë, mbështetje nga Qeveria për hetimin e pavarur ndërkombëtar. Mirëpo ajo që po themi është se në Qeverinë e Kosovës dhe në shtetin e Kosovës ka njerëz me interesa të forta kundër këtij hetimi të pavarur ndërkombëtar, këta janë pengesë. Sepse këta janë pjesë e problemit, janë palë në këtë kontest.

Ne po ta kishim shtetin në rregull, s'do të kishte nevojë për hetim të pavarur ndërkombëtar, këtu ka një arsye të thellë pse po na nevojitet hetimi i pavarur ndërkombëtar, sepse ka disa njerëz që nuk e duan një gjë të tillë dhe e kanë penguar deri më sot dhe këta njerëz duhet të spostohen, këta

njerëz duhet të hapin udhë, në mënyrë që hetimi i pavarur ndërkombëtar të jetë tamam hetim dhe tamam i pavarur. Këtë po e kërkojmë ne. Kanë dalë gjërat nga Dhoma e dëshmive, kanë dalë gjërat nga faktet të cilat janë mbledhur për vdekjen e dhunshme të Astrit Deharit. Nuk ka asnjë ndëshkim për këtë gjë.

Pra, hetimi i pavarur ndërkombëtar duhet të vijë në një kontekst të drejtë, jo në një kontekst, i cili është i ndotur me ata të cilët i kanë futur duart në dëshmi dhe ua kanë dhënë mediave që kanë qenë kundër “Vetëvendosjes” dhe vazhdojnë të jenë sot e kësaj dite, se nuk është e rastësishme që këto dy media shkuan.

Pra, duhet të spastrohet konteksti, ju mund ta keni tekstin në rregull, po konteksti është i ndotur dhe ne kërkojmë kontekst të pastër për këtë hetim të pavarur ndërkombëtar.

KRYESUESI: Prapë zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Albin, unë fola në pjesën e parë për dyshimin që është krejt normal. Populli e ka një shprehje, kur të humbë diçka e çmuar, të humbë edhe besimi, shpirti, ne i kemi ato dhe është krejt e logjikshme dhe e përdore atë në kontekst, pra situatën e njerëzve që kanë të zhdukur.

Sot më herë më pyeti zonja Nagavci pikërisht për këtë temë, është krejt e logjikshme që është një mosbesim, as nuk po e vejmë në pikëpyetje atë.

Mirëpo, ka diçka që del përtej kësaj që po thuhet në këtë rast. Kjo Qeveri, pikërisht kjo Qeveri, këta që janë, nuk na mbushin mendjen ose kemi dyshim në ta, nga pikëpamja e palës, në këtë rast, këta kanë rënë dakord, si ministri i Drejtësisë, si ministrja e Integritetit Evropian, si të gjithë kemi votuar në Qeveri, ne nuk e bëjmë këtë hetim, ia kemi aprovuar, pra, kërkesën familjes dhe avokatit të familjes.

Që nga ky moment ne e humbim edhe kontrollin mbi këtë, nëse jemi palë e dyshimtë edhe e kemi nxjerrë një terren neutral profesional, korrekt, s’di çka bëjmë tjetër, o burrë, në këtë rast. Për përgjegjësi fola, unë ju tregova standardin e përgjegjësisë qysh është, qysh ka qenë e qysh shkon. Po me këtë, mendoj, e kemi bërë një vepër, kemi vendosur t’ia japim një pale tjetër këtë temë të na tregojë ku jemi. A ka pasur ndërhyrje, a s’ka pasur incizime, a ka pasur ndërhyrje a janë keqpërdorur provat, a është keqmenaxhuar a çka është, krejt, ne jemi pajtuar.

Meqenëse është kështu, mendoj që Parlamenti në këtë rast, pa ndërhyrje në kompetencat e gjyqësorit a të hetuesve, a kushdo qofshin ata që merren me këto tema, i takon të thotë në rregull, i japim përkrahjen Qeverisë në këtë proces, falënderojmë edhe për financat e ato çka ka bërë, nuk është diçka e jashtëzakonshme, megjithatë mbetet vërejtja jonë në menaxhimin e deritashëm, ose

s'është dhënë përgjegjësi a ku ta di unë. Në rregull, nuk do të kemi mendim të njëjtë për këtë temë kurrë ndoshta këtu në Parlament, po të paktën na jepni një drejtim që ne si ekzekutiv t'i ecim ato që i kemi nisur, në fakt, edhe i kemi nisur duke u bazuar në kërkesa e në respektin e krejt temës, kjo është bukur përmbajtjesore, pra nuk është ndonjë mashtrim që po e bëjmë. Po pikërisht ashtu, ka ardhur familja, avokati ka çua shkresë, e kemi diskutuar atë shkresë, kërkesën e tyre, kemi rënë dakord, e kemi aprovuar, kanë ndodhur procedurat dhe kaq, shpenzimet janë paraparë, nëse ka nevojë ende, se mund të na kushtojë më shumë, këto i kemi bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi. Më fal, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit të Republikës,

Dëgjova me vëmendje atë që tha kryeministri deri më tash në paraqitjen e tij për sa i përket kësaj teme dhe mendoj që sikur edhe më parë, edhe tash këtu e kemi një keqkuptim të asaj se çka është fakt, e çka është interpretim.

Dhe, për rastin e Astrit Deharit, vdekjen e Astrit Deharit në burg dhe gjithë ato që kanë ndodhur më pastaj, ato janë fakte, janë fakte të cilat nuk mund t'i ndryshojmë asnjëri prej nesh. Natyrisht, secili njeri mund ta ketë interpretimin e vet për faktet, por jo t'i ketë faktet e veta edhe të manipulojë me to.

Në nivel faktik ka pasur një rrjedhë jashtëzakonisht brengosëse të gjithë asaj që ka ndodhur pas vdekjes së Astritit në burg, pra pas 5 nëntorit 2016.

Ndërkohë që i tërë procesi i hetimeve është trajtuar në atë mënyrë që të fshihet e vërteta, e jo të zbardhet rasti.

Gjatë tërë procesit, edhe prokuroria, edhe policia kanë qenë më shumë të angazhuara, madje do të thosha kryekëput të angazhuara në atë se si ta orientojnë opinionin publik karshi rastit, e jo se si ta zbardhin vdekjen e Astritit në burgun e Prizrenit.

Organet shtetërore, pra, kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në këtë rast, edhe në vdekjen si të tillë në burg, ku Astriti u privua padrejtësisht nga liria, iu mohua edhe fatalist siguria, por edhe në pengimin e hetimit të pavarur që e ka penguar dhe fatkeqësisht po vazhdon ta pengojë zbardhjen e rastit.

Të kujtojmë edhe një herë disa prej fakteve. Më 29 gusht 2016, Astriti ishte bashkë me Frashërin, Atdheun, Adean, Egzonin e Petritin të arrestuar nga Njësitë Speciale të Policisë. Asnjë bazë e as provë për atë arrestim nuk kishin atëherë, e u dëshmuar edhe me vendimin e Gjykatës së

Apelit që asnjë bazë e as provë nuk kishin asnjëherë për këta të rinj të arsyetuar nga njësitet policore të Kosovës.

Krejt çka kishte policia atë ditë ishte një urdhër nga lart dhe armët e shumta që i kishin sjellë me vete nëpër shtëpitë e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, natyrisht për t’i frikësuar ata dhe për t’ua tmerruar familjet.

Kështu i terrorizuan edhe ata, edhe shoqërinë, edhe secilin qytetar të Republikës së Kosovës e kështu filloi përndjekja e këtyre gjashtë aktivistëve politikë, me mjete terrori e frikësimi. Ndërsa i akuzonin të njëjtit për terrorizëm dhe shpejt rrjeti përgjegjës për këtë terror doli në shesh.

Policia përmes Shpend Maxhunit dhe Fatos Makollit, Luan Kekës e Nexhmi Krasniqit, të gjithë këta bashkë e montuan rastin kundër aktivistëve dhe e konstatuan me shpejtësi shkaku e vdekjes së Astritit. Edhe rasti, edhe shkaku i vdekjes dolën të kenë qenë të pavërteta.

Gjyqësori, përmes Dhurata Hoxhës, si ministre në atëbotë, Sylë Hoxhës, prokuror, Metush Birajt, Abdurrahim Islamit e Vehbi Kashtanjevës, këta u bënë bashkë në përndjekjen policore nga pozitat e tyre, duke e fshehur të vërtetën dhe duke e mbajtur rastin gjallë edhe sot e kësaj dite.

Me veprimet e tyre dhe deklaratat publike këta e orientuan qëllimisht hetimin për vdekjen e Astritit andej kah i konvenonte regjimit, e jo kah e drejta dhe e vërteta.

Dhe RTK-ja që ishte tërësisht në funksion të pushtetit karshi këtij rasti, duke i akuzuar madje edhe para policisë aktivistët për sulmin mbi ndërtesën e Kuvendit.

Të gjithë këta, si një zinxhirë u bënë pjesë e këtij krimi, krim ky ndaj qytetarëve të vendit, krim që e dërgoi Astritin në qeli dhe i cili nuk e la të dalë nga aty i gjallë. Kjo është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e këtyre, pra e organeve shtetërore.

Tash e një vit e tërë Kosova ose më shumë se një vit, u bënë një vit e katër muaj e tërë Kosova kërkoi drejtësi për Astritin dhe u bënë më shumë se një vit e katër muaj që po ashtu kërkohet hetimi i pavarur për Astritin.

Në asnjë rast ky hetim nuk u mundësua, e fatkeqësisht edhe sot po duhet ta kërkojmë një gjë të tillë.

Pengesat që vinin nga regjimi e pamundësonin këtë hetim dhe këto pengesa unë nuk kam se si t’i kuptoj ndryshe, përveç se metoda të fshehjes së vërtetës, pra që të pengohet drejtësia.

Më 5 nëntor, në Burgun e Prizrenit vdiq jo veç Astriti, por edhe më shumë se kaq. Më 5 nëntor vdiq edhe shteti i Kosovës, sepse vdiq edhe niveli bazik për një drejtësi të paanshme dhe të pavarur, vdiq përgjegjësia bazike e institucioneve për t'u afruar siguri qytetarëve, vdiq funksionimi bazik institucional për përgjegjësinë ndaj qytetarëve, vdiq edhe fija e fundit e besueshmërisë së qytetarëve në institucionet e vendit dhe kjo fatkeqësisht po vazhdon edhe sot.

Fenomeni i mosndëshkueshmërisë dhe mosdhënies së përgjegjësive nga pozicioni publik jo që nuk po përfundon në Republikën e Kosovës, por ka filluar të shtrihet edhe karshi rasteve fatale që rezultojnë me jetë njerëzish, siç është rasti i Astrit Deharit.

Natyrisht që kjo duhet të marrë fund një herë e përgjithmonë, edhe mirëmbajtja e kësaj mënyre të funksionari të institucioneve të Republikës është pikërisht ajo që mund ta quajmë 'politizim të gjyqësorit' dhe politizim të këtyre çështjeve dhe çështjeve me të cilat merret gjyqësori, sepse politizimi në këtë rast e ka vetëm një kuptim për mendimin tim është thjesht.

Është mbështetja politike që po u bëhet aktorëve të dyshuar për raste të caktuara dhe për shkak të kësaj mbështetje, mosndëshkueshmëria e tyre.

Pra, kjo është ai politizim, për të cilin ne si Kuvend jo që duhet të flasim, por edhe duhet ta luftojmë me vendosmëri, në mënyrë që në Republikën e Kosovës të krijohet sado pak një hapësirë, ku qytetarët do të fillojnë ta ndiejnë drejtësinë dhe barazinë karshi drejtësisë, e jo të lihen të nëpërkëmbur e të rrezikuar pikërisht nga ato institucione që formalisht janë të thirrura e që kanë mandat t'ua mbrojnë atyre jetën edhe dinjitetin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Visar dhe kolegë, edhe një herë e përsëris atë, edhe sa herë që diskutohet për këtë temë, s'ka dilemë që ato ndjenja, dhimbja e respekti, janë.

Unë dëshiroj të them që megjithatë duhet një dozë e kujdesit, të mos e çojmë deri në fund, çka nënkupton kjo. Të mos i gjykoni edhe ju pa i gjykuar drejtësia, si njerëz shkaktarë të asaj që ka ndodhur, se ndoshta nëse është 99% qysh po thoni ju, po 1% jo, atëherë jemi duke e bërë prapë një krim, domethënë besoni.

Qe Liburn, a bën të flas me ty, veç me leje, unë po flas bukur sinqerisht, nëse ne po e çojmë një hetim ndërkombëtar dhe nëse na vjen diçka, a duhet t'i besojmë dikujt, nëse vetes nuk po i besojmë, se i kemi dyshimet e ndërsjella, e kuptueshme, palë të kundërta, problemet, krejt po i dimë. Ama edhe kështu nxjerrja e konkluzioneve që e ka bërë, jeni ashtu, është ajo, ta keni një farë doze diku, se është në rregull ta keni, nëse i besojmë, diku ta dimë në çka të bazohemi. Ka diçka këtu, njerëz. Unë për shembull, kam familjarë të vrarë pas luftës, vëllai im s'e ka pasur

fatin të bëhet një hetim ndërkombëtar, s'ka mbërritur as deri këtu, një ditë zie e ka shpallur atëherë presidenti Rugova, dhe qe. Unë dyshoj në sa adresa, po megjithatë nuk po dua ta quaj dikë që e ka kryer, se duhet thënë një gjykatë a një institucioni a dikujt, edhe si e tillë, e di për çka po flitet, megjithatë po ju lus të ruheni, mos e çoni deri në fund, se mund të ndodhë që jeni duke bërë dy herë gabim, mund të ndodhë. Për shembull, unë dyshoj që Liburni e ka bërë një punë 99%, po përderisa s'e konstaton diçka që duhet t'i besohet, më mirë mos, se mund të ndodhë që s'është ashtu. Edhe nuk po e them këtë ta mbroj, as ta fajësoj dikë, e tregova rastin e familjarit tim.

Unë e di që kur të ndodhë një gjë e tillë, vetvetiu dyshimi është bazik, normalisht janë e krejt, veç ne jemi njerëz të zgjedhur, ta kemi një farë doze të kujdesit, pse po e them këtë, po e them edhe një herë, nuk qëndron që edhe sot ka vdekur drejtësia, ka një guxim politik prej kësaj Qeverie, këtë materie atyre që ka kërkuar familja, edhe avokati në këtë rast, i bie pala atyre t'ua japim të drejtën të hetojnë.

Unë mendoj që meriton një farë vlerësimi kjo, në fund të fundit, jo se ne po bëjmë diçka të jashtëzakonshme, detyrën po e bëjmë, ama prapë është një ndryshim, nuk është si sot, si dje. Ka një ndryshim, e po, llogari nuk po duam të japim, ndoshta keni të drejtë, po më nuk është në dorë tënde, edhe pse s'po japim llogari, unë në këtë rast, ta zëmë, prapëseprapë s'jam duke e hetuar më lëndën.

Ju kisha lutur, e di që ndjenjat, unë u bëra emocional për gjëra edhe të tjera, më të lehta, e kuptoj edhe ndjenjën tuaj, po ta ruajmë një farë dimensionit të kësaj se mund të ndodhë, për shembull, nëse na thotë një institucion relevant, s'kemi ku shkojmë, ajo është, në çdo kohë, po ne duhet të ruajmë njëfarë doze të besimit.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Ymeri.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Shumë shkurt, vetëm mendoj që prapë e kemi një lloj përzierje të dy çështjeve që për mendimin tim janë të rëndësishme dhe duhet të shihen secila në formën e vet.

Këtu po flasim për dy gjëra:

E para është hetimi ndërkombëtar, i cili do ta zbardhte shkakun dhe mënyrën e vdekjes së Astrit Deharit. Kjo është një dhe ajo natyrisht që do të prodhonte pastaj nëse ka të tilla arsye për ndjekje penale për persona të caktuar, të cilët unë nuk e di kush janë.

Po është edhe kjo e dyta, është dështimi i plotë i hallkave të ndryshme të aparatit shtetëror në këtë rast, për t'i siguruar jetën Astritit dhe, në anën tjetër, për ta zbardhur këtë rast.

Dhe këto dështime po ashtu bartin përgjegjësi në vete, pra nuk mund të thuhet që të presim deri në fund e të na tregojë hetimin ndërkombëtar, nëse ta zëmë, për shembull, Nexhmi Krasniqi, ish-komandant, është ende komandant i Policisë në rajonin e Prizrenit, ka gënjyer për rastin e Astritit. Ai ka gënjyer për rastin e Astritit, këtë e dimë të gjithë, është fakt dhe ai duhet të japë përgjegjësi për këtë.

Ose, për shembull, mënyra se si është sjellë prokurori, ose edhe Forenzika zyrtare që ka prodhuar një raport, i cili është në shpërputhje të plotë me atë që e kanë gjetur dy ekspertët e pavarur. Pra, këto janë fakte dhe për këto nuk ka nevojë për hetim ndërkombëtar, ne dimë që tashmë ka ndodhur dhe për këtë duhet të japin përgjegjësi.

Dhe, në këtë drejtim, ke më shumë se një rast të deklaratave skandaloze ndërhyrëse të ministres së Drejtësisë për rastin, e cila po ashtu duhet të japë përgjegjësi për këtë gjë.

Këto edhe mosdhënia e përgjegjësive nga këta persona për rastin, tregon se, në fakt, i njëjti aparat shtetëror, i përbërë madje pak a shumë nga të njëjtit njerëz që e kanë keqhetuar këtë rast qëllimisht, prapë janë në pozicione, të cilët mund ta pengojnë hetimin ndërkombëtar dhe hetimi ndërkombëtar nuk mund të prodhojë të vërtetë duke qenë i penguar nga personat të cilët vazhdojnë t'i menaxhojnë, ta zëmë, provat për rastin. E kjo pastaj e bën hetimin ndërkombëtar edhe të pamundshëm, edhe të dëmshëm, sepse nuk na e tregon të vërtetën, por na e përvjedh një gënjeshtëri të re për rastin e Astritit.

Pra, mendoj që këto kërkesa janë jashtëzakonisht legjitime, edhe racionale. Nuk ka këtu të bëjë fare me një tendencë të Kuvendit për t'i veshur faj askujt, po thirrje për përgjegjësi të organeve shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Tani mënyra e menaxhimit ose e deklarimeve publike ose edhe shkalla e përgjegjësive. Unë ju thashë më herët se sistemi ynë korrektues ka defekte, i ka edhe sot kur po flasim, jo veç i ka pasur atëherë, por i ka edhe sot.

Edhe menaxhimi i deklarimeve ka qenë disi i çakorduar, ta quaj. Mendoj se çakordime të tilla ka pasur edhe nga avokati mbrojtës, i cili është nxituar edhe ai në atë kohë në një farë mënyre të shpallë një farë lufte. Është dashur jo të dy palët ta bëjnë të njëjtin, ndoshta e ka bërë që të prapësohen ato që vijnë, po është dashur edhe ai të linte një farë, po e quaj ashtu situatë që e vërteta të dalë.

Unë kam qenë në gjykata tetë vjet, plot paragjykitime e dyshime që vërtet kanë besuar që janë ashtu, s'ka pasur kush që i bind ata të tjerë që s'është ashtu, ka ndodhur që në gjyq është

vërtetuar që qenka ndryshe. Për ata edhe po ju them, ta ruani ndonjë dozë të caktuar të korrektësisë. Sa i përket përgjegjësisë, nuk jam duke folur, mundeni, është politike, është e drejtë, është në rregull.

Sa i përket asaj anës tjetër, ta ruani një dozë të caktuar, se mund që po i hyjmë në hak dikujt që ndoshta...

Atëherë unë nuk dua ndoshta të kthehem në çdo sekondë në foltore, edhe një herë po e them që e thashë në fillim, bashkëndjej me dhimbjen që ka familja, bashkëndjej me dhimbjen që kanë kolegët e tij të idealit, të bindjeve, jam që Qeveria e vendit t'ia besoj këtë hetim një misioni ndërkombëtar dhe për këtë e kemi dakordimin e krejt partnerëve politikë, t'i mbulojmë shpenzimet për çdo aspekt tjetër, diskutimi mbetet i hapur, afatgjatë, besoj.

Po kisha lutur Parlamentin që të na japë këtë përkrahje dhe njëkohësisht paragjykimet ose gjykimet se çka ka ndodhur, ta ruajmë një dozë, ju kisha thënë, ta ruajmë një dozë, se ajo po e vështirëson pastaj pjesën tjetër, atë çka e tha edhe zoti Memli, nganjëherë varësisht ku po ulesh dhe si i shih gjërat, po duhet ta kem guximin në të gjithë vërtet në disa punë të biem dakord. Një shprehjeje mospajtimi për rastin që i ka ndodhur këtij djali të ri, që është yni, askush nuk është ndarë i kënaqur, askush nuk ka pasur qejf, nuk besoj që ka dikush as në këtë Parlament, as diku që ka ndjenjë tjetër.

Nëse shkojmë bash në ato hipotezat e tjera, s'e dimë kujt iu ka dashur të vdesë në burg, është pak problem të besosh se dikujt iu ka dashur të vdesë Astriti në burg, nuk besoj unë që e ka bërë dikush se i është dashur dikujt, për shembull, të paktën më duket shumë, më duket jashtë çdo kalkulimi politik a parashikimi, a çka do tjetër.

Ju kisha lutur të mos e çojmë deri aty, njëkohësisht nëse do ta kemi një hetim ndërkombëtar, atëherë ta presim rezultatin, po ulemi edhe një herë e bisedojmë, a ka përgjegjësi politike, penale, morale e të gjitha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është lehtë të flitet për temën, të cilën e kemi sot, sepse kemi të bëjmë edhe me ndjenjën njerëzore që duhet pasur, po edhe me atë që ka vdekur një qytetar në burg dhe pjesëtar i një familjeje që ka dhënë kontribut për këtë vend. Prandaj, edhe fjalët duhet të jenë shumë të

kujdesshme, sepse në këtë rast mund ta lëndojmë përsëri edhe familjen, por edhe mund t'i shmangim gjurmët, të cilat duhen deri te drejtësia.

Është e vërtetë që kemi pasur dhe e kemi një gjendje jo të mirë në rend dhe ligj në drejtësi dhe, nëse është kështu, atëherë duhet marrë masat që të mos ndodhë edhe ndonjë rast që mund të na befasojë pastaj se s'paskemi organe të përgjegjshme, të cilat duhet të funksionojnë brenda shtetit. Është e vërtetë që me ardhjen e Qeverisë së re e kemi një interesim të shtuar për rastin. Kryeministri Hardinaj vetë dhe drejtpërdrejt është takuar me familjen, ka ofruar gjitha angazhimet institucionale shtetërore që duhet bëhen në këtë drejtim që të plotësohet kërkesa e familjes për një hetim të pavarur ndërkombëtar dhe duhet të lejohet që të ndodhë, sepse më shumë se të gjitha fjalët tona vlen një hetim që e zbardh të vërtetën dhe familja ta dijë të vërtetën, ashtu siç duhet ta dimë edhe ne.

Prandaj, kryeministër dhe ju Qeveri, merrini të gjitha masat që kjo të ndodhë në mënyrë që të gjendet e vërteta, e njëkohësisht, meqë po pranohet se institucionet e drejtësisë dhe të gjitha ato që kanë të bëjnë me rendin e ligjin nuk janë në nivelin e duhur, atëherë të bëhet një reformë, e cila garanton edhe lirinë qytetare, edhe të drejtën para ligjit secilit, por edhe sidomos përgjegjësinë ndaj atyre që kanë marrë përgjegjësi institucionale dhe duhet të ndihen të përgjegjshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Kur një i burgosur vdes në burg, e para gjë që i shkon familjes ndërmend janë dyshimet. E para gjë që miqve, familjarëve, bashkëpunëtorëve, në këtë rast organizatës i shkon ndërmend janë dyshimet: Kush? Pse? Çka ndodhi?

Edhe sikur i tërë rasti pastaj të menaxhohet në qetësi të plotë, edhe sikur të ishte një rast për një të burgosur të zakonshëm, sërish dilemat dhe dyshimet nuk do të hiqeshin. Është krejt kjo normale kjo, sepse unë dhe disa këtu kemi qenë vetë të burgosur dhe e dimë pak a shumë sesi zhvillohen ngjarjet brenda, sesi zhvillohet jeta brenda.

Rasti i Astritit bëhet më problematik për faktin se nuk ishte i burgosur i zakonshëm dhe meqë nuk ishte i burgosur i zakonshëm dyshimet ishin edhe më të mëdha, dyshimet natyrshëm lindnin dhe natyrshëm ushqeheshin. Dyshimeve u jepte zë, u jepni fuqi edhe kundërthëniet njëra pas tjetrës të atyre që ishin përgjegjës për ta qetësuar familjen, për ta qetësuar organizatën që i takonte dhe për t'i qetësuar qytetarët, në përgjithësi. Pra, kjo ishte ajo pasqyra, piktura në të cilën

u përpoqa ta përshkruaj se çka ndodhi nga momenti kur e morëm lajmin, kur u dha lajmi se Astrit Dehari dhunshëm kishe ndërruar jetë në Burgun e Prizrenit.

Kjo është njëra anë, e këtu pa dyshim që shteti, përgjegjësit, të cilët kanë përgjegjësi për jetën e çdo të burgosuri dhe në veçanti kanë përgjegjësi për jetën e të burgosurve jo të zakonshëm, sidomos duke pasur parasysh veprën për të cilën Astriti dhe shokët e tij ishin arrestuar - dyshimet, kërkoj falje, për çka ata ishin arrestuar dhe mbaheshin në burg. Tash unë do të përpiqem t'i them disa fjalë nga një këndvështrim tjetër. A ka pasur përgjegjësi shteti ta mbajë gjallë Astritin? Natyrisht që ka pasur përgjegjësi. Shpesh e thonë kolegët nga "Vetëvendosja" që vendi më i sigurt është burgu dhe në burg e humb lirinë, por nuk e humb sigurinë, madje duhet të të rritet siguria. Por, ne që kemi qenë në burg e dimë që krijohen disa raporte me gardianë që i kapërcejnë detyrimet ligjore edhe të shtetit, i kapërcejnë detyrimet e rregullores, të protokollit të gardianëve dhe krijojmë miqësi, krijojmë raporte të mira, ku ata shpeshherë, për hatër tonë, për shkak se ne u kërkonim, i shkelnin rregulloret. Na linim të rrinim edhe nëpër dhoma, edhe pse nuk ishte e lejuar të rrinim vetë në dhoma. Na linim të dilnim jashtë nganjëherë, edhe pse nuk ishte orari për të dalë jashtë.

Pra, nëse kjo është vetëvrasje, nuk e di a është apo nuk është vetëvrasje, është një vdekje e dhunshme. Natyrisht që shteti pra ka përgjegjësi, por mendoj që është mirë ta integrojmë në analizë edhe këtë dimension se pse u la vetëm ai. A kishte qëllim që Astritit t'i ndodhte diçka? A ishte dikush në dijeni që Astritit do t'i ndodhte diçka dhe të lihet vetëm pastaj të kryhet akti makabër - krimi, siç po supozohet nganjëherë. Apo thjesht për shkak të raporteve të afërta që krijon një i burgosur me gardianin, ai u la në dhomë për të pushuar, sepse s'kishte disponim a ku ta di unë. Unë për vete me dhjetëra herë nuk kam dalë në shëtitje, dhe gardianët më kanë lejuar në Burgun e Prishtinës, në Burgun e Tetovës, në Burgun e Shutkës në Shkup të rri në dhomë vetëm pa asnjë shoqërues, edhe pse të tjerët kanë dalë, unë kam qenë i vetmuar, por ata na kanë lënë, dhe kanë qenë maqedonas, jo shqiptarë në Tetovë dhe në Shutkë, në Shkup.

Po përpiqem që ta bëj, si të them ashtu, një analizë se çka ka mundur të ndodhë, apo se si ka mundur Astriti të ndodhet vetëm në burg. Tash, kjo nuk e liron natyrisht nga përgjegjësia askënd, i cili, qoftë për shkak të lidhjeve që ka krijuar me Astritin, e ka lënë të qëndrojë në dhomë, qoftë për arsye tjera. Por, është vrasje apo jo? Mendoj që për këtë tani duhet të pritët që analiza, hetimi që do të bëhet nga ekspertët zviceranë, të vijë në përfundim. Unë ju siguroj që këta nuk kanë fuqi të ndikojnë te zviceranët. Atë e di. Madje këta s'kanë fuqi të ndikojnë hiç te ndërkombëtarët, se po të kishin s'do ta kishin bërë Gjykatën Speciale. Këta as veten s'kanë mundur ta mbrojnë nga ndërkombëtarët, e lëre më ta mbrojnë dikë tjetër që paska bërë një vrasje, qoftë "me porosi", qoftë "pa porosi".

Unë kam jetuar gjatë në Zvicër, e di mirë që zviceranin nuk mund ta shtysh ta thotë një gënjeshtër as për presidentin e Zvicrës, e jo më për presidentin e Kosovës; as për ministrin e

Zvicrës dhe as për kryeministrin e Zvicrës, e jo më për kryeministrat apo ministrat e Kosovës. Unë besoj në ato institucione. Unë mendoj që sapo të del rezultati nga ky hetim i ekspertëve zviceranë, ta quaj ashtu “lëmshi” do të zgjidhet përfundimisht, dhe do të shihet së paku a është vrasje apo vetëvrasje. Dhe, nëse nuk është vrasje, atëherë nuk mund të jetë gjë tjetër, por sidoqoftë përgjegjësi morale politike natyrisht që kanë të gjithë. Po, kjo është Kosova, niveli i përgjegjesisë për çka jepet përgjegjësi varet sa ndien njeri përgjegjësi dhe sa është njeri i përgjegjshëm. Në Perëndim jepet dorëheqje për gjëra më të vogla, e jo pse janë burra apo gra më të mira, por e dinë që një gjë e tillë do t’i kushtonte partisë në vota. Prandaj, atje jepet dorëheqje. Shpeshherë lavdërohen se atje janë të ndershëm. Jo, por ai ka për të dalë në votime dhe e di që s’merr më vota, dhe partia i thotë me ty më nuk mund të ecim më tej - jep dorëheqje, sepse në vota, në zgjedhje ndëshkohesh. Këtu nuk po ndodh ajo.

Po e shihni që nuk po ndodh ajo, kështu që edhe niveli i përgjegjesisë morale dhe i përgjegjshmërisë morale është në nivelin në të cilin është. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash unë nuk po jua kufizoj diskutimet, edhe replikat, në qoftë se keni, janë në llogari të grupeve, s’ka rëndësi kush diskuton, e keni minutazhin e juaj, merruni vesh mes vete më së miri. Të mos duket që po ndërhyj në diskutimet që njëri dëshiron t’i bëjë dhe duhet t’i kufizojmë për shkak të atyre raporteve.

Unë tash ia jap fjalën ministrit të Drejtësisë, por para se të flasë ai, do të dëshiroja për veten time të di, a ka filluar, a është ngarkuar dikush konkretisht, kush punon me atë Institutin zviceran? A e ka filluar Instituti punën, a s’e ka filluar? Dhe, kur pritet rezultati? Ajo po më intereson, të tjerat janë të diskutueshme.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të gjithë ne që jemi të pranishëm në këtë sallë kemi relacion të drejtpërdrejtë me politikën si veprimtari, por shumëfish më shumë kemi obligim ligjor e kushtetues për t’i mbrojtur të palëkundshëm tri shtyllat themelore që i japin kuptim vetë idesë të kësaj Republike, e që janë: mbrojtja e jetës, mbrojtja e pronës, liria për të prosperuar në të gjitha format që ia njeh ligji dhe Kushtetuta qytetarit të Republikës së Kosovës.

Tema për të cilën është duke u shtruar diskutimi është pikërisht një temë në të cilën politika e përditshme nuk shumë vend dhe çdo përpjekje për ta bërë temë të definuar me ligjet në fuqi, është tërësisht politike, siç është pretenduar dhe pretendohet vazhdimisht dhe është në radhë të parë cenim i këtyre tri shtyllave themelore. Në rrafshin personal, jo vetëm Astrit Dehari, por çdo qytetar i këtij vendi që e humb jetën është rast që na prek emocionalisht. Për këtë askush nuk mund të bëjë klasifikim se kush është dhe kush nuk është i denjë për t’u prekur emocionalisht nga humbja e jetës. Sepse, para se të kemi çfarëdo kualifikimi politik e partiak, social e kulturor,

të gjithë e kemi një status të barabartë. Jemi qytetarë të këtij vendi, të cilit i detyrohemi për ta respektuar dhe i cili na detyrohet për të na mbrojtur.

Unë sot po flas pikërisht në rrafshin e përgjegjësisë që e kam si ministër i Drejtësisë, pikërisht në trajtimin e kësaj çështjeje. Që nga java e parë e marrjes së detyrës, këtij rasti i jam qasur me seriozitet për atë që kam mandat institucional e ligjor.

Të nderuar deputetë të “Vetëvendosjes”,

Nuk më ka kërkuar askush, nuk më ka shtyrë askush, nuk kam pasur kurrfarë kërkesë prej askujt, në mbledhjen e dytë të Qeverisë së Republikës së Kosovës e kam vlerësuar si të nevojshëm angazhimin në zbardhjen e të gjitha dyshimeve për humbjen tragjike të jetës së shtetasit Astrit Deharit, duke iniciuar vetë zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, në atë kohë kur ju dhe të gjithë ne së bashku ishim të angazhuar në zgjedhjet lokale. Më 27 shtator 2017 i kam dërguar letër kryeprokurorit të Shtetit, zotit Aleksandër Lumezi, ku kam shprehur gatishmërinë time të plotë që ta ofroj ndihmën e nevojshme institucionale dhe financiare për realizimin e ekspertizës shtesë brenda dhe jashtë vendit, në njërën nga vendet e BE-së, apo SHBA-ve, siç e parashihte pika e katërt e rekomandimeve të miratuara në Kuvend, në seancën e jashtëzakonshme të 21 dhjetorit 2016.

Me qëllim të ofrimit të mbështetjes institucionale dhe financiare, i kam propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës ndarjen e 50 000 eurove për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e ekspertizës, propozim ky që është miratuar nga Qeveria, më 13 tetor 2017. Më tutje, së bashku me kryeministrin Haradinaj kemi pritur në takim prindërit e të ndjerit Dehari, ku jemi njoftuar me kërkesën e tyre që ekspertiza të kryhet në Qendrën Universitare të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, gjë që i tejkalonte rekomandimet e Kuvendit, kërkesë të cilën e kemi plotësuar në plotësi. Përderisa objekti i kërkesës së prindërve të Astritit hynte në përgjegjësinë e organeve prokuroriale dhe me qëllim të adresimit sa më të shpejtë të saj, kemi kërkuar nga Prokuroria që të ndërmerren masat dhe të gjitha veprimet e nevojshme në vendosjen e kontakteve me këtë institut në Zvicër.

Prokurori i rastit, të nderuar deputetë, ka vendosur kontaktet me qëllim të realizimit të ekspertizës në këtë institucion. Jemi duke i pritur rezultatet e bashkëpunimit institucional për hedhjen në dritë mbi të vërtetën.

Natyrisht, në një sistem demokratik, pjesë e të cilit jemi, pushtetet janë të ndara, megjithatë garancitë tona janë të pakompromis që kjo çështje të zgjidhet sa më parë, pikërisht aty ku familja ka zgjedhur të zgjidhet. Rrjedhimisht, ju ftoj që të shkëputni njëherë e përgjithmonë nga kjo mendësi fataliste dhe të besoni në institucionet tona të drejtësisë, sepse ky rast do të zbardhet dhe do të triumfojë e vërteta përballë mosbesimit dhe paragjyqimeve që janë ngritur deri më tani, cilado qofshin ato dhe nga kushdo që vijnë.

Të nderuar të pranishëm,

Pra jemi në një proces kur Prokuroria dhe prokurori i rastit janë duke e përkthyer materialin e kërkuar nga Instituti i Zvicrës dhe është një material prej rreth 2 000 faqesh dhe çdo gjë që do të kërkohej nga ky institucion, të jeni të sigurt që do të ju njoftoj dhe në kuadër të kompetencave të mia, duke mos u involvuar në punën as të prokurorit, as të askujt tjetër në kuadër të sistemit të drejtësisë, mirëpo derisa të zbardhet e vërteta, derisa ta kemi vendimin final të këtij instituti, unë nuk do të ndalem dhe do të ju informoj në çdo kohë kur ju e shihni të arsyeshme.

Pra, ju siguroj edhe një herë që nuk kam pasur asnjë ndalesë, nuk kam pasur asnjë kërkesë nga askush as të vonohet, as të shtyhet, mirëpo përkundrazi, gjatë kësaj periudhe, kur i pari në këtë Qeveri e kam iniciuar këtë çështje, kam pasur përkrahje edhe nga kryeministri, edhe nga të gjithë partnerët e koalicionit, që jemi pjesë e kësaj Qeverie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani kush e do fjalën? Besa Gaxherri, në radhë është Korab Sejdiu, s'ë di qysh merreni vesh ju ndërmjet vete, të dytë jeni të LDK-së. Radha është e Korab Sejdiut.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema të cilën e kemi shndërruar në interpelancë të sotme është vërtet tejet e ndjeshme. Po flasim për vdekjen e një djalë të ri, që konsideroj që çdo person apo çdo nënë e ndien dhembjen në vete dhe konsideroj që është tepër vështirë të diskutojmë për të, për vetë moshën e tij, por edhe njëkohësisht për vetë mënyrën e kësaj vdekjeje.

Që nga ditët e para që ka ndodhur ky rast, unë jam deklaruar dhe kam thënë që, qoftë vrasje, qoftë vetëvrasje, për këtë rast është përgjegjës shteti. Edhe sot po them. Dhe, unë konsideroj se të gjithë ne deputetët dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës duhet të jemi më shumë të interesuar se sa “Vetëvendosja” që të zbardhet ky rast. Nuk mund të paragjykojmë nëse ka pasur a s'ka pasur implikime shteti aty, por as nuk mund t'i përjashtojmë këto mundësi.

Prandaj, unë ato ditë kam thënë se duhet për të marrë përgjegjësi dhe është dashur nga hierarkia, nga vendi ku ka ndodhur rasti, të fillojnë dorëheqjet dhe normalisht që ta shohim ne të gjithë që vërtet dikush duhet të japë përgjegjësi për punën e tij.

Duke pasur parasysh këto dhe shumë gjëra që kjo temë ka qenë debat disa herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, unë nuk e kam pasur ndërmend sot të diskutoj. Edhe tash që jam duke diskutuar, e ndiej shumë vështirë, por në pjesën e parë të Kuvendit kur u diskutuan çështjet jashtë rendit të ditës, kolegu im zoti Molliqaj m'u drejtua mua dhe atë në një formë të papranueshme, prandaj unë vendosa që tash t'i përgjigjem atij. Zotit Molliqaj edhe një herë po i them që unë kurrë në jetën time, pak qetësi ju lutem, se tema është pak më serioze se ju, nuk e kam quajtur asnjërin nga aktivistët “terrorist”. Kurrë, me asnjë emër, dhe s'ë kam ndërmend ta quaj. Unë i

jam drejtuar këtu prej këtij Kuvendi Kryesisë së Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe kolegëve të mi, Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” në atë kohë. Pas rastit të gjuajtjes me zollë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ne si Kuvend, të gjitha partitë politike e kemi nxjerrë një rezolutë, me të cilën e kemi dënuar aktin terrorist mbi Kuvendin.

Dhe, po ju them shumë sinqerisht, kurrë s’më ka shkuar ndërmend që dikush, ndonjëra prej partive politike këtu brenda Kuvendit qëndron pas atij akti. Kurrë! Kam menduar që vërtet agjenturat e ndryshme do ta shfrytëzojnë përplasjen tonë, të cilën e kishit krijuar ju të “Vetëvendosjes”, së bashku me AAK-në dhe “Nismën” dhe nuk reflektonit fare as nuk ju interesonte fare se çka jeni duke bërë, dhe unë kam menduar se dikush po ndërhyr në mesin tonë dhe po e bën atë akt. Edhe sot dyshoj ashtu. Por, pas disa ditëve, unë s’e kam ditur as kush është burgosur, as kush kanë qenë ata njerëz, as si e kanë pas emrin ata njerëz, kur Policia e Kosovës ka ndërhyrë në selinë e “Vetëvendosjes” dhe ka gjetur maska, mollotov, gaz lotsjellës, armë të ftohta, unë jam trishtuar. Unë jam trishtuar dhe edhe një herë po ju drejtohem prapë, unë nuk e di a ka qenë ajo seli e partisë politike, apo çka ka qenë?

Edhe ju duhet të jepni sqarime, sikur që unë kërkoj prej drejtësisë sonë, prej Policës, prej gjykatave - drejtësi për Astritin dhe për secilin të vrarë e të vetëvranë në burgjet e Kosovës, nuk është i vetmi ai, njëkohësisht kërkoj prej jush përgjegjësi çka është, çka u janë dashur juve maskat në selitë tuaja? Çka ju duhen juve ato maska? Për çka keni ardhur këtu e keni gjuajtur gaz? Për çka keni dalë dhe e keni gjuajtur Policinë me mollotov? Për çka e keni gjuajtur kryeministrin? Ju doni t’i ikni përgjegjësisë! Jo, nuk mund t’i ikni përgjegjësisë. As nuk mund të fshiheni pas njerëzve, pas dhimbjeve të familjeve e të vrarëve apo të vetëvranëve, apo dikush që i ka vrarë. Nuk mund ta bëni këtë as ju, as ne.

Na jemi këtu zyrtarë të lartë që marrin përgjegjësi. Marrim përgjegjësi për veprimet tona, por edhe për veprimet e elektoratit tonë.

Prandaj, ju duhet ta kërkonit përgjegjësinë te ju, konkretisht te ju. Mos ma drejtoni gishtin mua, se s’e kam shprehur, kam kulturë dhe kam dije politike që të mos ia drejtoj gishtin kurrë kurrkujt në emër, pa pasur argumente. Aq më pak për ata djem të ri që unë s’i kam njohur. Edhe ai zoti Krasniqi që u drejtua kur unë nuk isha këtu, që keni thënë dikush nga LDK. LDK-ja kurrë s’e ka quajtur askënd “terrorist”. As unë s’po e quaj, as nuk e kam quajtur. Por po, po kërkoj prej juve përgjegjësi. Edhe atë ditë në debat kam kërkuar nga kolegët e mi deputetë për ta bërë Ligjin për partitë politike dhe të definohet qartë çka është partia politike dhe çka është organizata terroriste.

Edhe prapë po kërkoj. Nëse kështu po ju dhemb juve e s’po ju pëlqen, ajo është çështje e juaja. Por, unë asnjëherë nuk jam drejtuar këtu në këtë seancë për të treguar sa shantazhet, sa kërcënimet, sa fyerjet, sa linçimet i kam pasur prej aktivistëve tuaj. Asnjëherë! Mua më është gjuajtur vetura, 800 euro e kam paguar me pagën time. Ju e keni gjuajtur! Asnjëherë s’jam

drejtuar këtu. Të gjitha ato kërcënime, dy-tri i kam drejtuar në Policinë e Kosovës. Ju lutem shumë, duke u munduar të mos e drejtoj gishtin, të mos shndërrohen gjërat personale, edhe pse s'ka qenë ajo personale, sepse këtu s'kam personale me askënd. Për të mos i nxjerrë gjërat personale, i kam heshtur. Ju guxon, e merrni të drejtën, e drejtoni gishtin dhe thoni që zonja Gaxherri na ka quajtur “terrorist”.

Jo, zotërinj, s'ju kam quajtur “terrorist”. As s'po ju quaj, as nuk kam qejf kurrë që të jetë asnjë parti politike në Kosovën time terroriste, asnjë shqiptar, dhe as nuk besoj që janë, por ju keni përgjegjësi. Shumë të madhe keni përgjegjësinë dhe kthjelluni, edhe pse po më vjen mirë që keni nis t'i ulni ato gjakrat dhe të kthjelleni pak, se ju e dini çka bënit këtu, por reflektoni dhe kthehuni nga vetvetja, lëshojini këmbët në tokë dhe mos e drejtoni gishtin nga askush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë kush kërkon? Një herë... s'e di me kë e pati. Glauku një, edhe ky djali.

GLAUK KONJUFCA: Replikë për shkak të “Vetëvendosjes”, mbi të gjitha.

Këtu ka qenë një proces gjyqësor, sidomos sa i përket terrorizmit, ka qenë një aktivist i “Vetëvendosjes” i akuzuar dhe me pretendim se ka dashur të shkaktojë atentat në kryeministrin Isa Mustafa. Gjykata e ka trajtuar dhe ka ardhur në konkludimin që të gjitha ato që i janë veshur për veturën e kryeministrit kanë qenë montime nga njerëzit përreth kryeministrit dhe trimi është lëshuar prej burgut, mirëpo pesë muaj e kanë mbajtur në burg. Ky është rasti i parë, që dua t'ia ofroj zonjës Gaxherri. Por, veç për t'i treguar për një fakt, që pozicioni i saj prej të cilit po flet ajo është i gënjeshtërt, për shkak se këto institucionet te ne janë të kapura. Kjo po flet sikur të ishte njëfarë shteti i pavarur demokratik, sikur kjo të kishte ndodhur në Zvicër. Këtu kjo s'po e kupton që institucionet te ne janë të kapura, institucionet e gjyqësisë, dhe kur duan ta godasin kundërshtarin politik s'ta merr mendja, as fantazia bile s'ta rrokë se çka janë në gjendje të bëjnë. Se, ne i kemi përjetuar këto. Unë po të ofroj fakte. Njeriun e keni çuar në burg, e keni quajtur terrorist, “ka dashur ta vrasë kryeministrin”, është liruar pas pesë muajsh pa asnjë provë.

S'e di, a po e kupton, Besë, këtë punë, që po dua të ta shpjegoj, sepse deshe s'deshe je bërë pjesë e këtij aparati të kapjes së shtetit, veç që ti je bërë shtojcë propagandistike e atij. Ai e ka ekzekutimin e vet, e ti je shtojcë propagandistike e tij, kur na quan neve “terroristë”. Edhe tërë ditën thuaj s'ju quajta, kur para tre minutash na quajte sërish, kur the “kanë gjetur maska e kanë gjetur mollotovë, e...”. E ke rastin e Policisë kur kanë shkuar te aktivistët dhe i kanë marrë armët, i kanë ekspozuar në konferencë shtypi armët, të cilat nuk kanë lidhje me “Vetëvendosjen”. Është vërtetuar që armët e Policisë janë marrë, janë prezantuar aty armët që nuk kanë qenë as të Frashërit, as të Atdheut, as të Astritit, dhe janë ekspozuar përpara në konferencë për shtyp për ta krijuar atë lidhjen asociative “shikoji armët e “Vetëvendosjes, shikoji këta terroristët”. E ti, Besë,

ti i ke shërbyer kësaj, mos e harro. Edhe qytetari s'ka për të ta harrua kurrë që i ke shërbyer në mënyrë të paturpshme.

KRYETARI: Kundër-replikë, Besa!

BESA GAXHERRI: Glauk, mua sinqerisht po më vjen keq, në radhë të parë edhe prej teje, tash ju pasi që jeni ndarë jeni bërë diqysh... s'po di njeriu as çka keni ju, çka mendoni, as pse e thoni, a qysh e thoni... unë nuk fola në emër të institucionit, as sot, as dje, as kurrë njëherë. Unë fola në emrin tim personal. Unë nuk jam ajo që besoj në institucionet tona. I kam gjykuar më shumë se ju, veç mënyra ime është ndryshe, nuk është e dhunshme sikur e juaja.

Ti mua guxon të më quash “je bërë pjesë e aparatit propagandistik”! Po, ju pse e mbani maskën, më tregoni ju mua, s'po më interesojnë mua institucionet, pse i keni maskat ju? Për çka i vini maskat, pse fshiheni pas maske ju? Po ua lë armët. Pse? Unë s'kam vënë maskë kurrë, as nuk vë kurrë maskë, unë guxoj ta shikoj secilin në sy, secilin prej të gjitha partive politike. Unë pa maskë jam, ju thoni çfarë të doni. Unë s'e kam... unë e kam jetën dhe guxoj të ju shikoj secilin në sy. Ju e keni shfrytëzuar, keni dalë nëpër studio dhe me atë fotografinë e fëmijëve të mi, ju deri në atë nivel shkoni. Ju nuk i kurseni as familjet, ju s'e kurseni as kolegun, as institucionin, juve s'u intereson kurrëgjë, veç vetja juaj dhe me mënyrën e juaj. Edhe këtë mundohu qysh të duash ta interpretosh ti, sepse unë e kam guximin dhe edhe një herë po ju pyes, për çka ju duhen juve maskat dhe armët në selitë e juaja? Pikë! Kjo është përgjigjja e juaj.

KRYESUESI: Zoti Frashër Krasniqi e ka fjalën.

FRASHËR KRASNIQI: Kam folur sot unë për deklaratat e zonjës Gaxherri në lidhje me rastin tonë, një ndër të cilat unë i kam pasur parasysh ka qenë deklarata e saj e dhënë diku rreth një vit më parë prej këtij momenti, kur ajo specifikisht, kur pyetet për Astritin thotë, që ai ka pasur aktakuzë, po citoj tash “ai ka pasur akuzë për terrorizëm”, gjë që s'është e vërtetë, se s'ka pasur aktakuzë, në fakt. “Vetëvendosje” ka qenë e papërgjegjshme, sepse një i ri mund të gabojë, por pa instruksionet e një subjekti politik nuk mund të hyjë në këto ujëra dhe kërkoj përgjegjësi nga “Vetëvendosja” edhe për vdekjen e Astrit Deharit”.

Kjo ka qenë deklarata, është citim. Ekziston nëpër arkiva, si video, si deklaratë e shkruar, mund ta gjeni zonja Gaxherri, nëse e keni harruar. Nëse ju thoni që “Vetëvendosja” paska pasur përgjegjësi, sepse një i ri mund të gabojë dhe “Vetëvendosja”, apo një subjekt politik e ka shtyrë në këto ujëra, kjo automatikisht nënkupton që ju po e akuzoni këtë se e ka bërë aktin terrorist, ani pse nuk ka pasur, as prova, as fakte, as aktakuzë për këtë punë.

Unë nuk di si ta interpretoj këtë deklaratë, përveçse akuzë publike për terrorizëm, madje edhe personalisht për Astrit Deharin, i cili, sipas jush, paskësh qenë i manipuluar prej

“Vetëvendosjes”, por që e ka kryer aktin, kjo nuk diskutohet, sipas jush. Dhe, nuk e keni lënë, në fund të fundit, as drejtësinë ta çojë deri në fund këtë rast, gjë për të cilën ju na keni akuzuar dhe na akuzoni vazhdimisht se po përzihemi në punët e drejtësisë.

Një deklaratë të tillë e kam pasur parasysh, kur ju keni thënë në Kuvend dhe në emisione e në deklarata që Kuvendi i Kosovës është sulmuar me zollë nga aktivistët, nga ju nga “Vetëvendosja”, nga aktivistët e juaj, aty dihet se për kë aludohet. Nuk është, në fund të fundit, e domosdoshme ju t’i përmendni emrat personalë, sepse ne veç kemi qenë të arrestuar, kur janë bërë këto akuza. Faleminderit!

KRYESUESI: Besa Gaxherri, urdhëro!

BESA GAXHERRI: Koleg i nderuar,

Unë jam zyrtare, jam deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në atë kohë kam dhënë intervistë e ftuar nga një medium, tash nuk e di cili, por diçka vërtet ti fitove prej aty. Por, unë po të them që kam qenë e ftuar pas vdekjes së dhunshme të Astritit në studio dhe mbaj mend, tash nuk mund ta citoj as veten, sepse nuk mund ta mbaj në mend definitivisht çfarë kam thënë, por i kam në kokë mendimet e mia, normalisht. Normalisht që Astriti ka qenë i dyshuar, njëri nga ai grup i dyshuar për terrorizëm. Asnjëherë s’kam thënë, as s’po them, që ka qenë fajtor. Por, atë ditë kam thënë “po, është i dyshuar”, por në qoftë se vërtet ai do të dalë fajtor, po. Atëherë kam thënë, edhe tash po them, edhe ju keni përgjegjësi, sikurse unë që kam përgjegjësi për elektoratin tim, në qoftë se unë ata i ushqej, ose i ftoj për një sulm të caktuar.

Por, nuk kam mundur unë të konkludoj, as dje, as sot, asnjëherë, që Astriti ka kryer vepër penale. Tjetër është ju çfarë doni të nxirrni prej kësaj, tjetër është çka unë kam thënë. Edhe normalisht, insistoj prapë, ju e dini vetë se çfarë sjelljesh keni pasur, qysh jeni sjellë, qoftë në Kuvend, qoftë në rrugë, qoftë nëpër të gjitha institucionet dhe tash nuk mund t’i ikni përgjegjësisë. As nuk keni nevojë, as nuk keni mundësi ta drejtoni gishtin kah asnjëri nga ne, aq më pak te unë. Unë s’mund të ju kuptoj juve pse më drejtoheni mua, kur ju nuk keni argument, kurrë s’kemi pasur, as s’kemi, që unë e kam quajtur dikë “terrorist”. Asnjëherë! Individu... në demokraci përgjegjësia është individuale, por unë kërkoj përgjegjësi prej hierarkisë së “Vetëvendosjes”, sot mund të jeni të ndarë, nuk e di tash qysh e keni pasur atëherë, kush ka qenë përgjegjës që ju në selitë e partisë suaj politike keni futur maska, mollotov, edhe gaz lotsjellës dhe armë të ftohta. Kjo për mua është gjithçka. Unë nuk jam marrë me individë. Unë merrem me juve drejtpërdrejt, jemi të ulur këtu dhe kemi përgjegjësi institucionale dhe shtetërore të barabartë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Kur diskuton për çështje të ndjeshme të tilla, që i takojnë drejtësisë, por që politizohen për qëllime politike dhe kur dëgjon diskursin e fjalimeve këtu, je në dilemë si ta fillosh diskutimin. Nuk ke si të mos u japësh të drejtë atyre njerëzve të thjeshtë, që janë irrituar me politikën që bëhen këtu, që kanë filluar ta ndiejnë si humbje kohe që të na shikojnë në debatet televizive.

Jashtë kësaj sale, ku e ofendojmë njëri-tjetrin vend e pa vend, janë shumica, janë qytetarët tanë që u gjenden përballë sfidave e betejave të shumta për liri, për ta formuar e ndërtuar shtetin tonë të pavarur e sovran, janë gjenerata e re me plot ambicie për të ardhmen e shtetit tonë, të cilët nuk pajtohen me politikën e denigrimit të njerëzve, të parimeve e sukseseve, nuk pajtohen me banalizimin e politikës, sepse ata presin nga politikanët, presin nga ne të bëjmë më shumë që në këtë vend të ketë më pak ndasi, të ketë më shumë drejtësi, të ketë më shumë punë, më shumë përkujdesje shëndetësore, më shumë shpresë për të ardhmen, më shumë vlera që na ofrojnë me shtetet e zhvilluara të Bashkimit Evropian.

Fjalori joparlamentar i përdorur në këtë Kuvend nga Lëvizja “Vetëvendosje” është i papranueshëm për qytetarët. “Vetëvendosja” po e përdor parimin “sa më shumë të pavërteta të thuash, bëhesh më i besueshëm; sa më shumë fyerje të thuash, bëhesh më bindës”, duke u servilosur këtu sikur engjëj, e që në fakt nuk lënë gjë pa bërë për ta nëpërkëmbur identitetin e institucioneve, duke mos i respektuar ligjet, as rregullat, të cilat i kemi bërë vetë, duke abuzuar me vlerat e shtetit.

Të nderuar deputetë,

Kështu nuk i bëhet shërbim vendit tonë. Kosova shtet e ka zgjedhur rrugën e saj drejt integritetit evropian, e ka zgjedhur rrugën për fuqizimin e shtetit, e në këtë drejtim janë bërë punë të mira. Gjërave të mira duhet t’u gëzohemi gjithsecili e t’i shtyjmë përpara, por atyre që dëmtojnë t’i ndalojmë, duke e vënë në prioritet forcimin e shtetit, zbatimin e ligjit, rritjen e punësimit dhe mirëqenien e qytetarëve tanë.

Kolegë të nderuar,

Po kalojnë vitet dhe nuk po ndalet fushata manipulative nga “Vetëvendosja” duke e përdorur humbjen tragjike të jetës së Astrit Deharit. E dhimbshme që mbi tragjedinë e një djali të ri të një familjeje atdhetare të ndërtohen kauza politika për të arritur në pushtet. Për çështjen “Dehari” duhet të thuhet e vërteta nga drejtësia, duhet të thuhet e vërteta edhe nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Në “Vetëvendosje” të veprojnë ndërjegjija para politikës, koncepteve dhe egove të sëmura për të arritur në pushtet.

“Vetëvendosja” duhet të ndalojë së përdoruri shuarjen e jetës së Astritit si pretekst për mobilizim politik, sidomos në rrethanat e krijuara brenda tyre. Nuk duhet ta përdorë jetën e një të riu për t’u rikonsoliduar nga përçarjet e brendshme që kanë ndodhur në “Vetëvendosje”. Nuk dua ta

paragjykoj rastin e Astrit Deharit, duhet të zbardhet gjithçka çfarë ka ndodhur me të, qoftë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, dhe pajtohem edhe me atë që të dërgohet rasti edhe në Gjykatën e Strasburgut, por kurrë nuk pajtohem që vdekja e tij të jetë kauzë politike për t'i mbuluar të bëmat e tyre dhe për t'i tejkaluar ndasitë e tyre, sepse ka humbur jeta e njeriut, është shuar jeta e një dali të ri, i një familjeje atdhetare dhe shumë të nderuar e të respektuar, me të cilën bashkëndiej dhembjen për humbjen e dy fëmijëve të tyre.

Dua që në Kosovën tonë të veprojë drejtësia dhe e vlerësoj punën që po bën Qeveria dhe në veçanti Ministria e Drejtësisë, dhe dua t'i inkurajoj për veprimet e bëra për ta forcuar sektorin e drejtësisë, duke e shtuar buxhetin dhe duke i evituar mangësitë në ligjet ekzistuese, sepse ky vend ka nevojë për rregull e shtet ligjor, ka nevojë për respektim të ligjit të standardeve që i kemi vënë vetë këtu në këtë Kuvend.

Unë, edhe një herë tjetër, në këtë Kuvend, e kam shtruar pyetjen: Pse aktivistët e "Vetëvendosjes" vetëflijohen? Pse i kanë dhënë fund jetës së tyre me vetëvrasje? Opinioni mund të kuptojë shumë nga këto përçarjet e fundit, por fjalën e fundit duhet ta japin profesionistët e fushave të tilla. Profesionistët të kontribuojnë në qartësimin, por jo sipas interesave politike, sepse opinioni duhet të informohet se çfarë po ndodh këtu.

Shoqëria jonë, por as të rinjtë tanë nuk kanë nevojë për ideologji dhe frymëzim antidemokratik, që e ka instaluar "Vetëvendosja". Ky vend nuk ka nevojë të instalohet mentaliteti i individëve, ligji i partive politike, por ligji i shtetit demokratik. Nga situatat e fundit, që po ndodhin në "Vetëvendosje", u kuptua se në shekullin XXI nuk është më koha e sakrificave të dëmshme, nuk është koha më për sakrificë dhe lojalitet ndaj udhëheqësve shpirtërorë, sepse vjen në shprehje shpirtngushtësia dhe ngulfatet demokracia.

Të nderuar deputetë,

Qeveria dhe institucionet tjera që kanë përgjegjësi në këtë vend duhet të angazhohen fuqishëm për ta ndërruar situatën ekonomike e sociale, që të reflektojnë te të rinjtë tanë që të mos e zgjedhin rrugën e viktimizimit për interesa politike. Faleminderit!

KRYESUESI: Glauku ka replikë.

(Reagime nga salla)

O ti djalë, nuk u është dhimbsur veç juve, mos u bëni kështu. Të gjithëve na është dhimbsur.

GLAUK KONJUFCA: Gjatë viteve të '90-ta, në kohën e Milosheviqit, serbët e patën krijuar njëfarë shprehjeje "veç shqiptari i vdekur është shqiptar i mirë". Ky fjalimi i Safetes ma kujtoi

këtë për “Vetëvendosjen”, kur e lavdëroi shumë Astritin, e na goditi neve. Veç “Vetëvendosja” e vdekur për këtë është “Vetëvendosje” e mirë.

KRYESUESI: Zoti Veseli, kryetari i Kuvendit, e ka fjalën.

KADRI VESELI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, ndoshta është mirë që është thirrur kjo interpelancë. Është mirë të ketë debat, veçanërisht për çështje që janë bukur shqetësuese. Është e vërtetë, ka disa kohë që e mban pezull edhe skenën politike kosovare, po më së veçanti vetë qytetarët e Republikës sonë. Është shqetësuese kur në shtetin tonë të pavarur dhe sovran, në Republikën e Kosovës, qytetarët e së cilës kanë pasur përjetime shumë të rënda, ka pasur shumë njerëz nëpër burgje dhe është e vërtetë kanë pësuar shumë rëndë në rrethana të pasqaruara, pastaj edhe në rrethanën e lirisë së Kosovës, kemi dyshime të tilla.

Sido që të jetë, është mirë që bëhet debat, le të shikohet. Qytetarët e duan të vërtetën. Të gjithë ata prindër që janë, si prindërit e Astritit, e duan të vërtetën, a ka ndodhur, çka ka ndodhur, a ka vënë duar shteti mbi të, apo ka diçka e cila nuk është në përgjegjësinë e shtetit, e që mund të jetë përgjegjësi politike, ose njerëzore, ose sido që të jetë. Ajo që është kryesore, ne duhet të vijmë te e vërteta.

Më lejoni të theksoj, po flas si pjesë e këtij koalicioni, është mirë që në këtë koalicionin tjetër jemi edhe me partnerë të rinj, para qytetarëve tanë, nuk ka çmim, nuk ka mjet, nuk ka shpenzim, nuk ka veprim, nuk ka vendim, të cilin nuk jemi të gatshëm ta ndërmarrim për të shkuar te e vërteta. S’ka vendim, veprim, iniciativë, cilado të jetë, pak ndodh në shtetet e pavarura sovrane kur goditet në mënyrë aq abuzuese dhe shteti. OK, duam të shkojmë te një institut jashtë, shkojmë. E shikojmë dhe kemi për të shkuar, por ne të gjithë bashkërisht pastaj duhet të jemi kolegë të të gjitha partive të gatshme për ta pranuar edhe përgjegjësinë, edhe rezultatin e asaj.

Ajo që është kryesore, bile për këtë punë, nuk kemi pasur nevojë të thellohemi në konflikte aq shumë, por pastaj kur jemi para kësaj foltoreje, shpeshherë më tepër po orientohemi nga akuza, të cilat nuk janë të mira, po mundohen të manipulojnë. Ndoshta është qëllimi... por mirë, në politikë jemi për ta fituar pushtetin, por edhe pushteti nuk të vyen kurrgjë me çdo mjet, edhe pushteti nuk të vyen kur e humb etikën dhe qëllimin pse angazhohesh.

Unë do të pajtohem me Albinin për një çështje, diçka shumë e vërtetë është kjo, gjithsesi atë djalë të ri, që ka lindur në Zvicër, është një djalë i cili i ka prindërit, qoftë babanë, qoftë nënën, veprimtarë të lëvizjes në rrethana shumë të rënda, është e vërtetë që politika e ka çuar në vdekje. Kjo është e vërtetë. Unë e kam frikën, Albin, se është një politikë e pafytyrë, politikë e cila me çdo kusht e do veç pushtetin, një politikë e cila më së paku i duhet sot Kosovës, një politikë të

cilën je duke e promovuar ti, Albin Kurti. Kjo është ajo me të cilën do ta përfundoja fjalën me kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka kërkuar fjalën për replikë.

ALBIN KURTI: Nëse ka ndonjë shembull që dëshmon se ne nuk e duam pushtetin me çdo kusht, jemi pikërisht ne.

Tërë jetën në opozitë. Nëse ka ndonjë shembull të subjektit të pakorruptuar, të njerëzve që janë në udhëheqje, e që banojnë ende me qira, jemi ne. Ne kurrë s'bëhemi si ju. Ju, edhe e keni tradhtuar kauzën kombëtare, edhe e keni shitur vendin me privatizim. Prandaj, s'pritet kurrëgjë e mirë prej juve, e natyrisht që në fund edhe gënjeni.

KRYESUESI: Zoti Veseli e ka fjalën.

KADRI VESELI: Kjo puna e moralizimit, të shiten banesa e në të njëjtën kohë t'i kesh në konto 85 mijë euro që janë zyrtare, kjo është pak e çuditshme. Kjo pjesë bash nuk po më intereson, secili ka për ta bartur pjesën e moralit.

Kjo pjesa që po më bën shumë përshtypje, është pjesa e akuzave për tradhti shumë lehtë, që e kemi shitur, se as të babës nuk mund ta shesësh ashtu. E kupton, thjesht! "E kemi shitur Mitrovicën, e kemi shitur Kosovën".... thjesht, kjo është pak banale, po blijeni, mbrojeni. Kush e ka shitur? Blijeni, mbrojeni... ajo që është kryesore, është mirë të ndalemi te kjo pjesa që aktualisht janë sfida. Sfida është që aktualisht kemi të bëjmë me rastin e Astrit Deharit dhe me rastin e vdekjes së tij. Do të shkojmë deri në fund, po e ripërsëris edhe një herë, në çdo iniciativë të cilën e dëshironi, deri në fund. Është e rëndë pak kur nuk njihet shteti i Kosovës, por të shkojmë edhe te ajo pjesë. Çdo institut ndërkombëtar, i cili pranon, përveç atij që kanë kërkuar vetë familjarët, i cili është në Zvicër, çdo shtet që mendoni se është më korrekt se Republika e Kosovës ndaj Astrit Deharit dhe familjes së tij, kemi për të shkuar deri në fund, po jua japim fjalën, për ta gjetur të vërtetën. Por, kur të dalë e vërteta, duhet ta pranojmë të gjithë bashkë. Kjo është!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Më 9 shkurt 2018, në Kuvendin e Republikës së Kosovës u miratuan tri pika të mocionit të Lëvizjes "Vetëvendosje" përkitazi me aktivistët tanë që pak ditë më parë u liruan nga Gjykata e Apelit dhe rasti i tyre u kthye në rivendosje.

Unë do doja që t'i lexoj këto tri pika, pasi kryeministri Haradinaj po thotë që e respekton vullnetin e Kuvendit, të deputetëve të Kuvendit. Vetëm po dua t'jua përkujtoj se cilat janë pikat e

këtij debati, që janë votuar në Kuvendin e Republikës para disa ditësh, përkatësisht para pak më shumë se një muaji.

- Për rastin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës më 4 gusht 2016 të kërkohet dhe të mundësohet një hetim i plotë, i pavarur, ndërkombëtar i tërë rastit nga ndonjëri nga vendet perëndimore të Bashkimit Evropian, përfshirë vendet neutrale të Evropës Perëndimore dhe Zvicrën, përjashtuar rastin e Astrit Deharit, që do të hetohet veçmas.

- Të hetohen dhe të gjendet përgjegjësit në hierarkinë e lartë të Policisë së Kosovës të përfshirë për inskenimin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit më 4 gusht 2016 dhe për përndjekjen kriminale të aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” për këtë rast, dhe

- Të hetohen dhe të merren në përgjegjësi ligjore të gjithë personat përgjegjës në hierarkinë shtetërore për përndjekjen e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe për vdekjen e Astrit Deharit.

Tash, në vend se menjëherë të respektohet dhe të jetësohet vullneti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, atë ditë kemi parë tri deklarata, komunikata për shtyp: nga Ministria e Integritimit, nga Këshilli Gjyqësor dhe nga Ministria e Drejtësisë. Madje, akuzonin Kuvendin që po ndërhyr në sistemin e drejtësisë, merreni me mend. Të gjithë ne këtu e dimë që Kosova nuk ka sistem të pavarur të drejtësisë, këtë e kanë dëshmuar edhe aferat e klanit “Pronto”, ku protagonistin është personi që sapo e përfundoi fjalën e tij, me akuzat të pabaza dhe po të kishim një shtet normal, sigurisht që s’do të paramendohej që një njeri si Kadri Veseli të jetë pjesë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, por do të duhej të jepte përgjegjësi.

Dhe, sistemi ynë i brishtë i drejtësisë këtë e lë që të jetë kryetar i Kuvendit. Por, zonja ish-ministre e Drejtësisë ju nuk keni dhënë asnjëherë përgjegjësi që në duart tua ka vdekur një aktivist politik. Në Sllovaki, që është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, para disa ditëve është vrarë një gazetar dhe e dashura e tij. Menjëherë, ministri i Kulturës ka dhënë dorëheqje, me arsyetimin që nuk mund të jetë ministër i Kulturës në një shtet ku vritet gazetari dhe kryeministri i Sllovakisë thotë që në qoftë se kërkohet dorëheqja e tij, unë jap përgjegjësi dhe dorëheqje. Isa Mustafa në atë kohë përveçse s’ka dhënë dorëheqje, akuzonte Lëvizjen “Vetëvendosje”, asnjë person tjetër, përfshirë ministren e Drejtësisë që sot po qeshet këtu, në vend që të jepte llogari, askush s’ka dhënë dorëheqje dhe në vend që ministri i Drejtësisë këtu, sot, Abelard Tahiri, të na njoftonte se kush nga personat kanë dhënë përgjegjësi, qoftë morale, qoftë politike, qoftë penale në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Kush?! A ke emër dhe mbiemër? Dhe, si kanë dhënë përgjegjësi ata persona? Asnjë njeri, fare!

Prandaj, unë i thërras deputetët e Kuvendit që ta mbështetin rezolutën e Lëvizjes “Vetëvendosje”, sepse ne duhet të jemi shembull, në qoftë se pretendojmë që të jemi shtet anëtar

i Bashkimit Evropian, duhet të veprojmë me parime, vlerat dhe standardet e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar zonja Haxhiu,

Ju jeni juriste, me sa e di, edhe ju vetë leximi që u bëtë të konkluzioneve që i ka miratuar Kuvendi para kësaj kohe, ju vetë besoj gjeni aty, vetëm një i drejtohet ekzekutivit. Pra, vetëm e para për të mundësuar një hetim nga e drejta jonë. Të dy të tjerat, hetimet kur i përmendini, nuk e di, shiko, vetëm a ta pastrojmë pak, pasi jeni juriste, të mos ishit juriste s'kisha shkuar në këtë rrafsh.

Hetimi ndërkombëtar nga aspekti ekzekutiv, ne në fakt e kemi aprovuar, ajo po ndodh, të shkojmë pak më real. Ajo ka ndodhur, ne e kemi aprovuar dhe s'kemi pritur të na bëjë kurrkush ndonjë presion, e falënderoj edhe ministrin e Drejtësisë, Abelardin, edhe kolegët e tjerë, kanë qenë korrektë, e kemi pritur familjen. Është një ndryshim në qasje, e kemi bërë, pastaj hetimin për shkeljet procedurale, ligjore, e tjera, besoni, edhe ti po të jesh në Qeveri s'ke të drejtë ta bësh. E bën prokuroria, e bëjnë disa instanca të caktuara, s'e kemi ne, ekzekutivi, edhe Parlamenti s'guxon të nxjerrë këso konkluzimesh, drejtuar Ekzekutivit. Mund të krijoni, s'po di si të them, konkluzione të natyrave të tjera për Ekzekutivin, por jo këto, se nuk jemi në rregull. Ja Samiu është këtu, edhe ai është jurist, kemi edhe juristë të tjerë, merreni këtë material e shihni, çka janë detyrat tona, ia keni dhënë ekzekutivit si kërkesë, po hetim ndërkombëtar, në rregull. Të tjerat, besoni, s'na vijnë ne, se s'guxojmë edhe ne, në kuptimin nesër kushdo që është në Qeveri, s'guxon të bëjë hetime, se këto hetimet për këto vepra, ndoshta s'po di, nëse e keni fjalën për ndonjë masë disiplinore, s'po di të çfarë natyre, thyerjen e rregullave të punës, a? Po ato hetime që po i lypni ju qoftë brenda Policisë, qoftë brenda sistemit korrektues, ato i bën tjetër kush, i bëjnë ata që herë po u besoni kur po e shpallin dikën të pafajshëm pas pesë muajve, herë ashtu.

Edhe unë i kam pikëpamjet e mia, nëse duam të flasim, në këtë foltore para dy-tre ditësh e dhashë një mendim, u nxitova, e pashë që më kishin kritikuar që po foli për vendime që janë e drejtë ekskluzive e gjyqësorit, për ata edhe s'po dua të shkoj më andej. Por, ju lutem, vetëm një pikë na vjen dhe ne e kemi zbatuar. Dhe, bazuar në këtë që po e thoni ju, nuk ka më rezolutë për ekzekutivin. Unë ju thashë edhe më herët, asnjë problem nuk e kam në atë pse ka dyshime, pse s'po besohet, në rregull jemi. Edhe të lypni përgjegjësi, keni të drejtë. Unë ju tregova për punë të përgjegjësive, standardeve, ato- këto, ku jemi, qysh jemi. Mirë që na krahasuat me Sllovakinë, është shtet evropian, ka ecur në ekonomi shumë, kur janë ndarë në mënyrë paqësore me Çekinë, kanë pasur një perspektivë të jashtëzakonshme, ne ende jemi diku tjetër, shpresoj që i mbërrijmë ata.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar kryesues, nënkryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zoti Kurti, me tendencën tuaj për të instrumentalizuar për qëllime politike një rast tejet të dhimbshëm, të humbjes së jetës tani të ndjerit Astrit Dehari, në mend më bien tri opsione, me të cilat mund ta interpretoj tendencën tuaj për instrumentalizim të kësaj çështjeje tejet të dhimbshme.

Nën një, ose jeni tejet djallëzor dhe keni urrejtje patologjike kundër partisë, të cilën e përfaqësoj dhe dëshironi me çdo kusht të instrumentalizoni këtë çështje deri në pafundësi, madje duke ndërhyrë edhe në proceset e pavarura të organeve të rendit.

Nën dy, ose jeni të instrumentalizuar nga qarqe proruse, të cilat dëshirojnë me çdo kusht destabilizim në vendin tonë dhe në skenën politike, duke qenë mosbesues ndaj çdo institucioni të vendit tonë, duke përfshirë edhe organet gjyqësore të Kosovës të ndihmuara nga institucionet ndërkombëtare, ose nën tre, keni tendencë paranoike për të perceptuar gjërat në formë selektive, duke anashkaluar argumentet dhe faktet dhe duke i përzgjedhur vetëm ato të dhëna, të cilat ju konvenojnë juve, siç është edhe rasti me demarkacionin.

KRYESUESI: Pesë minuta pauzë! Seanca, pesë minuta pauzë!

(Ndërprerje)

Ju lutem, e kam dhënë pauzën, pushoni, e vazhdon pastaj ministrja fjalën. S'ta marr fjalën unë ty, mos u bë merak. Pesë minuta kemi pauzë, ju kisha lutur shkoni nëpër vendet tuaja.

Ju lutem, zini vendet tuaja ta vazhdojmë seancën. Nuk është mirë për neve që në një seancë kaq të ndjeshme të bëjmë këso gjestesh. Ju lus pa ofendime! Secili e ka fjalën e vet, secili e ka mënyrën e të shprehurit, keni të drejtat tuaja, keni të drejtën për t'iu kundërvënë me fjalë, me replikë, me të gjitha këto, këto janë rregullat e Kuvendit.

Edhe ju quajtet mjaft kriminelë, edhe kjo nëse e ka pasur fjalën pak më të rëndë, përgjigjuni, thoni që s'e ke mirë, por jo kështu. Ju lus, uluni, jemi të gjithë kolegë. Uluni, të gjithë në vend! Është më mirë për ne të gjithë, është më mirë për Kuvendin e Kosovës, është më mirë për secilin këtu.

Nuk kemi nevojë të tregojmë sa të fortë jemi me njëri-tjetrin, as që duhet të bëjmë këso gjestesh. Ju kisha lutur! Ju kisha lutur, uluni, nuk shkarkohen deputetët, as ministrat pse zhvillojnë debat në Kuvend.

(Ndërhyrje)

Mirë, mirë, nuk jeni ju ata që i përjashtoni ministrat, por është kryeministri! Ju mund të bëni mocion, ju lus, e keni të drejtën e mocionit nesër ta bëni, sonte. A doni sonte bëjmë mocion të jashtëzakonshëm, por nuk mund t'ia impononi kurrkujt vendimet sipas qejfprishjes së momentit. Ju lus, fjalori i secilit në këtë sallë ka pasur teprime, secili ka pasur teprime, mos kështu, edhe ju keni pasur teprime. Kurrkujt s'ia ndala fjalën, kurrkujt s'ia mora fjalën, kjo u shpreh si ministre, ka qenë ministre, edhe le ta vazhdojë diskutimin e saj, e ke radhën ti, Sami, pastaj të flasësh, ti nuk je më Ombudsperson këtu, je deputet.

Ju lus, uluni, edhe po ju lus, çdo veprim në këtë formë na dëmton të gjithëve, jo veç juve, jo veç neve. Rregullat i kemi për të gjithë njësoj. Thirrni, bëni mocion, thirrni seancë të jashtëzakonshme, thirrni debat me ministren pikërisht për këtë fjalim që e ka bërë. E bëjmë debatin nesër, e shtunë është, sonte nëse doni, deri në mëngjes rrimë e zhvillojmë debat, por jo në variantin që filloi. Ju lus, të keni mirëkuptim dhe ministrja duhet ta vazhdojë fjalën, pastaj ju merreni fjalën.

Unë s'mund t'ia marr fjalën, vetëm nëse ajo dëshiron. Zoti Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

(Ndërprerje)

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje, dëgjoni, veç një moment, vërtet në diskutime u lakua disa herë emri i ministres, edhe unë e kam dëgjuar disa herë, po ju them, jemi kolegë, ne kemi qenë bashkë opozitarë me "Vetëvendosjen", e dini, në atë kohë të opozitës i gjeni deklaratat e mia që kam thënë se mos jemi duke e tepruar në kërkesën për llogaridhënie të një ministre, sa e ka pas marrë detyrën në atë kohë, nuk e di a është kështu, se atëherë ka qenë një ministër tjetër nga po e njëjta parti, kjo ka ardhur.

Unë për fat pjesën e fundit të diskutimit nuk e përcolla, nuk isha në përcjellje të kësaj pjese, mirëpo mendoj që ne e nderuam si Parlament, si Qeveri, vërtet jo veç dhimbjen, por edhe, po e quaj ashtu, të drejtën për Astritin, nuk mendoj se e meriton një epilog ky debat kështu, qysh po duam ta biem punën së bashku. Ka raste të tjera, për tema të tjera, çka të doni bëjmë, po në këtë temë, mos se s'është në rregull, ka shumë dimensione pse s'duhet, edhe ju luta edhe më herët, përkrahni Qeverinë që t'i kryejë ato detyra që ka për një të vërtetë, nuk e dimë ajo e vërtetë çka është, ju luta po ashtu që ta bëjmë njëfarë konsensusi, në fund të fundit çka duam të koritemi, e gjejmë një temë, çfarë të doni bëjmë, por nuk është rendi sot kështu, besoni. Edhe nuk po dua as

ta teproj me çka do qoftë, po mendoj që sot e meriton njëfarë respekti kjo ditë, do ta kemi rastin, ne këtu jemi, do të bëjmë kundërshtime politike në tema të tjera. Për shembull, sot Andini më ndali në korridor, Andin Hoti, edhe më tha faleminderit që keni bërë një gjest, një gjest shumë i vogël është, një shpronësim për shtëpinë muze në Krushë. I thashë është nder për Qeverinë, i ka rënë ajo detyrë, kurrëgjë s'është.

Për këtë arsye edhe në këto dimensione ju kisha lutur që të kemi kujdes, do të kemi të tjera mundësi të vazhdojmë debatin, s'po ju mendoj më shumë.

KRYESUESI: Atëherë, po e vazhdojmë seancën, zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Atëherë, unë po vazhdoj fjalimin tim, jeni shndërruar në ekspertë të Forenzikës, kurse i gjithëdijshtëm jeni bërë edhe ekspert i policisë, ekspert i interpretimit të deklaratave, ekspert i çështjeve mjeko-ligjore, madje edhe ekspert i prokurorisë.

Sa kam qenë ministre e Drejtësisë, kam marrë këtë rast me seriozitetin më të madh të mundshëm dhe kam ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbardhjen e këtij rasti. Unë e di që ju jeni ithtar i ideologjisë, se qëllimi arsyeton mjetin, por nuk mund të kuptoj se si jeni në gjendje të përdorni çdo mjet, duke përfshirë edhe këtë rast tejet të dhimbshëm, për ta arritur qëllimin tuaj destruktiv, i cili është të arrini kaos dhe vetëshkatërrim të shtetit, për të cilin jemi sakrifikuar me breza. Pse duhet të jeni destruktiv tërë kohën? Nëse ishit pyetur ju, Kosova nuk do të kishte nënshkruar as Marrëveshjen e Rambujesë, sepse edhe në atë kohë keni pasur teori konspirative. Doli krejt ndryshe nga ajo që e proklamoni. Gjithashtu, në vazhdim më lejoni të shpreh shqetësimet lidhur me rekomandimet e miratuara nga Kuvendi dhe të paraqitura nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes dhe "Vetëvendosje".

Këto rekomandime cenojnë rëndë pavarësinë e gjyqësorit dhe të sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe, si të tilla, janë në kundërshtim me parimin themelor, kushtetues, të ndarjes së pushteteve. Përveç kësaj, rekomandimet në fjalë cenojnë detyrimet e Kosovës që rrjedhin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim për të respektuar pavarësimin e sistemit të drejtësisë, si një prej vlerave kryesore të Bashkimit Evropian. Ndërhyrje politike në pavarësinë e sistemit të drejtësisë, siç ishte miratimi i rekomandimeve në fjalë, cenojnë rëndë procesin e integritetit evropian të Kosovës, si një prej proceseve më të rëndësishme për zhvillimin e vendit. Ndërsa, në lidhje me interpelancën e sotme, e cila i dedikohet humbjes së jetës së tani të ndjerit Astrit Dehari, fillimisht dua të shpreh keqardhje të thellë, si dhe të them se kemi bashkëndjerë dhe bashkëndiejmë me familjen Dehari për humbjen e tyre.

Gjithashtu, më duhet të them se është për keqardhje sa larg mund të shkojnë disa individë që për qëllime politike të keqpërdorin vdekjen e një të riu, ashtu siç e kanë keqpërdorur që nga dita e parë kur ka ndodhur rasti. Albin Kurtit po i duhet një kauzë personale që të heqë vëmendjen prej

skandaleve që dolën nga partia e tij dhe kur them skandalet, e kam fjalën për akuza e kundërakuza që i kanë bërë përfaqësuesit e kësaj partie për njëri-tjetrin, duke përfshirë edhe akuza për përdorim të substancave narkotike në objektet e partisë, e deri te aktet e tjera të ulëta morale që nuk mund të përmenden në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Zoti Kurti kërkon shkarkimin tim se kinse unë nuk e paskam kryer punën time, një deklaratë sa e pavërtetë, aq edhe e turpshme, por e kemi parë së fundmi se Partia “Vetëvendosje” ka probleme serioze me trajtimin e grave dhe kjo reflekton edhe qasjen që ka zoti Kurti dhe të tjerët nga partia e tij ndaj meje.

Është evidente që keni probleme me gratë dhe trajtimin që u bëni atyre dhe ka pasur akuza publike të grave brenda partisë tuaj për trajtime jo të duhura, se çka keni bërë e dini ju më së miri dhe gratë në partinë tuaj. Më lejoni të përsëris, kam bërë çdo gjë që ka qenë në kompetencën time, unë nuk kam qenë në qeli me të ndjerin, nuk e kam takuar kurrë të ndjerin dhe menjëherë pasi jam njoftuar për rastin, kam lejuar dy deputete që t’i vizitojë aktivistët e tjerë në qendrat e tjera të paraburgimit dhe kam qenë maksimalisht bashkëpunuese dhe kam ndërmarrë veprime që kanë qenë kompetencë imja.

Këtu unë do të doja të ngrija çështjen edhe ndërgjegjes njerëzore. Sinqerisht, nuk e kuptoj sa të ulët duhet të jenë këta individë dhe si flenë të qetë kur për qëllime politike, për qëllime të reagimit të vëmendjes nga përplasjet dhe ndarjet brenda grupit, keqpërdorin humbjen e jetës. Zoti Kurti, në vend se të kërkonte shkarkimin tim e të tentoni të pastroni ndërgjegjen duke u bërë kinse i zhurmshëm për këtë çështje, thërrisni ndërgjegjes suaj dhe tregoni qytetarëve të Kosovës si mund të jeni i qetë ju kur jeni ju ata që kurrë nuk e keni lejuar të ndjerin të takohet vetëm me familjen e tij, pa prezencën tuaj.

Si mund të vazhdoni ju të udhëhiqni një parti politike, ku vetëvrasja e aktivistëve nuk ka ndodhur vetëm një herë, nëse po kërkonte shkarkimin tim për vetëvrasjen e të ndjerit Astrit, ku do ta kërkonte kurbanin për vetëvrasjen e vëllait të Astritit. Si nuk ju vjen turp të akuzoni pa bazë e nuk u tregoni qytetarëve çka ju keni bërë që dy vëllezër aktivistë të partisë suaj kanë bërë vetëvrasje. E thashë më herët, unë nuk e kam njohur të ndjerin, nuk e kam takuar asnjëherë, pse nuk u tregoni qytetarëve çka i keni thënë të ndjerit që e keni bërë të ndjehet aq keq që është dëshmuar me disa shkrime që rrodhën edhe nga ditari i tij që doli në medie.

Ju jeni të vetmit që e keni takuar vazhdimisht në Qendrën e Paraburgimit, pse nuk u tregoni qytetarëve çka i keni thënë, apo pse nuk mendoni çka do të duhej t’u thoni, t’ia lehtësonit situatën e të mos përfundonte si ka përfunduar. Komunikimet e fundit që dolën nga problemet që keni brenda partisë po dëshmojnë se keni ditur që nga fillimi se i ndjeri ka kryer vetëvrasje. Por, pa pikë turpi, pa pikë keqardhje keni keqpërdorur dhe vazhdoni të keqpërdorni. Ju e keni keqpërdorur dhe vazhdoni ta keqpërdorni edhe familjen e të ndjerëve, Arbënorit dhe Astritit. Menjëherë pasi kam marrë lajmin për vdekjen e Astritit, kam kërkuar kontaktet e familjes për të

shprehur ngushëllime, por nuk jam lejuar as t'i kontaktoj familjen, sepse keni thënë duhet të flisni me zyrtarë të partisë, sepse ju nuk e keni lejuar familjen të ketë mendim të vetin, siç nuk e lejoni askënd në partinë tuaj.

Prandaj, edhe po ju quajnë “baba”. Po, zoti Kurti, “baba” a dërgon aktivistë drejt vetëvrasjes, përveç nëse e keni keqkuptuar rolin. Institucionet kompetente, ekspertë të mjekësisë ligjore, në një proces transparent me prezencën edhe të mjekëve të tjerë të propozuar nga familja, vëzhguesve nga EULEX-i, kanë konstatuar se i ndjeri është vetëvrasë, edhe Prokuroria e Shtetit ka dalë me njoftimin zyrtar se pas hetimeve preliminare rezulton se i ndjeri është vetëvrasë.

Pikërisht pse kam ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe brenda kompetencave, pa hezitim kam kërkuar përfshirjen edhe të “Scotland Yard”-it. Prandaj, për fund, në atë mënyrë dhe instrumentalizime me këto veprime ju po tentoni ta kapni shtetin. Lërimi organet e rendit dhe të drejtësisë ta thonë fjalën e vet, duke përfshirë edhe hetimin ndërkombëtar, i cili tanimë është autorizuar, pasi po ju intereson e vërteta, pse po bëni gjithçka që të pengoni këtë dhe keni ndërhyrë tërë kohën që nga fillimi për ta penguar të vërtetën. Pra, duhet të lejoni që e vërteta, cilado që të jetë, të dalë në shesh.

KRYESUESI: Faleminderit! Faleminderit prej të dyja palëve, faleminderit që u qetësuan të dyja palët, në rregull është. Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryesues, faleminderit!

Ishte për t'u përshëndetur kërkesa juaj për ta ndërprerë seancën pesë minuta, në fund të fundit, besoj që kur të merrni vendime të tilla, duhet t'i respektoni si kryesues i kësaj seance dhe mos lejoni që Kuvendi i Republikës së Kosovës të shndërrohet në arenë të përplasjeve, qoftë edhe nga ato që mund të jenë emocione subjektive.

Lidhja Demokratike e Kosovës, Grupi Parlamentar, do të abstenojë më tutje nga ky debat dhe arsyeja kryesore është që grupet politike, edhe mazhoranca, edhe kërkuesit e interpelancës e kanë humbur kontekstin e thirrjes së këtij debati.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Konsideroj që interpelanca për rastin “Dehari” shkoi mirë, derisa deputetët e “Vetëvendosjes” filluan të fyejnë, fillimisht kur foli deputetja Safete Hadërgjonaj, pastaj ministrja Dhurata Hoxha, Besa Gaxherri gjithashtu më herët, dhe prej fillimit, nëse i shikojmë në aspektin si deklarojnë dhe si veprojnë, këta të japin të kuptosh që të vetmit janë në këtë Kuvend që nuk janë të interesuar për t’u zgjidhur dhe të zbardhet ky rast.

Fatkeqësisht, unë nuk e them çka këta kanë në zemër, por e them çka po deklarojnë dhe çka këta po manifestojnë me veprimet e tyre. Nëse e marrim në retrospektivë, çështja “Dehari” është politizuar shumë, është shumë e rëndë kjo që i ka ndodhur Republikës së Kosovës, është shumë e rëndë kjo për familjen, është turp për një subjekt politik që në tragjedinë e një familjeje, apo të një djali të ri, një shtetasi të Republikës së Kosovës, që u vra në këtë rast, apo u vetëvra, këtë duhet t’ua lëmë organeve të drejtësisë, se ne s’jemi këtu ekspertë në Parlament, por të gjithë ne po kërkojmë që e kemi një ekspertizë shtetërore, e cila thotë “zoti Dehari është vetëvrasës”, zotërinj të nderuar. Edhe në të njëjtën kohë, kemi deklaratimet e zyrtarëve të lartë të “Vetëvendosjes” që kanë thënë që “zoti Dehari nuk besojmë që ka pas dikush tjetër dorë aty, por është vetëvrasës”.

Ne i kemi parë mediet, nuk po dua t’ua përmend emrin, nuk di tash a janë në grupin tuaj, apo në grupin tjetër, por nëse e shikojmë kauzën në retrospektivë, këtu ka humbur familja, kanë humbur të gjithë, por politikisht e keni keqpërdorur dhe keni fituar ju. Politikisht e keni keqpërdorur, dhe është turp që një rast vrasjeje të keqpërdoret në zgjedhje siç e keni keqpërdorur ju. Të gjithë ne jemi të interesuar që të zgjidhet ky rast. Unë personalisht e them publikisht këtu, jam i interesuar që nëse i duhet Qeverisë ose familjes Dehari, ta lë rrogën e deputetit, vetëm që rasti të shkojë ku ka kërkuar familja. Ne e dimë kur u bë ekspertiza, po flas si jurist, kanë qenë 18 veta në sallë kur është bërë ekspertiza e të ndjerit Dehari.

Kanë qenë katër veta aty që i ka dërguar familja, avokati dhe “Vetëvendosja” kur është bërë ekspertiza shtetërore. Unë jam ithtar të ju besoj institucioneve shtetërore. Derisa të kemi ekspertizë tjetër, e kemi vetëm një ekspertizë, e cila thotë se zoti Dehari e ka vrasë veten. Fatkeqësisht, ky është deklarim publik i shtetit të Kosovës dhe i institucioneve. Kjo mund t’i ndodhë secilit, mund t’i ndodhë çdo familjeje. Nuk është mirë që i ka ndodhur zotit Dehari, por mos e keqpërdorni këtë. Nëse i shikojmë deklaratat e aktivistëve dhe zyrtarëve të lartë të “Vetëvendosjes”, kur thonë se kemi pasur raste, dua të theksoj se “Vetëvendosja” do të duhej të japë sqarime të mjaftueshme për opsionet e tyre, për shembull kur thonë dhe vendosmëria e anëtarëve të “Vetëvendosjes” shkon deri në vetëmohim. Pse e thonë këtë? Këtë e keni thënë ju!

Nuk e kemi thënë ne. Do të thotë, këtu është çelësi i tërë lëmshit që vetë e krijoi Lëvizja, ndërsa nuk arriti ta menaxhojë situatën dhe nuk mundi të ju dalë ballë veprimtarëve, apo veprave të tyre politike, nëse i kanë bërë. Unë po e them, nuk jam ithtar që të interferojmë në drejtësi, po hajde ta lëmë drejtësinë që ta bëjë punën e vet. Nëse e pengojmë drejtësinë, atëherë çka dimë ne që ta

zbardhim këtë rast, përveçse të kërkojmë që organet përkatëse, në këtë rast tha kryeministri, tha ministri i Drejtësisë, tha ish-ministrja, që ky rast ka shkuar sipas kërkesës së familjes në një shtet që është në këtë rast neutral dhe në një shtet kredibil, një shtet që e ka një drejtësi shumë kredibile, Zvicra. Hajde ta presim atë ekspertizë, nëse ka njerëz që e kanë në dorë këtë, pavarësisht cilit subjekt i takojnë, edhe nëse kanë të bëjnë me Partinë Demokratike, unë e përkrah që ata të përgjigjen para ligjit dhe duhet të përgjigjen në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse ligji duhet të jetë për të gjithë, por jo të keqpërdoren këto vepra politike.

Ta marrim përgjegjësinë për metodat e pastrimit të trurit, që ju vetë e keni thënë nëpër terren, e keni thënë shumë vende, që në politikën tonë është pastrimi i trurit të rinjve për qëllime politike, duke i trajtuar anëtarët e vet si “mish për top”. Nuk është mirë të keqpërdoret papunësia, të keqpërdoret ndoshta vullneti i të rinjve për ndryshimet që duhet t’i ketë Kosova për të ecur më shpejt, duhet të ketë zhvillim më të madh ekonomik, duhet të ketë integrim që ju tash me mosveprim apo me veprim po e pengoni integrimin e vendit, e ju e dini pse po pengoni, është problemi juaji. Atëherë, nuk është mirë që këta të rinj ne t’i përdorim për interesa personale apo për përfitime, apo për politikën ditore. Me të vërtetë, secili që e ndien veten njeri në këtë Kuvend, e ndjen dhimbjen e asaj familje.

Është një familje që ka dhënë për këtë vend. Dhe, e ka humbur djalin e vet, që s’ka shumë për prindin që e humb fëmijën e vet në këtë rast. Andaj, unë kam ndier dhe ndiej dhimbjen e familjes Dehari, por turpi për këtë zinxhir të konspiracionit të “Vetëvendosjes” kundër të tjerëve mbetet te ju, e jo te na, se ne po ju mbështetim dhe po ju thotë edhe Qeveria, edhe koalicioni, edhe subjekti të cilit i takoj, edhe kryetari i Kuvendit u deklarua publikisht, edhe ish-ministrja, ministri, edhe kryeministri, “hajde po ju mbështetim”, pavarësisht çfarë kosto do të ketë, ato para, tek e fundit, nuk janë të Qeverisë janë të taksapaguesve, janë të gjithë qytetarëve, t’ju mbështetim që të zbardhet ky rast.

Unë kisha kërkuar prej juve që të mos bëjmë këso situatash në Parlament, të mos i mëshojmë kësaj tavoline këtu si të jetë tupan, se atëherë po më bën të dyshoj me të vërtetë sikur kur pat dalë Adem Salihu me atë zbulimin e atij fisit atje që i kemi si të afërt, po më bën përnjëmend që i keni të afërt me këto veprime ata “kalashët” a çfarë kanë qenë. Ne jemi këtu dhe kërkojmë prej Qeverisë që t’i ndërmarrë të gjithë hapat për zbardhjen e rastit “Dehari”, por të mos e pengojmë këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja “Vetëvendosje” i ka edhe gjashtë minuta e nëntë sekonda. Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën, ose Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Dhurata Hoxha, si e re që pretendon që je shkolluar jashtë, si person që mban një pozitë publike, si grua, si nënë, a të vjen turp ta mbash një fjalim të tillë këtu? A të vret ndërgjegjja që një i ri i këtij vendi ka vdekur dhunshëm në duart tuaja?

KRYESUESI: Atëherë, vazhdojani Samiut fjalën tash! A e kreve? Se s'po di a ta ndalën fjalën. Kush ta ndali? Unë s'ta ndala fjalën! Regjia, jepja fjalën Sami Kurteshit.

A e ndale vetë, a ta ndali dikush fjalën? Regjia, atëherë jepja fjalën te foltorja.

SAMI KURTESHI: Sado që të bëhet përpjekje për të ikur nga rasti “Dehari”, megjithatë ne duhet të kthehemi te rasti “Dehari”. Te rasti i vrasjes në mënyrë të dhunshme apo i vdekjes së Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit. Unë kam pritur nga ish-ministria diçka tjetër, por tash po më bind se ka të drejtë dorë drejtpërdrejt në vrasjen e Astrit Deharit. Me këtë fjalim sot, në këtë jam bindur.

Çështja tjetër, që dua unë ta ngre, zoti kryeministër, kjo ministre në Kabinetin e juaj nuk i bën nder Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo nuk ka vend në një qeveri. Ju e mbani, por është përgjegjësi juaja. Çështja tjetër, zoti nënkryetar, kryesues, një ministër i Qeverisë në këtë foltore nuk ka hapësirë sa të dojë, sepse këtu kanë hapësirë deputetët. Ministrat e Qeverisë kanë hapësirë në Qeveri, ku ne nuk shkojmë t'i pengojmë, kjo është çështja. Prandaj, me fjalime të tilla mund të paraqitet para kryeministrit, edhe para kujtdo tjetër.

Çështja që unë dua ta them, Gjyqësori dhe Policia e Kosovës, në të cilën ju po thirreni, ka vërtetuar me të gjitha faktet materiale se aktivistët e “Vetëvendosjes” nuk kanë dorë në sulmin mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pra, as Astrit Dehari. Astrit Dehari është mbyllur në burg dhe është vlarë i pafajshëm. Ky është problemi. Ne prandaj e duam një hetim ndërkombëtar të të gjithë rastit, ta dimë kush po fshihet, kush e ka inskenuar dhe kush e ka montuar. Ndërhyrja e ish-ministres së Drejtësisë me kërkesën për hetime ndaj avokatit të familjes dhe dy ekspertëve ndërkombëtarë ka qenë ndërhyrje e drejtpërdrejtë në drejtësi. Kjo është ndërhyrje. Dalja e drejtorit të Departamentit Kundër Terrorizmit në televizion rregullisht për ta bindur opinionin dhe deputetët se kemi me të bëjmë terrorizëm është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në procesin e hetimit. Kurrkund në botë nuk ngjan kjo. Ndërhyrja e Sylë Hoxhës ende pa u kryer hetimet, të thotë që është vetëvrasje, kjo është ndërhyrje e drejtpërdrejtë prej drejtësisë, prej Prokurorisë në drejtësi, në vendimin e gjykatës.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka dëshmuar, me dorën e vet zoti Kalludra, se këta njerëz janë të pafajshëm. Astrit Dehari ka vdekur i pafajshëm në burg. A e ka mbytur veten, a e ka mbytur dikush, ai ka vdekur i pafajshëm në duart e Shtetit dhe të Policisë, që dikush e ka komanduar, duke nisur prej Shpend Maxhunit, Fatos Makollit, për ta mbyllur në burg dhe për ta vlarë. Mua nuk më interesojnë shumë tjerat, prandaj kërkesa është: le të bëhen hetime ndërkombëtare të rastit për terrorizimin në Kosovë, kush e ka gjuajtur ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës? Kush ka dhënë urdhër? Kush janë nxitësit? Kush janë motivuesit?

Vetëm atëherë do të dihet e tëra e vërteta për rastin e Astrit Deharit dhe për rastin e sulmit mbi Kuvendin. Kjo ishte fjala ime. Krejt përpjekjet tjera për ta dezorientuar diskutimin e sotëm janë të kota, vetëm një hetim ndërkombëtar i gjithë rastit që do të dëshmonte kush është fajtor e sjell drejtësinë në këtë vend.

Një vend pa drejtësi rrëshqet në kriminalitet. Satisfaksioni i vetëm i familjes, i shoqërisë, yni, është drejtësia e domosdoshme me çdo kusht dhe në çdo kohë në këtë vend, por jo kjo drejtësi që e keni kapur për fyti. Është duke vdekur, sepse po ngulfatet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit!

Sami e dëgjova fjalën tënde dhe nëse një temë si kjo e Deharit nuk ka epilog, është krejt e kuptueshme që është një temë e gjallë edhe ka debat, ka diskutim, do të ndodhin përballje mediale, përballje të ekspertizave, e ku di unë, derisa s'ka epilog një herë, derisa të gjithë nuk biem dakord, kjo është kështu.

Ama një gjë po e kam të vështirë ta kuptoj Sami edhe te ti. A është burrë kjo që jemi pajtuar ne për ta dërguar këtë hetim? A është ndonjë farë kontributi drejt asaj që po e kërkon? Po thojeni burrë, le ta dimë ku jemi, se unë ende s'e mora vesh. Ne po ju themi atë klauzolën e parë të asaj që ju keni rënë dakord. Ne e kemi dakorduar, hetime nuk bën Qeveria, o Sami, ti e di kush i bën. Tash edhe një problem është, unë s'jam korrigjues juaji, as i kritereve qysh ju i gjykoni gjërat se ju i gjykoni vetë, veç ta kini parasysh, e keni një shpërputhje Samiu e disa prej juve këtu në pjesën e parë të "Vetëvendosjes" siç jeni ulur. Nganjëherë ju dëgjoj duke e quajtur këtë Kalludrën s'po di çka, nganjëherë thirrreni në vendimet e tij, a bën ta di për cilin Kalludër e keni fjalën e ju, pra?

(Ndërhyrje nga salla)

Shiko, pra, a po e shihni në këtë rast nuk qenka krejt e kapur burrë siç po thua ti, paska diçka, dikush është duke i marrë disa vendime. Jepjani shansin pra kësaj të drejtës, kësaj të vërtete.

(Ndërhyrje nga salla)

Shumë na ndihmoni...

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Të lutem, zoti Kurteshi, ta përfundojë, pastaj si ta duash fjalën, më duket ke ende minuta.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: ...Pse është kjo temë ende gjallë dhe pse diskutohet, për mua është e kuptueshme. Derisa kjo temë s'ka përgjigje, është e pranishme. Nuk po dua as të them pse, a është politike a s'është, a është ajo tema, nuk është dhënë epilogu i mirëfilltë, nuk janë pajtuar palët në këtë farë të vërtete, ani se është një vlerësim vendor, një ekspertizë, krejt kemi rënë dakord të shkojmë një hap më tutje, hajde t'ia lëmë njëfarë mundësie kësaj pune bashkë. Pastaj, ku ia nis ky hetim, a duhet shkuar deri s'po di ku, edhe ato i diskutojmë. Shkruajeni ndonjë shkresë, a ndonjë diçka, çka është në pyetje, çka po kërkoni e t'i bëjmë.

Po nuk i kemi ato kërkesa, nuk i kemi dëgjuar, hera e parë i dëgjuam në foltore. Besoj që edhe institucionet e ligjit është hera e parë që i kanë dëgjuar sot këto që po fliten këtu. T'ia japim njëfarë perspektive edhe këtij debati, besoni arsyeja pse jam kah qëndroj këtu, domethënë edhe jam kryetar i Qeverisë, më keni thirrur, por edhe për shkak të respektit për rastin për të cilin jemi duke folur. Ndonjëherë e kisha bërë ndonjë tërheqje taktike, se i kemi disa detyra, prandaj ju kisha lutur ta trajtojmë me respektin më të madh deri në fund. Përballja jonë do të vazhdojë për shumë tema, për shumë pikëpamje do të kemi rast, por jo në këtë temë, ju lutem!

KRYETARI: Frashër Krasniqi ishte në radhë për fjalë.

FRASHËR KRASNIQI: Në çështjen e vdekjes së Astrit Deharit, pika më e rëndësishme në këtë rast është pse u mbajt Astrit Dehari në paraburgim. Pavarësisht rezultatit të ekspertizës ndërkombëtare a vendore, problemi kryesor është që Astrit Dehari, dhe këtë nuk duhet ta harrojmë, sot do të ishte në mesin tonë sikur të mos ekzistonte procesi gjyqësor politik dhe i montuar për terrorizëm në rastin e sulmit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, edhe përgjegjësia kur kërkohet në raport me këtë rast, kërkohet për montimin e këtij procesi, i cili e shkaktoi vdekjen e Astrit Deharit, pavarësisht në çfarë mënyre ka ndodhur kjo.

Astrit Dehari, siç u tha edhe më herët, vdiq në paraburgim, pa pasur aktakuzë të ngritur. Sot është më shumë se e qartë se mbajtja e tij në paraburgim ka qenë totalisht e padrejtë dhe e pajustificueshme. Asnjë dëshmitar i vetëm në krejt këtë proces nuk e ka identifikuar asnjëherë Astrit Deharin si pjesëmarrës, qoftë në kryerjen e sulmit, qoftë në organizimin e sulmit në Kuvend. Nuk e ka identifikuar asnjëri nga ne dhe asnjë provë e asnjë fakt tjetër nuk e ka implikuar përfshirjen tonë në këtë rast.

Të gjithë ne që kemi qenë të akuzuar bashkë me Astrit Deharin jemi liruar dhe asnjë prej pretendimeve të Prokurorisë për rrezikshmërinë e mbrojtjes tonë në liri nuk ka ndodhur. Pra, paska mundur të mbrohet në liri Astrit Dehari prej fillimit, kurrë s'do të kishte ndodhur, sepse po vërtetohet që gjithçka ka qenë montim politik. Nuk ka dilema për këtë punë, të gjitha ekspertizat serioze, qoftë vendore apo ndërkombëtare, duke e përfshirë edhe FBI-në, kanë

treguar që krejt ky rast është totalisht i pabazuar. Të gjitha deklaratat e dëshmitarëve kanë treguar që montimi i këtij procesi ka filluar në Policinë e Kosovës dhe ka vazhduar më tutje.

Dhe, sot kur flasim për drejtësinë në lidhje me vdekjen e Astritit, nuk mund të mos e përmendim një indikator shumë domethënës: kë e kemi ministër të Drejtësisë në Kosovë? Sepse edhe ky person e ka një të kaluar që lidhet me këtë rast, me këtë rastin e montuar politik ndaj nesh. Dhe, pse po them që e ka? Sepse është pikërisht ministri i Drejtësisë që sot e kemi, Abelard Tahiri, i cili prej fillimit të këtij procesi gjyqësor ka dhënë deklaratat publike, e ka përfshirë veten në mënyrë publike në këtë rast. Në atë kohë e pati marrë rolin e prokurorit publik, duke folur me emra dhe mbiemra se kush qenkan kryerësit e këtij sulmi, pra duke folur tamam si prokuror dhe normalisht që s'ka pasur asnjë fakt dhe asnjë provë për këtë punë. Ka përmendur emra konkretë, duke dhënë sinjale të qarta për njerëzit e tyre në sistemin e drejtësisë që kë ta gjykojnë, për çka dhe si ta gjykojnë.

Në anën tjetër, është shumë interesant se janë pikërisht njerëz shumë të afërt të ministrit të sotëm të Drejtësisë, Abelard Tahiri, shokë të afërt të tij, të cilët e kanë organizuar ndërtimin e këtij rasti, qoftë në nivel të opinionit publik, qoftë në atë të Policisë. Dhe, ju e dini për kë e kam fjalën. Janë shokët e ministrit, Mentor Shala, Mefail Limani, Ridvan Berisha e tjerë, që janë në RTK, qysh para arrestimit tonë patën filluar të ndërtojnë akuza publike të drejtpërdrejta në raport me ne, në raport me “Vetëvendosjen” dhe me aktivistët e saj për këtë rast dhe pak ditë pas tyre janë pikërisht shokët tjerë tash të Abelard Tahirit në Njësitin Antiterror të Policisë së Kosovës, të cilët intervenuan, prapë pa prova, prapë pa fakte, për të na arrestuar neve. Dhe, cili është rezultati sot? Kadri Veseli e emëron bash ministër të Drejtësisë një person, i cili më shumë do t'i shkonte të ishte ndonjë ministër i persekutimit publik të kundërshtarëve politikë, por assesi ministër i Drejtësisë.

Tash, unë sot do ta pyesja ministrin: A distancohesh prej deklaratave publike që i keni dhënë se filani e fisteku, duke më përfshirë edhe mua, janë kryerësit e këtij akti terrorist? Sepse neve po na thoni mos u përzieri në drejtësi, e po flisni për raste të drejtësisë. Tash, a nuk do të ishte korrekte që ju të dilni të thoni në këtë foltore që “kam gabuar që jam përzier, nuk është dashur të vij në ato përfundime, kërkoj falje sot që i kam dhënë, nuk mendoj sot njësoj”, dhe ta shohim si po qëndrojmë secili në përzierje në punët e drejtësisë.

Qysh mund ta argumentoni që ky proces nuk është politik, kur iu la në dorë Beqir Kalludrës, i cili as që përpiqet ta fshehë si gjykatës ndikimin politik në vendimet e tij? Ai person i ka dënuar deputetët e opozitës për gaz lotsjellës, dënim skandaloz politik, ai person na dënoi neve në mënyrë skandaloze pa fakte, pa prova me 21 vjet, gjë që u refuzua prej Gjykatës së Apelit, dhe çuditërisht ai person e liroi Azem Sylën dhe sapo e përfundoi me neve e mori rastin e Azem Sylës, dhe sot e liroi. Dhe, tash ju po na thoni që nuk ka lidhje politika në proceset gjyqësore, kur

ashiqare që e keni personin i cili po jua kryen krejt punët, krejt vendimet gjyqësore që ju keni pas interes të merreni në një mënyrë të caktuar.

Nuk mund të ketë drejtësi për Astritin për aq sa vazhdon shfrytëzimi i sistemit të drejtësisë për t'i zgjidhur hesapet politike me opozitën dhe me kundërshtarët politikë. Dhe, nuk do të ketë drejtësi për Astritin derisa në Kosovë njerëzit të mbahen në paraburgim për vite me radhë, pa aktakuza, pa arsye, pa faj, vetëm se këtë e duan njerëz të caktuar, qoftë të politikës, qoftë biznesit, dhe të cilët kanë ndikim te gjykatësit e korruptuar.

Por, normalisht që herët ose vonë do të ketë drejtësi për Astritin, ngase do të vijë drejtësia në Kosovë për krejt Kosovën, atëherë kur vendi ynë do të qeveriset prej një gjenerate të re, që do ta çlirojë sistemin gjyqësor prej duarve tuaja, që e keni kapur.

KRYETARI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Frashër, unë kam qenë në paraburgim, edhe në aktakuzë. I kam kaluar tre vjet e nëntë muaj dhe i kam pas cimerë plot të tjerë, e di ndjenjën e atij që ka ke aluar paraburgimin. Unë e di qysh ndihesh ditën e parë, javën e parë, muajin e dytë plus-minus, ani që s'e kam bërë këtu në Kosovë, disa e kanë bërë në burgje më të vështira, ka këtu të tillë, bile para atyre ruaju se kanë heq më shumë, e ke edhe kryetarin, më falni tash s'e nuk e kam hallin të fus spica, por janë disa që e kanë bërë edhe atje, te komshinjtë.

Shiko! Ka diçka Frashër që kur flisje ti, unë mundohesha ta shoh çka nxjerr unë si kryetar i Qeverisë, prej kësaj, prej fjalës tënde. Tash ti e akuzove një ministër që është sot i Drejtësisë, që ky paska identifikuar, paragjykuar, gjykuar publikisht e krejt tjerat, por e vërteta është që në mandatin e këtij ministri sistemi gjyqësor, e unë e di që ky s'ka ndikim, ju gjeti të pafajshëm, ju liroi, shkuat në shtëpi. Nëse është ashtu, shyqyr pra, a po e sheh, hajde burrë t'ia nisim edhe diku tjetër. Nuk e kam, beso, as për hatër timin, as tëndin, nuk jam duke menduar në vota, por nëse është dime kështu t'i vlerësojmë gjërat, ia ndihmojmë njëri-tjetrit, në këtë rast secilit që është i interesuar për të vendosur njëfarë rregulli në këtë Kosovën tonë. Çka të bëjmë, bre? Gjithmonë do të ketë pasoja, çmime. S'ka marrë kurrkush përgjegjësi për kurrkënd deri sot, krejt kështu janë, ja ua kemi dhënë nga 15 euro për ato ditë. Një ditë e bëjmë një ligj edhe ua japim. Më falni, s'e di!

Jam kah dua të flas, domethënë nuk është bërë pa vuajtje, pa pasoja, pa heka, pa dhimbje kjo Kosovë. Nëse e kemi në plan ta bëjmë pak më të mirë, e vërteta është që në kuadër të këtij ministri, që po ia përmend emrin dhe po thua është ky, në rregull, por në kuadër të këtij çka ndodhi, u gjet një epilog i kësaj teme. Për shembull, nga pikëpamja e atij që ka rënë nëpër këto gjëra, unë jam shpallur i pafajshëm. Kam pasur aktakuzë, më kanë mbajtur e më kanë mbajtur, e më kanë e shpall të pafajshëm. Shiko, unë dyshoj në plot gjëra të asaj drejtësie, por në atë epilog

të paktën nuk dyshoj, që më kanë lëshuar të pafajshëm. Edhe pse jam duke e folur këtë? Ky afiksimi, ky gjykimi publik, besoni nuk i jep efektet, nuk i jep as te ata që marrin vendime. Nëse është ndonjë gjyqtar duke e parë këtë seancë, ose ndonjë prokuror, qysh i gjykon ai këto që po i themi ne. Të të liroj kështu, s'po di çka po dua.. ta çojmë një porosi në fund se unë nuk mendoj që ka bazë më që Parlamenti të votojë diçka të re. E pse?

Atë që ju e keni propozuar para një kohe, të nderuar kolegë deputetë, Qeveria me vetiniciativë, pa kërkesën tuaj, e ka qëndrim që e ka marrë që vitin që shkoi, e ka marrë për shkak të së njëjtës ndjenjë që krejt e keni. Është e padrejtë të mos gjendet e vërteta për Astritin. Është e padrejtë të mos gjendet e vërteta, jo veç për prindërit e tij, por për krejt ne që jemi prindër të dikujt. Edhe drejtësia, edhe në atë element, ju lutem, e kemi marrë drejtimin. Elementet tjera të kësaj kërkesës suaj unë nuk jam me to, jo se nuk ka terren edhe për ato diskutime, por sot nuk jam me to, e nuk dua të hyj më thellë. Si Qeveri, shikoni, ne kemi plot probleme, edhe gjendja gjyqësore në Prokurori është e vështirë, besomëni, nuk është e lehtë. Ka raste që presin me kohë të tëra. Unë jua thashë një mendim, ju e dini, paradite e bëj një proces, edhe s'po dua për atë të lëshohem, se s'po dua t'i japë askujt argumente që t'i komentoj këto, ama mendoj që kemi shumë për të përmirësuar në sistemin gjyqësor. Këtë e pranojnë edhe Këshilli Gjyqësor, edhe Këshilli Prokurorial, edhe plot që janë në këto tema, mund ta bëjmë së bashku, por Parlamenti të mos e marrë, thënë ndryshe, t'ua japim besimin në punë atyre që e kanë, por jo ne ta bëjmë punën e tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Abelard Tahiri, ministri, e ka kërkuar fjalën. Replikë? Urdhëro, veç pak sekonda ju kanë mbetur. Po e shoh Dardanin, në të njëjtën kohë.

FRASHËR KRASNIQI: Zoti kryeministër, Është e qartë çfarë ka ndodhur në rastin tonë. Është e vërtetë që neve na ka liruar Gjykata e Apelit, është e qartë që në momentin kur është parë se për arsye elektorale nuk po ju duhet më ky rast, se kurrkush nuk po ju mbështet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vetëm pak, nuk e di sa lejohet me Rregulloren, në qoftë se LDK-ja ia kalon ka minuta mjaft, për arsye se pastaj u zgjatet të gjithëve. Abelard Tahiri e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Edhe një herë po ta them, angazhimi i parë imi si ministër i Drejtësisë, në kuadër të kësaj Qeverie, ka qenë po kjo iniciativë, që t'i vëmë një epilog kësaj ngjarjeje tragjike që ka ndodhur në Burgun e Prizrenit. Dhe, jam shumë i bindur që në kuadër të mandatit tim do të arrijmë t'i nxjerrim edhe para drejtësisë, qofshin ata brenda institucioneve, qofshin ata jashtë institucioneve, njerëzit që e kanë shtyrë drejtë vetëvrasjes Astrit Deharin.

Sa u përket çështjeve të mia, mendimeve të mia politike, ato i kam, do t'i kem, asnjëherë sa do të jem ministër i Drejtësisë nuk do ta komentoj asnjë rast gjyqësor, çfarëdo qoftë ai, na pëlqeu apo s'na pëlqeu, e pasi ta përfundoj mandatin do ta them prapë mendimin tim, ashtu siç e kam thënë në të kaluarën. Rastet e tilla nuk do t'i komentoj, mirëpo jam shumë i bindur që në kuadër të këtij mandati ne do ta zbardhim dhe ky institut që tashmë ia kemi dërguar këtë dokumentacion do të na ndihmojë shumë që t'i japim drejtim dhe të zbardhet njëherë e mirë dhe të besojmë të gjithë pra në këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Nga reagimet të cilat u dhanë, Ali Lajçi u tërhoq. Është një minutë e 17 sekonda, në qoftë se ka më shumë... Arbër Rexhaj, e keni fjalën.

ARBËR REXHAJ: Atëherë, faleminderit!

Këtu ministri doli dhe paragjykoi, në ndërkohë tërë kohën gjatë tërë seancës në njëfarë forme thuajse në fund domethënë të pranohen edhe nga "Vetëvendosja" edhe nga të gjithë të paraqiturat nga ai institucion në Zvicër. Ndërsa, ministri po paragjykon dhe po thotë "vetëvrasje", e kjo tregon për natyrën e dyshimtë të kësaj. Përpos asaj unë, po dua ta pyes ministren me një pyetje shumë objektive: Pse nuk e bëri një gjë, e cila ka qenë shumë e vogël, pra të marrë masa ndaj atyre të cilët i kanë nxjerrë filmimet prej Burgut të Prizrenit? Pra, vetëm një masë të vogël nuk e ka pasur mundin ta ndër marrë.

Pra, Astriti është e vërteta që nuk do të shuhet asnjëherë në Kosovë. Ai në fakt do të duhej të ishte perspektiva e Kosovës së ardhshme, modeli i të riut, i cili përpiqet të punojë, të studiojë, të japë, kontribuon, të sakrifikon, nuk ndalet, reziston, proteston, rebelohet. Pamja në arkivolin e tij nuk është pamja e vërtetë. Ajo është pamja e pushtetit, e cila...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vetëm të konstatojë, me kaq sa po shoh më nuk ka deputetë të paraqitur. Zoti Lajçi është i vetmi, por ka mbaruar koha e grupit parlamentar. Më vjen keq! S'kam mundësi që t'ia jap fjalën, atëherë kështu-ashtu i takon edhe në bazë të procedurës kryeministrit të Republikës së Kosovës.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Edhe një herë, e para ashtu siç e filluam, është një temë e ndjeshme, besoj është një ndjenjë e gjithkujt që kjo temë do respekt... është pa epilog, e do kujdesin më të madh prej të gjithë neve.

Edhe nuk po them që, e thashë në fillim, menaxhimi në ato deklaratimet e para ka qenë i habitshëm, i çakorduar, në përgjithësi, në ditën e sotme, kërkesën e parë, kryesore, që e vërteta të mos jepet tani nga instancat më vendore, por nga një instancë tjetër, mendoj, po ju them edhe një herë, sikur të ishit në Qeveri, "Vetëvendosje", cilido prej juve Arbër, ti po të ishe kryeministër,

më shumë sesa t'ia aprovosh kërkesën familjes, bash ku po kërkon familja, edhe emrin e institucionit, çka ke për të bërë burrë? Tjetër gjë jeni duke thënë pra, beso dy tema janë. Shiko, dy tema janë, besoni! Jo unë t'i them "unë po ta gjej një institucion", por të vijë familja e të thotë "zotni, e kam gjetur institucionin, po dua bash ky", që bukur e çuditshme është shteti tash të thotë "po". Bashkë kam qenë me këtë ministrin prapë që po e gjuan, edhe i kemi thënë "po" familjes. Ku e ka kërkuar, "po".

Nuk është kjo, s'po di pse s'po e konstatojmë që ka ndodhur kjo. Unë e kam përshtypjen që sa herë që po dilni, prapë po ktheheni në atë pikë. Tjetër është, në rregull për tjerat. Unë, po e shoh që dikur, duke folur, po shkojmë më në çosh, dhe unë po e hetoj që po ndodh ajo, unë po shkoj më andej, dikush më këndej, po e shoh atë pjesë. Ama, ka edhe diçka, nëse flet në gjuhën e shkresave, një zyrtar i Kosovës, cilido qoftë, u obligohet shkresave zyrtare që ka sot Kosova. Ministri i Drejtësisë nuk guxon të referohet në shkresa tjera, pos në ato që deri sot i kanë dhënë institucionet e drejtësisë. Ju e dini çfarë kanë thënë ato shkresa. Mundet t'i duket Arbërit paragjykim, por edhe mos harroni - proceduralisht në atë gjendje jemi njëherë. Nëse ndryshon ajo, ndryshon pozicioni i gjithkujt, dhe unë e respektoj, edhe Abelardi e respekton, por njëherë përnjëherë si procedurë aq kemi, ato shkresa i kemi.

Unë bile edhe me kujdes nuk u thirra në to gjithë kohën, veç prej kujdesit që të mos e japim atë pamje, ama ashtu është realiteti, letrat e shkresat ato i kemi njëherë. Për fund, po ju lus kolegë deputetë edhe njëherë, t'i jepni përkrahje Qeverisë, ashtu siç thamë, që po me përkrahje timen, po që kemi rënë dakord krejt partnerët qeverisës, i falënderoj për këtë besim të ndërsjellë, edhe unë jam i bindur që është qëllimi për ta gjetur të vërtetën. Dy kërkesat tjera i tejkalojnë kompetencat e Ekzekutivit, janë fushë e tjetërkujt. Shkruajuni atyre direkt, jeni grup parlamentar, shkruani direkt institucionit të Gjyqësorit, Hetuesisë, shkruani se s'është marre. Deputetë, shkruani, por Ekzekutivi s'mund të hyjë në këtë.

Njëkohësisht, nëse jemi dakord, edhe njëherë unë po ju them që sa herë që ta vlerësoni që mund të ndihmoj këdo që është i interesuar në këtë temë, ju pres personalisht, ju pres me ministër, jam në gjendje të shkoj të flas me palë të ndryshme që ta kryejmë këtë punë, ta heqim këtë barrë të rëndë në mendje e në zemrat e secilit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më diskutues, propozuesi aktualisht duhet ta ketë fjalën, i ka pesë minuta të interpelancës. Ndërkohë kisha kërkuar që deputetët, të cilët janë në ambientet e Kuvendit, të kthehen për votim.

ALBIN KURTI: Nuk mund të arrijmë tek e vërteta pa e ngrehur çështjen e përgjegjësive. Nuk janë të ndara këto. Pikërisht duke e kërkuar përgjegjësinë arrihet tek e vërteta, por dua të them tetë shënime vendimtare nga raporti mjeko-ligjor i dy mjekëve të caktuar nga familja, Besim Ymaj dhe Besim Latifaj.

1. Lidhur me dëmtimet në gojë dhe asfiksionë, nga raporti citat: “Në bazë të pamjes dhe lokalizimit topografik të lëndimeve në rrënjën e gjuhës dhe kavitetit të gojës, me lehtësi mund të rikonstruktohet mënyra e shkaktimit të lëndimeve. Mbyllja e laringut me fundin e gojës, një ngufatje e tillë kryhet gjatë dhunimit, zakonisht me qëllim të pengimit të britmës për ndihmë të viktimës së sulmuar të rriturit. Asfiksi mekanike e shkaktuar nga mbyllja e vrimës së gojës, pa i mbyllur vrimat e hundës nuk parandodhin zakonisht”. Pra, është goxha e pamundur që Astriti ta ketë ngjeshur vetë shishen në fytin e tij, duke qarë rrënjët e gjuhës së vet dhe duke i rezistuar gjithë kësaj dhimbjeje dhe duke vazhduar ta mbajë shishen e plastikës në gojë deri në asfiksi. Ajo çka po thonë doktorët është se ka shumë mundësi që për ta finalizuar asfiksionë ia kanë mbyllur edhe vrimat e hundës me jastëkun që gjendej aty. Sipas raportit thuhet, “të dhënave të vendit të ngjarjes, një jastëk në dysheme me mbetje jarge, send i butë i përdorur për të cilin vihen re njolla pështyme të lëna nga viktimja në çastet e vdekjes, mund të kenë kontribuar në rezultatin përfundimtar të mënyrës dhe natyrës së kësaj asfiksionë mekanike”.

2. Lëndimet në pjesën e djathtë të qafës së Astritit nga raporti, citat: “Zakonisht në vetëdëmtime, plagët e qafës më shpesh lokalizohen në pjesën e përparme dhe anësore majtas, kur viktimja e ka aktive dorën e djathtë dhe anasjelltas, si dhe me drejtim nga lartë poshtë”. Çfarë janë duke thënë këta dy mjekët ligjorë të familjes, është se nuk ka shpjegim se si Astriti, i cili nuk ishte majtak - mëngjarash, dhe në fakt e përdorte dorën e djathtë t’i ketë shkaktuar vetë këto lëndime në pjesën e djathtë të qafës, poshtë nofullës. Lëndimet që paraqiten në pjesën e djathtë të qafës së Astritit, lëndimet që duket që janë bërë me brisk rroje do të kishin kuptim deri diku të ishin vetë lëndime, nëse Astriti do të kishte qenë mëngjarash, por Astriti e përdorte dorën e djathtë. Për më tepër, drejtimi i prerjeve të këtyre lëndimeve është horizontal, përreth qafës, e jo vertikal nga lart-poshtë, ose nga poshtë-lart. Prandaj, nisur nga pozicioni i këtyre lëndimeve në qafë, si dhe nga orientimi i prerjeve në këto lëndime, duket se Astriti nuk i ka bërë vetë këto.

3. Lëndimet përcaktohen si shenja vetëmbrojtje, në raport thuhet: “Lëndimet në kokë, në parakrahun e majtë dhe në faqen e jashtme të poshtme të parakrahut të dorës së djathtë, anën e djathtë të qafës, në këndin e nofullës së poshtme janë shkaktuar me mjete të fortë dhe këto klasifikohen si lëndime trupore me natyrë më shumë si shenja vetëmbrojtëse”. Për të gjitha këto lëndime, mjekët ligjorë janë duke thënë se janë shkaktuar në ballafaqim e sipër me persona të tjerë.

4. Mjekët ligjorë të familjes nuk u lejuan kurrë në vendngjarje. Kjo përbën një shkelje flagrante të procedurave mjeko-ligjore dhe analizave kriminalistike, duke ua pamundësuar mjekëve të familjes t’i bëjnë analizat në vendngjarje, si dhe duke pamundësuar analizat e provave fizike të gjetura në vendngjarje. Nëse pushteti nuk kishte diçka për të fshehur, nuk ka pasur arsye për të bërë këso shkeljesh flagrante.

5. Plani operativ i hetimeve nuk u shtrua kurrë si hetime për një vdekje të dhunshme. Nga raporti, i gjithë plani hetimor-operativ duhej të shtrihej që në fillim si një vdekje e dhunshme, gjersa janë konstatuar dëmtimet traumatike, duke evituar mendimet paraprake, sepse një orientim joprofesional është shumë i keq në këtë proces. Mjekët e familjes janë duke thënë se Policia dhe Hetuesia nuk e analizuan kurrë këtë rast në asnjë moment, e që prej fillimit si rast të një vrasje të mundshme. Mënyra e hetimit e ka paragjykuar që në start si vetëvrasje.

6. Mungesa e ndihmës së shpejtë adekuate në kontaktin e parë me ndodhinë e ngjarjeve, sipas materialeve të çështjes dhe dëshmimeve të dhëna, ka paqartësi dhe kontradikta në lidhje me praninë apo jo të shenjave të jetës. Nëse ka pasur shenja jete, puls dhe frymëmarrje sipas personelit mjekësor, dhënia e ndihmës së mundshme mjekësore nuk ka qenë në nivelin e duhur. Interesi mjeko-ligjor fokusohet kryesisht te vendi ku është gjetur kufoma në vendin e ngjarjes, si dhe duart e viktimës duhej të ishin mbështjellë me qese të bardhë që të mos humbasin provat. Kjo të bën të dyshosh pse ndihma e shpejtë nuk është dhënë shpejt ashtu siç duhet.

7. Oraret e mbërritjes në spital janë korigjuar dhe janë rishkruar me dorë, dhe

8. Naser Makolli, shoku i dhomës, në riintervistim e ndryshon deklaratën, duke folur edhe për frikën që kishte nëse e merr Policia në pyetje. Kjo është shënuar edhe në raportin e autopsisë së mjekëve të familjes.

Më 14 prill 2017, Kryeministria i kthen përgjigje, duke e refuzuar familjen për hetim ndërkombëtar, kjo i transferohet edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Tomë Gashit. Prandaj, votojeni mocionin!

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës e ka kërkuar fjalën në ndërkohë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: S'e di a lejohet, me procedurë, jo a?

KRYETARI: Në qoftë se dëshironi t'i ndihmoj kësaj, kryeministri deri tani qe shumë korrekt. Albin, ta japë prapë fjalën në qoftë se do.

Në ndërkohë, veç ta kemi parasysh, kryeministri kërkoi vetëm që t'i sigurojë kolegët e Lëvizjes "Vetëvendosje" për veprimet institucionale. Sido që të jetë, shkojmë drejt në votim. Faleminderit kryeministrit për mirëkuptim.

Përgatitemi ngadalë kolegë, do të bëjmë atë që është më e mira, ta konstatojmë numrin e deputetëve të pranishëm në sallë. 65 deputetë janë në sallë. Regjia, ju lutem, në qoftë se nuk ka dikush kartelë... Xhelal Sveçla, s'prish punë, voton vetëm me dorë. Atëherë, veç mos e përdor. Kërkoj falje, një minutë!

Rendi i tretë nga pjesa e mesit qenka prishur, a ka mundësi ta ngrehni dorën që Administrata ta ketë parasysh sa veta jeni, sepse ose nuk punojnë, ose s'keni kartela. Sa veta jeni, ju lutem? Shkojmë me dorë, që të mos e komplikojmë. Në tri votime shkojmë: për, kundër abstenim. A shkojmë me dorë? Shkojmë në mënyrë elektronike, ju kisha lutur.

Kërkoj falje, edhe një herë kolegë deputetë, nëse nuk ju punon mekanizmi i votimit, ose nëse nuk kanë kartela ngrehni duart, ju lutem, të mos keqkuptohemi! Më vjen keq, atëherë regjia dhe deputetët ju lutem, këta që kanë kartela votojnë, pastaj në fund këta që janë me dorë i ndajmë, votojnë veç, s'kam çfarë të bëj. Votojmë një herë, vetëm me kartela!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Vetëm deputetët që janë me kartela. Kolegët deputetë, të cilët ishin me votim me dorë vetëm, kush është për? Faleminderit!
Kush është kundër? A ka abstenim?

Më lejoni t'i bëjmë bashkë tani, e konstatoj edhe me elektronikë, edhe me dorë... E ndajmë votën.

E kemi një problem para konstatimit, vetëm 58 deputetë kanë marrë pjesë në votim. Do të thotë, unë mund ta konstatoj në qoftë se dëshironi kush është për e kush kundër, por megjithatë 58 veta. Nuk ka vendimmarrje, pa votuar 61. E provojmë edhe një herë, derisa janë të pranishëm 65 deputetë. Shkojmë prapë në mënyrë elektronike, tani janë 66 deputetë, po e shoh që ka reagime, ndoshta disa nuk duan, unë me zor s'mund t'i detyroj që të votojnë.

Edhe një herë, kolegët në rend të parë, ata të cilëve u punon mekanizmi për të votuar, vetëm ata votojnë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 52 deputetë në mënyrë elektronike: 23 janë për, 26 kundër, 3 abstenime.

Tani shkojmë te votimi me dorë. Vetëm kush është për? Kush është kundër? Kush është abstenim? Më vjen keq, prapë i kemi vetëm 58 deputetë. Kjo është situata të cilën e kemi për këtë pikë të rendit të ditës.

Të nderuar deputetë,

Në ndërkohë, në qoftë se kemi pajtueshmëri, do ta shtynim këtë seancë për 21 mars 2018, në orën 10:00.

Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

E premte, më 23 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16 mars 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI; Të nderuar deputetë,

Zonja deputete,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministër,

Në sallë kemi 57 deputetë,

Po i vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 16 mars 2018 në pikat e përfunduara të rendit të ditës, si në vijim.

3. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari

Diskutimet për këtë interpelancë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 16 mars 2018, po në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, votimi është shtyrë.

Zoti Glauk Konjufca e ka kërkuar fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Zoti kryesues, për shkak të seancës së kaluar, e cila u mbajt për demarkacionin dhe për shkak të arrestimit të deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, sot mendoj që janë pamundësuar kushtet për të trajtuar këtë pikë të rendit të ditës përmes votimit, sepse na mungojnë shtatë deputetë, të cilët po mbahen në paraburgim.

Lëvizja “Vetëvendosje” kërkon lirimin e tyre të menjëhershëm, gjithçka ata kanë bërë, ka qenë e nevojshme, për shkak që bindjet e tyre dhe tonat kanë qenë që vendimi që u mor për demarkacionin ka qenë një vendim i dëmshëm. Prandaj, konsiderojmë që kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të trajtohet pa lirimin e tyre.

Ne kërkojmë që nëse ka nevojë kjo të shtyhet deri në lirimin e deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, për çka u bëjmë thirrje organeve të drejtësisë të mos instrumentalizohen dhe të mos bëhen pjesë e kapur nga pushteti.

KRYESUESI: Po mendon të ketë mocion, e keni si mocion, ju si grup parlamentar. Zoti Dardan Sejdiu e ka kërkuar fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Pajtohem me kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, pra që votimi për këtë mocion të shtyhet deri në lirim të deputetëve dhe kërkoj gjithashtu që deputetët të mos mbahen në paraburgim pa arsye. Faleminderit! Pra kërkojmë që të shtyhet ky mocion deri në lirim të deputetëve.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë unë duhet të konstatoj që ne kemi kuorum të mjaftueshëm për të votuar. Sidoqoftë, mocionin që e kërkoj zoti Glauk Konjufca unë e hedh në diskutim dhe mendoj që deklaratimet e grupeve parlamentare do të ishin të mirëseardhura dhe pastaj të shohim si t’ia bëjmë.

Në sallë kemi 73 deputetë. Sipas radhës fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë parlamentar nuk ka ndonjë kundërshtim për këtë mocion procedural, ne e mbështesim kërkesën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi parlamentar i PDK-së, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë vetëm do të theksoja se duhet ndarë kërkesën e mocionin prej autorizimeve dhe prej përgjegjësive që i kanë organet e drejtësisë, këto dy gjëra nuk ndërlidhen dhe nuk janë në raport të drejtë njëra me tjetrën.

Institucionet e drejtësisë e kanë punën e tyre, Parlamenti e ka punën e vet, sido që të jetë, ne e mbështesim kërkesën për ta shtyrë votimin e rekomandimeve të interpelancës për seancën e ardhshme, besojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi, në emër të AAK-së.

AHMET ISUFI: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet një propozim të tillë.

KRYESUESI: Zoti Bilall Sherifi, në emër të “Nismës”.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Po, edhe “Nisma” e mbështet kërkesën për shtyrjen e kësaj pike në një seancë tjetër.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Edhe ne e përkrahim propozimin, jemi për shtyrje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë, mendoj që diskutime të tjera nuk ka nevojë, të gjithë keni rënë dakord që të shtyhet votimi për seancën e radhës, kjo është me rëndësi, me votim formal nëse doni i çoni duart.

Dakord. Kundër a ka? Nuk ka kundër. Faleminderit!

Konstatohet që seanca e sotme miratoi kërkesën e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes” që votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Kosovës, zotit Haradinaj, të shtyhet për seancën e radhës.

4. Shqyrtimi i Propozim-Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2018 është hartuar në bazë të projektligjeve të papërfunduara nga sesioni vjeshtor i vitit 2017, programit legjislativ të Republikës së Kosovës për vitin 2018, planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2018, programit kombëtar të zbatimit dhe agjendës për reforma të AER-së.

Programi i Punës për vitin 2018 paraqet një dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës, mbikëqyrës, zgjedhor dhe përfaqësues.

Sipas radhës, normalisht që kryetarët ose përfaqësuesit e komisioneve parlamentare, nëse e kërkojnë fjalën, mund të flasin. Por ajo që dua ta them unë është se ne kemi ngelur shumë mbrapa me miratimin e ligjeve dhe në qoftë se në dhjetëditëshin e ardhshëm nuk i përkushtohemi kryerjes së detyra tona, s’po them që opinioni dhe elektorati i të gjitha partive do të na vlerësojë ose do të na gjykojë, por dua të them që Raporti i progresit i Bashkimit Evropian, i cili do të shpërndalet shumë shpejt, Kuvendin e Kosovës do ta nxjerrë shumë keq sa i përket këtij aspekti.

Pra, radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e komisioneve parlamentare, sipas radhës zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues i Qeverisë,

Ju të pranishëm,

Media,

Sot e kemi në shqyrtim Propozim-Programin e Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018.

Jemi pothuajse në fund të marsit, zakonisht nuk e di pse vonohet kaq shumë miratimi i planit të Kuvendit për vitin kalendarik, po sidoqoftë, komisionet kanë filluar punën e tyre edhe më herët.

Bazuar në hartimin e planit të punës së komisioneve, gjithashtu edhe komisionin të cilin e kryesoj, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka hartuar planin e punës për këtë vit kalendarik bazuar në strategjinë legislative që e ka sjellë Qeveria në Kuvendin e Kosovës, duke shtuar edhe nisma ligjore.

Kështu që ne jemi në rregull si komision me agjendën, me planifikimin e aktiviteteve tona.

Komisioni gjatë vitit 2018 si aktivitete kryesore do t'i ketë shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, monitorimin e resorëve të Qeverisë që i bie në fushën e Komisionit, mbikëqyrjen e agjencive të pavarura të fushëveprimit të komisionit, trajtimin e çështjeve në përmirësimin e mjedisit biznesor, mbikëqyrjen e shpenzimeve publike të ministrive të linjës dhe agjencive të pavarura, mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve që dalin nga komisioni, e që i miraton Kuvendi.

Komisioni do të bashkëpunojë gjithashtu me të gjitha institucionet relevante vendore e ndërkombëtare.

Në komision këtë vit kalendarik Qeveria ka sjellë 18 projektligje, ndërkohë që është një nismë ligjore e komisionit, që domethënë që i kemi 19 ligje t'i shqyrtojmë, t'i amendantojmë dhe t'i miratojmë në këtë vit kalendarik.

11 projektligje i kemi në shqyrtim, tri kanë hyrë në fuqi, kështu që bazuar në atë që ka sjellë Qeveria në Kuvend, që bie në fushëveprimin e këtij komisioni, ne jemi vetëm në tejkalim të planit të punës.

Në kuadër të planit të punës për Komisionin për Zhvillim Ekonomik është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve që i kemi planifikua dy ligje minimalisht, nëse do të kem kohë, ky plan i punës nuk është i pandryshueshëm, duhet të jetë fleksibil ndërkohë në qoftë se del një që është e rëndësishme, ne mund edhe ta fusim si plan të punës.

Më tutje kemi raportet e institucioneve të pavarura, komisionin përkatës, tetë agjenci të pavarura i raportojnë këtij komisioni.

Katër ministri i raportojnë komisionit dhe këto ministri, sipas parashikimit, i kemi planifikuar që ministrat e linjës të raportojnë në komision, dy ministra tashmë kanë raportuar.

Vizita e institucioneve të pavarura, i kemi planifikuar tetë vizita. Raportet e performansës janë tri.

Vizitat e komisionit homolog të Shqipërisë, një vizitë. Vizitë bizneseve e sektorëve privatë, tri vizita. Vizitë ndërmarrjeve publike qendrore, varësisht nga agjenda, tryeza nga fusha e komisionit, e kështu me radhë.

Unë mendoj se komisionet duhet ta fusim në planin e punës së tyre edhe ecurinë ose përparimin e dialogut Kosovë-Shqipëri, në ato fusha ku bien në komisionet përkatëse, si bie fjala në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, i kemi tri fusha shumë të rëndësishme, siç është fusha e energjisë, e aviacionit dhe e telekomunikacionit.

Ju ftoj që ta miratojmë këtë plan të punës së Kuvendit në përgjithësi, edhe ashtu mendoj që jemi vonuar me këtë miratim formal. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Nuk e di pse është kjo zhurmë.

Faleminderit, tash besoj që është në rregull.

Unë do të flas vetëm në pika të shkurtra sa i përket Komisionit për Legjislacion.

Nga kryesuesi i kësaj seance u tha që kemi mbetur shumë mbrapa me agjendën legjislative, është e vërtetë që është kështu dhe kjo ka ndodhur për shkak se agjendës së Kuvendit i është mbivendosur tema e demarkacionit. Sa herë kemi thirrur mbledhje të Komisionit për Legjislacion, për t'i diskutuar projektligjet, të cilat na janë proceduar nga Ministria e Drejtësisë, por edhe ato që janë nisur me Komisionit për Legjislacion, në vazhdimësi jemi detyruar ta shtyjmë mbledhjen e Komisionit për Legjislacion pikërisht për shkak se mbivendosej demarkacioni dhe anuloheshin agjendat e tjera të komisioneve parlamentare.

Tjetra është që sipas Rregullores së Punës, seancat e Kuvendit janë çdo të enjte dhe ditët e tjera janë të rezervuara për komisionet parlamentare.

Ka kohë që Kuvendi nuk ka funksionuar normalisht, natyrisht për këtë përgjegjësinë e ka kryetari i Kuvendit, sepse ai e thërret Kryesinë e Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit e cakton rendin e ditës.

Pra, do të duhej të jemi përgjegjës karshi Kuvendit dhe që seancat të mbahen me rregull, në mënyrë që të mos ngarkohemi pastaj me pika të rendit të ditës, nga 30 për një seancë, të cilat nuk po mund t'i kryejmë asnjëherë.

Komisioni për Legjislacion aktualisht i ka në procedurë 15 projektligje, plus dy nisma të komisionit që është Draft-rregullorja e punës së Kuvendit që do ta trajtojmë menjëherë pas kësaj pike, por po ashtu edhe nisma e Komisionit për Legjislacion që e ka marrë për barasvlefshmërinë në punë, pra barasvlefshmërinë ndërmjet burrave dhe grave, që është një nismë e Komisionit për Legjislacion dhe do ta trajtojmë shumë shpejt dhe do ta sjellim në Kuvend këtu para jush.

Po ashtu si plan të punës kemi paraparë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, njëra prej problemeve më të madha të komisioneve parlamentare, përfshirë edhe Komisionin për Legjislacion, është që kjo e drejtë kushtetuese fare pak zbatohet nga komisionet parlamentare. Por, edhe kur zbatohet, pastaj e kemi shumë vështirë t'u qasemi institucioneve, pikërisht për shkak të mostransparencës që kanë institucionet publike në raport me komisionet parlamentare, në raport me Kuvendin, por po ashtu kemi jashtëzakonisht shumë probleme sa i përket prezencës së ministrave në komisionet parlamentare. Mendoj që kjo duhet të adresohet për shkak se jo rrallëherë, komisionet ndonëse ftohen, i ftojnë ministrat gjegjësisht në komisione për të raportuar, ata neglizhojnë punën apo paraqitjen dhe llogarinë para komisioneve parlamentare.

Ajo çfarë duhet theksuar është se ne kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë që të respektojë afatet kohore sipas agjendës legjislative për procedim të projektligjeve në Kuvend.

Po ashtu shpesh përmendet Raporti i progresit, tashmë secili e ka të qartë që Raporti i progresit për Kosovën do të jetë negativ. Për herë të parë do të flitet për kapjen e sistemit të drejtësisë shprehimisht. Po ashtu në këtë pakon për sistemin e drejtësisë, kur të na e sjellin në komision thuhet që “për shkak të agjendës së reformave evropiane”. Por, që në emër të agjendës për reformën evropiane kontrabandohen edhe nene të tjera, të cilat propozohen nga individë apo grupe të caktuara.

Prandaj, Komisioni për Legjislacion do ta trajtojë me seriozitet secilin projektligj që vjen në Komision, jo shpejt e shpejt, në përputhje me afatet kohore, siç i parasheh Rregullorja e Punës dhe ajo çfarë mund të them këtu që nuk do ta tejkalojmë afatin që e parasheh Rregullorja dhe do të organizojmë dëgjime publike me shoqërinë civile dhe institucione të tjera, të cilat janë të prekura nga projektligjet që sillen në Komisionin për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën, ose Shqipe Pantina, më fal. Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Vitin e kaluar ne patëm diskutuar bukur gjatë për Programin e Punës së Kuvendit, jo vetëm ne deputetët brenda kësaj salle, por kjo u diskutua edhe nga organizatat e ndryshme që e mbikëqyrin punën e Kuvendit.

Unë pata shpresuar se vërejtjet dhe komentet e dhëna do të përfshiheshin në programin e këtij viti, sepse kjo ishte edhe një nga arsyet dhe qëllimet që u diskutua aq gjatë.

Por, për fat të keq, edhe këtë vit programi nuk e përmban gjithë punën që e bën Kuvendi.

Unë nuk mendoj se puna e Kuvendit është e kufizuar thjesht në legjislacion, qoftë në miratimin apo mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, ndonëse ne marrim shumë kritika se nuk po punojmë sa duhet, unë prapë mendoj se ne punojmë shumë më shumë se sa është prezantuar në programin të cilin ne e kemi përpara.

Unë po i përmend disa nga organet e këtij Kuvendi, të cilat mendoj që bëjnë punë jashtëzakonisht të madhe, të cilat fare nuk janë bërë pjesë e këtij programi.

Para se t'i përmend ato, te pjesa legjislative mungon një projektligj. Ne kemi pasur një interpelancë këtu, ndonëse rekomandimet nuk janë miratuar, po në një pyetje parlamentare që unë i kisha shtruar ministrit të Administratës, ai është zotuar se Ligji për pagat do të vijë në seancë në qershor dhe kjo duhet të përfshihet në programin e Kuvendit.

Përveç kësaj, duhet të përfshihen edhe aktivitetet e organeve apo trupave të tjerë të Kuvendit, siç janë, forumi për transparencë.

Unë nuk po e shoh deputetin Zenun Pajaziti, i cili e drejton këtë forum, por ne kemi bërë goxha punë aty, kemi hartuar edhe disa dokumente, e për të cilat ky Kuvend, seancat të paktën do të duhej të njoftohej. Për shembull, dy dokumente të rëndësishme që i ka hartuar forumi dhe këtu duhet falënderuar jo vetëm deputetët që kanë punuar, por edhe përfaqësues të organizatave të Shoqërisë Civile dhe organizatave ndërkombëtare që e mbështesin punën e Kuvendit.

Ta zëmë, është Kodi etik për deputetët, i cili shpresojmë të bëhet pjesë e Rregullores së Punës, por edhe Rregullorja për Media, ato nuk janë të pasqyruara në këtë program.

Të tjerë trupa të Kuvendit janë grupet e miqësisë, janë një numër i grupeve të miqësisë me vende të ndryshme, e unë mendoj se puna e këtyre grupeve të miqësisë nuk janë thjesht vizitat turistike, por ne takohemi me kolegët tanë nga vende të ndryshme, qoftë për të shkëmbyer përvoja apo qoftë për të ndërmarrë edhe iniciativa të përbashkëta.

Puna e grupeve të miqësisë, bile edhe vetë grupet e miqësisë mungojnë tërësisht në këtë program dhe unë besoj se ato duhet të jenë pjesë e programit të punës së Kuvendit.

Po ashtu, pjesë e programit duhet të jenë edhe grupi i grave deputete, edhe grupi i deputetëve të rinj. Të dy këta organizma po ashtu, përkundër vërejtjeve që mund të kemi, kanë bërë, kanë ndërmarrë iniciativa tejet të rëndësishme, jo vetëm që janë në shërbim të punës, promovimit të Kuvendit, por edhe të qytetarëve.

Prandaj, edhe puna e tyre do të duhej të jetë pjesë e këtij programi. Pra, programi duhet të plotësohet me aktivitetet e tjera, të cilat nuk janë pjesë e kësaj, por që janë aktivitete të cilat i kryen Kuvendi, i bëjnë deputetët, por edhe stafi tjetër civil dhe për të cilat duhet të njoftohen fillimisht deputetët në seancë dhe, natyrisht, edhe qytetarët e vendit. faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Ne e kemi studiuar Programin e Punës së Kuvendit apo planin e punës dhe konsiderojmë se është obligim i dy komisioneve, sidomos i Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit për Integritet Evropian që ligjet që kanë të bëjnë me agjendën evropiane dhe që kërkojnë që sa më shpejt të shkojnë në procedim, duhet të azhurohen dhe, njëkohësisht ne nëse duam të jemi më efikas si Kuvend, atëherë duhet ndjekur edhe praktikatat e vendeve, të cilat i kanë edhe seancat e ndara, seanca të cilat janë të debateve, të shqyrtimit të projektligjeve në leximin e parë dhe të dytë dhe ndarjen, pastaj, në seanca vetëm për votim, sepse kështu edhe punojmë më racionalisht, edhe mund ta zbatojmë Planin e Punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Mendoj se Plani i Punës së Kuvendit për këtë vit në shikim të parë duket shumë voluminoz, mirëpo unë kam disa vërejtje dhe sugjerime, për shkak se kam edhe pyetje parlamentare që nuk kam marrë përgjigje, përkundër insistimit në të kaluarën, vërehet mungesa e Ligjit për pyje dhe natyrisht paksa më duket jokorrekte Ligji për arsim e lartë është paraparë në tetor, kur dihet se edhe në legjislaturat e kaluara ky ligj nuk ka kaluar.

Mendoj se Qeveria, por edhe Kryesia e Kuvendit është mirë t'u dhënë përparësi dhe prioritet ligjeve, të cilat janë duke u zvarritur me vite të tëra në Kuvend dhe nuk po kalojnë me idenë që kalimi i tyre dhe materia e atyre ligjeve t'u shërbejë qytetarëve.

Ajo që po vërehet edhe në Planin e Punës dhe që është shqetësim permanent disavjeçar, është mungesa e ligjeve që garantojnë një reformë zgjedhore dhe për të cilën edhe përfaqësuesit e lartë

politikë të forcave politike ka vite të tëra që trumbetojnë se do të marrin hapa në këtë drejtim. Edhe për vitin 2018 nuk po shoh diçka të tillë, po shpresoj që ndoshta edhe me iniciativa të grupeve parlamentare apo edhe deputetëve, disa nga ligjet të futen si prioritet i prioriteteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë Propozim-Program të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018. Është evidente që ka ngecje, mirëpo është edhe normale, duke pasur parasysh edhe dinamikën e punës dhe arsyet që tashmë janë të njohura edhe për ne deputetët, por edhe për opinionin.

Mirëpo mendoj se me një dinamikë të shtuar të punëve mund të arrijmë dhe të kompensojmë atë që është e humbur. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Dëshiroj të shtoj diçka që zonja Pantina pak më herët e përmendi. Mendoj që duhet të përfshihen më shumë disa angazhime dhe disa aktivitete që janë planifikuar të bëhen nga Forumi për transparencë parlamentare.

Mendoj për krejt çka ka ndodhur në Kuvend edhe për krejt çka janë pritjet që lidhen me punën më transparente dhe me qasjen më të madhe të publikut, Shoqërisë Civile, qytetarëve në Kuvendin e Kosovës duhet të përfshihen në këtë dokument edhe disa plane që janë të këtij forumi.

Siç e dini, është bërë një plan i veprimtimit i Kuvendit për transparencë për 2016-2020, mendoj që duhet të jenë të përfshira. Këtu ka edhe disa aktivitete që Kuvendi duhet dhe mund t'i bëjë më mirë në krahasim me të kaluarën, edhe pse ka pasur një progres jashtëzakonisht të madh.

Po ashtu edhe Kodi i etikës që është punuar nga ky forum, me partnerët e tjerë, e që është ideja të përfshihet në Rregulloren e Kuvendit, po ashtu janë punë të këtij forumi që nuk janë vetëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, por edhe të Shoqërisë Civile, mendoj që duhet të jenë të përfshira tash e tutje edhe në këtë dokument.

Po ashtu edhe në informata që dalin nga Kuvendi, si informacione ditore dhe të tjera të publikuara, ende nuk jemi mësuar ta shohim Forumin e transparencës, e që tashmë po synojmë të jemi edhe pjesë e organizatave ndërkombëtare në këtë drejtim.

Po ashtu, duhet të themi që Parlamenti i Kosovës është lavdëruar në krahasim me të kaluarën për transparencë, për shkak të punës së mirë që është bërë në Kuvend nga deputetët, stafi civil, shoqëria civile, e të tjerë.

Mendoj që është koha të përfshihen në këtë dokument. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Ne për çdo vit këtu e shqyrtojmë agjendën legislative, por një dukuri, të cilën unë dua ta kritikoj, është që çdo legjislaturë deri tash sjell një agjendë shumë ambicioze legislative dhe e cila, me sa e mbaj mend unë, këtu shtatë vjetët e fundit, sa jam në Kuvend, për çdo vit kjo legjislaturë nuk arrin të shqyrtojë më shumë se 60% të planit legjislativ. Pra, maksimumi ku mund të arrijmë është 60% e planit, kështu ka ndodhur gjithmonë.

Kjo do të thotë që gjithmonë kemi agjenda të fryra në Republikën e Kosovës dhe kjo është një farë lloj dukurie, e cila e përshkon shtetin dhe institucionet tona në çdo dimension të tij, duke filluar prej statistikave të punësimit, të cilat i fyejnë gjithmonë, e deri te buxheti i shtetit, i cili konstruktohet shpeshherë edhe me shifra fiktive, gjithmonë të fryra. Pra, po dua ta kritikoj këtë tendencë në Republikën e Kosovës, e cila vjen gjithmonë prej pushtetit që të paraqesim pasqyra joreale për çdo aspekt të funksionimit institucional të Republikës sonë.

E dyta, sa i përket përmbajtjes së agjendës legislative, çdo program legjislativ vërehet qartë, vërehet në një lexim të parë, të menjëhershëm, që është shumë i varfër nga aspekti i propozimi të masave ligjore anti-korrupsion, Pra, keni llojllojshmëri të ligjeve aty dhe të masave që propozohen, por dy ligje që vazhdimisht mungojnë dhe që janë më të nevojshmet për Republikën e Kosovës dhe të cilat kërkohen edhe në çdo raport të Bashkimit Evropian, është Ligji për konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të paligjshme dhe Ligji anti-mafia. Këto nuk bëhen kurrë në Republikën e Kosovës. Këto nuk i bën asnjë pushtet, asnjë Qeveri në Republikën e Kosovës, dhe mungesa e këtyre masave tregon që këtu në Kosovë nuk ka vullnet politik për ta luftuar korrupsionin dhe bile kjo edhe hedh dyshimet që vetë pushteti në njëfarë mënyre është thellë i përfshirë në korrupsion.

E treta, që dua ta ngre si çështje është që pika më e dobët e punës sonë profesionale sa u përket ligjeve është kjo zyra që quhet Zyra për vlerësimin e përputhshmërisë të ligjeve tona me ‘acquis communautaire’, Bashkimit Evropian. Pse po e them këtë? Sepse unë i mbaj në mend këtu në Kuvendin e Kosovës së paku nja 20 ligje, të cilat kalojnë, bëhet një vit që kanë kaluar ato ligje,

na kthehen sërish në Kuvendin e Kosovës, dhe arsyetimi pse na rikthehen në Kuvendin e Kosovës pas një viti është se na ka ardhur një vlerësim nga Bashkimi Evropian, i cili thotë që nuk ka përputhshmëri me standardet e legjislacionit të Bashkimit Evropian, kurse ne e kemi një zyrë këtu, e cila, ju e dini, formën standarde të ligjeve tona ia bashkon edhe atë faqen, ku thotë: “Mirë e kemi shqyrtuar, gjithçka është në rregull, është në përputhje të plotë me standardet evropiane”. Pas një viti, ne do të detyrohemi ta rishqyrtojmë sërish dhe thotë “paska dalë diçka që nuk qenka në përputhje me standardet dhe në përputhje me ‘acquis communautaire’. Çka i bie kjo? Kjo i bie që atje në një zyrë në Qeveri, që është për vlerësueshmërinë e ligjeve tona në raport me ‘acquis communautaire’ është shumë e dobët profesionalisht. Unë prej përvojës po flas, se kemi pasur shpesh raste kur na rikthehen ligje, të cilat zbulohet që nuk na qenkan në përputhje me legjislacionin e BE-së, e ne këtu i kalojmë si ligje.

Kritika e katërt është që këtu në Kuvendin e Kosovës asnjë Qeveri nuk po e sjell ligjin për vetveten, pra Ligjin për Qeverinë. Kjo është shumë keq. Çka i bie kjo? Kjo i bie që Qeveria lihet gjithmonë në mëshirën e modelimit sipas koalicioneve qeverisëse. Pra, Qeveria po u dashka t’i përshtatet modelimit sipas interesave të pushtetit. Ky është një mesazh shumë i keq për një shtet serioz. Pse? Sepse po i bie që në hierarki të vlerave politike më lart është pushteti se shteti. D.m.th. pushteti e modelon shtetin, sipas të interesave të veta, që janë të përkohshme dhe të cilat ndryshojnë sipas rrethanave, të cilat i sjellin fushatat elektorale, koalicionet dhe nevojat ‘ad hoc’ të pushtetit, që lindin aty për aty.

Pra, që një qeveri dhe një pushtet të tregojë se është vërtet serioz, ligji i parë që duhet ta sjellë është Ligji për ta disiplinuar dhe për ta organizuar në mënyrë të ligjshme vetveten. Qeveria këtu na i sjellë me qindra ligje, e nuk na e sjellë Ligjin për vetveten. Kjo është e paprecedent. Nuk ka shtet në botë i cili nuk ka Ligj për Qeverinë. Është vetëm Republika e Kosovës. Pse nuk ndodhë kjo? Sepse, a do të jenë 22 ministri, a do të jenë 25 ministri, kjo bëhet duke e keqpërdorur shtetin, duke krijuar ministri të paqena vetëm për ta arritur joshjen e partnerëve të koalicionit.

E pesta që dua ta them është që ne po flasim shumë ligjet, por me të vërtetë është shumë diskutabile se sa po zbatohen ligjet në Republikën e Kosovës. P.sh., paradoksi më skandaloz në këtë legjislaturë ishte që më 25 janar, Qeveria e Kosovës këtu në agjendë legjislative e ka Shqyrtimin e Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, kurse më 22 janar Agjencia Kundër Korrupsionit ka vlerësuar që vetë Qeveria e ka shkelur Ligjin për konfliktin e interesit. Pra, tri ditë para se të vijë ky ligj, i cili është për parandalimin e konfliktit të interesit, agjencia del dhe thotë vetë ky ligj është shkelur nga Qeveria, kurse Qeveria në Programin e vet vetëqeverisës që e ka prezantuar në 140 faqe, njërën prej arritjeve më të mëdha dhe mburrjen e vet e ka që po e sjell Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, të cilin vetë e shkel me vendimin për ngritjen e pagave, e kam fjalën, që prej agjencisë u vlerësua si vetë shkelje e Ligjit të cilin Qeveria na e sjell përpara.

Dhe, e gjashta dhe e fundit, e me këtë dua ta përmbyll, na nevojitet edhe një kod elementar, apo ndoshta bën edhe t'ia mbajmë një kurs edukativ kryetarit të Parlamentit. Nëse e keni dëgjuar sesi ka sharë kryetari i Parlamentit, është e incizuar, para dy ditësh në seancën për demarkacionin, atëherë kjo bëhet shumë urgjente, sepse po vërtetohet që nuk e ka as edukatën, as kulturën elementare për të qenë në atë pozitë të kryeparlamentarit.

KRYESUESI: Fjalën e ka Blerta Deliu!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit,
Kolegë deputetë,

U përmend një pjesë e madhe e argumenteve për shkak të vonesave që ne i kemi pasur në miratimin në ligjeve, unë konsideroj që pavarësisht agjendës së demarkacionit, që ka qenë njëra prej agjendave më të rëndësishme të këtij Kuvendi, ne si komisione e kemi kryer një pjesë të madhe të obligimeve tona në raport me projektligjet, kemi mbajtur mbledhje të rregullta të komisioneve dhe i kemi kryer obligimet konform të Planit të punës së Kuvendit, që lidhet edhe me Programin e Kuvendit të Kosovës.

Ne si Komision e kemi në shqyrtim Projektligjin për kontrollin e brendshëm dhe është i vetmi projektligj që Komisioni për Integritet e ka në shqyrtim. U tha këtu që ministrat nuk kanë qenë të përgjegjshëm, e sa i përket Komisionit për Integritet Evropian konsideroj që ministrat e kanë kryer obligimin e tyre për të raportuar në Komision, dhe nëse e shohim të njëjtën periudhë të viteve të kaluara, konsideroj që ka pasur një agjendë shumë dinamike në raport me ministrat, të cilët kanë raportuar në Komision.

Në Komisionin për Integritet ka raportuar Ministria e Administratës Publike, ajo e Integritetve, e Drejtësisë dhe e Punëve të Brendshme, të cilat kanë sjellë informata kryesisht lidhur me agjendën evropiane. Edhe me të drejtë e përmendët z. Haliti që ne duhet t'i kryejmë obligimet tona në raport me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Dje kryetari i Kuvendit, z. Veseli, i ka ftuar kryetarët e komisioneve menjëherë pas miratimit të demarkacionit të kufirit me Malin e Zi. Ai e ka kërkuar një dinamik të shtuar të komisioneve parlamentare që lidhen konkretisht me ERA-n, agjendën e reformës evropiane, që ne t'i kryejmë këto obligime.

Janë një numër i madh i projektligjeve që nuk i janë nënshtruar akoma leximit të parë në Kuvend dhe ka shumë projektligje të cilat pritet të kalojnë në leximin e dytë. 39 projektligje janë në procedurë të shqyrtimit, prej tyre 9 projektligje janë kryesisht projektligje që lidhen me agjendën e reformave evropiane, që vijnë kryesisht nga Ministria e Drejtësisë. Ne duhet t'i kryejmë obligimet deri më 31 mars.

Ju e dini që në javën e dytë të prillit publikohet edhe Raporti i Progresit për Kosovën, prandaj ky Kuvend ka përgjegjësi dhe obligim që të procedojë me projektligjet e shumta dhe të mos i

bllokojë në komisione parlamentare. Është kërkuar efikasitet i shtuar dhe unë besoj shumë që kryetarët e komisioneve do ta marrin përgjegjësinë e tyre për proceduar me ligjet që i presin. U përmend Forumi për Transparencë, kam qenë një kohë pjesë e këtij forumi, mendoj që duhet përfshihet më detajisht në planin e punës dhe është diskutuar për kodin e etikës.

Mendoj që ky Kuvend, pas gjithë asaj që kemi parë viteve të fundit, ka shumë nevojë që ta funksionalizojë këtë kod dhe deputetët ta kenë përgjegjësinë e tyre që të jenë të përgjegjshëm në punën që kryejnë si deputetët të Kuvendit të Kosovës. Dhe, po ashtu është mirë që Planin e punës të Kuvendit ta ketë një pozicion të qartë edhe Grupi i Grave Deputete. E dini që së fundi e kemi zgjedhur edhe kryetaren e këtij grupi, zonjën Mexhide Topalli-Mjaku. Ky grup ka funksionuar shumë mirë viteve të kaluara dhe e ka bërë një punë të mirë me përkushtimin e të gjitha deputetëve, të cilat kanë qenë të interesuara për agjendën e grave për ta shtyrë këtë agjendë dhe duhet të bëhet pjesë e agjendës së Kuvendit.

U përmend edhe zyra, e cila e bën përputhshmërinë e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian. E dini që Kuvendi i Republikës së Kosovës së fundi është duke e ideuar një departament të veçantë që do të merret konkretisht me legjislacionin që prek atë të Bashkimit Evropian, do të merret me përputhshmërinë dhe me gjitha projektligjet, të cilat lidhen me agjendën tonë evropiane. Dhe, po ashtu, mendoj që Zyra për Media duhet të jetë pak më shumë efektive.

Kohëve të fundit kemi parë që lajmet plasohen shumë vonë në këtë ueb-faqen e Kuvendit, e kuptoj që ka një dinamikë të shtuar të komisioneve dhe të deputetëve në agjendat e tyre, por besoj që kjo do t'i kontribuonte një informimi më efikas dhe më të shtuar të punës që bëjnë deputetët brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe jo vetëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e nevojshme që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta ketë Planin e punës, por mbi logjikën me të cilën funksionon Kuvendi i Republikës së Kosovës. Edhe sot kur po debatojmë, jo rrallë herë, sigurisht edhe nga interesimi i deputetëve dhe grupeve, jo vetëm ato politike që përfaqësojnë, por edhe nga interesat e ndryshme, u jepet shumë përfaqësi grupeve joformale, apo aktiviteteve joformale, siç quhen në aktivitetin tonë parlamentar.

Unë mendoj që edhe në Planin e punës kjo duhet të strukturohet, të organizohet dhe të ketë aktivitet përmbajtësor me afate dhe me ditë të caktuara për shkak të implikimit që ka natyra e punës së Kuvendit dhe interferimit të drejtpërdrejtë, qoftë në hartimin e ligjeve dhe në mbikëqyrjen parlamentare.

Nga dinamika që kemi parë edhe në këtë aktivitetin e fundit, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur që të miratojë ligje, ndërsa aktivitetet joformale janë në rritje, të cilat nuk kanë një cilësi dhe nuk kanë efekt apo impakt në shoqërinë tonë kosovare për t'i shtyrë aktivitetet dhe ngjarjet të cilat janë në interes dhe në zhvillim të vendit. Kështu që unë besoj që fokusi ynë duhet të jetë në miratimin e ligjeve dhe në mbikëqyrjen parlamentare ashtu siç na takon me Rregulloren e Kuvendit, por mbi të gjitha edhe mandatin Kushtetues që e ka Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kështu që ju kisha lutur që shumica e kohës dhe shumica e diskutimeve, por edhe shumica e asaj tendencës në raportin me Kryesinë e Kuvendit i nënshtrohet një lloj presioni të aktiviteteve apo të grupeve joformale, të cilat nuk kanë impakt në Legjislativin, apo që lidhen edhe drejtpërdrejtë me Ekzekutivin e vendit.

Kështu që dinamika e punës duhet të saktësohet, mbi të gjitha reduktohet në bazë të përgjithësisë, të cilën e kanë edhe komisionet parlamentare, pa i përjashtuar aktivitetet politike dhe qëllimet e subjekteve politike në jetën parlamentare.

Mendoj që këto duhet t'i ketë parasysh edhe Kryesia e Kuvendit, por edhe grupet parlamentare, mbi të gjitha edhe deputetët, që ta ushtrojnë mandatin e tyre kushtetues në harmoni me ligjet dhe Rregulloren e Kuvendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Sipas Programit legjislativ të vitit 2018 janë paraparë për shqyrtim në kompetencë të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike këto projektligje: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-188 për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, Projektligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Projektligji për Diasporë, që parashihet të procedohet Kuvendit të Kosovës.

Komisionet parlamentare dhe deputetët, përpos miratimit të ligjeve, e kanë si obligim edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe varësisht prej zbatimit kanë të drejtë të kërkojnë edhe për t'u sjellë në Kuvendin e Kosovës ligjet për plotësim-ndryshim. E dëgjova Glaukun që tha po sillen projektligje të këqija, por për ato projektligje nuk duhet të akuzohet Qeveria, sepse Qeveria i sjell dhe i procedon në Kuvendin e Kosovës, ndërsa janë deputetët ata që ia japin formën finale të projektligjit. Dhe, secili deputet dhe komisionet parlamentare, ku shqyrtohen këto projektligje, e kanë obligim që njëkohësisht këto ligje të jenë të implementueshme.

Po ashtu, ju e keni dëgjuar se para pak kohësh, kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, ka kërkuar që në Kuvend të sillen edhe Projektligji për Qeverinë, dhe është në agjendën legjislativë, ndoshta Glauku s'e paska lexuar mirë agjendën legjislativë, sepse është me numër rendor 07 prej projektligjeve që parashihen për të ardhur. Është në agjendë legjislativë

dhe në momentin që sillet, është detyrë e deputetëve dhe komisioneve përkatëse nëse do ta miratojnë dhe si do ta rregullojnë çështjen e projektligjit të Qeverisë, sepse kemi projektligje dhe kemi ligje për të gjitha sferat dhe është e pakuptimtë që të mos jetë një ligj edhe për Qeverinë e Republikën së Kosovës.

Njëkohësisht, Komisioni për Punë të Jashtme i ka në monitorim plot projektligje, e ju e dini që njëkohësisht pas monitorimit hartohet raporti i punës së komisioneve dhe nëse gjatë monitorimit shihet që këto projektligje nuk po zbatohen praktikisht, ekziston mundësia që këto ligje të sillen për plotësim-ndryshim. Ligjet që po i monitorin Komisioni për Punë të Jashtme janë: Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, Ligji për Diasporën dhe Mërgatën dhe Ligji për investime strategjike.

Unë i lus të gjithë deputetët dhe komisionet parlamentare që në momentin që sillen ligjet të respektohen afatet kohore për amendamentim dhe të sillen për miratim në afat kohor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Përtej atyre që u thanë, si deputet i Parlamentit të Kosovës dëshiroj të them që unë personalisht jam ekstrem i pakënaqur me dinamikën e punës së Parlamentit deri më sot kur po flasim. Prej kur jam deputet i këtij Parlamenti, nuk mbaj në mend që ky Parlament e ka zhvilluar qoftë një seancë normale dhe që ky Parlament ka folur për diçka që është brenda kornizave të punës që ne duhet ta bëjmë si deputetë të Parlamentit të Kosovës.

Shpikja e temave të mëdha nga individë të ndryshëm, nga politikanë të ndryshëm, ka qenë pikërisht qëllim për ta bllokuar punën e Parlamentit në miratimin e ligjeve. Për shembull, gjithmonë më ka interesuar se si ka mundësi që ne si popull në statistika, në hulumtime të ndryshme, jemi shpallur populli më i lumtur në një vend kaq të varfër, me një milion probleme, dhe të njëjtën pyetje do t'ia bëja çdo deputeti të Parlamentit të Kosovës: A mund të jemi të kënaqur me punën, të cilën ne e kemi bërë deri më sot?

Prandaj, i bëj thirrje opozitës që së bashku me ne, me disa deputetë, që të bashkëpunojmë në aprovimin e ligjeve dhe t'i parashtrijmë kërkesa konkrete Qeverisë së Kosovës për Ligjin për Qeverinë, që e përmendi Glauku, e që është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm, e që është bajagi turp që ne nuk e kemi këtë ligj deri më sot.

Gjithashtu, do të dëshiroja nga çdo deputet i Parlamentit Kosovës që duke e ushtruar mandatin tonë ta rritim presionin dhe ta rritim kontrollin ndaj Ekzekutivit. Disa herë e kam thënë në këtë foltore se deri më sot kontrolli nga Parlamenti në raport me Qeverinë ka qenë vetëm 6%, d.m.th.

94% Qeveria e ka kontrolluar Parlamentin, e vetëm 6% Parlamenti e ka kontrolluar Qeverinë. Prandaj, do të dëshiroja që ta ndryshonim këtë trend dhe t'i futeshim punës, e t'i lëmë pak vizitat lidhje e pa lidhje, që një pjesë e deputetëve e kanë qëllim vetëm të vizitojnë vende të ndryshme. E kam thënë edhe për Ekzekutivin që ka plot zëvendësministra që me paratë e taksapaguesve të Kosovës mezi presin të nxjerrin një thirrje nga ndonjë shoqatë kulturore nëpër vendet e ndryshme të Evropës dhe pastaj të shkojnë në vizitë, e duke postuar fotografisë se gjoja kanë bërë vizita zyrtare.

Prandaj, të ndërruar deputetë, dëshiroj t'i kthehemi punës dhe ta rritim dinamikën e aprovimit të ligjeve. Pavarësisht se çka thotë zyra e Bashkimit Evropian, ne duhet ta kryejmë punën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar këtë, disa nga kolegët e mi të grupit tonë e dhanë opinionin e tyre dhe më lejoni që t'i jap edhe disa vlerësime tona.

Në veçanti, sa u përket detyrave shtesë që duhet t'i ketë Kuvendi, në mënyrë që ky Kuvend të mos reduktohet në detyra krejt - sigurisht të rëndësishme, por procedurale në aprovimin e projektligjeve që vijnë nga Qeveria.

Ne mendojmë që në këtë Plan-program punës së Kuvendit duhet të zërë vend edhe diplomacia parlamentare. Deputetët e komisioneve parlamentar, në veçanti nga Komisioni për Politikë të Jashtme, edhe ata për Integritet Evropian janë shumë aktivë në pjesëmarrjen në trupat ndërkombëtare të BE-së, rajonale dhe të tjerë. Për ta promovuar shtetin e Kosovës, unë besoj që kjo duhet të jetë pjesë e agjendës së punës së Kuvendit të Kosovës, pra pjesëmarrja nëpër ngjarje të planifikuara paraprakisht dhe promovimi i institucioneve të shtetit të Kosovës në to. E dyta, duhet të zërë vend në Program të punës edhe angazhimi i komisionit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, një takim është mbajtur, një tjetër është planifikuar më vonë. Jo vetëm pjesëmarrja në takimet e përbashkëta të Komisionit për MSA-në, por edhe bashkëpunimi me Qeverinë e Kosovës dhe institucionet tjera për t'i përmbushur detyrat që Kosova i ka karshi Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe gjithashtu transparenca dhe llogaridhënia. Deputeti Zenun Pajaziti veç e përmendi, është një komision i veçantë parlamentar për këtë çështje. Është duke punuar me e sa di intensivisht në terren për ta promovuar transparençën e Kuvendit karshi qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Janë edhe disa ligje shtesë, pra nisma ligjore, të ndërmarra nga grupet e deputetëve. Tri janë nga grupi ynë parlamentar që nuk janë reflektuar në këtë Program të punës dhe ne dëshirojmë që t'i

shohim edhe këto pjesë të Programit të punës të Kuvendit, por mbi të gjitha unë kërkoj që të jemi më të kujdesshëm në respektimin e një agjende më strikte të punës së Kuvendit, sepse kemi dalë komplet jashtë rrjedhës së punës së Kuvendit. Ka qenë një praktikë përpara me mbledhjet e Kryesisë Kuvendit të hënave, dhe pastaj komisionet parlamentare të martave e të mërkurave, dhe çdo të enjte seancë parlamentare. Mosrespektimi i kësaj dinamike e ka nxjerrë Kuvendin nga realizimi i programit të punës siç është paraparë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Mendoj që kur diskutojmë për Planin e punës brenda këtyre tri legjislatrave, mendoj që duhet të kthehemi pak në retrospektivë dhe të shohim atë që kemi bërë dhe atë që nuk kemi mundur ta bëjmë brenda kësaj periudhe kohore, dhe ato defekte të cilat paraqiten, e në veçanti mosndjekja e hapave të duhur, pastaj kur Kuvendi debatohet për problematika të caktuara dhe në fund nxjerr konkluzione dhe rekomandime për institucionet përkatëse, e në veçanti kur kemi të bëjmë pastaj me nevojën që fusha të caktuara të rregullohen me ligj dhe Kuvendi t'i nxjerrë rekomandimet për rregullimin e asaj fushe me anë të ligjit, dhe ajo mbetet pastaj një letër e shkruar në Kuvend e nuk përcillet më tutje.

Ka ndodhur që në tri legjislatura më parë ne debatojmë për një çështje, në atë legjislaturë nuk janë marrë hapat të duhur për ta bërë ligjin për fushën për të cilën kemi diskutuar, as në të dytën, është bërë një pjesë e saj, pastaj e treta ka harruar se çka është rekomanduar dhe është votuar në Kuvend në të tri apo katër legjislatura më parë.

Ndodh njëjtë që në legjislaturën e kaluar ne kemi diskutuar për shkeljen e drejtave të punëtorëve, një problem shumë serioz, sepse punëtorët nëpër vendet e tyre të punës, përveç diskriminimeve që u bëhen, qoftë në institucione, në organizata private apo ato publike, kemi pasur edhe humbje të jetës dhe pastaj edhe dëmtime me invaliditet të pjesshëm apo të përhershëm për disa prej këtyre punëtorëve, dhe kemi nxjerrë rekomandime që të përmirësohet legjislacioni dhe tani kur shohim këtë plan Plan-program, e shohim nuk është paraparë plotësim-ndryshim i Ligjit të punës edhe për të përmirësuar, edhe për të avancuar të drejtat e punëtorëve. Është paraparë vetëm Ligji për Inspektoratin e Punës, por jo edhe Ligji i punës.

Ligji i punës do të duhej të ishte në agjendën e Kuvendit këtë vit edhe për faktin e përmirësimit apo të rregullimit të çështjes së lehonisë, në veçanti aty ku kemi menduar që ka nevojë të përmirësohet në zgjatjen e pushimit të lehonisë, nga ajo që është sot 9 muaj, të bëhet 12 muaj, dhe sigurisht pastaj t'i marrim praktikën edhe nga Bashkimi Evropian që aty ku ka mundësi të rregullohet edhe më mirë dhe besoj që diskutimi për këtë çështje do të duhej të ishte i një niveli

shumë më të gjerë dhe të profesionit e të fushës për ta rregulluar këtë problematikë, e në veçanti për rregullimin e kësaj çështjeje.

Në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kemi diskutuar edhe për ligjet që e prekin fushën e shëndetësisë. Janë të planifikuara që të ndodhin në muajin e gjashtë, edhe atëherë kemi deklaruar se janë vonë këto ligje, prandaj Kuvendi do të ecte më shpejt me hapa sa i përket kësaj fushe, në veçanti për pakon ligjore të shëndetësisë, sepse mendoj që problemet të cilat janë grumbulluar në shëndetësi do të duhej të rregulloheshin, fillimisht me anë të legjislacionit të vendoseshin në një rend dhe një pikë, në vend që ku kemi pasur një mospërputhje të ligjeve, aty ku e kemi parë që gjatë kësaj periudhe kohore ka nevojë të përmirësohet edhe Ligji për shëndetësinë, edhe Ligji për sigurime shëndetësore. Zbatimi i Ligjit të odave të profesionistëve shëndetësorë ka ngecur dhe është ngadalësuar qëllimshëm nga Ministria e Shëndetësisë. Funksionimi i tyre do të duhet të ishte më i mirë dhe mendoj që ne duhet ta rregullojmë këtë me plotësimin e këtij ligji, aty ku kemi parë që ka disa defekte në zbatimin e tij.

Pra, duhet të përfshihet edhe Ligji i odave të profesionistëve shëndetësorë që do të jetë pjesë e pakos ligjore bashkë me Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor, i cili planifikohet të diskutohet tek në fund të vitit, dhe gjithashtu një ligj i cili ka qenë në Kuvend në legjislaturën e kaluar dhe më nuk ka ardhur, dhe mendoj që është gjithashtu më i domosdoshëm, sepse miliona euro të Kosovës shkojnë jashtë për shkak të mungesës së Ligjit për transplantimin e organeve dhe indeve, prandaj mendoj që ai ligj duhet të jetë pjesë e pakos ligjore dhe të mos shpenzojmë miliona euro për trajtimin e pacientëve jashtë vendit në mungesë të rregullimit të kësaj fushe nëpërmjet këtij ligji.

Pra, mendoj që edhe ajo që te ne e kemi diskutuar në tri legjislatura më herët sa i përket problemit apo avancimit të sportit, i kemi dy ligje që i kemi miratuar në mandatin e kaluar, por ka ngecur Ligji për menaxhimin e objekteve sportive, një ligj i cili është më se i domosdoshëm, në veçanti në këtë etapë të zhvillimit të sportit dhe kjo fushë duhet të rregullohet edhe për aspektet e menaxhimit, por edhe për aspektin e sigurisë së objekteve sportive, sepse në këtë botë të pasigurt mendoj se duhet të investohet, ose të punohet më shumë në parandalimin e këtyre dukurive, që mund të jenë me pasoja fatale. Pra, kjo fushë duhet të rregullohet me ligj dhe mendoj se gradualisht ne duke e rregulluar dhe duke rrumbullakuar pakot ligjore të këtyre fushave ne arrijmë ta bëjmë punën tonë, por gjithsesi mendoj se do të ishte mirë që Kuvendi aty ku sheh që mungon një përpjekje e vazhdueshme e institucioneve përkatëse e ministrive të caktuara për të plotësuar, ose për të përmbushur rekomandimet që dalin nga Kuvendi, pas shumë debateve dhe diskutimeve këtu, që t'u shkruhet nga një letër këtyre institucioneve sepse kanë pjesë në agjendën që Kuvendi e ka miratuar apo në rekomandimet që Kuvendi i ka bërë të detyrueshme apo që to të jenë pastaj të zbatueshme nga institucionet përkatëse qeveritare.

Pra, nuk mund të funksionojmë nëse Kuvendi e bën një Plan-program të vetin legjislativ e ministrinë e caktuara një plan tjetër dhe të mos jemi të koordinuara sa i përket këtyre aspekteve të funksionimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Programi i Punës së Kuvendit për këtë vit, bazuar në rregulloren e Kuvendit është dashur të vijë në seancë dhe të miratohet gjatë muajit shkurt, që do të thotë se po vjen me pothuajse një muaj vonesë.

Për vitin 2018 janë paraparë të procedohen 135 projektligje, kurse gjatë këtyre tre muajve sa po kalojnë këto ditë në seancë, domethënë kanë ardhur vetëm 22 projektligje në lexim të parë dhe vetëm disa prej tyre edhe në lexim të dytë, që do të thotë se për pjesën e mbetur të vitit që kanë mbetur 8 muaj, nëse nuk i llogarisim një muaj të pushimeve të Kuvendit, janë 113 ligje projektligje, 29 raporte pune dhe 18 ligje janë planifikuar të mbikëqyren, që i bie se çdo muaj pune do të duhej të procedojmë ligje aq sa kemi proceduar për tre muaj e që i bie rreth 20 ligje projektligje gjatë një muaji, që pothuajse me dinamikën që është këtu ka punë edhe për vitin e ardhshëm.

Në këtë program pune, përkundër numrit të madh të projektligjeve të parapara nuk janë paraparë edhe disa projektligje të cilat janë premtuar, se do të vijnë këtë vit në Kuvend dhe do të miratohen. Për shembull, punëtorëve të arsimit të viteve të '90-ta, Ministria e Arsimit u ka premtuar se Ligji për këtë kategorinë e mësimdhënësve do të vijë në Kuvend, do të miratohet dhe ata do të fillojnë t'i shfrytëzojnë benifitet, të cilat ministria dhe kjo shoqëri u ka premtuar, por siç po shihet në këtë program pune ky projektligj nuk është paraparë as për këtë vit dhe kjo është një padrejtësi e madhe për krejt këtë kategori të mësimdhënësve, të cilët në vitet më të vështira për Kosovën në përgjithësi dhe sidomos për arsimin në Kosovë e kanë dhënë kontributin e vet dhe tani po kalojnë 20 vjet nga koha kur ata e kanë përfunduar këtë mision, ose 30 vjet nga koha kur e kanë filluar këtë mision dhe fatkeqësisht, një pjesë e madhe e tyre tanimë nuk janë në jetë.

Po ashtu, është premtuar që gjatë këtij viti të procedohet edhe projektligji gjithëpërfshirës për aftësitë e kufizuara, pasi që aktualisht në këtë fushë ekzistojnë vetëm dy ligje, Ligji për persona të verbër dhe Ligji për tetraplegjikë dhe paraplegjikë, kurse për gjashtë kategori tjera të personave me nevoja të veçanta nuk ka ligj. sipas përfaqësuesve të forumit, ose shoqatave, të aftësive të kufizuara, Ministria për Punë dhe Çështje Sociale gjatë viti 2015 dhe 2016 ka punuar në draft-konceptin e projektligjit gjithëpërfshirës për këto kategori dhe e ka përfunduar punën në prill të vitit 2017, por tash edhe pas një viti të përfundimit të punës ky projektligj nuk ka ardhur në Kuvend.

Dëshiroj të them se këto dy projektligje të premtuara për këto dy kategori që janë, konsideroj, të veçanta në shoqërinë tonë do të duhej të procedohen gjatë këtij viti dhe po ashtu, seancat e Kuvendit tash e tutje të mbahen për çdo javë dhe të mos ndodhë që t'i grumbullojmë nga 20 e 30 pika përnjëherë e pastaj ato të na zgjasin me javë dhe po ashtu, kur i kemi 30 pika kualiteti i punës në orët e vona të mbrëmjes nuk mund të krahasohet me punën që mund ta bëjmë, nëse kemi normalisht 7, 8 e 10 pika e punojmë 7-8 orë në ditë e jo njëherë të punojmë 15 orë e pastaj dy javë mos me qenë fare nëpër seanca. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën ia jap deputetes Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit.

Sot po e shqyrtojmë Propozim-Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2018. Rezultatet e mira, puna dhe mospuna e Kuvendit është e përbashkët, e të gjithë deputetëve, qoftë opozitë, qoftë opozitë.

Në takimin që e kishim dje me kryetarin e Kuvendit numri i projektligjeve që janë në Kuvend është 52, do të thotë aktualisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë 52 projektligje të ndara, kuptohet nëpër komisione. 39 prej tyre tashmë janë në komisione, pastaj janë tri marrëveshje që presin për aprovim në Kuvendin e Kosovës. 29 kanë kaluar në parim, 10 të tjera presin prapë në shqyrtim të parë në komisione. Por, ajo që u theksua dje dhe që është për t'u shqetësuar të gjithë deputetët është një afat kohor, që është paraparë deri në fund të muajit mars që deputetët, kryetarët e komisioneve, gjithashtu të gjitha komisionet, vërtet të kryejnë një punë më intensive, në mënyrë që të zëmë këto afate që në raportin e progresit, i cili pritet që kah mesi i muajit prill të dalë, mos të jemi thjesht si Kuvend dhe të marrim vërejtje aty për shkak të mospunës së Kuvendit.

Çdoherë Kuvendi nuk ka arritur mjaftueshëm të monitorojë Qeverinë dhe vërtet ajo është shqetësim i vazhdueshëm i të gjitha legjislativave, prandaj presioni, puna e deputetëve për ta monitoruar Qeverinë e Republikës së Kosovës duhet të intensifikohet, por të mos mbetemi mbrapa me punën tonë si deputetë, pra të gjithë deputetëve.

Prandaj, sinqerisht është diçka që asnjëherë nuk duhet, ose nuk është e mjaftueshme ta lëmë anash pa e përsëritur rekomandimet që dalin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe që nuk merren parasysh nga Qeveria e republikës së Kosovës. Është shqetësuese ajo se që nga viti 2013 pra qoftë në Komisionin e atëhershëm Parlamentar të Komisionit të Arsimit, por edhe nga rekomandimet që kanë dalë në debat që është mbajtur në vitin 2013 në Parlamentin e Republikës së Kosovës dhe i rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës që në afatin prej tre muajsh të sjellë Ligjin e punëtorëve, pra që rregullon statusin e punëtorëve të viteve të '90-ta.

Ky projektligj nuk ka ardhur dhe unë sinqerisht sot i bëj thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që tani është viti 2018, janë pesë vite kur nuk janë marrë parasysh rekomandimet e Kuvendit, i bëj thirrje që ky muaj që po vjen, muaji prill, të jetë muaji i fundit që Qeveria të sjellë së pari në Qeveri për aprovim këtë Kuvend dhe t'ia sjellë Kuvendit, në mënyrë që të mbyllet ky spektakël i daljes apo nënshkrimit të marrëveshjeve me Sindikatën e Arsimin dhe ato rekomandime asnjëherë nuk po merren parasysh. Pra edhe një herë, çfarëdo që ne bëjmë, si pozitë, si opozitë, dhe në fund rezultatet, ose puna e mirë ose jo e mirë e Kuvendit është e përgjithshme, është e gjithë deputetëve. Andaj, edhe një herë i ftoj të gjithë kolegët deputetët që ne të kryejmë punën tonë, por njëkohësisht të jemi shumë më të angazhuar në monitorimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sepse vërtet shifrat janë alarmante, që ne nuk po arrijmë të monitorojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, t'i bëjmë presion që të sjellë edhe ligjet të cilat rregullojnë fusha të ndryshme, por mbi të gjitha që të jenë të ndërgjegjshëm dhe të përgjegjshëm në zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Kuvendi, një shprehje jo e mirë që ka ndodhur deri më tani, por vërtet është momenti që të shihet që puna e deputetëve dhe rekomandimet që jepen nga Kuvendi të merren parasysh dhe të jenë rekomandim që duhet ta zbatojë Qeveria e Republikës së Kosovës.

Andaj, edhe një herë, të jemi më të përkushtuar dhe është mirë që ligjet të cilat janë në shqyrtim në parim, pra të sillen në Kuvend dhe është shumë me rëndësi që shumë seanca që thirren, qoftë nga pozita apo opozita, ose debate të ndryshme që thirren në Kuvend, të mbesin në një ditë të caktuar, por mos të mbesin prapa me kalimin e ligjeve të cilat ne i kemi në parim të shqyrtuara apo që po mbesin për t'u shqyrtuar. Ajo që është diskutuar dje le të merret parasysh nga të gjithë kryetarët e komisioneve, por njëkohësisht edhe nga vetë deputetët. Puna jonë le të shihet që është punë serioze dhe vërtet mos të ndalemi asnjëherë duke e monitoruar mjaftueshëm Qeverinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma. Urdhëro, Xhevahire!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot po diskutojmë në një seancë të mirëpritur, normale, që ish dashtë me diskutua shumë më shpesh për punët që i kemi obligim. Kisha dashur të fokusohem më shumë te ligjet që bien ndesh, vijnë në Komisionin Funkcional ku jam anëtare, pra Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie, një komision i cili ka tri fusha shumë të rëndësishme. Po ashtu, kontrollon edhe katër agjenci shumë të rëndësishme, veçanërisht në çështjen e reformave të Administratës Publike.

Mirëpo, para se të fokusohem te ligjet kisha dashur në disa çështje të përgjithshme të flas. E përmendi edhe kolegja ime Blerta, çështja e funksionimit të Zyrës së Medieve nuk është që neve

na shqetëson shumë ajo se sa do të duket puna jonë, por është mirë që parimi i transparencës, për të cilën kemi shumë dëshirë të flasim të gjithë, të ekzistojë edhe si mekanizëm që funksionon në Kuvend. Merreni me mend, krejt Kuvendi e kemi një aparat fotografik, domethënë çfarë mund të përfshijë vetëm si pamje vizuale të punës sonë që e bëjmë nëpër komisione. Përshkrimi i aktiviteteve bëhet në mënyrën më të dobët të mundshme, veçanërisht puna që bëhet nëpër komisione prezantohet shumë pak. Puna e përfaqësuesve, deputetëve, prezantohet tepër pak jashtë vendit dhe në mënyrë shumë të dobët dhe kurrë s'arrijmë me i marrë mediet prej Kuvendit, më shumë e bëjnë deputetët në mënyrë individuale.

Ishte dashur ta kemi si fokus edhe sekretaria, pse jo edhe Kryesia një ditë të veçantë ta shqyrtojë, po unë kisha pasur dëshirë që bile një ditë të diskutojmë, qoftë edhe në një seancë të mbyllur, sepse ka çështje për të cilat kemi nevojë edhe ne si deputetë me e kërkuar përkrahjen për të qenë funksional, sepse lypet një punë e përgjegjshme.

Më lejoni të theksoj, që Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie deri në fund të vitit i ka 15 ligje, i ka 6 raporte të cilat vijnë në fund të marsit, 2 prej tyre kanë mbetur prej vitit 2016 për shkak të shpërbërjes së Parlamentit, ndërsa tani aktualisht i kemi 4 ligje që janë në procedurë, për të cilat jemi duke punuar intensivisht. Njëri veç kaloi, Ligji për kryeqytetin, u pa se kishim nevojë që secili të flasim e të marrim poenë politike edhe u ngutëm, derisa e kemi edhe një ligj të rëndësishëm, siç është Ligji për transmetuesin publik, në të cilin sigurisht se ka nevojë të punohet intensivisht.

Brenda komisionit kemi një punë të shkëlqyeshme të deputetëve edhe një aktivitet të ministrave, për të cilin ka nevojë fuqizim. Për shembull kemi nevojë ta njohim ministrin e Pushtetit Lokal, shumë kisha pasur dëshirë sot ta kemi këtu edhe kryeministrin, po mirë e di që kanë punë, mirëpo merreni me mend, asnjë prej anëtarëve të komisionit nuk e njohim ministrin e Pushtetit Lokal, as fytyrën nuk e dimë si e ka.

Mendojmë se ndoshta është mirë pas këtyre punëve të mëdha që i kemi kryer ta shohim atë në komision, sepse kemi ligje që vijnë prej Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe që janë të përfshira në pakon për reforma të administratës. Po shpresoj, që më në fund do ta njohim se kush është.

Përmendi edhe kolegu, tash mos marrin për të reaguar, por e përmendi Glauku çështjen e Ligjit të Qeverisë, por unë po i them se nuk është i shqetësuar veç Glauku, po kemi interes edhe ne vet si deputetë të mazhorancës që ta shohim sa më parë. Nëse flasim për prioritetë është mirë t'i vendosim në balancë këto prioritetë, sepse Ligji për Qeverinë do të vijë në fund të korrikut e kur të vijë në korrik ne e kemi si praktikë, e dimë mirë që krejt këto ligje që vijnë në korrik shkojnë deri në shtator, në fund të shtatorit dhe në tetor dhe s'arrijmë t'i kryejmë gjatë vitit hiç. Kështu që, s'jam shumë optimiste që do të arrijmë ta kryejmë.

Nëse nuk e kryejmë ligjin më shpejt edhe s'vjen si prioritet Ligji për Qeverinë e kemi më problem t'i realizojmë edhe punën e obligimet tona, që i kemi në raport me reformat në administratë publike, sepse po ashtu krejt në fund e kemi Ligjin për Shërbimin Civil, organizimin e Administratës Publike dhe kot ne flasim pastaj për balancimin e pagave dhe për çështje tjera, që edhe na lidhin tash në çështjen e formulimit edhe të kritereve tjera drejt liberalizimit të vizave, sepse nuk mund t'i rregullojmë, se rregullojnë fusha të theksuara.

Vetëm shkurtimisht desha t'i përmend, ta dimë se cilat ligje pritet të miratohen. Kemi kaluar Projektligjin për kryeqytetin, kemi në procedurë Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, ku jemi vetë sponsorizues si komision, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për statistikën zyrtare, ku sponsorizues është Zyra e kryeministrit, kemi Projektligjin për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare, kemi kaluar marrëveshjen për ratifikim, themelimin e shkollës rajonale të administratës publike, në këtë drejtim dua ta përgëzoj, se ministri Jagxhillar është jashtëzakonisht një prej ministrave më të përgjegjshëm, jo vetëm në raport me projektligjin, por edhe me raporte e kemi përherë shumë të përgjegjshëm në raport me anëtarët e komisionit.

Projektligji për Radiotelevizionin e Kosovës, ku e kemi të paraparë në maj të përfundohet, dhënia në shfrytëzim për këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, që e ka Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, Projektligji për ndryshimin e Ligjit për qasje në dokumente publike, që është një sponsorizim i Qeverisë dhe Projektligji për Shërbimin Civil, për organizimin e Administratës Publike, që i kemi dhjetë qeveri që është dashur me u pritë në pako, i kemi krejt në fund të vitit.

Ndërsa tani edhe një çështje, çështja e raportimit të organizatave, agjencive të pavarura, që vijnë në Kuvend, katër prej tyre janë në kuadër të Komisionit për Administratë Publike, është një punë goxha voluminoze, mirëpo është një çështje tjetër, pra ne ende s'e kemi i rregulluar këtë mekanizëm e që po na mungon me vite të tëra. Ne i sjellim, mirëpo çfarë efekti po kanë ato raportime, kur s'kanë asnjë penalizim, edhe nëse kalojnë, edhe nëse s'kalojnë në Kuvend. Mendoj se ishte dashur të mendojmë më seriozisht edhe për çështjet se si i përcjellim brenda Kuvendit punën e agjencive të pavarura, sepse e kemi vetëm një zyrtar. Një zyrtar me mbi 30 agjenci të pavarura, është e pamundur edhe fizikisht me e përcjell punën. Pra, kemi nevojë që ta kemi një ngjasim të punës me një ekip i cili do të punonte veçantë me raportet dhe punën, funksionimin e agjencive të pavarura.

Sigurisht, se na pret një punë e madhe. Unë kam besim që pas këtyre proceseve që i kaluam pak më sfiduese, mendoj se secili do të jemi pranë obligimeve të veta si deputetë. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti i fundit që e ka kërkuar fjalën është zoti Sami Kurteshi. Unë lus kolegët që s'janë në sallë të kthehen, sepse pastaj do të shkojmë me proces të votimit. Urdhëro, Sami, e ke fjalën!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nga shënimet që kam mbajtur do të përqipem të mos i përsëris gjërat që i thanë kolegët, gjëra shumë të vlefshme.

Unë kam bërë një analizë krahasuese në mes asaj që ka ofruar Qeveria në Programin legjislativ për vitin 2018 dhe Propozim-Programin e Punës së Kuvendit. Kur i sheh të dyja dhe i analizon ka mospërputhje, po ato mospërputhje edhe unë s'kam mundur t'i kuptoj bash drejtë, sepse Qeveria e paraqet 75 projektligje dhe akte të ndryshme, që do t'ia dërgojë Kuvendit, kurse te Kuvendi në Propozim-Program kemi nja 113 projektligje, hiq ato 11 prej vitit 2017, mbesin diku rreth 100 projektligje. Këtu ka mospërputhje, por kjo sidoqoftë ka arsytet e veta sigurisht.

Ne kur e shohim këtë Propozim-Program janë 140 çështje që ia ka paraqitur Propozim-Programi seancës edhe këto 140 çështje shumica prej tyre projektligje që duhet të shqyrtohen nga dy herë, hiq interpelancat, mocionet dhe veprimet e ndryshme që i kemi e që u përmendën nga kolegët, llogaritet të kryhen në 20 seanca që sipas këtij Propozim-Programi duhet të mbahen brenda vitit, sepse nëse në çdo dy javë një seancë mbahet i bie se s'kemi më shumë, aty diku bie rreth 20 seanca. Nëse llogariten krejt çështjet tjera, për të cilat mendohet se duhet të shqyrtohen nga Kuvendi, kjo është vërtet krejtësisht e pamundur edhe po të zgjasin këto seanca nga 10 – 12 orë e më shumë. 140 çështje duhet të kryhen brenda 20 seancave. Kjo është diçka e pamundur, prandaj unë dëgjova edhe propozime tjera, hiq atë frikën edhe përmirësimin e imazhit që duam ta kemi edhe nxitjen apo shtytjen që na jep agjenda evropiane dhe raporti i progresit, ne ligjet i bëjmë për Kosovën, për nevojat tona dhe duhet t'i zbatojmë ne, por nuk duhet t'i bëjmë për Evropën.

Prandaj, unë mendoj se neve na duhet një nxitim shumë më i madh në këtë drejtim. Edhe po t'i mbanim nga dy seanca në javë të gjitha çështjet që janë shtruar në këtë Propozim-Programi nuk do të mund të kryhen. Megjithatë, ky Kuvend është Kuvend profesional, domethënë llogaritet se këta njerëz punë parësore e kanë punën në Kuvend dhe unë mendoj se vetëm me një angazhim dhe disiplinë të gjithë Kuvendit, ne mund ta arrijmë agjendën pa na shtyrë agjenda evropiane dhe pa na shtyrë ndonjë raport i progresit të Bashkimit Evropian, t'i kryejmë punët tona për të cilat edhe e kemi marrë votën edhe marrim paga relativisht të mira, që në të vërtet janë tepër të mira për punën që e bëjmë, kur shohim se ku jemi në këtë gjendje. Kjo është çështja e parë dhe unë mendoj se kjo çështje duhet të shqyrtohet.

Një çështje tjetër, që unë dua ta ngre, në të vërtet u ngrit pjesërisht edhe nga deputeti Konjufca po edhe nga të tjerët. Është Zyra e, ta quaj ashtu, "homologimit të legjislacionit tonë me ato të 'acquis communautaire'" me të Bashkimit Evropian. Ajo është një vërejtje jashtëzakonisht e

madhe, sepse në shumë fletë që i marrim ne, në të vërtet janë veç fjali formale dhe nuk ka asgjë përmbajtjesore, në shumë raste të ligjeve. Po ashtu, në shumë projektligje vërehet se kemi përkthime të dobëta nga ligje të ndryshme, që nuk përkojnë, as me gjuhën, standardin gjuhësor, po as me normën juridike, as me realitetin në Kosovë dhe ky është një problem i madh, hiq problemet që i kemi gjuhësore, sintaksore e drejtshkrimore e që na vijnë e kalojnë edhe në leximin e dytë. Përveç kësaj, ne kemi edhe çështje tjera. Një çështje u përmend, Ligji për Qeverinë, që sigurisht se do të vijë diku në nëntor, nëse arrijmë. Me këtë tempo s' do të arrijmë as në nëntorin e vitit të ardhshëm ta nxjerrim këtë ligj, po është paraparë që shqyrtimi i parë të bëhet dikur në nëntor, shqyrtimi i dytë në dhjetor. Kjo është njëra çështje, kjo vonesë ka arsytet e veta, por sigurisht se është e qëllimshme, se në të vërtet asnjë qeveri nuk është e interesuar ta nxjerrë një Ligj për Qeverinë. Por, ajo që shihet edhe në këtë projekt-program të Kuvendit kemi një paradoks që unë megjithatë dua ta theksoj.

Ne kemi... tash na ka ardhur edhe ndryshimi-plotësimi i Ligjit për sigurime shëndetësore, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Llogaritni ne nuk kemi sigurime shëndetësore, kurse paradoksin e kemi që po e ndryshojmë dhe po e plotësojmë ligjin për diçka që nuk e kemi fare. Edhe, unë nuk po e di a jemi të ndërgjegjshëm që po lejojmë kësi paradokse të na vijnë në këtë Kuvend dhe ne të diskutojmë për diçka që nuk e kemi. Unë nuk e di a qeshin krejt qytetarët e Kosovës kur të dëgjojnë se po ndryshohet dhe po plotësohet Projektligji për sigurime shëndetësore, kur ne nuk kemi sigurime shëndetësore në këtë vend.

Sigurisht, se ka edhe çështje të tjera. Unë kisha lutur edhe një herë, që Kuvendi të marrë parasysh që ta rrisë tempon e punës dhe jo dy seanca në muaj, ashtu siç është paraparë në këtë Propozim-Program, po ti bëjë dy seanca në javë derisa ne të arrijmë ta plotësojmë agjendën, pa marrë parasysh cilit grupim politik i takojmë. Ne për këtë jemi zgjedhur, kemi marrë votën dhe marrim pagat.

Çështja tjetër, unë kisha lutur edhe Zyrën e Kuvendit që merret me redaktimin e projektligjeve të teksteve, që të kenë kujdes e të mos lëshohen absurditete gjuhësore, së paku, sepse absurditetet dhe paradokset normative ne i kemi në shumë ligje, që mandej po ashtu e bëjnë të pamundur zbatimin e ligjeve, sepse në kuadër të këtyre teksteve normative ne kemi paligjës, paradokse që kanë kundërthënie thelbësore logjike.

Sërish, unë kërkuj që tempoja e punë së seancave të Kuvendit të rritet edhe ne të ndërgjegjësohemi e të disiplinohemi, sigurisht me Rregullore të Kuvendit ne kemi mundësi që ta rishikojmë çështjen e disiplinimit dhe çështjen e arsytimit të mjeteve nga taksat e qytetarëve, që i marrim si pagesa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në ndërkohë, fjalën e ka kërkuar edhe deputetja Flora Brovina. Urdhëroni!

FLORA BROVINA: Faleminderit, nënkryetar!

Me propozim-planin e punës së Kuvendit 2018 parashihet që në fund të sesionit pranveror të kemi Ligjin për shëndetësi. Në rregull, unë mendoj që Ligji për shëndetësi do ta marrë përgjigjen shumë më vonë, domethënë pasi të kryhet programi pranveror, në fillim të programit të vjeshtës. Megjithatë, mendoj se në këtë ligj për ta shqyrtuar Ligjin për shëndetësi na mungon një ligj shumë i rëndësishëm e që është aprovuar në Kuvendin e Kosovës, është Ligji për emergjencat dhe ky ligj duhet të kishte hyrë në fuqi në vitin 2018, gjë që nuk ka shenja që ky ligj do të hyjë si i tillë.

Unë mendoj se ne në Komisionin për Shëndetësi duhet të bëjmë diçka më shumë, që ky ligj të marrë një rrugë, ose të nisë fazën e parë të implementimit. Ligji në fjalë është aprovuar në këtë Kuvend dhe unanimisht. Me këtë rast dua të falënderoj ish-kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa dhe ish-ministrin e Financave, kolegun tim pra, Avdullah Hotin, të cilët kanë pasur mirëkuptim dhe e kanë kuptuar rëndësinë e Ligjit të emergjencës, ligj i cili është shumë – shumë i rëndësishëm për të pasur një shëndetësi çfarë na duhet dhe çfarë e kërkojmë.

Unë besoj që edhe kryeministri aktual dhe ministri i Financave, që ndodhet në mbledhje, do ta kuptojnë njësoj rëndësinë e këtij ligji dhe që ky ligj të shqyrtohet së bashku me ministrin e Financave, me ministrin e Punëve të Brendshme, me përfaqësuesit e FSK-së, pastaj me Ministrinë e Pushtetit Lokal, me ministrin e Shëndetësisë, së bashku të nisim të aplikojmë pra fazën e parë të këtij ligji, me Komisionin për Shëndetësi, i cili është edhe përpiluesi i të gjitha amendamenteve dhe ka bërë çmos që ky ligj të jetë në legjislacionin tonë.

Ligji është kompatibil me të gjitha ligjet e ngjashme me shtetet evropiane dhe është ligj i domosdoshëm në shëndetësi, e për këtë duhet të jemi krenarë ne që kemi punuar në legjislacionin e kaluar që e kemi pruar ligjin dhe e kemi aprovuar këtë ligj.

Ligji është i shtrenjtë, por kërkon faza të ndryshme të aplikimit të tij dhe faza e parë pikërisht është lidhja e marrëveshjeve ndërministrorë, formimi e qendrave të thirrjes dhe shndërrimi i qendrave të emergjencës në komuna të ndryshme në një tërësi dhe marrja e përgjegjësisë në nivelin qendror shtetëror, sepse kjo nuk u nënshtrohet sigurimeve shëndetësore, por harxhimet për këtë formë të mbrojtjes shëndetësore do t'i marrë Qeveria në nivelin qendror.

Unë propozoj që ky ligj të shqyrtohet para shqyrtimit të ligjit bazik, pra Ligjit për shëndetësinë, që do të ishte fundi i muajit prill ose fillimi i muajit maj dhe para se të aprovohet, të rishqyrtohet buxheti që të mund të propozojmë konkretisht se çka po mendojmë në rishqyrtimin e buxhetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Shkumbin Demaliaj, urdhëro Shkumbin!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar delegatë,

Ministër,

Pata dëshirë të kyçem edhe një herë, se m'u duk se ishte pak e zbehur, por fjala e deputetëve të opozitës na i mori 30 minuta ishte vetëm një rreshtim, dikush i kishte ndryshuar nga mesi, dikush nga fillimi, e njëkohësisht flisnim në gjuhën e njëjtë, nga kushtoi një gjysmë ore.

Mirëpo kisha pasur dëshirë edhe një herë t'i drejtohem zotit Konjufca, se Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, që e tha dy-tri herë se Qeveria nuk po e bie ligjin për vetveten, është në kuadër të kësaj, Programi i Punës dhe strategjisë legislative të Qeverisë Haradinaj është me numër 107, faqe 18.

Qeveria e ka ligjin, po ky është një plotësim-ndryshim që duhet ta rregullojë, sepse asnjë institucion nuk mund të punojë pa e pasur ligjin dhe po mundohen të manipulojnë me kërkesë, e me qytetarin, në këtë rast, gjoja sa poshtë i kemi institucionet.

Në këtë rast, kisha dëshiruar të them se është e drejtë opozitare të ngrejë kesi çështjesh, mirëpo strategjia legislative e Qeverisë e ka paraparë këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: I jap fjalën për replikë deputetit Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Qeveria pritet ta sjellë këtë ligj, mirëpo ligji do të vlejë vetëm për Qeverinë e ardhshme.

Kurse Qeveria aktuale është e ndërtuar mbi të njëjtin princip, të cilin unë e kritikova, pra kjo është Qeveria më e madhe në historinë e Republikës së Kosovës që e kemi pasur ndonjëherë.

Nëse e shihni numrin e ministrive, po sidomos nga aspekti i zëvendësministrave, kallëzohet plotësisht që kemi të bëjmë me principin e pazareve që ka mbizotëruar në krijimin e kësaj Qeverie. Dhe, tash po tentohet që të silllet një ligj, i cili do të vlejë vetëm për Qeverinë e ardhshëm.

Tash, pyetja që unë e kam për Qeverinë ishte, pse nuk vendosi kështu edhe për pagat, që të vlejë një vendim për rritjen e pagave, po për rritjen e pagave të Qeverisë së ardhshme, jo të kësaj aktuales.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Po e shfrytëzoj si kundër-replikë, po më shumë procedurale. Vetëm në Komunën e Prishtinës, të cilën e ka drejtuar "Vetëvendosja", tani janë ndarë në dy pjesë, janë

mbi 500 punëtorë me Kontratë mbi vepër që brenda një viti buxhetor i tejkalojnë pagat e zëvendësministrave për katër vjet. Edhe për të vajtuar, e thashë, është çështje opozitare, po duhet të jemi realistë në të gjitha këto drejtime, ne e kemi pranuar këtë çështje, për shkak se një koalicion i madh e ka trajtuar këtë, mirëpo ne nuk mund të nxjerrim ligje abstrakte lidhur me një diçka tjetër, po në element procedural, edhe nëse ndodh për Qeverinë e ardhshme, duhet të jetë, pse jo. Ne këtu jemi për t'i hartuar këto ligje, t'i procedojmë dhe t'i aprovojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kolegë të tjerë të paraqitur për diskutim.
Në vazhdim do të votojmë për Propozim-Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2018.

Shqipe Pantina e kërkon fjalën!

SHQIPE PANTINA: Më fal, vetëm pyetje kam.
U diskutua shumë e u dhanë disa propozime, në bazë të procedurës kjo kalohet të votohet vetëm një herë. Tash, si do të përfshihen propozimet që ne i dhamë këtu.

KRYESUESI: Do të votohet në pako, domethënë vazhdojmë me votimin e Propozim-Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2018, duke u përfshirë vërejtjet, propozimet dhe plotësimet që kanë dhënë grupet parlamentare dhe deputetët individualisht.

Në sallë të pranishëm janë 72 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

A ka ndonjë deputet pa kartelë, një. Atëherë kanë marrë pjesë në votim 68 deputetë, 65 janë për, asnjë kundër dhe 3 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Programin e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018.

5. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit

Ndërkohë unë shoh që ka dy deputetë të paraqitur. Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!
Më duhet, ndoshta pak me vonesë, po në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, pas koordinimit edhe me kryetarin e Kuvendit dhe ministrin e Financave, të paraqes propozim për plotësimin e rendit të ditës për seancën e sotme, për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, meqenëse kemi kaluar të gjitha procedurat edhe në komision, por edhe te komisionet e tjera, propozojmë që ky projektligj të futet në

seancën e sotme me procedurë të përshpejtuar, meqë ndërlihet me buxhetin e Republikës së Kosovës, respektivisht me kalimin e mjeteve të privatizimit që të përdoren për financimin e projekteve kapitale për zhvillimin ekonomik afatgjatë.

Duke pasur parasysh faktin se në Ligjin e buxhetit të Kosovës 2018 janë paraparë projekte përkatëse që do të financohen përmes mjeteve të privatizimit, do të ishte me interes që të miratohet ky ligj sa më shpejt, në mënyrë që projektet mos të kenë pengesa në fjalë.

Edhe një herë po e përsëris, projektligji i ka kaluar të gjitha procedurat edhe në Komision për Buxhet dhe Financa, edhe në komisionet e tjera funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ne kemi një mocion procedural. Unë paraprakisht do të pyes përfaqësuesit e grupeve çfarë qëndrimi kanë në lidhje me mocionin.

Avdullah Hoti, së pari e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Ne pajtohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Po, i nderuar nënkryetar,
Ne e mbështesim përfshirjen e kësaj pike në rendin e ditës së sotme.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ne si grup parlamentar në parim e kundërshtojmë kështu futjen e projektligjeve nëpër procedura, për shkak se unë sot besoj që asnjëri prej deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk i ka parë amendamentet e komisionit. Prandaj, do të duhej që paraprakisht t’i kishim.

Por, fjalën e mora sidomos për çështjen e futjes në rendit të ditës sa i përket qëndrimin të Komisionit për Legjislacion. Vetëm të theksoj faktin këtu që Komisioni për Legjislacion nuk i ka përkrahur amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet, jo pse kemi pasur probleme kushtetuese në raport me amendamentet, për të sqaruar për opinionin publik, por për shkak të qëndrimin tonë karshi Agjencisë së Privatizimit, pra kjo është arsyeja pse ne nuk i kemi përkrahur si Komision për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i deputetëve të pavarur, zoti Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Në fakt, nuk e kemi të qartë pse është kaq i ngutshme kjo, dhe pse duhet të futet në rend të ditës në këtë mënyrë. Mendoj që është tepër e rëndësishme për deputetët të jenë në gjendje që të lexojnë amendamentet mirë e mbarë dhe më pastaj të diskutojmë mbi to në Kuvend.

Në këtë drejtim, është pak problematike të kërkojmë nga deputetët që amendamentet apo tema në fjalë, ligji në fjalë, të ecim tutje pa e lexuar mirë e mbarë.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe. Deputeti Igor Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

U ime Poslaničke grupe Liste srpske takođe se slažemo da ovakvi prilozi moraju da prođu kroz odgovarajući skupštinske odbore kako bi mogli da donesemo odluku o njima i u astali u dnevni red. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma”, Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

“Nisma” e mbështet propozimin e deputetit, përfaqësuesit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Aynı şekilde “6+” Parlamenter Grubu da bu öneriye hemfikir olmaktadır.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Në emër të Grupit Parlamentar do ta përkrahim këtë mocion, duke ditur edhe rëndësinë, po edhe prioritetin kohor.

KRYESUESI: Faleminderit, Blerim, ju kërkoj falje që nuk jua dhashë fjalën sipas radhës, e kalova radhën pa qëllim.

Atëherë duhet të deklarohe mi votim, tërheq vëmendjen se për këtë mocion procedural duhet të jenë për 2/3 e deputetëve të pranishëm në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Atëherë, në votim kanë marrë pjesë 69 deputetë, për janë 46, 11 kundër dhe 12 abstenime.

Konstatoj që seanca e miratoi këtë mocion procedural dhe sipas Rregullores, kjo do të jetë pikë e fundit të rendit të ditës së sotme.

Lus administratën të bëjë gati dhe të shpërndajë materialin përkatës për të gjithë kolegët deputetë.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar Projekt-Rregulloren e Kuvendit dhe ka rekomanduar miratimin e saj.

Unë ftoj nënkryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Hajdar Beqa, për arsyetimin e raportit të komisionit.

Atëherë, në emër të komisionit, fjalën e merr kryetarja, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Hajdar Beqa ka qenë kryetar i Grupit Punues dhe besoj që do të kontribuojë edhe sa i përket diskutimit të tij në këtë seancë. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke vepruar në pajtim me nenin 81 të Rregullores së Kuvendit dhe duke e pasur parasysh përmbajtjen dhe nevojën për ndryshimin e kësaj Rregulloreje, ne kemi draftuar Draft-Rregulloren e re të Punës së Kuvendit dhe atë e keni para jush.

Në fillim duhet të përmend faktin që edhe në dy legjislaturat e kaluara, në atë kohë Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit ka punuar në Draft-Rregulloren e Punës, por që pastaj ajo Draft-Rregullore nuk merrte formën e prerë apo nuk votohej në Kuvendin e Republikës, për shkak se kishte pengesa nga individë përbrenda Kryesisë së Kuvendit apo grupe të caktuara përbrenda Kuvendit.

Rregullorja që keni para vetes nuk është më e mira e mundshme, për faktin se ne kemi qenë të penguar sidomos nga dy vendimet e Gjykatës Kushtetuese që ka të bëjë me interpretimin për çështjen e grupit parlamentar, por po ashtu edhe për imunitetin e deputetëve.

Megjithatë, ne jemi munduar t'i parashohim disa ndryshime, të cilat nuk janë të rregulluara me Rregulloren aktuale në fuqi ndoshta që shtatë vjet, vetëm sa i përket përbërjes së komisioneve parlamentare ka pësuar ndryshime, në fakt, emërtimet e komisioneve parlamentare, por edhe përbërjes së tyre, por jo që janë prekur tema të tjera, të cilat kemi pasur probleme në vazhdimësi.

Çështjet e diskutuara dhe për të cilat nuk kemi pasur pajtime të përgjithshme kanë qenë çështja e konferencës së kryetarëve, veçmas përbërja e saj. Pra, siç e keni parë në Draft-Rregulloren e Punës së Kuvendit tashmë është një organ i ri, Konferenca e kryetarëve që edhe fuqizohet më shumë nga Kryesia e Kuvendit, e cila përbëhet nga kryetari i Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare që përfaqësojnë vullnetin politik të grupeve parlamentare në Konferencën e kryetarëve, por këtu nuk kemi pasur pajtueshmëri për shkak se zoti Gashi, që është njëherësh edhe përfaqësues i LDK-së, ka kërkuar që edhe nënkryetarët e Kuvendit të jenë pjesë e Konferencës së kryetarëve.

Unë nuk mendoj që kemi bërë mirë që kemi propozuar bashkë me nënkryetarët e Kuvendit si përbërje, për faktin se ka qenë e mjaftueshme që vetëm shefat e grupeve të përfaqësohen në këtë organ.

Pastaj ka një kapitull të veçantë që avancohet aspektin e mbikëqyrjes së Kuvendit. Natyrisht duhet të fuqizohet me amendamente të tjera të deputetëve dhe grupeve parlamentare.

Por, po ashtu, kapitull të veçantë për rolin e Kuvendit në çështjet e integritetit evropian.

Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare, kemi paraparë që pyetjet parlamentare deputeti ta përmbyllë në fund pyetjen parlamentare, për shkak se tani e kemi të rregulluar që ministri e bën përmbylljen dhe shpesh po manipulohet në këtë drejtim.

Pastaj deklaratimet jashtë rendit të ditës, duke pasur parasysh që po janë shumë të nevojshme, për shkak të problemeve që kemi në vend, i kemi rritur në 40 minuta, aktualisht janë 30.

Te neni 12, ku flitet për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, ka qenë propozimi i Grupit "6+" dhe Listës serbe që zgjedhja e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve të tjera të bëhet në pako.

Arsyeja që nuk e kemi përkrahur këtë propozim ka qenë se kemi vlerësuar se në qoftë se e përkrahim një propozim të tillë, mund të biem ndesh me dispozitat e Kushtetutës.

Pastaj ka një precizim më të saktë sa i përket akteve të nxjerra nga Kuvendi dhe Kryesia, por që diskutimet më të shumta kanë qenë te rezoluta e Kuvendit që Komisioni ka vendosur që ta bëjë akt jodetyrues. Unë nuk mendoj që duhet ta bëjmë akt jodetyrues. Shtrohet pyetja se ç'kuptim ka

vota e deputetit në qoftë se një vendim që e nxjerr nuk është i zbatueshëm apo i detyrueshëm për institucionet e tjera.

Sa i përket betimit të deputetit, e dini që betimin e deputetit nuk e kemi paraparë në Kushtetutë, andaj kemi diskutuar që ndoshta është mirë ta riformulojmë, por në draftin që keni para vetes, e keni të njëjtin, ndoshta me ndryshime dhe diskutime në shqyrtim të dytë pastaj mund të punojmë në këtë drejtim.

Është precizuar rregulli dhe mbarëvajtja gjatë punimeve në Kuvend.

Te neni 66, paragrafi 5 është përcaktuar se projektligji që nuk miratohet në shqyrtim të parë në seancë plenare, nuk mund të paraqitet përsëri pa kaluar tre muaj nga dita e mosmiratimit.

Një vërejtje të cilën e kemi përmendur edhe aty ka të bëjë me tërheqjen e projektligjeve. Sidomos në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Qeveria apo propozuesi deri në shqyrtim të dytë mund ta tërheqë projektligjin, por që pastaj kjo po paraqet probleme, sepse komisionet parlamentare po punojnë dy muaj në amendamente, pastaj Qeveria vetëm po e tërheq pa asnjë arsytim, dhe kjo duhet të adresohet, nëse kalon, natyrisht, sepse nuk dihet në qoftë se kjo rregullore e merr votën e deputetëve të Kuvendit.

Pastaj, mundësia që pas votimit të amendamenteve, me kërkesë të komisionit përgjegjës raportues, votimi i projektligjit me amendamentet e miratuara mund të shtyhet në seancën e radhës.

Risi në këtë kapitull është shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin vjetor të Republikës së Kosovës.

E kemi paraparë që të gjitha komisionet parlamentare, varësisht prej fushëveprimtarisë që mbulojnë, ta kenë të drejtën e shqyrtimit të projektbuxhetit. Natyrisht, roli vendimtar këtu duhet ta ketë Komisioni për Buxhet dhe Financa, por që edhe komisionet e tjera, përfshirë këtu Komisionin për Legjislacion dhe të tjerat, varësisht prej fushëveprimtarisë që kanë.

Pastaj, kemi paraparë që marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen në Kuvend, siç përcaktohet me nenin 18, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet t'i dërgon Kuvendit para nënshkrimit të atyre marrëveshjeve, për shkak të problemeve që kemi pasur në vazhdimësi.

Është edhe një gjë e rëndësishme që sa u përket raporteve të institucioneve të pavarura, aktualisht me Rregulloren që e kemi në fuqi, ndonëse Kuvendi mund ta votojë kundër një raport të një institucioni të pavarur, nuk kemi pasur asnjëherë sanksione për institucionet apo për personat që i kanë drejtuar ato institucione.

Tani i është lënë mundësia Komisionit FunkSIONAL që e mbulon fushën e caktuar të institucioneve të kërkojë edhe shkarkim të drejtuesit apo Bordit, deri në atë shkallë kemi diskutuar në komision dhe besoj që kjo është mirë.

Por po ashtu edhe mendimi i anëtarëve pakicë në komision, shpesh në raportet përfundimtare të komisioneve nuk shkruhet mendimi ndryshe i anëtarëve të komisionit. Kemi vlerësuar se është jashtëzakonisht e rëndësishme të parashihet edhe mendimi ndryshe i anëtarëve të komisionit.

Ka edhe çështje të tjera, unë besoj që keni pasur mundësinë t'i lexoni, për shkak se është një dokument i rëndësishëm.

Në emër të Komisionit Parlamentar për Legjislacion unë ju ftoj që ta përkrahni këtë rregullore dhe, në qoftë se kjo rregullore merr mbështetjen e deputetëve, sepse duhen 2/3 e deputetëve për të kaluar kjo rregullore. Atëherë jeni të ftuar të dërgoni amendamente në emër individual, por edhe në emër të grupeve parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë që të deklarohen kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Sipas radhës, së pari i jap fjalën përfaqësuesit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Çështja e Rregullores është një çështje e cila ka vite të tëra që endet nëpër Kuvend dhe e cila nuk ka arritur të përfundojë.

Interesat e trajtimit të këtyre çështjeve kanë qenë të ndryshme, mendoj personalisht se trajtimi që i është bërë ka qenë prej këndvështrimit personal dhe këndvështrimit momental politik. Jo një qasje pragmatike, për të parë se si mund të rregullohet më mirë puna e Kuvendit.

Në fakt, Rregullorja që është në funksion, aktualja, nuk është e keqe, është një Rregullore e cila funksionon mirë. Pastaj në princip, si parti e qendrës së djathtë ne jemi për atë sa është e mundur të ketë derregullim, dhe jo të rregullohet çdo gjë me normë, sepse momenti kur gjithçka është e rregulluar me normë, atëherë kthehet në problem, sepse nuk mund të dalësh jashtë normës.

Meqenëse Kuvendi përfaqëson vullnetin politik dhe angazhimin politik të momentit, unë mendoj se shumë çështje, të cilat po tentohet të rregullohen me rregullore, nuk duhet të rregullohen, sepse duhet t'i rregullojnë forcat politike të Kuvendit.

Gjithsesi, ndër problemet që unë i kam vërejtur dhe për të cilat ne si LDK do ta japim përkrahjen e kushtëzuar për kalimin në rundin e parë, pra për kalimin në parim të kësaj rregulloreje, meqenëse se si Kuvend po mendojmë që duhet ndryshuar, megjithëse personalisht mendoj se ndryshimet që janë bërë këtu më shumë bëjnë dëm se hair.

Po i përmendi disa prej problemeve kryesore. Problemi kryesor ka të bëjë me Konferencën e Kryetarëve.

Koncepti i parë fillestar, i cili ka qenë është absolutisht i papranueshëm, është problematik dhe është antikushtetues, sepse tenton që nëpërmjet një trupe siç është Konferenca e Kryetarëve, pra kryetari apo kryetarja e Kuvendit, ta ketë një trup tjetër e cila jashtë Kryesisë së Kuvendit, dhe e cila do të merret me çështje specifike, do të miratojë rendin e ditës dhe çështje tjera të cilat janë antikushtetuese, sepse mënyra e organizimit të funksionimit të Kuvendit tonë rregullohet mbi bazën e kriterit të përfaqësimit politik në Kryesinë e Kuvendit. Pra, nënkryetarët e Kuvendit apo nënkryetarët dhe nënkryetarët e përbëjnë Kryesinë e Kuvendit sipas forcës politike, e cila rregullohet me Kushtetutë.

Ideja e vendosjes së kësaj trupe - Konferencës së Kryetarëve, ka qenë një ide duke i parë disa individë në Kryesinë e Kuvendit si individë me ndikim sipas forcës politike që kanë nga partitë politike nga vijnë dhe vullneti i partive të vogla për t'i eliminuar, apo edhe njerëzve brenda partive të mëdha, për t'i eliminuar disa individë nga forca e ndikimit në politikë ka çua deri aty sa e kanë propozuar një ide të Konferencë të Kryetarëve, që është një ide e vendeve fqinja, që realisht nuk është rasti më i mirë i parlamentarizmit.

Dhe, këtu kemi problemet kryesore të cilat i hasim.

Unë kam insistuar në grupin punues dhe në Komision, që nëse shkojmë me idenë e Konferencës së Kryetarëve, atëherë le ta formalizojmë një praktikë pozitive që e ka Kuvendi i Kosovës.

Dhe, praktika pozitive e Kuvendit të Kosovës është praktika e mbledhjes së përbashkët e Kryesisë së Kuvendit me shefat e grupeve parlamentare.

Pra, shefat e grupeve parlamentare nuk kanë të drejtë vote në Kryesinë e Kuvendit, por marrin pjesë, e kanë të drejtën e fjalës, diskutimit e të propozimit, sepse përfaqësojnë partitë politike, por, në fund të fundit, për çështjet ekskluzive të cilat ka kompetencë Kryesia e Kuvendit dhe që parashihen edhe me Kushtetutë, edhe me Rregulloren e Punës, është Kryesia e Kuvendit ajo që merr vendim.

Pra, ideja ime është që ta formalizojmë mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare dhe kjo normalisht mund të quhet edhe Konferencë e

Kryetarëve. Nuk është problem emri, por nuk mund të krijosh një trup krejt tjetër jashtë Kryesisë së Kuvendit, pra të përjashtohen nënkryetarët e Kuvendit, sepse nënkryetarët dhe nënkryetaret e Kuvendit janë përfaqësues politikë sipas forcës politike dhe nëse shkojmë me formulën e pjesëtimit, ju mund të shihni se mund të prodhojmë pasoja negative politike nëse i japim fuqi vendimmarrëse Konferencës së Kryetarëve, duke përjashtuar nënkryetarët, sepse po krijohet një trup tjetër që e disbalancon vendimmarrjen.

Një problem tjetër që është vërejtur, për të cilin unë po ashtu kam pasur vërejtje edhe në grup punues, dhe mendoj se duhet ta shqyrtojmë dhe trajtojmë brenda dy leximeve, është çështja e projektligjeve në tri lexime. Mendoj se është shumë problematike, e kemi hequr në grup punuese, por gjithsesi duhet ta shohim këtë çështje edhe një herë. Nuk e kemi luksin që ne të shkojmë në tri lexime, ka pasur tendenca të diskutimit se po ka raste kur Kuvendi po vendos ta përkrahë një amendament, pastaj amendamenti është në kundërshtim me frymën, ai është vendimi i Kuvendit dhe Kuvendi vendos për këto çështje.

Çështja tjetër e rëndësishme për të cilën unë mendoj se po ashtu duhet të jemi më fleksibël, është çështja që ka të bëjë me kthimin e projektligjeve në shqyrtim në momentin kur Kuvendi i ka rrëzuar. Është vendosur që të ketë tre muaj që Qeveria të mos mund ta propozojë të njëjtin ligj, e mendoj se është gabim. Sepse ne jemi në një dinamikë tjetër, kemi nevojë që Kuvendi, edhe nëse refuzon një ligj, brenda një afati më të shkurtër ne kemi nevojë për ta ridizajnuar dhe ripërshtatur një ligj për të hyrë në praktikë kuvendare, sepse ne jemi akoma të pastabilizuar me ligje. Mendoj se tremujori shkakton shumë probleme në të ardhmen.

Te marrëveshje ndërkombëtare, edhe këtu e kemi një problem thelbësor për të cilin unë kam pasur vërejtje edhe në Komision, i kam edhe këtu në seancë. Kuvendi nuk mund ta paragjykojë një marrëveshje ndërkombëtare. Kuvendi nuk mund ta paravendosë një marrëveshje ndërkombëtare, sepse Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare që është ligj specifik e përcakton - marrëveshja ndërkombëtare e merr plotfuqishmërinë nga presidentja apo presidenti a ekipi negocues, dhe ne nuk mund t'ia japim një plotfuqishmëri të dytë prej Kuvendit, sepse është Konventa e Vjenës ajo që e përcakton se si merret plotfuqishmëria dhe mendoj që është gabim që Kuvendi ta paragjykojë që ta autorizojë të shkojë apo të mos shkojë për t'u nënshkruar një marrëveshje, sepse Kuvendi po e paragjykon një marrëveshje.

Ndërkohë që Kuvendi është ai që e gjykon, e jep vendimin final, ose e përkrah, ose nuk e përkrah.

Prandaj, mendoj se është gabim qysh është në Propozim-Rregullore dhe këtë çështje ne do ta diskutojmë prapë brenda dy leximeve dhe nëse nuk bëhen këto rregullime, normalisht që LDK-ja nuk e përkrah.

Edhe një problem tjetër, që është problemi i institucioneve të pavarura, mendoj se pajtohem që institucionet e pavarura në këtë vend nuk e kanë sistemin e llogaridhënies, por duhet të pajtohem edhe për një element tjetër, sepse kemi institucione të pavarura kushtetuese dhe ligjore. Pra, Kushtetuta ua garanton pavarësinë funksionale, por nuk mund që me Rregullore të Kuvendit ta rregullojmë mënyrën e raportimit dhe në rast të moskalimit të raportit, shkarkimi automatik i Bordit apo drejtorit ekzekutiv, apo qysh do që quhet titullari kryesor i atij institucioni. Duhet me ligj specifik, sepse është ligji specifik që e rregullon një institucion të pavarur kushtetues, apo një institucion të pavarur ligjor, i cili i raporton Kuvendit.

Kemi pastaj institucione, agjenci e tjera, me dhjetëra, të cilat duhet të rregullohen, por duhet të rregullohen me ligj specifik, jo në mënyrë uniforme me Rregulloren e Kuvendit, sepse Rregullorja e Kuvendit ka të bëjë me punën e Kuvendit, nuk ka të bëjë me punën e institucioneve të pavarura. Punën, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve dhe agjencive të pavarura e rregullon Ligji specifik, pra me një rregullore të përgjithshme për mënyrën sesi funksionojmë në Kuvend nuk mund ta rregullojmë mënyrën sesi funksionon një institucion i pavarur kushtetues, ose një institucion i pavarur ligjor, ose një institucion tjetër, i cili i raporton Kuvendit. Pra, duhet të mos i ngatërrojmë konceptet.

Konceptet në këtë rast janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe t'i ruajmë balancat e pushteteve. Unë jam që ta rregullojmë çështjen e institucioneve të pavarura, sepse institucionet e pavarura kanë probleme dhe ne nuk ua aprovojmë, Kuvendi nuk ua aprovon raportet, ndërkohë që ata s'mërziten hiç, e vazhdojnë punën e vet, edhe pse puna e tyre është e pasuksesshme, e vazhdojnë punën e vet. Por, këtë çështje ne duhet ta rregullojmë me ligje specifike, sepse secili prej këtyre institucioneve ka ligj specifik dhe nuk mund me një rregullore të përgjithshme të përjashtohet një ligj specifik, sepse dalim edhe kundër konceptit të logjikës së funksionimit të ligjeve. Ligji specifik e prevalon ligjin e përgjithshëm.

Në këtë rast, mendoj se duhet t'i kemi parasysh këto balanca dhe ne si LDK në parim e përkrahim këtë Rregullore, por të kushtëzuar, për t'i eliminuar këto problematika. Pra, problematika e parë ka të bëjë me Konferencën e Kryetarëve, problematika e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e ligjeve në dy apo tri lexime dhe kthimin e ligjeve kur Kuvendi i rrëzon, problematika e tretë ka të bëjë me paragjykimin që u bëhet marrëveshjeve ndërkombëtare. Kuvendi nuk mund t'i paragjykojë marrëveshjet ndërkombëtare, por Kuvendi gjykon dhe vendos si instancë finale për marrëveshjet ndërkombëtare, dhe elementi i tretë, ndër të tjera, është institucionet e pavarura, të cilat duhet të trajtohen me ligje specifike, e jo me një Rregullore të përgjithshme.

Pra, në këtë rrethana, mendoj se ne duhet të jemi të kujdesshëm për mënyrën sesi mund ta disbalancojmë përfaqësimin politik në Kuvend, mund ta disbalancojmë vendimmarrjen në praktikën legjislative, praktikat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe mund të ndërhyjmë, t'i

rrezikojmë institucionet e pavarura ligjore dhe kushtetuese. Faleminderit, meqë i kam edhe tre sekonda, po e përfundoj me kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Arben! Sipas radhës, e ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetin Hajdar Beqa. Albulenë, pasi të deklarohen përfaqësuesit. Replikë, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe një herë në emër të Komisionit, për faktin se fola në emër të komisionit, vetëm disa sqarime, sepse kur e dëgjova zotin Gashi duke folur, e pata një përshtypje që e kemi hequr komplet Kryesinë e Kuvendit. Besomëni, foli në atë mënyrë sa mendova mos rastësisht e kemi hequr komplet Kryesinë e Kuvendit. Kjo nuk qëndron. Ne e kemi diskutuar goxha gjatë, edhe në komision, edhe në grupet punuese. Mendoj që Konferenca e Kryetarëve që e keni në draftin këtu para jush është një mekanizëm i mirë, në të cilën shprehet vullneti politik i grupeve parlamentare nëpërmjet shefave të grupeve parlamentare dhe ka një dobësim të kompetencave të Kryesisë dhe fuqizim të kompetencave të Konferencës së Kryetarëve, përkatësisht shefave të grupeve parlamentare.

Por, kjo nuk është diçka e keqe, domethënë. Përkundrazi, besoj që është e mirë edhe sa i përket komplet punës në Rregulloren e Kuvendit. Përfaqësuesi i LDK-së, zoti Armend Zemaj, ka qenë në mandatin e kaluar, ja tash erdhi, është mirë që të kontribuojë edhe ai, për faktin se ne në vazhdimësi i kemi diskutuar këto çështje në komision dhe asnjëherë nuk janë kundërshtuar nga zoti Zemaj, përkundrazi janë përkrahur. Edhe zoti Hoti, shef i Grupit Parlamentar, para si të them dy-tri javësh në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, e ka dhënë mbështetjen për këtë rregullim. Andaj, unë nuk po i kuptoj kështu qëndrimet që po ndryshojnë brenda ditës, apo brenda javës. Përnjëmend! Unë pajtohem me disa prej çështjeve që kanë të bëjnë me shqyrtimin e tretë të projektligjeve. Këtu shkruan që bëhet me kërkesë të propozuesit, apo me kërkesë të komisionit, po - pajtohem plotësisht që kjo duhet të hiqet.

Nuk e di se kush e ka futur këtu, për shkak se në një kohë, ne si opozitë mandatin e kaluar e patëm bojkotuar Kuvendin e Kosovës për shkak të Demarkacionit dhe “Zajdenicës” dhe pastaj dikush e ka paraparë këtë nen, por besoj që kjo duhet të hiqet në ndryshime.

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi, kundër-replikë!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Veç sa për sqarim. Kuvendi në demokraci e përfaqëson vullnetin e qytetarëve mbi bazën e votave. Tendenca e krijimit të Konferencës së Kryetarëve për të krijuar dominimin dhe hegjemoninë e pakicës, është e papranueshme. Nuk mund të krijohet një trup kuvendore, në të

cilën merr vendim pakica. Prishet ideja e përfaqësimit demokratik, prishet ideja e përfaqësimit kushtetues; në frymë dhe në germë është kundërkushtetuese, pasi po doni të flisni kështu.

Në frymë dhe në germë, sepse Kushtetuta e Kosovës, nënkryetarët e Kuvendit i përfaqëson mbi bazën e forcës politike dhe etnike, dhe e përfaqëson po ashtu frymën dhe vullnetin politik. Krijimi i një trupi, i cili e përfaqëson pakicën politike, siç është Konferenca e Kryetarëve me kompetenca vendimmarrëse është antikushtetuese në frymë dhe në germë, është e papranueshme demokratikisht dhe politikisht, dhe nuk është e përkrahur prej LDK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, s'ke të drejtë, Albulenë! Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, edhe si kryesues i Grupit Punues për Rregulloren.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Punues për hartimin e Rregullore së Kuvendit, duke vepruar në pajtim me vendimin e Komisionit për Legjislacion, datë 17. 10. 2017, në përbërje: Hajdar Beqa, kryesues; Korab Sejdiu, anëtar; Albulena Haxhiu, pastaj Sami Kurteshi, anëtar; Shkumbin Demaliaj, anëtar; Bilall Sherifi, anëtar; Barim Shabani, nga "6+", anëtar, dhe nga Lista serbe, Igor Simiq, anëtar, kemi mbajtur disa takime dhe kemi qenë unikë në shumicën e rasteve. Ne nuk do të ndalemi se shumë sqarime i bëri edhe kryetarja e Komisionit realisht për ndryshimet që kanë ndodhur në këtë Rregullore.

Grupi Punues, duke analizuar qëllimin e Projekt-Rregullore, përmbajtjen, nevojën për këtë Rregullore, rëndësinë e saj, si dhe me qëllim të rritjes së efektivitetit të normimit dhe në favor të lehtësimit të zbatimit të saj në praktikë dhe duke marrë për bazë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e ka hartuar Draft-Rregulloren që sot e kemi para vetes si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pa dyshim që është një version më i avancuar i Rregullore në krahasim me Rregulloren aktuale, meqë e kemi harmonizuar me dispozita kushtetuese dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, ky draft avancon aspektin legjislativ dhe mbikëqyrjes së Kuvendit, si dhe rolin e Kuvendit në çështjen e integriteteve evropiane. Duke mos u ndalur në secilën risi që ka ndodhur në këtë Rregullore dhe u sqarua edhe nga kolegët tjerë deputetë, anëtarë të komisionit, që paraqet ky draft i Rregullore, po ju njoftoj se kemi arritur t'i përafrojmë qëndrimet, ndonëse secili grup në dispozita të caktuara nuk jemi pajtuar.

Çështjet që kanë qenë të diskutuara dhe për të cilat nuk kemi pasur pajtim të përgjithshëm ka qenë çështja e Konferencës së Kryetarëve, veçmas të përbërjes së saj. Po ashtu, te neni 12, ku flitet për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, ka qenë propozim i Grupit “6+” dhe i Listës serbe që zgjedhja e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve tjera të bëhet në pako. Arsyeja që nuk është përkrahur nga komisioni dhe nga Grupi Punues ka qenë se kemi vlerësuar se mund të bjerë ndesh me dispozitat e Kushtetutës, por që ndërmjet dy leximeve do ta adresojmë seriozisht këtë çështje dhe do ta përkrahim në harmonizim edhe me Kushtetutën e vendit.

Kemi pasur edhe çështje diskutuese që vlen të theksohen, e që nuk jemi pajtuar, por realisht me votë kemi marrë vendime, ka qenë edhe te marrëveshjet ndërkombëtare, realisht pajtohemi me atë që e tha edhe zoti Gashi, nuk është mirë t’i paragjykojmë, ato janë kategori kushtetuese. Kushtetuta e sqaron shumë mirë edhe drejtë kush mund të nënshkruajë në emër të Republikës së Kosovës marrëveshje, pas nënshkrimit ne duhet t’i ratifikojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dhe, aty nuk e kemi pasur një unitet si komision. Megjithatë, i ka marrë votat në komision në atë formë, por unë konsideroj që ndërmjet dy leximeve kemi mundësi ta bëjmë dhe këtë çështje ta ndryshojmë në harmonizim edhe me Kushtetutën.

Në takimin e mbajtur më 14, 15 dhe 16 shkurt kemi vendosur të punojmë si komision në përbërje të plotë, sepse një herë kemi punuar si grup, pastaj kemi mbajtur edhe tri ditë një si lloj punëtorie në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku kemi punuar gjithë komisioni dhe të gjithë anëtarët nga të gjitha subjektet politike, duke përfshirë edhe Lidhjen Demokratike, edhe Partinë Demokratike, “Vetëvendosjen”, AAK-në, Lista serbe, “Nismën për Kosovën”, “6+”. Kemi dhënë kontribut në vazhdimësi dhe i falënderoj të gjithë, sepse konsideroj që e kemi bërë një punë të mirë edhe e kemi respektuar në përpikëri Planin e Veprimit që e kemi pasur edhe si grup punues, edhe si Komision për Legjislacion.

Do të thotë, ne e kemi dhënë kontributin tonë në takimet që i kemi pasur. Konsideroj që në këtë fazë, edhe në emër të Partisë Demokratike, por edhe si kryesues i Grupit Punues, duhet ta përkrahim në parim Rregulloren, kurse ndërmjet dy leximeve duhet ta japim kontributin tonë edhe si deputetë, edhe si grupe parlamentare. Ne kemi pasur takime, unë si kryesues i Grupit Punues kam pasur takime edhe me shefat e grupeve, e na ka ftuar edhe kryetari i Parlamentit, zoti Veseli. Në atë kohë ka qenë një proces shumë transparent, na është kërkuar që t’ua dërgojmë Draft-Rregulloren, ua kemi dërguar të gjitha grupeve parlamentare, e kanë pasur një afat kohor të gjitha ato që ta japin kontributin e vet. Kanë qenë të gjithë shefat e grupeve në ato takime, e kanë pasur kohën kur mund ta japin kontributin, nuk do të thotë që s’mund ta japin prapë tash ndërmjet dy leximeve.

U përmendën disa, ne nuk ia kemi hequr kompetencat kurrkujt. Te Konferenca e Kryetarëve, realisht Kryesia e Kuvendit i ka kompetencat kushtetuese dhe ne nuk mund që me Rregullore t’ia lëvizim kompetencat. Ne e kemi parë që është e rëndësishme dhe është një avancim ta kemi

Konferencë të Kryetarëve, do të thotë pa i prekur kompetencat e Kryesisë së Kuvendit, prandaj mendoj që është një avancim në këtë Rregullore.

U përmendën këtu si çështje tri diskutime, realisht Konferenca e Kryetarëve, leximi i tretë dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Unë mendoj që te leximi i tretë kemi mundësi të bëjmë ndryshime, te Konferenca e Kryetarëve mendoj që është mirë, meqë nuk preken kompetencat kushtetuese, te marrëveshjet ndërkombëtare mendoj se duhet të mbetet siç ka qenë në Rregulloren e vjetër, por megjithatë edhe si deputet, edhe si grup punues, edhe si anëtar i komisionit, por edhe si Partia Demokratike do ta japim kontributin tonë ndërmjet dy leximeve.

Andaj, unë mendoj se çështja e Rregullores ka qenë shumë gjatë, e treta legjislaturë jemi që po punojmë në ndryshimin e saj. Është mirë të kemi qëndrim edhe politik, sepse për të kaluar Rregullorja na duhen 80 vota, e pa një konsensus politik të të gjitha subjekteve, në këtë rast, apo grupeve parlamentare, ne e dimë që nuk mund të kalojë Rregullorja e Kuvendit. Andaj, konsideroj që nëse ka vullnet politik dhe me të vërtetë ato deklarime që po bëhen, që jemi për ta bërë një Rregullore të re, atëherë sot ju thërras që ta votoni këtë Draft-Rregullore, ta votojmë dhe ta japim kontributin ndërmjet mes dy leximeve. Ne do të jemi transparentë edhe ndërmjet dy leximeve, kemi me qenë të hapur edhe për shoqërinë civile, edhe për palët tjera të interesit, të cilat janë të interesuara që të japin kontribut.

Në vazhdimësi kemi pasur propozime edhe nga jashtë, edhe nga brenda, po flas për plotësim-ndryshimin në këtë Rregullore. Edhe sot më kanë ardhur propozime të reja, por unë mendoj që duhet t'i respektojmë procedurat. Andaj, kërkoj nga ju zoti kryesues që sot, deputetët të flasin për këtë çështje, e nëse duhet edhe një herë shefat e grupeve, por konsideroj që duhet të votohet në parim Rregullorja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Veç disa çështje, por shumë të tjera do t'i thotë zoti Sami Kurteshi, sepse tash së fundi ka qenë intensivisht i kyçur në grupet punuese të kësaj Rregulloreje. Edhe një herë sa i përket çështjes që e shtroi zoti Gashi, për të dalë pastaj te çështjet tjera. Qëllimisht po e përmend emrin për shkak se është e rëndësishme që të adresohet kjo. Sipas meje, Kuvendin e drejtojnë subjektet politike, zoti Gashi, dhe të gjitha subjektet politike duhet ta kenë një organ ku koordinohen. Nuk mund të përjashtosh subjekte politike vetëm pse i ka 10%, apo i ka 12%, a i ka 6%. Ky është diskriminim dhe ku - në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Tjetra? Edhe Arbeni, por...

KRYESUESI: Albulenë, më fal, ne po kërkojmë deklaratimet e grupeve parlamentare. Këto janë të rëndësishme, por për debat, për diskutim, tani na jepni vetëm deklaratimet në emër të grupeve parlamentare, pastaj vazhdojmë.

ALBULENA HAXHIU: Dakord, zoti nënkryetar! Unë të kisha lutur që të mos më ndërhyjni për shkak se nuk po dal jashtë rendit të ditës, pikërisht po flas për temën që diskutuam tani. Pra, edhe Arbeni, por edhe LDK-ja si opozitë do të duhej që të ishin të interesuar që opozita ta kishte hapësirën e vet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në organet e këtij Kuvendi, përfshirë këtu edhe komunitetet tjera, të cilat janë të përfaqësuara në Kuvend. Dhe, ky ndryshim, edhe një herë po e them nuk është kundërkushtetues. E kemi trajtuar shumë në Komisionin për Legjislacion. Mund të jetë kundër kushtetues vetëm në mendjen e zotit Arben Gashi.

Edhe disa çështje tjera sa i përket Rregullores. Ne si grup parlamentar kemi tentuar në grupet punuese që t'i heqim privilegjet e deputetëve, sepse ka pasur një tendencë që privilegjet për deputetët në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit të parashihen në Rregulloren e Kuvendit, të kontrabandohen disi. Por, ne kemi refuzuar, sepse kemi thënë që në qoftë se privilegjet parashihen në këtë Draft-Rregullore, ne nuk mund ta përkrahim. Prandaj, edhe mirë kanë bërë Grupi Punues dhe komisioni që e kanë tërhequr.

Unë kërkoj që të parashihet një mekanizëm që i bën përgjegjës ministrat para deputetëve, sidomos në kohën e pyetjeve parlamentare, por po ashtu edhe në thirrjet që u bëhen nga komisionet parlamentare. Unë e përmenda te Plani i Punës ka raste të shumta kur ministrat pa asnjë arsytim refuzojnë të shkojnë në mbledhjet e komisioneve parlamentare, por po ashtu as 50% e pyetjeve që i parashirojnë deputetët përbrenda seancave parlamentare nuk marrin përgjigje nga ministrat për shkak se refuzojnë të vijnë në seancë.

Pra, mendoj që duhet të ketë një sanksion a tërheqje të vërejtjes publike, sepse keni parë edhe në vendet tjera, por s'mund ta gjesh një vend si Kosova ku ministrat nuk i japin llogari Kuvendit. Jemi rast i veçantë edhe në këtë drejtim. Dhe, sigurisht që kjo duhet të parashihet në ndryshimet e ardhshme.

Po ashtu, sa u përket shkeljeve që ndodhin në këtë Kuvend, shkeljeve të Rregullores, por edhe fyerjeve dhe sharjeve që u bëhen deputetëve nga udhëheqësi i seancës parlamentare, përkatësisht nga kryetari i Parlamentit, kemi raste të shumta kur, ndonëse bëhen shkelje të shumta në këtë Kuvend, ndonëse fyhen deputetët pikërisht nga kryetari i Kuvendit, ende nuk është marrë asnjë përgjegjësi ndaj atyre që po e shkelin Rregulloren e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit do të duhej të ishte shembull i respektimit të deputetit, por edhe i respektimit të Rregullores së Kuvendit, e ne kemi parë këtu që Kadri Veseli ka fyer e ka kërcënuar vazhdimisht deputetët e Kuvendit, me theks të veçantë të Lëvizjes "Vetëvendosje", por që asnjëherë nuk ka dhënë përgjegjësi.

Po ashtu, ne konsiderojmë që Komisioni për Buxhet do të duhej t'i takonte opozitës. Meqenëse Qeveria udhëheq me Ministrinë e Financave, është tepër e rëndësishme që ky komision të drejtohet nga opozita. Janë këto disa nga çështjet tona, të cilat ne do t'i shndërrojmë në amendamente, por po ashtu edhe një herë po e theksoj faktin që zoti Sami Kurteshi ka edhe çështje tjera që, në qoftë se kjo Rregullore merr miratimin e deputetëve të Kuvendit, atëherë ne menjëherë do t'i procedojmë amendamentet dhe në qoftë se amendamentet tona nuk përkrahen nga deputetët e Kuvendit, natyrisht që pastaj në shqyrtim të dytë vota jonë do të ndryshojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë e ka kërkuar fjalën deputeti Arben Gashi. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Në fakt, nuk jam i interesuar të bëj shumë replikë, sa jam i interesuar ta bëj një sqarim, çka konsiderohet subjekt politik në Kuvend dhe si e rregullon Kushtetuta e Kosovës.

Nuk mund të lejojmë në princip si Lidhje Demokratike e Kosovës që subjektet politike në Kuvend ta udhëheqin Kuvendin. Me Kushtetutë përcaktohet se kush dhe si drejtohet Kuvendi. Çka nënkupton "subjekt politik"? Subjekt politik nënkupton parti ose nismë, e cila ka garuar në zgjedhje, dhe ajo mund t'i ketë një ose dy deputetë, dhe të marrë vendim në emër të Kuvendit nuk mundet. Kushtetuta e Kosovës e rregullon shumë qartë mënyrën sesi udhëhiqet Kuvendi. Do të thotë, kryetarin apo kryetaren e Kuvendit e propozon grupi më i madh parlamentar, i dalë nga zgjedhjet. Po ashtu, nënkryetarin e parë, nënkryetarin e dytë, apo nënkryetaren e dytë e propozon grupi i dytë; nënkryetarin e tretë, grupi i tretë; nënkryetarin e katërt, komuniteti serb; nënkryetarin e pestë, komunitetet tjera me rotacion, dhe të gjitha së bashku e përbëjnë Kryesinë e Kuvendit. Kjo është Kryesia e Kuvendit.

Nëse tentohet me një akt tjetër më të ulët se Kushtetuta për ta ndryshuar përbërjen politike të Kuvendit, unë personalisht dhe LDK-ja konsiderojmë që është antikushtetuese. Kështu është mënyra si e shohim ne, e nëse dikush tjetër e sheh ndryshe, le ta çojë në Gjykatë Kushtetuese dhe le të gjykojë.

Interpretimi yë është interpretim autentik i LDK-së dhe mënyra se si ne e vlerësojmë. Nuk mund të lejomë që pakica politike në Kuvend ta udhëheqë Kuvendin. Është abc-ja e demokracisë dhe e frymës tonë kushtetuese. Pra, nëse ne sot jemi në opozitë, jemi më të vegjël, duhet të punojmë që të bëhemi më të mëdhenj dhe pastaj mbi bazën e përkrahjes qytetare ta udhëheqim Kuvendin, e jo ta udhëheqim Kuvendin duke qenë pakicë. Kështu! Është shumë e thjeshtë, ne jemi që të rritemi, të bëhemi shumicë dhe pastaj të udhëheqim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Deputetëve të Pavarur, kush e do fjalën? Dardan Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Tashmë është e qartë që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka funksionuar me një Rregullore të miratuar diku më 29 prill 2010, dhe kjo Rregullore nuk ka ndryshuar asnjëherë. Edhe pse rregulloret për funksionimin e Kuvendit është dashur t'u nënshtrohen dinamikave të Kuvendit, sepse praktika e cila krijohet në Kuvend, e një Rregullore nuk ndryshohet, e bën krejt këtë çështje goxha statike.

Ne si Grup i Deputetëve të Pavarur do ta përkrahim këtë Rregullore në lexim të parë për disa arsye që do t'i shtjelloj më vonë, por gjithashtu do të parashtrijmë edhe amendamente, që ndërlidhen me funksionimin sa më të mirë të Kuvendit.

Besojmë se është shumë që pozitive në këtë Rregullore për seancën e jashtëzakonshme më në fund është arritur të përcaktohet koha minimale dhe maksimale kur do të duhej të mbledhet Kuvendi. Ajo çka kisha dashur të diskutoj është çështja e nënshkrimeve. Ndonëse mua më duket teknike, besoj që është tepër e rëndësishme. Nëse një deputet kërkon që të mbahet seancë e jashtëzakonshme me 1/3 e deputetëve, e kur ndonjë deputet që e përkrah këtë iniciativë nuk është në Kosovë, atëherë seanca nuk mund të thirret pa të. Mendoj që zgjidhja duhet të jetë nënshkrimi digjital. Mendoj që kjo është një qasje që mund ta marrim dhe do ta lehtësonte shumë më shumë ecjen përpara. Nënshkrimi digjital tashmë është diçka që përdoret edhe prej institucioneve e korporatave në mënyrë të rregullt dhe mendoj që nuk ka asnjë telash nëse një gjë të tillë e aplikojmë edhe në Kuvendin e Kosovës. Besoj që kjo çështje do ta lehtësonte thirrjen e seancave të jashtëzakonshme.

Gjithashtu, pozitive në këtë Rregullore është edhe kategorizimi i projektligjeve që shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Konsideroj që jo për çdo gjë Qeveria mund të iniciojë e të shtyjë përpara projektligje me procedurë të përshpejtuar, për shembull Ligjin për Buxhetin. Jo, nuk duhet të lejojmë që Ligji për Buxhetin të ecën me procedurë të përshpejtuar. Gjithashtu, besojmë që pozitive është edhe koha për deklaratat e deputetëve dhe grupeve parlamentare, e cila është rritur për dhjetë minuta dhe mendoj që kjo është një gjë cilësore. Për mua si ekonomist, edhe për Grupin tonë Parlamentar, i vlerësojmë gjithashtu lart amendamentet 73 dhe 74, që është shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin vjetor të bëhet me procedurë të veçantë nga projektligjet e tjera dhe vlerësojmë se shqyrtimi i Buxhetit të bëhet edhe në të gjitha komisionet parlamentare. Mendoj që këto dy amendamente janë gjëra pozitive në këtë Rregullore.

Gjithashtu, është mirë që Rregullorja e re e definoi qartë nocionin e pranisë së kuorumit dhe votimit, dhe ky është një hap përpara. Me këtë Rregullore vlerësojmë që është rregulluar edhe çështja e kohës për pyetjet parlamentare dhe kështu duke ia dhënë mundësinë deputetit që ta mbyllë diskutimin rreth çështjes së shtruar. Deri më tash këtë e ka bërë ministri, mendojmë që është në rregull që ai që e ka iniciuar një çështje, ai edhe ta përmbyllë atë çështje. Normalisht që

Rregullorja gjithashtu i trajton procedurat e raportimit dhe trajtimit të raporteve nga institucionet e pavarura. Deri më tash këto raporte nga institucionet e pavarura kanë qenë thjesht një dokument, i cili na është sjellë dhe nuk kemi pasur mundësi ta trajtojmë në mënyrë të duhur.

Ajo për të cilën do të doja të diskutoja është Konferenca e Kryetarëve. Në nenin 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konkretisht në paragrafin 6 thuhet: “Kryetarët dhe nënkryetarët e formojnë Kryesinë e Kuvendit dhe Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit”. Pra, me Rregulloren e vjetër, konkretisht me nenin 15, Kryesia e Kuvendit e ka përcaktuar çdo gjë në lidhje me punën e Kuvendit, ndërsa me Rregulloren e re kjo kompetencë i hiqet dhe vendoset te një organ, që quhet Konferenca e Kryetarëve, përkatësisht neni 21 i kësaj rregulloreje të re.

Këtë organ duhet ta shohim në aspektin kushtetues sesi trajtohet. A bie ndesh me nenin 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nëse bie ndesh, atëherë të sigurohemi që ky trup të mos ketë këso lloj implikimesh. Unë dhe grupi ynë parlamentar nuk kemi asgjë kundër një Konference të Kryetarëve, porse duhet të jemi të sigurt, e po besoj shumë edhe të saktë, në ndërtimin e këtij trupi, nëse duam ta ndërtojmë një trup të tillë me shefat e grupeve parlamentare, e që kjo të mos bjerë ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Grupi i Deputetëve të Pavarur në lexim të dytë do të sjellë amendamente në lidhje me Rregulloren e re, për momentin ne jemi në përkrahje të kësaj Rregulloreje.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Shkumbin Demaliaj. Urdhëro!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Duke dashur të përpiqem të mos i përsëris kolegët e Komisionit për Legjislacion që kemi punuar bashkë në grupet punuese lidhur me Rregulloren, ne e dimë se funksionojmë me një Rregullore, për të cikën vetë Kryesia dhe Kuvendi në legjislaturat e kaluara kanë paraparë se duhet të kemi ndryshim për shkak të funksionimit më të mirë të Kuvendit, mirëpo edhe në Grupin Punues e kemi pasur një konsensus për ta sjellë këtë Rregullore deri këtu. Kanë punuar në dy legjislaturat grupet punuese të deputetëve, por nuk kanë mundur të trajtohen, e shkaqet dihen. Ka plotë shtatë vjet, po hyjmë për vitin e tetë që tentohet për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit dhe me këtë propozim që e kemi sjellë tani shihet fare mirë se ku janë problemet që kundërshtohen në këtë rast, edhe nga grupet parlamentare, por edhe nga deputetët.

Pjesëmarrja sot e deputetëve lidhur me debatin për Rregulloren e Kuvendit po shihet shumë e ulët. Përpos nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, deri më tani janë paraqitur vetëm nëntë deputetë që dëshirojnë ta marrin fjalën, për shkak se po shihet se nuk i kanë vënë kujdes shumë çështjes së Rregullores që e përcakton gjithë fushëveprimin e tyre. Kur flasim për Konferencën e

Kryetarëve, ne e kemi pasur një konsensus këtu, se deri më tani veprimet e Kryesisë së Kuvendit kanë qenë diskriminuese në raport me subjektet dhe grupet parlamentare në Kuvend.

Është e vërtetë që Konferenca e Kryetarëve nuk vendos, mirëpo të shkojnë shefat e grupeve parlamentare të subjekteve politike në takimet e Kryesisë dhe të shfrytëzohen në mënyrë statike vetëm sa për pjesëmarrje, kjo nuk ka qenë adekuate. E them këtë për shkak se ne kemi grupe parlamentare në Kuvendin e Kosovës që kanë 11 dhe 12 deputetë, por nuk kanë anëtarë të Kryesisë, as nënkryetarë. Po, zoti kryesues, po të shoh që po i rrudh krahët, por kemi grup parlamentar që i ka gjashtë deputetë edhe ka anëtarë Kryesie, atëherë a është diskriminuese kjo? Pse të mos u jepet mundësia edhe shefave të grupeve që përfaqësojnë subjektet politike në takimet e Kryesisë pa drejtë vote, që të mos e kenë këtë Konferencë të Kryetarëve. Nuk vendos Konferenca e Kryetarëve, por vendos Kryesia dhe aspak nuk zbehet neni 67 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në grupet punuese në Komisionin për Legjislacion kemi shqyrtuar edhe shumë elemente tjera. Kanë qenë propozimet e mekanizmave tjerë, edhe ndërkombëtarë që ndihmojnë punën e Kuvendit dhe bashkëpunojnë me komisione të ndryshme parlamentare, në këtë rast edhe me Komisionin për Legjislacion, jo që të kontrabandohet ligji apo përgjegjësia e deputetëve dhe privilegjet në Rregullore, por komplet Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, meqenëse përfshihet për çështje të deputetëve, të futet në Rregulloren e re. Mirëpo, kjo gjë nuk ka ndodhur, sepse unanimisht e kemi parë si komision që kjo të tërhiqet nga Rregullorja.

Lidhur me shumë çështje tjera me këtë Rregullore ende nuk po i rregullojmë të gjitha çështjet, për shkak se ka pasur ndërhyrje të interpretimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shumë elementë, që pengojnë edhe fushëveprimin e deputetëve dhe të Kuvendit lidhur edhe me imunitetin edhe për pensionet suplementare dhe lidhur me shumë çështje tjera, për shkak të një interpretimi që ka bërë me aktgjykim Gjykata Kushtetuese lidhur me këtë çështje dhe aty direkt është prekur Kushtetuta, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës u jep imunitet deputetëve.

Mirëpo, lidhur me gjithë këtë konsensus të përbashkët që kemi pasur ne duke përfshirë kohëve të fundit, për shkak se në grupin punues që kemi pasur një trajtim shumë serioz nuk ka marrë pjesë Lidhja Demokratike e Kosovës, për shkak se zoti Korab Sejdiu ka pasur udhëtim, thotë, në Amerikë, zoti Gashi pasi e kemi pasur afër dëgjimit publik projekt-rregulloren ka ardhur me disa kundërshtime, po asnjëri nga këta dy deputetë nuk e kanë trajtuar këtë çështje dhe nuk kanë mundur të vendosin qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Edhe në aspektin procedural sa kemi punuar në grup, po më vjen mirë që në parim edhe të kushtëzuar po e përkrahin këtë çështje për të kaluar në lexim të dytë. Unë besoj se brenda kësaj kohe sa është projekt-rregullorja në shqyrtim, këta do të japin kontributin, por edhe të gjithë deputetët, lidhur me mundësinë e shkuarjes drejt dhe finalizimit që të votohet me 2/3-at. Ka

elementë tjerë kushtetues brenda kësaj projekt-rregulloreje që duhet të jenë brenda saj, por meqenëse kjo projekt-rregullore për të kaluar dhe për t'u finalizuar e votuar duhet t'i ketë 2/3-at e Kuvendit është mirë që të gjitha grupet e deputetëve, po edhe ne si Aleancë e të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve, të gjitha kërkesat e tyre për t'i futur në këtë rregullore ato po bien ndesh me parimet kushtetuese, me normat kushtetuese është mirë meqenëse janë 2/3-at edhe ato ndryshime kushtetuese që i plotësojnë këto kritere për të qenë rregullore t'i bëjmë paraprakisht, meqenëse duhen 2/3-at për ta ndryshuar edhe ndonjë nen të Kushtetutës paraprakisht t'i votojmë edhe ato ndryshime po edhe Rregulloren edhe mos të nxjerrim dhe t'i shpërfaqim në të ardhmen ato elementë, si gjoja nuk po lejon Kushtetua, ose ndonjë aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese lidhur me një çështje.

Neve mund t'i bëjmë ndryshimet kushtetuese, ato t'i inkorporojmë ne Rregullore dhe Rregulloren ta votojmë bashkë me ndryshimet! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Shkumbin! Mua s'më takon të flas gjatë, së paku jo prej këtu, por sa për një sqarim përfaqësimi në Kryesinë e Kuvendit është kushtetues, domethënë është i rregulluar me nenin 67. Ju të gjithë po thoni se keni një konsensus, po këtu duket që s'keni, e kam fjalën për grupet parlamentare. E dyta, keni propozuar një kategori e cila do të marrë kompetenca kushtetuese, jo të Kryesisë së Kuvendit, sepse Kushtetuta e përcakton si mekanizëm që administron, por lexoni pikën 6 dhe 7 të nenit 67 të Kushtetutës dhe do të vëreni që Konferenca e Kryetarëve merr kompetencat e kryetarit të Kuvendit, por në një nen më lartë ju ato kompetenca ia njihni edhe kryetarit. Kjo është pjesë të cilën duhet ta diskutojmë më tutje, por është qartësisht mekanizëm kundërkushtetues.

Ia jap fjalën përfaqësuesit të Grupit Parlamentar Lista Serbe, deputetit Igor Simiq.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Poslanička grupa Lista srpska je razmatrala ovaj Nacrt-poslovnika i lično sam bio član radne grupe koja je analizirala novi predlog poslovnika. Sam poslovnik ovakav kakav je predložen zahteva određene izmene i ja očekujem da će svi poslanici, sve parlamentarne grupe, imati svoje odgovarajuće predloge, kako bi ovaj poslovnik učinili boljim. Novi poslanik je potreban ovom Parlamentu pre svega zato što će rešiti neke probleme koje smo imali u prošlosti kada se tiče funkcionisanja samog Parlamenta.

Poslovnik ćemo podržati u načelu ali će Srpska Lista imati amandmane na ovaj predlog i ukratko ću sada u ime svoje poslaničke grupe predstaviti neke od predloga. Ono što predstavlja jedan od nedostataka ovog nacrtu jeste da po prvi put poslovnik ne sadrži definisano koji su skupštinski odbori, osim da Skupština ima stalne i funkcionalne odbore iako je to, na primer, ustavna kategorija propisana članom 78 Ustava. Takođe, neverovatno je da to bude deo Ustava a da se na 130 stranica novog poslovnika ne nalazi. U prethodnom poslovniku ovo pitanje je vrlo jasno

definisano i u članu 69 jasno je rečeno „Skupština Kosova imenuje stalne funkcionalne i ad-hoc komisije. Komisije predstavljaju politički sastav Skupštine. Član 69, stav 3, Stalne komisije su: Komisija za budžet i finansije, Komisija za prava i interese za zajednice i povratak, Komisija za zakonodavstvo i sudska pitanja, Komisija za evropske integracije.

Druga stvar, isto tako naši predlozi će se odnositi i na funkcionisanje same Skupštine a kroz poštovanje prava na upotrebu srpskog jezika kao službenog jezika u skladu sa Ustavom. Ne znam da li je kolegama poslanicima to poznato, ali najveći broj materijala koji dobijamo za rad u odborima ili na sednicama Skupštine a šalju ih i institucije, ne dobijamo ih na srpskom jeziku a o njima moramo da se izjasnimo, ili za njih da glasamo, što je kršenje osnovnih prava koje garantuje i sam Ustav.

Kad smo kod jezika moram da napominjem i da je ovaj predlog-poslovnika o radu kao i veliki broj zakona ima ogromne manjkavosti kada je u pitanju prevod na srpski jezik. Daću jedan konkretan primer: U nacrtu-poslovnika član 16, stav 6, na srpskom jeziku piše da će predsednik Skupštine u saradnji sa šefovima parlamentarnih grupa imenovati privremenu delegaciju Skupštine, koja će predstavljati Kosovo a u engleskoj i albanskoj verziji stoji da će delegacija predstavljati Skupštinu, što verujem da je primerenije i da je ono što je želeo sam pisac da kaže.

Što se tiče izbora potpredsednika Skupštine naš predlog će definisati način na koji se biraju potpredsednici iz redova srpske zajednice. Kada su u pitanju ostale nevećinske zajednice ostavljam kolegama da one same daju svoj predlog. Naš stav će biti da kao što se biraju i predstavnici većinskog naroda, odnosno da politička partija koja predstavlja Srbe u Skupštini Kosova sa najvećim brojem osvojenih glasova, odnosno mandata, daje kandidata za potpredsednika Skupštine.

Takođe kod izbora Vlade, posebno ministara iz Srpske zajednice ili pozicije u različitim institucijama koje pripadaju srpskoj zajednici a o kojima se izjašnjava ova Skupština naš predlog će se odnositi na to da kandidati moraju imati podršku većine poslanika srpske zajednice, u protivnom oni neće imati legitimitet za rad. Takođe ono što je vrlo značajno i potrebno definisati zastupljenost svih predstavnika nevećinskih zajednica među civilnim službenicima Skupštine, jer je to vrlo bitno pitanje, smatramo da mora biti definisano poslovníkom.

Još jednom ću ponoviti, u načelu Srpska lista podržava ovaj nacrt poslovnika ali će kroz rad u samim odborima dati ove amandmane. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Nisma deputeti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi duke debatuar për plotësim-ndryshimin e Rregullores, sepse Kuvendi ka një Rregullore, u tha këtu, funksionon mbi bazën e një rregulloreje, edhe pse ajo është miratuar qysh në vitin 2010, por megjithatë është bartur në çdo legjislaturë rregullorja si e tillë, për faktin se s'kemi arritur apo s'kanë arritur deputetët e legjislaturave të kaluara të arrijnë pajtueshmëri për ndryshimet të cilat gjatë rrugës janë vërejtur se ka mangësi apo ka nevojë për t'u ndryshuar. Domethënë, jemi në këtë pikë, mos të krijohet përshtypja që Kuvendi fare s'ka rregullore dhe dikush po do dhe dikush s'po do fare me i dhënë një rregullore.

Jemi te faza në të cilën duhet të përcaktohem i dëshirojmë të bëjmë një ndryshim cilësor në mënyrën e menaxhimit të administrimit, të funksionimit të Kuvendit apo dëshirojmë të mbetemi në mënyrën e vjetër, e cila ka qenë e rregulluar përmes rregullores që aktualisht është në fuqi.

Cilat janë ndryshimet e parapara në këto ndryshime. Ndryshimi real, substancial, cilësor, është krijimi i një mekanizmi, siç po thuhet, trupe përmes së cilës nuk do t'i merreshin kompetencat, siç po thuhet, Kryesisë së Kuvendit, por do të përfshiheshin vetëm në një çështje kryetarët e grupeve parlamentare. Pra, Konferenca e Kryetarëve nuk ndërhyr në kompetencën kushtetuese, së paku nga këndvështrimi im dhe i Nismës të Kryesisë, sepse bëhet fjalë vetëm për një çështje që ka të bëjë me rendin e ditës, thirrjen e seancave dhe rendin e ditës të seancave plenare.

Nuk ndërhyr në asnjë çështje të cilat Kryesisë së Kuvendit ia ngarkon Kushtetuta tanimë u tha edhe neni 67, pika 6, pastaj pjesa e kompetencave të kryetarit. Pra, nëse lexojmë me vëmendje atë nen, dikush e sheh që po i merret një kompetencë, dikush... unë, për shembull, nuk e shoh që po i merret ndonjë kompetencë, sepse aty shkruan që kryetari dhe nënkryetarët e përbëjnë Kryesinë, të cilët kanë përgjegjësinë për të administruar me Kuvendin në bazë të Rregullores së miratuar nga Kuvendi. Domethënë, aty asgjë më shumë nuk thuhet. Tash, varet si duam ta shohim. Nëse duam ta shohim që edhe mbledhja, seanca, thirrja e seancave, përcaktimi i rendit të ditës, hyn te administrimi i Kuvendit, atëherë mund të themi që po ia marrim një kompetencë. Së paku, unë nuk e shoh që nga njëqind kompetenca që i ka pasur, i ka ushtruar deri më tani Kryesia, debati për seancat, për rendin e ditës së seancave, për mënyrën e udhëheqjes së seancave, nuk hyn në kategorinë për të cilën u fol deri më tani.

Kryetarët e grupeve nuk do të dalin ta udhëheqin seancën. Ajo mbetet kompetencë e kryetarit dhe nënkryetarëve, pra kur s'është kryetari e udhëheq njëri nga kryetarët. Kryetarët e Grupeve Parlamentare nuk do të vendosin për çështje administrative, siç janë buxheti i Kuvendit, siç janë mënyra e organizimit e strukturimit të Kuvendit, por ato nuk janë. Pra, bëhet fjalë vetëm për një çështje që ka të bëjë me thirrjen e seancave, mënyrën e thirrjes së seancave, rendin e ditës së seancave, që të jemi të qartë, sepse u krijua, së paku unë krijova përshtypjen se këtu po bëhet fjalë për suspendim të Kryesisë. Nëse e keni lexuar me vëmendje, aty shihet mirë që kryetarët e grupeve parlamentare, madje as nuk do ta përcaktojnë përmes votës, nuk do të kenë fuqi

mbivotuese edhe nëse bëhet ajo që u tha këtu, se mund pakica të mbivotojë shumicën, ata nuk do të kenë fare mandat për të vendosur nëse nuk ka pajtueshmëri të plot. Nëse nuk ka, ta zëmë, pajtueshmëri në mes kryetarëve të grupeve atëherë çështja i bartet seancës dhe në seancë pastaj vendoset për një çështje, për të cilën në mbledhje të kryetarëve të grupeve ata nuk kanë arritur të gjejnë pajtueshmëri. Pra, më shumë do ta kisha parë apo së paku edhe e kam pa deri më tani këtë çështje si përfshirje, kryetarët e grupeve të përfshihen në vendimmarrje cilësore të përgatitjes së seancave, se sa me qëllim të përjashtimit të nënkryetarëve.

E dimë që kështu është i rregulluar me Kushtetutë Kuvendi i Kosovës, e dimë që Kryesia e Kuvendit përfaqëson balancat politike dhe etnike, i dimë këto. Pra, ky mekanizëm që është paraparë në këtë projekt-rregullore, në këto ndryshime, që të mos e përsëris veten, më shumë ka të bëjë me dhënien zë të deputetëve përmes grupeve parlamentare, të shumicës së deputetëve, të gjithë deputetëve përmes grupeve, përkatësisht përmes kryetarëve të grupeve, se sa tendenca për t'u përfshirë në çështjet e administrimit. Administrimi mbetet ashtu siç e thotë Kushtetuta dhe Rregullorja.

Tash, u përqendrova më shumë te kjo çështje, sepse besoj se kjo e bën atë kapërcimin, atë ndryshimin, do ta quaja, pak më cilësor në raport me Rregulloren e vjetër. Të tjerat janë gjëra të mira, ka ndryshime të mira që fuqizojnë instrumentet e kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë, ndihmojnë në mbarëvajtjen e Kuvendit, janë qartësuar disa gjëra, për të cilat shpeshherë secili i kemi dhënë vetes të drejtë të akuzojmë, qoftë kryesuesin, qoftë kryetarin, se po shkel rregulloren, pastaj kryetari apo kryesuesi shpeshherë kanë ndërhyrë në fjalim të deputetëve duke akuzuar se po shkel Rregulloren. Pra, ideja ka qenë që në rrugë e sipër të përmirësojmë gjërat për të cilat secili kemi pasur nga një ide se çka është kushtetuese çka nuk është, çka është konform Rregullores dhe çka nuk është konform Rregullores. Gjithashtu, meqë kam qenë anëtar i komisionit po i them edhe disa fjalë rreth disa çështjeve që i kanë ngritur kolegët nga komuniteti serb, përkatësisht Lista Serbe dhe që nuk u tha këtu, dhe komunitetet tjera, rreth mënyrës së zgjedhjes së nënkryetarëve nga ana e tyre. Aty do të kemi, aty kam dilema edhe unë, kam vështirësi edhe unë të pranoj në tërësi propozimet e tyre, por nëse nuk arrijmë të gjejmë një pajtueshmëri, konsensus siç thuhet, edhe me ata edhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës e cila kohëve të fundit edhe e bëri të qartë edhe në seancë, është kundër atij ndryshimi, mendoj se edhe kjo rregullore apo edhe ky tentim për të ndryshuar Rregulloren do ta ketë fatin e njëjtë, të tentimeve paraprake, të cilat më duket me sa di unë nuk kanë arritur të vijnë as në seancë, kjo së paku ka arritur të vijë në seancë në lexim të parë.

Nëse nuk do të ketë pajtueshmëri politike për të parë, të gjithë së bashku të ecim në drejtim të përmirësimit të Rregullores, atëherë do të mbetet në lexim të parë, nëse vjen në lexim të dytë do të rrëzohet. Kjo është e tëra, por hajde ta shohim pozitivisht siç e kemi parë në komision dhe të shohim ku mund të afrohem dhe cilat gjëra mund të pajtohemi dhe të ecim përpara, nëse ka gjëra për të cilat fare nuk mund të pajtohemi, atëherë t'i lëmë ato anash. Pra, le të flasim në

procesin e miratimit të Rregullores për gjërat që mund të pajtohemi, unë besoj që ka këtu shumë gjëra për të cilat mund të pajtohemi dhe të mos i prekim sot ato për të cilat edhe u tha edhe i dimë të gjithë se nuk ka pajtueshmëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi e ka fjalën për replikë, meqë i është referuar diskutimit të tij.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Sqarim për këtë çështje. Neni 21, Konferenca e Kryetarëve. Cilat janë përplasjet? Grupi i partive të vogla në Kuvend thotë: Konferenca e Kryetarëve përbëhet nga kryetari i Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare.

Nga këndvështrimi i LDK-së është antikushtetues. Propozimi i LDK-së dhe që kaluar në komision është: Konferenca e Kryetarëve përbëhet nga kryetari i Kuvendit, nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Pra, është de-facto formalizim i asaj që sot njihet si mbledhja e përbashkët e Kryesisë së Kuvendit me shefat e grupeve. Është një praktikë e mirë në Kuvendin e Kosovës, që prej se ekziston Kuvendi i Kosovës Kryesia e Kuvendit së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare merren vesh për rendin e ditës dhe për çështje tjera, megjithëse këto kompetenca janë të parapara qartë me Kushtetutën e Kosovës.

Pra, praktikën e mirë ne po e kthejmë në normë, ndërsa partitë e vogla në Kuvend po kërkojnë që praktikën e mirë me e shkëputë dhe me e qitë në favor të partive të vogla dhe këtu prishet balanca, sepse kjo nënkupton që vendimmarrjen për rendin e ditës dhe shumë çështje tjera, që kanë të bëjnë me punën në Kuvend e merr pakica në Kuvend. Kjo është dilema që ne e kemi. Ne sot jemi pakicë dhe nuk po duam ne të ndikojmë në vendimmarrje demokratike, ne duhet të luftojmë të bëhemi shumicë, të punojmë të bëhemi shumicë në Kuvend që të mund t'i çojmë agjendat tona përpara, por jo nëpërmjet një rregulloreje të vendosim ne si pakicë se si do të qeveriset Kuvendi, sepse është antikushtetuese, është antidemokratike dhe jo përfaqësuese e vullnetit qytetar. Pra, të punojmë që të bëhemi të mëdhenj dhe kur të jemi të mëdhenj ne t'i çojmë politikatat tona përpara dhe jo nëpërmjet, duke qenë të vegjël të imponojmë vendimmarrjen në Kuvend nga vogëlsia jonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi kundër-replikë!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk do të hyj në të drejtën e zotit Gashi që ta vlerësojë kushtetuese apo jokushtetuese, demokratike apo jodemokratike cilindo propozim apo akt, që debatohet këtu në Kuvend. Por, ai është vetëm këndvështrim i zoti Gashi apo i zotit Sherifi, apo i cilitdo zotëri këtu apo zonje.

Ndërsa, këndvështrimet, analizat e pikëpamjet tjera që i dha, unë edhe në komision i kam thënë, nuk është se nuk ke çështje, ke çështje por unë mendoj më politike, siç është sundimi i pakicave në Kuvend, siç e interpreton zoti Gashi. Fare nuk mendoj se nuk ka absolutisht asnjë pikë, por mendoj se është e gabuar, mendoj që nuk është e qëndrueshme. Sa i përket asaj se sa është kushtetuese e sa nuk është, e kemi një institucion për të cilin tek pasi ta kalojmë në Kuvend mund të shkojmë ta pyesim se a është kushtetuese apo jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Më duket pak paradoksale, që dokumentin tonë themelor ne pastaj t'ia dërgojmë Gjykatës Kushtetuese kur e kemi në dorë ta sqarojmë vet.

Problemi i kushtetutshmërisë së përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës lidhet me sistemin zgjedhor, me rezultatet zgjedhore dhe me kuotat që lidhen me përfaqësimin etnik. Domethënë, kjo është kategoria kushtetuese.

Konferenca e Kryetarëve s'mund të marrë kompetencat e kryesisë, sepse janë kushtetuese dhe Kushtetuta thotë që janë administrative. Te kjo që propozon Rregullorja e re, ka elemente ekzekutive dhe elementet ekzekutive janë në dorë të kryetarit. Konferenca e Kryetarëve, edhe një herë, që prek kompetencat e Kryesisë së Kuvendit prek përfaqësimin dhe i dëmton ose i merr kompetencat e kryetarit të Kuvendit, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë. Domethënë, kjo është logjika dhe përfaqësimi i punës.

Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar "6+", Emilija Rexhepi apo kush është? Bahrim Shabani. Urdhëro!

BAHRIM SHABANI: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Što se tiče nacrtu poslovnika kojeg danas ovde razmatramo Parlamentarna grupa "6+" razmatrala je ovaj poslovnik i svakako mi ćemo imati određene amandmane na ovaj poslovnik. Međutim to ćemo dostaviti između dva čitanja. A danas, svakako da će Parlamentarna grupa "6+" podržati u načelu ovaj nacrt poslovnika. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani grupet parlamentare janë deklaruar të gjitha, dhe atë nga disa herë. Kemi edhe 11 kolegë që janë paraqitur për të marrë fjalën. Tani unë ju pyes a dëshironi të vazhdojmë apo të marrim një pauzë deri në orën 15:00 dhe pastaj të kthehemi dhe të vazhdojmë diskutimet.

Domethënë, pajtoheni që ta bëjmë një pauzë. Po! Edhe numri i deputetëve në sallë është shumë i vogël.

Atëherë, shihemi në orën 15:00. Faleminderit!

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës që e kemi në shqyrtim.

Grupet parlamentare dhe përfaqësuesi i Komisionit FunkSIONAL e kanë thënë fjalën e tyre.

Tani jemi te deputetët, Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Para se të filloj për këtë, i kam dëgjuar këtu shumicën e kolegëve dhe kolegeve që kundërshtojnë jashtëzakonisht shumë, se neve na është thanë që seanca fillon në orën 15:00. 45 minuta vonesë! Dhe nuk ka asnjë arsytim! Nuk e di a pajtohen këta kolegë tjerë, veç kjo i bie që ne bëjmë çka duam dhe kur të duam. Megjithatë, ky është një parlament dhe duhet t'i përmbahemi një rregulli, ose së paku tregoni që nuk doni t'i përmbaheni rregullit dhe secili prej nesh le të vijë bash kur të donë.

Në pikën para kësaj biseduam për Programin e Kuvendit, për projekt-programin për këtë vit, kurse në mbledhjen e parë pas asaj pike një vonesë 45 minuta. Për besë, e keni obligim që një herë ju bashkë me nënkryetarët t'u kërkonti falje këtyre kolegëve tuaj deputetë për këto vonesa dhe të mos ndodhin më këto. Kjo është sa i përket kësaj.

Ne jemi duke biseduar për Rregulloren e Kuvendit, e unë kam qenë njëri nga anëtarët e Komisionit dhe të grupit punues, dhe kemi diskutuar, kemi punuar, jemi përpjekur të punojmë në atë Rregullore, dhe mendoj se e kemi bërë një punë të mirë, por jo të mjaftueshme. Ne i kemi pasur vërejtjet tona, sugjerimet tona nga jashtë dhe nga brenda. Unë si deputet, por si pjesë e Grupit Punues, edhe Komisioni për Legjislacion, natyrisht që i kam edhe vërejtjet e mia, edhe pse nuk mund të them se ato nuk janë pranuar me shumicë nga të gjithë ne që kemi punuar aty.

Ajo çka për mua mbetet ende e parregulluar, vërtet unë e kam shkruar këtu tash nuk po e them për shkak të kësaj vonese, por përgjegjësia e deputetëve, domethënë rregullsia e përcjelljes së seancave.

Shpeshherë ka ngjarë, përvoja ka treguar, se ne e kemi humbur kuorumin në seancat plenare të Kuvendit, sepse prania e deputetëve ka qenë e pamjaftueshme.

Po, unë mund ta marr me mend se ne nuk jemi bash të përgjegjshëm, por megjithatë e kemi një obligim minimal edhe te çdo punëdhënës privat po të ishim nuk do të na paguante po të shkonim

me kaq vonesa, ose të mos shkonim fare në punë, sepse asnjë ndërmarrje nuk pranon një punëtor që nuk i shkon në punë, as që vonohet për çdo ditë.

Kjo është diçka që nuk është rregulluar me këtë Rregullore dhe unë mendoj se duhet t'i kushtohet kujdes.

Një kujdes i veçantë, unë mendoj se duhet t'u kushtohet prej gjithë deputetëve edhe seancave konstituive të Kuvendit. Ne e kemi parë, përvoja ka dëshmuar se kemi pasur vonesa javore e mujore rreth konstituimit të Kuvendit dhe kjo çështje nuk është rregulluar deri në fund.

Ka vërejtje edhe sa i përket tekstit të betimit, por ato janë vërejtje krejt gjuhësore teknike. Mendoj se ato do t'i paraqesim si amendamente.

Një çështje tjetër që u hap këtu dhe u diskutua jashtëzakonisht shumë, është në njëfarë mënyre Konferenca e Kryetarëve, e grupeve parlamentare. Ishte një diskutim i mirë me argumente dhe kundërgjegje, por ajo çka mua më mungoi ishte se, me aq sa e kuptova, kishte një përzierje të aspekteve procedurale dhe aspekteve politike.

Megjithatë, unë e kuptoj kështu një Konferencë të Kryetarëve të grupeve parlamentare si një ikje nga arroganca e shumicës, por edhe një përpjekje për të ikur nga dominimi e diktatura e pakicës, të opozitës në këtë rast.

Unë mendoj se nëse ndahen çështjet procedurale dhe politike, kryetarët e grupeve parlamentare sa i përket aspektit politik të rregullimit të çështjeve politike në këtë Kuvend duhet ta kenë fjalën e tyre. Unë mendoj që edhe ata të grupeve të vogla parlamentare, sepse për jam i bindur që sa më gjithëpërfshirëse të jetë vendimmarrja në lidhje me një agjendë afatmesme ose afatgjatë të Kuvendit, aq më pak do të ketë probleme në Kuvend, dhe aq më pak do të ketë kundërshtime në kuadër të Kuvendit.

Një çështje tjetër të cilën unë dua ta hap me theks të veçantë është te çështja e nenit 75 - te marrëveshjet ndërkombëtare.

Unë i dëgjova disa interpretime këtu dhe nëse dikush e ka propozuar këtë nen, ose këtë paragraf, në të vërtetë kam qenë unë, duke u mbështetur në disa fakte, unë do të përpiqem që ato fakte t'i bëjë qarta tani për të gjithë deputetët këtu.

Megjithatë, kërkesa për futjen e një paragrafi i cili do të kërkonte që seanca parlamentare e Kuvendit t'i trajtojë tekstet e marrëveshjeve ndërkombëtare që duhet të vijnë në Parlamentin e Kosovës për ratifikim është e logjikshme, e ligjshme dhe në përputhje me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe me Konventën e Vjenës për marrëveshjet ndërkombëtare.

Unë mendoj se kolegët deputetë do të kenë kujdes që të dëgjojnë me kujdes. Unë kur e kam kërkuar këtë, nuk kam folur për kompetencën e nënshkrimit të dokumenteve. Mirëpo, unë kam folur sipas Konventës së Vjenës për dy nene të konventës, e ato janë neni 9 i Konventës së Vjenës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, dhe për nenin 10.

Në nenin 9 kërkohet miratimi i tekstit. Kjo parashihet edhe me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës dhe ky miratim i tekstit, i cili do të duhej të ratifikohej në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është i domosdoshëm.

Në nenin 10 të konventës kemi të bëjmë me autentifikimin e tekstit. Po ashtu, përveçse mund të miratojmë një tekst, një marrëveshje ndërkombëtare, sipas nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të duhej të vinte në Kuvend për ratifikim. Është një hap jashtëzakonisht i mirë, i qëlluar. Po të ishin nënshkruar, ose po t'i ishin diskutuar tekstet e marrëveshjeve, po them për këtë të demarkacionit, qysh në mars-prill, ose maj 2015, sigurisht që kjo marrëveshje për demarkacionin do të ishte kryer qysh në muajin shtator, ose tetor 2015.

Meqenëse askush nuk e ka konsultuar Kuvendin e Republikës së Kosovës për një tekst të cilin ai duhet ta ratifikojë, ne e kemi një vonesë trevjeçare me gjithë këtë gjaknxehtësi, me gjithë këto probleme që i kemi pasur, me gjithë këto burgosje dhe me gjithë këto çështje.

Unë mendoj dhe po e them, para marrëveshjes, çështja e tekstit të marrëveshjes ndërkombëtare që duhet të ratifikohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e nevojshme, jo por është e domosdoshme që të silllet për diskutim në këtë Kuvend, të diskutohet, të ndodhin pajtimet ose mospajtimet, edhe me një orë, edhe me pesë orë, edhe me dhjetë orë, edhe me njëzet orë, mirëpo po e them dhe jam i bindur se me të gjitha konfliktet, me të gjitha mospajtimet, një tekst i një marrëveshje të tillë mandej do të ratifikohet me një shpejtësi të jashtëzakonshme pa i pasur të gjitha këto probleme që i kemi pasur ne këtu.

Prandaj, unë përsëri po them, propozimi im që paragrafi 7 i nenit 75 është mirë të mbetet në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës për lehtësimin e punës. Ne nuk hyjmë në kompetenca të asnjë institucioni, as nuk prekim Konventën e Vjenës për marrëveshjet ndërkombëtare. E vetmja çështje që duhet të ndërrohet ndoshta në këtë paragraf është që të silllet në Kuvendin e Republikës teksti para marrëveshjeve, i cili mund të diskutohet, të ndryshohet, të miratohet, të autentifikohet dhe të dërgohet për nënshkrim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Te vërejtja me vend e kolegut Kurteshi, është e drejtë e plotë.

Më lejoni të theksoj se qysh disa ditë më herët e kam autorizuar te nënkryetarët për të vazhduar për këtë seancë, edhe dua të tregoj shumë sinqertë, unë isha në takim, e kam ndërprerë takimin vetëm për shkak të kësaj.

Përveç agjendave që i kemi në seancë, në të njëjtën kohë po duhet t'i takoj në kuadër roli si kryetar i Kuvendit edhe personalitetet e ndryshme, të cilat vijnë pikërisht për Kuvendin në vizitë te kryetari i Kuvendit. Kjo ka qenë arsyeja.

E pashë që as nënkryetari Haliti, as nënkryetari Shala nuk paskan ardhur. Bile nuk kam qenë fare as i njoftuar. Keni të drejtë plotësisht, prandaj më vjen keq për këtë situatë, e cila ka ndodhur.

Megjithatë, në rastet tjera zonja Aida qenka këtu, nënkryetarët, qenka edhe zoti Simiq, ta fillojnë menjëherë, nuk kanë çka të presin, është edhe autorizim publik. Pritet 15 minuta, ka paralajmërim në Administratë, në momentin kur nuk ka paralajmërim sikur sot, kanë mundur të qëndrojnë deputetët edhe një orë a dy. Kur ka paralajmërim është çështje tjetër, se kryetari i Kuvendit e merr përgjegjësinë vetë edhe e arsyeton vonesën. Por, sot s'ka qenë fare e parashikuar se unë mund të isha në udhëheqjen e seancës dhe kjo që nga java e kaluar është ditur.

Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAL: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Besoje që ajo që duhet të jetë e njohur dhe në bazë të diskutimit është se ne nuk po e formojmë sot Kuvendin e Republikës së Kosovës as me këtë Rregullore, por sigurisht që duhet bazuar në praktika të ndërtuara parlamentare nga konsensusi politik dhe në normat tjera që janë rregullim kushtetues, goftë edhe raporti ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Rregullorja duhet të strukturoret në tërësinë e pikëpamjes logjike, atë teknike dhe gjuhësore.

Tash më lejoni që edhe nga ato çka u diskutuan, çka do të thotë dhe çka unë mendoj për këtë.

Baza juridike për nxjerrjen e Rregullores së Kuvendit është e përcaktuar edhe në Rregulloren në fuqi, sipas nenit 81.

Dhe, e drejta e Kuvendit të Republikës së Kosovës normalisht për ta rregulluar organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës me Rregulloren e Kuvendit mbështetet në nenin 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kur flasim për organizimin e brendshëm nënkuptohen detyrat e përgjegjësitë e organeve që janë të përcaktuara me Kushtetutë. Dhe, me Kushtetutë është përcaktuar edhe rasti kur kryetari dhe nënkryetari veprojnë si Kryesi e Kuvendit.

Neni 67 i Kushtetutës e ka përcaktuar Kryesinë, unë po e citoj për shkak të asaj që ka një lloj dyshimi të pjesa tjetër që Grupi Punues e ka paraparë të Konferenca e Kryetarëve.

“Kryetari dhe nënkryetarët e formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit”, e mbyll citatin.

Dhe duke u nisur nga determinim kushtetues, disa detyra të Kryesisë kalojnë në instanca tjera, e disa i mbeten edhe më tutje kësaj.

Kolegë deputetë,

Unë mendoj që ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit më shumë duhet të konsistojnë në ato që kanë dalë nga debatet, qoftë tash, qoftë nga e kaluara, dhe nga nevoja që Kuvendin ta vëmë në funksion, ashtu siç është, edhe përfaqësues, edhe ligjvënës, edhe mbikëqyrës.

Kujdes të veçantë duhet t'i kushtojmë barazisë gjinore në organet drejtuese dhe në trupat punuese të Kuvendit konform përqindjes së pjesëmarrjes të femrave të Kuvend.

Pengesa tjetër që ka dalë dhe që duhet të rregullohet saktësisht është shqyrtimi i projektligjeve në procedurë, edhe në atë që ne e quajmë “të përshpejtuar”, amendamenti i ndryshimit dhe plotësimit të ligjit vetëm brenda propozimeve të sponsorizuesit, me përjashtime të specifikuar. Pse po e them këtë? Sepse jo rrallë herë ndërhyrjet që janë bërë në legjislacion e kanë humbur logjikën nga ajo që ka ardhur nga sponsorizuesi dhe ka krijuar edhe dilema në implementim edhe ripërsëritje në plotësim-ndryshimin e shumë ligjeve.

Dhe, pjesa që po diskutohet është mënyra e mendimit kushtetues, qoftë edhe ajo që u tha për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ku domosdoshmërisht ne u nënshtrohemi edhe konventave, por edhe Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Te çështja që ka të bëjë me përcaktimin e kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe përcaktimi i rendit të ditës, që deri më tash ishin kompetencë e Kryesisë së Kuvendit, me Rregulloren e re propozohen ndryshime, të cilat janë kompetencë të Konferencës së Kryetarëve.

Dhe, për këtë arsye unë e përmenda pse duhet të vazhdojë logjika, pse duhet të ndiqet gjuha dhe pse duhet të ndiqet teknika, se nëse ka devijim nga kjo, atëherë e humb arsyen edhe Konferenca e Kryetarëve.

Konferenca e Kryetarëve duhet të jetë një trup, i cili ka cilësi të organit ndërfraksional, në këtë rast pozitë dhe opozitë.

Konferencën e Kryetarëve nuk e zgjidh Kuvendi, dhe kjo nënkupton që përbëhet vetëm prej kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve, apo shefave të të gjitha grupeve parlamentare.

Andaj, Konferenca është dhe duhet të jetë një trup koordinues operativ, i cili i koordinon dhe e bënë operativën në aspektin procedural, aktivitetet parlamentare dhe punon në principin konsensual, dhe në rast të mosarritjes së konsensusit çështjet i adresohen Kuvendit për vendimmarrje. Nga kjo kanë devijuar disa aspekte të brendshme të kësaj Rregulloreje dhe për këtë arsye unë i dëgjova edhe kundërshtime, sepse e kanë pasur një dokument bazë, i cili është punuar, dhe tendenca për ta begatuar, ta quaj ashtu, ka devijuar nga ajo që është logjikë e këtij trupe të ri brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Andaj, organizimi i brendshëm i Kuvendit e përcakton mënyrën e funksionimit të Kuvendit në seancë plenare dhe mënyrën e nxjerrjes së akteve nga Kuvendi.

Kolegë deputetë,

Nevoja për ndryshimet e propozuara unë mendoj që është imediate dhe duhet të jetë shumë e kujdesshme për këtë arsye të cilën e përmenda, sepse konsensusi politik dhe qëndrimet politike në raport me çështjet në Kuvend duhet të jenë konsesuale, duke marrë parasysh edhe vetë numrin që kërkohet për miratimin e kësaj Rregulloreje, që kërkon 2/3.

Unë jam i gatshëm që të jem në funksion të punës së Grupit Punues të Komisionit për Legjislacion, që ndërmjet dy leximeve t'i heqim ato dilemat në logjikën sesi kanë rrjedhur disa nene dhe cili ka qenë qëllimi dhe intenca e begatimit të Rregullores së re të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Drago mi je što od mojih kolega danas ovde u sali slušam Pravilnik Skupštine, odnosno odabir i izbor potpredsednika za zajednice.

Kada smo mi tokom konstituisanja ovog Parlamenta iznosili to, i medijski se obratili, i tražili podršku, niste nas ozbiljno svadili. Smatram da ovaj Parlament već u trećom sazivu krši Ustav Republike Kosovo oko odabira potpredsednika za zajednice.

Citiraću Ustav Republike Kosovo, član 67. tačka 4: “Dva potpredsednika predstavljaju zajednice, koji ne čine većinu u Skupštini, i oni se biraju većinom glasova svih poslanika. Jedan potpredsednik će biti iz redova poslanika Skupštine, koji zauzimaju rezervisana ili zagarrantovana mesta za Srpsku zajednicu, a drugi iz redova poslanika skupštine, koji zauzimaju rezervisana ili za garantovana mesta za ostale zajednice koje ne čine većinu”.

Kada smo mi ovde govorili da to nije ekskluzivno pravo jedne političke grupacija, odnosno parlamentarne grupe, kao što je “6+”, zato što imate i van te grupe poslanici u Parlamentu iz redova manjinskih zajednica, konkretno Bošnjачke nacionalne zajednice, Egipćanske nacionalne zajednice i Aškalijske zajednice, takođe i Goranske nacionalne zajednice, vi to niste shvatili ozbiljno, nego ste to glasali.

Ja molim Komisiju za zakonodavstvo, pre svega molim članove te Komisije da ne krše Ustav Republike Kosovo, da poštuju odabir, ne mešam se kako će Srpska zajednica izglasati svog potpredsednika, ali i te kako ću se mešati kako će Pravilnik o radu Skupštine, odnosno ovog Parlamenta, formirati glasanje u vezi odabira potpredsednika za ostale zajednice.

Mi ćemo podneti amandman i nadam se da će se ovde usvojiti, ukoliko se ne usvoji obratićemo se Ustavnom sudu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Ju të pranishëm,

E kemi në shqyrtim të parë Projekt-Rregulloren e Kuvendit, për të cilën mendoj se të gjithë deputetë duhet të aktivizohemi, sepse kemi pasur rast të hasim në parregullsi dhe në një mbarëvajtje jo të mirë dhe një efikasitet jo të mirë të punës së trupave të Kuvendit, siç janë komisionet dhe më gjerë.

Neni 1 i kësaj Rregulloreje i përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të republikës së Kosovës, të organeve të tij drejtues dhe trupave të tij të punës në ushtrimin e funksionit ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

Qëllimisht e përmenda neni 1 të Rregullores së Kuvendit për t'u ndërlidhur më poshtë në diskutimin tim.

Do vazhdoj me nenin 12, paragrafi 2, që rregullon zgjedhjen e nënkryetarëve, ku thuhet: “Kryetari i Kuvendit kërkon nga tri subjektet më të mëdha parlamentare ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër nga ai i kryetarit”. Konsideroj që ky është një ndryshim substancial pozitiv dhe konsideroj që kjo dispozitë shpreh parimin e barazisë gjinore në organet më të larta vendimmarrëse, siç është Kuvendi i Kosovës, dhe është risi në këtë Rregullore.

Neni 28.3, përbërja e Komisionit Parlamentar thotë “e reflekton fuqinë politike të grupeve parlamentare”.

Po ta analizojmë me vëmendje këtë dispozitë, shohim se nuk është shumë në harmoni me dispozitat tjera. Bie fjala, te neni 29, paragrafi 3, ku thuhet “një deputet nuk mund të jetë kryetar në më shumë se një komision të Kuvendit”, që është shumë e arsyeshme dhe është tepër normale, sepse është e pamundur prë të treguar efikasitet në punën dhe në obligimet e tij.

Në të njëjtën logjikë mendoj se duhet kufizuar edhe pjesëmarrjen e një deputeti si anëtar i dy apo tri komisioneve, siç kemi praktika të tilla, ndërkohë që ka pasur raste kur një deputet i tillë i angazhuar në më shumë se dy komisione, duke u thirrur në njëfarë formule të ndarjes së përfaqësimit të grupeve parlamentare të Kuvendit, nuk ka pasur mundësi të jetë efektiv pothuajse në asnjë komision.

Rasti i parë ka qenë pengesë. Domethënë, ai deputet që ka qenë i përfshirë në dy-tri komisione, ka qenë pengesë duke paraqitur mungesë kuorumi në komisione, duke vrapuar për t'i vënë nënshkrimet edhe në komisionet tjera, si dhe gati ka qenë e pamundur për t'u familjarizuar me veprimtarinë e komisionit.

Nenet 56, 57, 58 dhe 59 e kanë një lidhshmëri logjike ndërmjet tyre, meqë parashohin rregullën dhe mbarëvajtjen gjatë punimeve në Kuvend, për çka jemi dëshmitarë edhe kohëve të fundit se sa herë është penguar mbarëvajtja e punimeve në Kuvend. Neni 57 parasheh llojet e masave për ata që e pengojnë mbarëvajtjen e Kuvendit.

Neni 58 parasheh masat e vërejtjet, paralajmërim për largim nga seanca.

Neni 59 - masat e largimit nga seanca, e këtu do të ndalem pak. Ka të bëjë me masat që do të merren për deputetin që përdorë diskurs të gjuhës joparlamentare, ndërhyrje në diskutim, e të tjera.

E llojet e masave për këto raste janë të parapara edhe në fund në shtojcën e kësaj Rregulloreje, siç është Kodi i Sjelljes.

Neni 66 ka të bëjë me shqyrtimin e parë të projektligjeve, thotë: “Nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë nga dita e shpërndarjes”, mendoj që kjo duhet përjashtuar në rastet kur nismat ligjore vijnë nga deputetët apo nga Kuvendi, sepse nuk ka shumë nevojë që të pritet nëpër sirtarë, se deputetët veç e kanë bërë vetë atë nismë ligjore, kështu që nuk duhet humbur kohë dhe posa ta kthejë Qeveria përgjigjen duhet të vazhdojë procedura përkatëse.

Neni 89, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe vendimeve në paragrafin 3, ku thuhet: “Komisioni në përputhje me planin vjetor të punës mund të mbikëqyrë zbatimin e një ligji”, mendoj që shprehja “mund” duhet të zëvendësohet me shprehjen “duhet të mbikëqyrë së paku një ligj së paku një ligj”, jo vetëm një ligj, meqë dihet se funksioni i Kuvendit është përveç ligjvënës dhe përfaqësues, edhe mbikëqyrës. Konsideroj se është tepër me rëndësi mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve atyre ligjeve që i nxjerrim në vetë si Parlament.

Në fund të këtij materiali kësaj Rregulloreje të Kuvendit, është edhe shtojca e Rregullores së Kuvendit, që është shumë e rëndësishme, Kodi i Veshjes dhe Kodi i Sjelljes, si elemente shumë me rëndësi për deputetin.

Ky kod përcakton parimet dhe standardet e sjelljes që priten nga deputetët gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Kodi i Sjelljes siguron zbatimin e parimeve dhe standardeve të etikës, me qëllim të forcimit të besimit të qytetarëve të përfaqësuesit e zgjedhur.

Kodi nuk rregullon aspektet e jetës private të deputetit, përveç nëse sjellja dhe veprimi i tij apo i saj dëmton reputacionin dhe integritetin e Kuvendit.

Pra, me fjalë tjera, Kuvendi është vendi ku përplasen idetë për ta zhvilluar vendin dhe jo arenë e etiketimesh, fyerjesh e përplasjesh verbale, e nganjëherë edhe fizike, për çka e kemi krijuar një imazh të keq, edhe të qytetarët, por edhe jashtë vendit.

Kodi ka të bëjë me atë që të tregojë respekt për kolegët tjerë deputetë dhe për qytetarët dhe të sigurohet që veprimet e tij të mos e dëmtojnë integritetin dhe reputacionin e Kuvendit si institucion.

Kemi pasur rast pra me pa pamje jo të këndshme, që jo vetëm e kanë dëmtuar reputacionin e Kuvendit dhe të deputetit, por e kanë dëmtuar rëndë edhe imazhin e vendit.

Unë këtu po e përfundoj, ndërsa vërejtjet dhe sugjerimet e mia do t’ia përcjell Komisionit përkatës në formë të amendamenteve. Faleminderit!

KRYETARI: Në ndërkohë kisha kërkuar, kolegë deputetë, që kush i interesuar për diskutime të materies, që i kemi edhe në pikat e ardhshme, le të qëndrojë, por mundësisht në orën 17:00 ta bëjmë votimin e parë atyre që i kemi përfunduar në debat. Mundësisht, kolegët deputetë le të vijnë në orën 17:00 që ta bëjmë votimin e parë, pastaj vazhdojmë në procedim.

Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Në seancën e paradites janë thënë shumë gjëra, të cilat i kemi diskutuar edhe në mandatin e kaluar.

Është normalisht një kohë e zgjatur ose e tejzgjatur pikërisht për shkak të mos them neglizhencës, por edhe argumenteve dhe kundërgjergjenteve të vetë deputetëve dhe ka vite që Rregullorja e Kuvendit është në duart e deputetëve, e deputetët nuk arrijnë ta përfundojnë një dokument, pikërisht për shkak të funksionimit të vetë Kuvendit.

Prandaj, këto mospajtime në lexim të parë për mua janë shumë të paarsyeshme dhe është e drejtë e secilit të bëjë amendamente, por është mirë që sa më parë ta kalojmë në leximin dhe të kthehemi në kohën kur ne mund të bëjmë edhe amendamente të tjera.

Unë dua ta ngre vetëm një çështje për të cilën në mandatin e kaluar e kemi pasur një debat për Avokatin e Popullit si institucion i pavarur. U tha më herët që institucionet e pavarura dhe dokumentet të cilat gjatë debateve, rezoluta apo rekomandime që dalin nga seancat e Kuvendit për institucione, të cilave shumë herë nuk u miratohen raportet, apo u miratohen në Kuvend, edhe pse ka shumë diskutime apo thuhet shumëçka në ato debate, e në fakt nuk ndërmerren masa asnjëherë, apo thjesht askush nuk jep llogari nga institucionet, të cilat nuk i kryejnë obligimet për çka janë të thirrura, apo për çka e ushtrojnë funksionin e tyre.

Por, dua ta ndaj mendimin se në rekomandimet që kanë dalë nga ai debat për mosrespektimin, ose, në fakt, moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet në fjalë, në fund një pikë e rekomandimeve ka qenë që raporti i Avokatit të shqyrtohet, por jo të votohet. Prandaj, unë kërkoj mirëkuptim nga grupi punues, apo nga Komisioni për Legjislacion që raportin e Avokatit të Popullit ta shohë si kategori tjetër nga institucionet e tjera, sepse në fakt, është edhe kategori kushtetuese. Prandaj, është mirë që secili prej institucioneve të tjera të ketë llogaridhënie në momentin kur nuk miratohet raporti në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në të kundërtën, pse atëherë të diskutohet, pse të hedhet në votim në qoftë se askush nuk jep llogari.

Pra, në qoftë se e merr besimin ose votimin në Kuvend, atëherë thjesht le të dihet se cilat janë ato institucione që janë më të përgjegjshme, të cilat nuk përpiqen për ta ndryshuar vit pas viti, por i njëjti mund të mos kalojë dhe askush nuk jep llogaridhënie. Prandaj, kjo është ndoshta çështja

kryesore për të cilën unë desha të thirrem dhe, normalisht është mirë të mendojmë se vërtet dokumentet e Kuvendit, pikërisht në Rregullore të hyjnë, të bëhen të obligueshme për Qeverinë dhe nëse nuk janë të obligueshme, unë nuk e di pse atëherë Kuvendi thirr debate dhe në fund të fundit, votojmë rezoluta apo rekomandime të ndryshme dhe ato nuk janë të obliguara për Qeverinë. Nëse nuk janë të obliguara, atëherë nuk e di se çfarë dokumenti mund të jetë ai në fund të një debati, ndoshta tërëditor dhe në fund e minimizojmë apo vetë ne si Kuvend nuk i japim rëndësinë një rekomandimi të votuar.

Prandaj, janë dy çështje me të cilat ne kemi biseduar edhe në mandatin e kaluar shumë herë dhe pikërisht këto duhet të merren parasysh në Rregulloren e Kuvendit. Ndoshta një çështje që do të duhej të mendojë pikërisht grupi punues është edhe mënyra. Unë nuk e di personalisht se si, por ndoshta kush është pak më profesional, më jurist, që Kuvendin në momentin që po kemi problem me kuorum apo dhe mënyra e mosvotimit, pa marrë parasysh që sot është një subjekt politik në Qeveri apo nesër është dikush tjetër në opozitë, problemet që po na ndodhin këtu dhe po mbesin shumë herë ligje, të cilat nuk po arrijmë t'i votojmë, është për shkak se deputetët kanë të drejtë për të mos votuar, por nuk e di ndoshta do të ishte mirë që kjo pjesë të rregullohet me Rregulloren e Kuvendit, sepse në fund të fundit kjo është një Kushtetutë e Kuvendit, një dokument se si rregullohet mënyra e funksionimit të vetë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Andaj, me mirëkuptimin më të madh të të gjithë deputetëve është mirë që ne ta kalojmë në leximin e parë, sepse është dokument i vetë Kuvendit dhe, në qoftë se nuk arrijmë ta kalojmë këtë dokument, atëherë nuk e di se për çfarë jemi edhe ne si deputetë ose çka pritet prej nesh. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Kryetar, kërkoj falje, unë s'e kam kërkuar fjalën, e kam kryer në cilësinë e kryetarit të grupit dhe më s'kam nevojë të flas.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Së pari i uroj mirëseardhje në Parlament Listës serbe, se jam frikësuar mos nuk po na vijnë më, e s'kam mundur gjithë natën të fle.

Po kaloj në temë, së pari ne e dimë që arsimi në Kosovë është shkatërruar pikërisht nga profesorë që japin mësim në 5-6 universitete dhe kurrë nuk shkojnë në ligjërata. Shëndetësia është shkatërruar kur mjekët punojnë në 5-6 klinika dhe kurrë s'janë në vendin e punës, por edhe më keq është kur deputetët e Parlamentit të Kosovës e kanë përgjegjësinë zero përpara punës dhe obligimeve të veta. Po e them këtë, zoti kryetar, se ma merr mendja që bëj pjesë në grupin e

ngushtë të deputetëve që në asnjë seancë nuk kam munguar dhe në asnjë komision parlamentar deri më sot s'kam asnjë mungesë.

Edhe në ditët kur s'kemi Parlament, unë e konsideroj si vend pune. Prandaj, mbi bazën e kësaj, nuk po e kuptoj pse të mos futet në Rregullore, përderisa Kuvendi i Kosovës është punëdhënësi ynë, edhe na i jep rrogat, pse të mos futet në Rregullore që asnjë deputet nuk mund të mungojë pa një arsytim specifik? Aida, po e luan kryet, po thotë s'bën, veç duhet ta bëjmë Aidë, s'kemi qare pa e bërë, se përndryshe kështu do të vazhdojmë me ligje. Unë kërkoj falje, ndoshta s'kam të drejtë, ndoshta është mungesë e eksperiencës, po ky është propozimi im, e para. E dyta, do të ishte mirë që në Rregulloren në bazë të eksperiencës së parlamenteve evropiane, po e marr si shembull Parlamentin holandez, të bëhej një ditë votim. Domethënë, pavarësisht seancave, Parlamenti i Holandës voton vetëm ditëve të martë, edhe kur e dinë deputetët që kemi atë ditë duhet t'i votojmë ligjet, atëherë vijmë. Një eksperiencë tjetër që do të propozoj të futet në Rregullore të Kuvendit si amendament, në qoftë se kalon, kalon, po s'kaloi, nuk bëhet nami, që ulëset në Parlamentin e Kosovës të jenë të përziera, opozita të ulet bashkë me pozitën.

Ani de, jo, jo, s'u bë kiameti, unë veç po propozoj. Ma mirë është të rrihemi afër se largas, se lëndimet janë më të vogla. Këtë eksperiencë e kanë shumë parlamente të botës, me Rregullore është në Parlamentin e Suedisë. Të futet në Rregullore që çdo udhëtim i çdo deputeti të specifikohet dhe të publikohet në ueb faqen e Kuvendit të Kosovës.

Votimi për marrëveshjen ndërkombëtare do të duhej të ulej, domethënë të mos jetë kërkesë 80 vota, por të jenë më pak, sepse shpeshherë po ngecim edhe në votimin e këtyre gjërave. Dhe, krejt në fund, do të dëshiroja që çështja e imunitetit dhe roli i kryetarit të Parlamentit dhe Kryesisë së Parlamentit të futeshin në Rregullore që Prokuroria e Shtetit të mos ketë guximin ta prekë asnjë deputet të Parlamentit të Kosovës, as të arrestohet, as të ndalohet, për çfarëdo veprimi të tyre pa e paraqitur me shkrim, në mënyrë specifike kërkesën para kryetarit të Parlamentit dhe Kryesisë së Parlamentit. Në qoftë se një polici i lejohet ta arrestojë një deputet, pavarësisht edhe për gaz a pa gaz, a çka do qoftë ajo, unë jam kundër atyre veprimeve.

Besoj që masë shumë më e madhe ndëshkuese do të ishte sikur Kryesia e Parlamentit dhe kryetari i Parlamentit ta largonte një deputet nga seancat për gjashtë muaj, se sa të arrestohen deputetët. Prandaj, këto janë disa propozime të mia, të cilat dëshiroj të hyjnë në Rregulloren e ardhshme dhe në mungesë të Kryesisë për ta udhëhequr Parlamentin sikur sot, ta ketë të drejtën kryetari i grupit më të madh parlamentar, në qoftë se është në sallë, del dhe e udhëheq, edhe këtë mund ta fusim në Rregullore.

Sepse, krejt Kryesia mund të jenë në udhëtim dhe ne mbesim pa seancë, kështu që edhe këtë mendojeni, të nderuar kolegë deputetë, se sot pati propozime që unë ta zëvendësoj kryetarin, po

diqysh tamam desha të dal, erdhi kryetari, s'e pata atë fat, megjithatë faleminderit, kryetar, që na kërkove falje, kaq kisha. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naser Rugova e ka fjalën, bëhet gati Blerim Kuçi, edhe Ilir Deda është pastaj.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë për ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit që mendoj se është ai shpirti organizativ i funksionimit të një organi më të lartë, siç është Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organ përfaqësues dhe ligjvënës.

Prandaj, në këto ndryshme, edhe nga debatet, por edhe nga përfaqësuesit e subjekteve politike që janë në këtë grup punues vërtet duhet të jemi të kujdesshëm me ecjen tutje në plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje. Pa dyshim që ka ngecje, ka mangësi, ka vakum në Rregulloren aktuale dhe dua të besoj që me një konsensus të plotë të të gjithë të zgjedhurve të popullit ta plotësojmë, ta ndryshojmë dhe ta miratojmë një version përfundimtar që është, në radhë të parë në interes të punës së Kuvendit dhe të ecjes në binarë normal të punës së një organi më të lartë përfaqësues.

Kërkoj të jemi të kujdesshëm dhe gjatë plotësim-ndryshimit të kësaj Rregulloreje, apo edhe gjatë debatit në etapa të mëtutjeshme ta respektojmë frymën kushtetuese dhe nenet kushtetuese, se nganjëherë po vërej që disa nga kolegët deputetë po japin propozime që mund të jenë apo mund ta vënë në pikëpyetje kushtetutshmërinë e kësaj Rregulloreje për organin më të lartë legjislativ të vendit. Unë mendoj që kjo Rregullore duhet të shkojë në funksion të menaxhimit më efikas të punës së Kuvendit, sepse ka vërejtje substanciale të forcimi i rolit monitorues të Kuvendit, gjegjësisht të komisioneve parlamentare dhe dua ta ngre këtu një çështje, u ngrit edhe nga kolegët e tjerë: qartësim i kompetencave, apo aty ku kemi mundësi, rregullim me ligj të institucioneve të ndryshme dhe agjencive të pavarura, bordet e të cilëve zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me qëllim të mbikëqyrjes sa më të mirë, ngritjes së përgjegjësisë, profesionalizmit, por edhe monitorimit të cilësisë së punës së këtyre institucioneve të pavarura, bordet menaxhuese, të të cilave i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkoj që për secilin institucion, i cili thjesht bordi menaxhues i zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në raportin e punës, apo në raportin e evaluimit të performansës vjetore të secilit nga këto institucione, në qoftë se ai raport nuk kalon, thjesht ai bord i atij institucioni automatikisht duhet të shkarkohet. Besoj që kjo do të sillte një frymë tjetër, një përgjegjësi tjetër edhe të rolit tonë, edhe zgjedhës për këto borde, por edhe monitorues dhe do të shkojë në interes qoftë të atyre agjencive apo ndërmarrjeve të

rëndësishme publike, sepse vërtet jemi dëshmitarë të vërejtjeve serioze, papërgjegjësishë dhe neglizhencës së këtyre institucioneve të pavarura.

Dhe, krejt në fund, kërkoj që gjuha joparlamentare, gjuha që nuk përkon me përgjegjësinë, autoritetin publik të të zgjedhurve të popullit, të sanksionohet, e në veçanti po i drejtohem kryetarit, sepse kjo ia lehtëson punën edhe kryetarit të Kuvendit, kushdo që është ai ose ajo dhe, në një formë thjesht e penalizon sjelljen joparlamentare, me të cilën jemi ballafaquar dhe po ballafaqohemi vite të tëra. Andaj, kërkoj një konsensus edhe për këto sugjerime, por edhe për sugjerimet mjaft substanciale të disa nga kolegëve, e në veçanti nga juristët, kemi juristë mjaft të përgatitur këtu, kanë edhe përvojë parlamentare, por edhe juridike, që ta hartojmë një Rregullore që në radhë të parë mos të mendojmë vetëm për legjislaturën tonë, por uroj që kjo Rregullore e miratuar të mos ketë nevojë të ndryshohet bile për nja 4-5 legjislatura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Rugova! Tash, zoti Kuçi, fjala për ju, edhe zoti Deda është diskutuesi i fundit.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Edhe pse kjo çështje pak a shumë është trajtuar prej kolegëve të mi, por dua të shtoj vetëm diçka që të mos ju humb kohë.

Problemet me Rregulloren me sa e kam parë unë kanë të bëjnë kur Rregullorja ndërhyt në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kur ndërhyt në nene të caktuara apo në kategori kushtetuese, atëherë po shfaqet efekti domino. Për shembull, neve na pëlqej ose s'na pëlqej, neni 67, pika 7, e përcakton kompetencën, rendi i ditës është kompetencë e rezervuar për kryetarin e Kuvendit. Vetëm kryetari i Kuvendit e përcakton rendin e ditës dhe thërret dhe kryeson seancat. Mirë apo keq, ata të cilët e kanë hartuar, këtë çështje e kanë rregulluar përmes këtij neni. Ndërhyrja në këtë nen dhe dhënia e kompetencave një kryesie që ne po i themi nënkryetar, ka pasuar probleme sikur që është neni 69, nën 4, ku seancën e jashtëzakonshme e thërret, ka të drejtë ose e thërrasin 40 deputetë. Më 22 dhjetor thirrëm seancë të jashtëzakonshme për çështjen e Ligjit për Dhomat e Specializuara, sot pas dy a tre muajve, ende nuk është mbajtur kjo seancë.

Nuk është me rëndësi a është mirë a keq, a gabim apo pa gabim, kjo seancë sot e kësaj dite nuk është thirrur, këtu është problemi i ndërhyrjes së Rregullores në kompetenca, të cilat janë kushtetuese. Ne e kemi nënshkruar një dokument, një kërkesë, ka qenë e drejta jonë kushtetuese, edhe kush është Kryesia e Kuvendit të na e mohojë këtë të drejtë kushtetuese. Ajo është obliguese edhe për kryetarin e Kuvendit, e sidomos për nënkryetarët e Kuvendit. Pra, ndërhyrje të tilla do të na shkaktonin nesër probleme me nenin 65, ku thuhet që Kuvendi jep pëlqimin për Dekretin e presidentit mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Nesër mundet të ndodhë që presidenti të thërrasë seancë të jashtëzakonshme për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme, dhe një Kryesi, e cila nuk është kategori kushtetuese ose që është kategori kushtetuese, por s'i ka

këto kompetenca, do të na shkaktojë probleme. Ose e ndryshojmë Kushtetutën, e pastaj Rregulloren.

Duke i parë këto probleme, të nderuar kolegë, ne duhet të jemi të kujdesshëm lidhur me kompetencat e Kryesisë. Nuk duhet t'i jepen Kryesisë kompetenca të cilat nuk i ka me Kushtetutë. Na pëlqej apo s'na pëlqej, këtë kompetencë për rendin e ditës, si kategori kushtetuese, e ka vetëm kryetari i Kuvendit. Ne në qoftë se komplikojmë në këtë formë, atëherë do të kemi komplikime, do të na ndodhin probleme qysh na ndodhi me thirrjen e seancës së jashtëzakonshme për Dhomat e Specializuara. Kjo nuk bën të ndodhë, unë i falënderoj ata, të cilët tash e kanë parë këtë problem dhe e kanë rregulluar. Po duhet pas kujdes, kategoritë kushtetuese, të drejtat tona kushtetuese, të atyre të drejta kushtetuese nuk guxojmë t'i komplikojmë me Rregullore të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Deda, fjala për ju!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Është për t'u përshëndetur që më në fund e kemi një projekt-dokument kryesor, i cili e rregullon funksionimin e Kuvendit të Kosovës dhe e përshëndes, në të njëjtën kohë Kodin e mirësjelljes, i cili është më rigoroz dhe i cili mëton që parlamentarizmi të avancojë në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, edhe unë ndoshta do të përsëritëm si disa kolegë të tjerë, por kjo është në frymën e diskutimeve, të cilat duan që kjo Rregullore të kalojë dhe që të jetë e pa diskutueshme, nëse mund të jetë e tillë. E para, ne nuk mund të votojmë për një projekt-rregullore, e cila nuk është e bazuar me Kushtetutën dhe Konferenca e Kryetarëve është jokushtetuese. Tjetra, ka ndodhur, një pasi që shumë gjatë punohet në këtë Rregullore, për shembull e kemi nenin 75, pikën 7, e cila ka të bëjë për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas projektligjit që e kemi tash, projekt-rregullores që e kemi para vetes, pika 7 thotë: "Marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen në Kuvend duhet t'i dërgohen Kuvendit para nënshkrimit të marrëveshjes". Kjo ka ndodhur për shkak të një keqkuptimi të kujtdo që e ka përfshirë këtu, sepse në legjislaturën e kaluar është kërkuar që Qeveria të marrë mandat negociues nga Komisioni për Politikë të Jashtme që të mos hasim në probleme që janë praktika parlamentare në Evropë, të cilën të fundit e ka Sllovenia në rajon.

Domethënë, kjo është absolutisht e panevojshme, sepse e komplikon, nuk i eviton ato që kanë dashur t'i evitojnë propozuesit. Tash, ne në të njëjtën kohë i kemi avancuar me këtë Propozim-Rregullore dhe sa i përket procesit të MSA-së, ku definohet shumë qartë përgjegjësia dhe llogaridhënia e Qeverisë karshi Parlamentit të Kosovës, informimi i rregullt dhe aprovimi, i cili duhet të merren nga Komisioni për Integritet Evropian dhe, më në fund, e përfundon edhe mënyrën ad hoc të emërimit të anëtarëve të Komisionit për Stabilizim-Asociim dhe është e qartë e cekur në këtë projekt-rregullore. Ne nuk mund ta kemi një definim të qartë vetëm sa i përket

procesit të MSA-s, unë i bashkohem thirrjes së kolegëve që të forcohet edhe më tutje roli dhe kompetencat e komisioneve parlamentare dhe këtij Kuvendi sidomos sa i përket përgjegjësisë të agjencive të kompanive publike. Nëse me të vërtetë raportet e agjencive publike nuk kalojnë në Kuvend, atëherë bordet e tyre automatikisht duhet të shkarkohen dhe në këtë duhet të jemi unikë.

Tjetra, në të njëjtën kohë duhet të definohet edhe sjellja e ekzekutivit me deputetët. Ne e kemi parë shpeshherë ekzekutivin, i cili e ka për detyrë t'u raportojë deputetëve, sillet në mënyrë të tillë thua se ne u raportojmë pjesëtarëve të ekzekutivit. Kjo njëjtë, pasi që te ne duhet të sanksionohet gjithçka me ligj, do të ishte mirë të definohet qartë edhe para leximit të dytë. Dhe, për fund, Kosova në të ardhmen do të bëhet pjesë e plotë, shpresojmë, e bashkësisë ndërkombëtare. A duhet që kjo Rregullore ta reflektojë edhe atë çka po na pret para nesh, që do të thotë ne duhet të kemi edhe fuqizim të mëtutjeshëm të kompetencave të Komisionit për Punë të Jashtme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ndërkohë i paskemi nxitur edhe dy deputetë, Adem Mikullovcit e ka fjalën, edhe Bekim Haxhiu.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryesisht çka kam pasur ndërmend të them, tashmë u tha, s'dua të përsëritem. Mua më ka mbetur vetëm një, dua të them që seanca konstituive nëse ndodh e ndërpritet sikur që na ndodhi kësaj here, nuk është e paraparë me Rregulloren e vjetër si të vazhdohet, kush e vazhdon. Aty shkruan decidivisht "e vazhdon kryesuesi kur të dojë ai". Mua kjo më tingëllon pak e palogjikshme që një njeri, që ndodh shpeshherë sikur që isha unë edhe pa eksperiencë, ta vazhdojë mbledhjen kur të dojë ai. Duhet të gjejmë një mënyrë që të vendosë dikush tjetër kur të mbahet seanca, nëse është ndërprerë rastësisht. Kjo më ka mbetur ta them, të tjerat u thanë, dhe s'dua t'i përsëris.

KRYETARI: Ke të drejtë plotësisht, zoti Mikullovcit, se kjo nganjëherë bëhet edhe pre e luftës politike, kur s'po mund ta zgjidhim kryetarin e Kuvendit. Faleminderit!

Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Do të përpiqem të jem i shkurtër, sepse është diskutuar shumë për këtë Rregullore, por në këto tri mandate, sa jam deputet i Parlamentit të Kosovës, është parë që Rregullorja e Kuvendit, e cila rregullon funksionimin e punës së Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare dhe shumë çështje

të tjera, në shumë përplasje politike është shfrytëzuar deri në atë masë që edhe është dërguar edhe në interpretime kushtetuese çështja e Rregullores.

Pra, kur i kemi hyrë kësaj pune për një Rregullore të re të Kuvendit të Kosovës, atëherë i sugjeroj grupit punues që vërtet, pa dallime politike, të mos e shikojnë veten në pozicionin aktual politik, në të cilin janë sot, pozitë apo opozitë, por Rregullorja të punohet që vërtet të jetë në funksion të mbarëvajtjes së punës së Kuvendit dhe ato dilema, të cilat kanë qenë dhe të cilat janë keqinterpretuar në raste të caktuara, të hiqen, por gjithsesi burimi i funksionimit të kësaj Rregulloreje, draftimi i saj duhet të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Një sugjerim ekskluziv për grupin punues, i cili ka qenë deri tani dhe besoj që do vazhdojë atë punë edhe më tutje, që kjo Rregullore duhet të bazohet në Kushtetutë, të mos i ikë asaj dhe në veçanti të parashohë disa momente ose disa veprime, të cilat duhet të rregullohen, edhe sa u përket detyrave dhe përgjegjësive të deputetit, edhe sa i përket raportimit të institucioneve të pavarura, të cilat shpesh atë raportim e vonojnë edhe me vite dhe nuk i raportojnë Kuvendit e nuk kanë asnjë përgjegjësi përpara qytetarëve, qoftë për mjetet financiare, të cilat i shpenzojnë, qoftë për punën e tyre ose mospunën thënë më mirë, të tyre dhe për çështje të tjera, të cilat do të duhej t'i rregullojmë në veçanti në këtë Kuvend të mos shikohet nga aspektet politike pozicionimet aktuale në Kuvend, por që të jetë në shërbimin e të gjithë deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash ndërkohë nënkryetari Kujtim Shala e ka kërkuar fjalën. Hajdar, s'ë pashë më herët, ti je në emër të komisionit, në fund pastaj e ke. Zoti nënkryetar, fjala për ju!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Ne po diskutojmë për dokumentin themelor të Kuvendit të Kosovës, për një draft i cili nëse miratohet, kthehet në një Kushtetutë të Kuvendit të Kosovës. Unë edhe kur s'kam qenë pjesë e Parlamentit, kam pasur njohuri për debatin për një dokument të tillë dhe për tentimin që Kuvendi i Kosovës të miratojë një dokument të ri të kësaj natyre, pra dokumentin që quhet Rregullore e Kuvendit ose Rregullore e Punës së Kuvendit.

Në këta muaj sa kam përvojë në Kuvendin e Kosovës dhe në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, si anëtar i Kryesisë, unë kam vërejtur që ne kemi një Rregullore, e cila nëse implementohet, nëse zbatohet, është plotësisht funksionale. Kuvendi ka probleme të mëdha të funksionimit të tij, por unë kam parë që ato probleme nuk lidhen aspak me Rregulloren e Kuvendit. Problemet lindin sepse nuk respektohet Rregullorja. Kjo Rregullore vërtet ka pasur dy-tri mungesa të rëndësishme, të cilat janë plotësuar pas kërkesave për interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese, si çështja që lidhet me problemet elektorale, cila është shumica parlamentare, elektorale, kujt i takon

mandatari, e tjerë. Pas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, në këto pjesë kjo Rregullore është plotësuar.

Tani drafti që kemi marrë ne në pjesën më të madhe të tij mua më duket plotësisht i panevojshëm. Do të duhej ndërhyrë në çështjet e një natyre që janë shumë më teknike, për shembull, çfarë ndodh nëse në një pikë të rendit të ditës kërkohet që seanca të deklarohet me votim, deputetët janë në sallë dhe nuk marrin pjesë. A duhet të kalojmë në një pjesë tjetër, apo jo? Me çështje të tjera, nuk do të duhej të merreshim fare. Elemente të reja të këtij dokumenti, sa kam vërejtur unë janë dy, po mendoj si më të rëndësishme. E para, propozimi për Konferencën e Kryetarëve, për të cilën kemi biseduar gjatë të gjithë dhe kemi biseduar gjatë, sepse është elementi i ri dhe problematik, sidomos kur lexohet në raport me Kushtetutën dhe dy, plotësimi i Kodit të mirësjelljes së deputetëve dhe të etikës.

Për të parën unë kam dhënë mendimin edhe më herët, besoj që ai propozim, ai nen, më duket është neni 21 i Rregullores, është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, sepse merr ose i kodifikon për vete një numër funksionesh, të cilat i takojnë një kategorie kushtetuese, ajo është kryetari i Kuvendit, pa emër, domethënë si funksion. Kjo nuk mund të bëhet, kjo s' duhet të ndodhë. Domethënë, Kuvendi i Kosovës nuk guxon të miratojë një dokument, dokumentin e tij themelor dhe të shkelë Kushtetutën drejtpërdrejt. Kompetencat kushtetuese janë kushtetuese, nuk mund të riorientohen, nuk mund të përthihen me asnjë dokument tjetër, sepse ajo është akti themelor, edhe politik, edhe juridik i një vendi, dhe besoj pajtoheni.

Sa i takon Kodit të Sjelljes, të Mirësjelljes së deputetëve, unë besoj se aty ka elementë shumë të rëndësishëm që ne s'i kishim përpara dhe elementë që lidhen drejtpërdrejtë edhe me konfliktin e interesit, e tjerë. Unë besoj që ato pjesë nuk duhet të mbeten si aneks, si pjesë e kodit, po ato janë pjesë për trupin e tekstit të Rregullores dhe do të mund të përfshiheshin te pjesa e detyrave, ose detyrimeve të deputetit, sepse kështu do ta kodifikonim drejtpërdrejt sjelljen.

Tani në këta muaj unë kam parë, që përpos deputetët që lidhen drejtpërdrejtë me interesa të caktuar, si deputetë kolegë tanë që janë këtu dhe janë biznesmenë, normalisht që është kushtetuese dhe me votë duhet të vendosin ligje, norma, edhe për ato fusha të cilat janë veprimtari e tyre. Këto do të duhej të përcilleshin me kujdes, do të duhej të verifikoheshin deri në çfarë shkalle veprime të tilla vendimmarrëse nuk përbëjnë konflikt interesi.

E dyta, ka nisma dhe të miratuara nga Kuvendi, për të cilat Kuvendi e di që nuk ka bazë kushtetuese.

E treta, ka nisma në të cilat deputetët qartësisht përfaqësojnë grupe të interesit dhe janë të përfshirë edhe vet dhe Kuvendi i miraton. Kjo nuk mund të zgjidhet me kodin e sjelljes së

deputetit, kjo gjë duhet të zgjidhet me trupin e Rregullores, me detyrat dhe me detyrimet që ka deputeti.

Kosova, përpos tjerave, është një zonë elektorale dhe kjo do të thotë që deputetët, s'ka rëndësi në cilën zonë marrin vota më shumë ose më pak, janë përfaqësues të të gjithëve. Nëse pjesëtohen pastaj si interesa në shërbim të grupeve të interesit, të medievet, ose të biznesit, e tjerë, ne gjithmonë do të kemi probleme me atë që quhet konflikt i interesit e nëse, Kuvendit dhe Kosovës i intereson që të ketë përfaqësime të asaj natyre, atëherë le të legalizohet. Ka vende që e kanë legale dhe ne s'kemi pse hulumtojmë kush ka konflikt i interesit e kush nuk ka. Legalizohet, deputetët vijnë, përfaqësojnë, llojnë hapur, kodifikohet me ligj dhe jemi në rregull. Unë besoj, që teksti është shumë problematik, po unë do të respektoj qëndrimin e grupit tim parlamentar dhe do të votoj për, me kushtin që ne të merremi seriozisht me këtë dokument dhe në leximin e dytë të shmangen të gjitha problemet që paraqet ky dhe të tentojmë të korrektojmë në ato pika ku është e nevojshme, pjesë të cilat i ka Rregullorja që kemi në fuqi dhe që janë mungesa të vogla teknike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka përfunduar radha e debatuesve. Propozuesi e ka fjalën. Hajdar Beqa, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

E vlerësoj shumë këtë debat. Edhe si komision, edhe si grup punues, kemi dhënë kontribut në këtë rregullore, në këtë projekt-rregullore, ka dhënë edhe administrata e Kuvendit, po edhe të tjerët. I falënderojmë të gjithë.

Unë e shoh shumë me vlerë debatin e sotëm dhe si Komision për Legjislacion po të njëjtën kohë edhe si kryetar, kryesues i grupit punues për Rregullore, do t'i marrim parasysh këtë debat, të gjitha vërejtjet, të gjitha propozimet, që konsideroj se kanë qenë në të mirën e këtij dokumenti dhe mendoj se sot ne duhet ta përkrahim me votë të gjithë deputetët, në mënyrë që t'i hapim rrugë e ta përmirësojmë edhe në mes dy leximeve ta bëjmë amendamentimin e Rregullores.

Konsideroj se jemi të vonuar, kryetar. Është një akt i rëndësishëm dhe pres dhe i ftoj të gjithë deputetët që ta mbështetin. Sa i përket, nuk dua të ndalem shumë, por edhe si komision, edhe si grup punues, e kemi pasur parasysh që të mos biem ndesh, as me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, as me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe te këto që kemi pasur disa konteste, si konferenca e kryetarëve, marrëveshjet ndërkombëtare, e tjera, e tjera... do t'i marrim parasysh dhe në grup punues do t'i harmonizojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mbetet për votim në momentin kur të arrijmë kuorumin. Në orën 17:00 do të kemi votimin e parë, pastaj e përcaktojmë votimin tjetër. I lus kryetarët e grupeve parlamentare që deputetët të vijnë në orën 17:00.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuari kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë dhe me qëllim të përmbushjes së prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pas përfundimit të procedurave për marrjen e kredisë në dhjetor të vitit 2017 Ministria e Financave ka nënshkruar Marrëveshjen e huas me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin për ndërtimin e autostradës Kijevë-Zahaq.

Kjo marrëveshje paraqet vetëm një pjesë të financimit të këtij segmenti të Autostradës. Kushtet e financimit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim janë më të favorshme se huaja në treg. Me interes 1% plus euro-bor, maturitet 15vjeçar dhe greis periodë 3 vjet. Rekomandimi i Ministrisë së Financave është bashkë me këto institucione me reputacion të lartë të fillojë menjëherë procedurat për kontraktimin e këtij segmenti. Në këtë mënyrë afati optimal për fillimin e këtij projekti është pjesa e parë e vitit 2018.

Konstruktin financiar i marrëveshjes për projekt është si në vijim: 71 milionë hua nga BERZH-i; 80,2 milionë hua nga Banka Evropiane për Investime; 38 milionë kontribut nga Qeveria e Republikës së Kosovës; 7,1 milionë grand nga korniza investuese e Ballkanit Perëndimor dhe 0,6 milionë grante nga BERZH-i.

Marrëveshja e kredisë me Bankën Evropiane për Investime është në proces të negocimit dhe pritet të nënshkruhet në fund të muajit mars dhe pastaj përmes Qeverisë të përcillet për ratifikim në Kuvend. Procedurat për një pjesë të grandit nga korniza investuese e Ballkanit Perëndimor janë duke u zhvilluar dhe 2,7 milionë janë tashmë të siguruara. Ministria e Financave do të kujdeset që të merret edhe grandit final për mbikëqyrje të punimeve dhe mbështetje institucionale në shumë prej 4,4 milionë euro.

Projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshje financiare të kredisë është përgatitur nga Ministria e Financave dhe përcjell nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ratifikim në Kuvendin e Kosovës bazuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 10 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare. Marrëveshja e kredisë për këtë projekt është arritur konform planifikimit buxhetor dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, andaj ju ftoj që ta përkrahni të njëjtën edhe me votën e juaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit të komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e Projektit të ndërtimit të autostradës Kijevë-Zahaq. Shuma e marrëveshjes është 71 milionë euro dhe do të zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës. Norma e interesit do të jetë 1% plus euro-bor, ndërsa kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë 15 vite, do të ketë një greis-periudhë prej tre vjetësh. Kthimi i kredisë fillon më 30 prill të vitit 2021 dhe do të përfundojë më 30 dhjetor 2032.

Për zbatimin e këtij projektligji shpenzimet operative do të akomodohen në kuadër të rregullës fiskale të deficitit prej 2%, ndërsa projektet kapitale do të financohen në kuadër të mekanizmit të klauzolës së investimeve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar projektligjin dhe marrëveshjen dhe ka vlerësuar rëndësinë e financimit për realizimin e Projektit të autostradës Kijevë-Zahaq, si dhe kushtet e tërheqjes dhe kthimit të kredisë dhe ka mbështetur këtë marrëveshje. Pra, mbështesim idenë që investimet kapitale, sidomos në rrugë të bëhen me kredi të këtilla të buta për periudha afatgjate dhe të lirohet Buxheti i Republikës për shpenzime të tjera.

Prandaj, komisioni ynë i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare nuk kemi të lajmëruar. Kemi nga deputetët. Atëherë, Lutfi Zharku, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,
Ministra,

Lidhja Demokratike e Kosovës e mirëpret nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, duke marrë parasysh punën e madhe që është bërë në mandatin e kaluar për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge, këtij aksi rrugor, që është i një rëndësie të posaçme. Natyrisht marrëveshja, siç e përmendi edhe ministri, përfshin edhe 600 mijë euro grand në kuadër të marrëveshjes nga Banka

Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, që janë për studim financimi të atij segmenti rrugor, është për zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë rrugore dhe natyrisht për mbikëqyrje, inxhinierin për monitorim të huadhënësit.

Në anën tjetër, gjatë mandatit të kaluar është punuar me WBIF-in për studimin e fizibilitetit të projektit kryesor. Është kryer projekti detaj dhe është në proces e sipër mbikëqyrja për njësinë për zbatimin e projektit. Në kuadër të kësaj do të jetë edhe grandit për inxhinierin mbikëqyrës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Për këtë çështje ka pasur për detyrë që të flasë deputeti Liburn Aliu, i cili po vazhdon që të mbahet padrejtësisht në paraburgim, por edhe 6 deputetë tjerë. Natyrisht, në mungesë të tij, në emër të Grupit Parlamentar unë e përkrah, e them qëndrimin e Grupit Parlamentar, që e përkrah Marrëveshjen për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq.

Konsiderojmë se është e rëndësishme që të përfundojë ky projekt dhe kemi pasur kontakte të shumta edhe me qytetarët andej. Andaj, besoj që do të përfundohet, sepse e dimë që ka kohë të gjatë që nuk po përfundon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sefete Hadërgjonaj nga Partia Demokratike e Kosovës, urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Marrëveshjen për hua ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ta votuar këtë marrëveshje dhe ne si grup parlamentar do të votojmë për dhe ftojme të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës, që ta votojnë këtë marrëveshje, meqenëse kjo rrugë është mjaft me interes për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Blerim Kuçi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetar!

Grupi ynë parlamentar duke ditur se kjo çështje është trajtuar edhe në komisionin përkatës, pra në Komisionin për Buxhet dhe Financa, me vota unanime ka kaluar dhe është bërë rekomandimi drejt Kuvendit, po ashtu duke ditur edhe rëndësinë e këtij projekti, si projekt nacional dhe kushtet e favorshme të huas, ne si grup parlamentar do ta përkrahim që të gjithë këtë projekt të rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka fjalën në emër të Grupit të Deputetëve të Pavarur.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Grupi i Deputetëve të Pavarur gjithashtu përkrah Marrëveshjen për hua me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në lidhje me Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq. Besoj që ashtu sikur çdo marrëveshje ndërkombëtare, edhe kjo do të arrijë t'i ketë votat e duhura, që të ecim tutje.

Në anën tjetër, do të mund të ishte edhe një shembull se si mund të ndërtohet infrastruktura rrugore në mënyra që nuk janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me kontraktues, kemi pasur në të kaluarën. Pra, është një shembull i mirë, se si mund të flasim për infrastrukturën e domosdoshme në Republikën e Kosovës, pa qenë të ndërlidhur me një operator ekonomik, i cili tashmë që një kohë të gjatë merr shuma marramendëse prej Buxhetit të Kosovës e kontratat e të cilave nuk i kemi parë. Është hera e parë që shohim një kontratë për hua lidhur me një autostradë, e cila është saktë e detajuar dhe mund të përcjellim procesin e blerjes së shërbimit të ndërtimit të autostradës.

Rrjedhimisht, si Grup i Deputetëve të Pavarur përshëndesim një lloj të modelit të tillë për ndërtimin e infrastrukturës dhe do ta përkrahim.

KRYETARI: Enver Hoti, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate e mbështet plotësisht marrëveshjen ndërmjet Qeverisë për huazim, duke marrë parasysht kushtet që përmban marrëveshja e që janë shumë të favorshme. Inkurajojmë Qeverinë që të vazhdojë me projekte të tilla dhe të përcjellë praktika të tilla për projektet që do të jenë në interes të vendit. Po ashtu, duke pasur parasysht edhe rëndësinë e autostradës Kijevë-Zahaq për vendin e sidomos për rajonin, ne e mbështesim plotësisht dhe u bëjmë thirrje të gjithë deputetëve që ta mbështesin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar në emër të grupeve parlamentare. Tash, ka për deputetë. Arben Gashi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe Time Kadrija në emër të AAK-së. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar ka folur zoti Zharku. Unë po flas si deputet.

Mendoj se është e rëndësishme që rruga Kijevë-Zahaq të rriten kapacitetet e saj dhe po ashtu, mendoj se është e rëndësishme të potencohet se kemi një model tjetër të financimit të rrugëve. Mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme të potencohet ky lloj modeli. Nga modeli i financimit nga buxheti i autostradave dhe rrugëve të Kosovës kemi kaluar në modelin e financimit me hua, kredi të buta, me periudhë të gjatë kohore të kthimit prapa të kredisë. Kështu që, mendoj se është ndryshim substancial, sepse paratë e Buxhetit mbeten që të investohen në fusha të tjera, siç mund të jenë prioritetet si arsimi, shëndetësia e çështje të tjera të karakterit të zhvillimit ekonomik apo atij social.

Pra, modeli i propozuar në atë kohë, me sa di unë nga zoti Zharku, është model i mirë i financimit të kësaj rruge dhe po ashtu, nxis ministrin e financave që ta nxisë Qeverinë, ta edukojë Qeverinë për sistemin e financimit afatgjatë dhe për sistemin e ruajtjes së Buxhetit të shtetit për çështje prioritare dhe jo financimit të infrastrukturës së fortë. Pra, investimet në infrastrukturën e fortë, kryesisht në sistemin modern të ekonomisë dhe të financimit bazohen mbi bazën e kredive të buta afatgjata dhe aty ku është e mundur me grande prej donatorëve të ndryshëm, nëse ka mundësi prej Bashkimit Evropian, ose grande tjera.

Pra, e nxis ministrin e Financave dhe Qeverinë, që të koncentrohen më shumë tek financimi i infrastrukturës së fortë mbi bazën e grave dhe subvencioneve të ndryshme dhe jo mbi bazën e shpenzimit të Buxhetit të Kosovës për çështje të investimeve në infrastrukturën e fortë, sepse pastaj mbeten shumë pak para në dispozicion për çështje prioritare, siç janë arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, mirëqenia sociale, sundimi i ligjit, e tjerë, e tjerë...

Pra, ky ishte observimi im, ishte sugjerimi për Qeverinë dhe po ashtu, ishte deklarimi i hapur i përkrahjes sime për këtë lloj të financimit dhe për këtë projekt konkret. Faleminderit!

KRYETARI: Time Kadrijaj e merr fjalën. Rexhep Selimi është deputeti i fundit që ka kërkuar fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po më vjen mirë që për këtë pikë të rendit të ditës e kemi një konsensus. Nuk është hera e parë që është debatuar, sepse ka qenë një padrejtësi që u është bërë rreth 500 mijë qytetarëve të Rrafshit të Dukagjinit, të cilët për një periudhë shumë të gjatë kanë pritur që të ndërtohet kjo autostradë. Sot është lajm i gëzuar për të gjithë ata qytetarë, sepse më në fund Qeveria konkretisht po vepron, në mënyrë që edhe këta 500 mijë qytetarë të jenë të lidhur me një autostradë, që do t'ua mundësojë një lëvizje më të lirë, një lëvizje më të shpejtë, në drejtim të kryeqendrës së Republikës së Kosovës.

Ne e falënderojmë Qeverinë, por gjithashtu dua t'i falënderoj të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare që sot po i japin përkrahje një projekti të tillë me rëndësi të veçantë.

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Meqë, tashmë u konstatua se për këtë projekt dhe për këtë marrëveshje bashkërisht nuk ka ndonjë kundërshtim nga grupet parlamentare, atëherë mendoj se për Qeverinë do të jetë një mundësi e re, që menjëherë të fillojë projekte të reja dhe të ngjashme, madje unë do doja që Qeveria menjëherë të fillonte me projektin e rrugës së njëjtë tashmë, meqë Autostrada apo rruga, magjistralja, Prishtinë - Pejë mund të konsiderohet si projekt që mund të kryhet shpejt, të fillojë menjëherë me projektin Pejë - Deçan - Gjakovë - Prizren, një rrugë e cila do t'i ndihmonte shumë asaj zone dhe njëkohësisht një rrugë që është e mbingarkuar.

Po ashtu, me këtë rast, ndoshta tash Qeveria e Kosovës ka edhe një lehtësi tjetër, mund ta fillojë edhe një projekt të ri në rrugën Pejë - Rozhajë, pasi që pas marrëveshjes së djeshme kjo rrugë është shkurtuar për disa kilometra. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka në ndërkohë është lajmëruar. Kryeministri e ka fjalën në fund pastaj. Kryeministër, a ka mundësi. Atëherë Milaim Zeka, pastaj kryeministri.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Po e shoh njëfarë forme edhe kur po diskutojmë për këtë projekt kaq madhor, që pjesa dërmuese e deputetëve po mendojnë të flasin se po qe se flasin diçka kundër mos po i humbin votat. Bile, tash shefi i grupit tim parlamentar tha: fol, fol, po mund t'i humbësh votat. Megjithatë, unë do flas. Do flas, sepse nuk është lajm i gëzueshëm që ne në këtë vend mbarojmë vetëm asfalt, se ky popull, ishalla pra mësohet në vend sallatave të hajë asfalt.

Por, lajm i gëzueshëm është kur ne marrim projekte dhe ndërtojmë një spital modern, që qytetarët e Kosovës mos t'i harxhojnë 120 milionë euro për shërim të sëmundjeve të tyre jashtë territorit të Kosovës. Nuk ka qeveri në Bot, në vendet perëndimore, pyetni sllovenët, pyetni kroatët, në qoftë se buxhetin e shtetit e çojnë në asfalt maksimumi mbi 30%. Prandaj, mbi bazën e kësaj nuk ka njeri që është kundër ndërtimit të infrastrukturës, por edhe në anën tjetër krejt qeveritë e kaluara buxhetin kryesor e kanë çuar në asfalt.

Sugjerimi dhe këshilla ime është që kjo qeveri në buxhetin e vitit 2019 ta ndryshojë qasjen dhe ta ngritë në mënyrë radikale buxhetin në arsim dhe në shëndetësi, përndryshe edhe pse jam kundër këtij projekti do të votoj për.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, i është përmendur emri.

BILALL SHERIFI: Kolegu Milaim Zeka e ka ngatërruar financimin me buxhet dhe financimin me kredi. I është ngatërruar kjo pak.

Ky projekt nuk ka të bëjë me buxhet, bile pikërisht ky buxhet e heq ngarkesës që i është bërë ndër vite Buxhetit të Kosovës. Pra, të financohet një rrugë për të cilën me dekada duhet t'i japësh paratë, ngadalë-ngadalë t'i paguash, Milaim, edhe t'i heqësh menjëherë nga buxheti, janë dy gjëra të ndryshme. Unë kur ta thash atë, bëra hajgare dhe nuk është mirë hajgaret të fliten në foltore, as me mua, as me kolegët tjerë, se njerëzit nganjëherë tallen në besim diçka, se kur të dalësh në televizion atje merr përmasa serioze. Milnim, mësohu, bëhu pak më serioz edhe pse nuk e ke të lehtë të bëhesh serioz.

Pra, që të jemi të qartë, Nisma mbështet të gjitha projektet e tilla për të cilat nuk ngarkohet Buxheti menjëherë, por përkundrazi lehtësohet Buxheti dhe ato para të cilat do të kishin shkuar në asfalt, siç po thotë Milaimi, tash mund të shkojnë në shëndetësi, mund të shkojnë në arsim, sepse nuk jemi të detyruar që përnjëherë, brenda një viti buxhetor, të ndajmë para të mëdha nga Buxheti i Kosovës. Pra, le të shërbejë kjo, siç thanë disa kolegë, si model që projekte të tilla infrastrukturore të financohen me kredi të tilla të buta, për të cilat nuk detyrohemi të ndajmë menjëherë para. Mbi të gjitha, ka edhe një periudhë greis, që quhet, disa vjeçare, për të cilat ti fare nuk fillon të kryesh pagesën. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën edhe Albin Kurti.

KRYEMINISTRI: Sot tema është prezantuar prej ministrit Hamza. E falënderoj për punën që e ka bërë, por njëkohësisht u shpreh falënderim edhe ministrave paraprakë të Qeverisë paraprake.

Jemi në proces të përmbylljes së një projekti, që është i filluar më herët, i një autorrugë që lidh Pejën, që lidh Dukagjinin, që mendojmë se e ka peshën e vet. E mira e ngjarjes së sotme është se na jep më shumë hapësirë kjo kredi, prapëseparapë duhet me e kthye këtë kredi, pra nuk është donacion, por e ka kohën e pauzës që është rreth tri vjet dhe i ka kushtet e favorshme. Mendoj që është ngjarje e mirë për Kosovën. Njëkohësisht, duhet vazhduar me projekte tjera, siç u sugjerua këtu nga plot kolegë, dhe jemi dakord.

Diçka për ata që po gëzohen që është shkurtuar rruga. Njerëzit që u gëzohen këtyre temave, që po japin lajmin kështu, diçka dua të them për kolegët e tyre, për kolegët e tij, të Rexhës. Rexha ka ditur gjithnjë t'i shpëtojë të vetat, Albin. Rexhep Selimi ka qenë i mirë, ka ditur gjithnjë t'i shpëtojë të vetat, i ka nxjerrë. Kam drojën që do të jetë në rendin e atyre që do t'i shpëtojë të vetat dikur.

KRYETARI: Albin Kurti e ka kërkuar fjalën.

ALBIN KURTI: Së pari, Rexhep Selimi ishte këtu deri tash, pra kur të vijë atëherë mund t'i drejtohesh. Ju e patë që këtu ishte, folët kur ai s'ishte!

Por, ajo çka unë e kërkova është se ne duhet të brengosemi pse nuk po marrim kredi për ndërtimin e termocentralit? Pse po marrim kredi të buta vetëm për asfalt? Fundja, asfalti nuk është vlerë e shtuar në ekonomi as për së afërmi, qysh është termocentrali, sepse termocentrali është kapacitet gjenerues. Bile, asfalti, rrugët, duhet ta lidhin industrinë me konsumatorin, prodhimin me tregun, e kështu me radhë. Në njërën anë ne marrim kredi të buta për asfalt e në anën tjetër kemi lidhur kontratë me "Contral-Global", i cili kërkon garanci shtetërore prej nesh për kredinë që do ta marrë ai.

Në njërën anë thuhet, pra se shteti i Kosovës nuk është mjaftueshëm i fuqishëm e i sigurt, që ta ndërtojë vet termocentralin e në anën tjetër, fondi investiv privat thotë, jo unë besoj në juve më shumë se sa ju që besoni në vetvete, prandaj ma sillni atë garancinë shtetërore për kredinë që më nevojitet, për termocentralin, që do ta ndërtoj me paratë e juaja, por do të jetë imi për 20 vjet.

Unë besoj se kjo kredi që po mbështetet tash nga i gjithë Kuvendi i Republikës së Kosovës e ngrit një çështje shumë më themelore. Pse po kërkohet mbështetja për kredinë për asfalt e jo për kredinë për termocentral, që do të duhej të ishte shumë më prioritare për ne se sa kjo. Prandaj, unë besoj që kjo vjen për shkak se nuk ekziston një plan zhvillimor nacional, pjesë e të cilit do të ishin asfalti, energjia, e kështu me radhë.

Vetëm edhe pak, Rexhep, se do të mund të përgjigjesh. Pra, pse nuk merret kredia për termocentral, është pyetje shumë më e rëndësishme, se sa pse po merret kredia për këtë asfaltin tani. Thuhet, që Kosova është shoqëri në tranzicion e në fakt, ne më shumë jemi bërë vend transit, se sa shoqëri në tranzicion, sepse në njërën anë s'patëm tranzicion, se s'patëm proces të lëmuar të kalimit prej një shkalle në një shkallë tjetër, po dikur me Rregullore të UNMIK-ut e më pastaj me vendime të Qeverisë kemi bërë privatizime të egra abuzive rapide. Ndërkaq, në anën tjetër jemi bërë vend transit sepse po ndërtojmë vetëm rrugë. Kosova për t'u zhvilluar e për të sjellë punësim, sidomos për rininë dhe për gratë, është e domosdoshme që të shndërrohet në një vend ku koncentrohet kapitali, e jo vetëm një vend ku qarkullon kapitali.

Investimi vetëm në rrugë është investim për vend transit, pa koncentrik, pa akumulim të kapitalit. Ne kemi nevojë për akumulim të kapitalit e jo vetëm për qarkullim të tij. Prandaj, nuk është e rastësishme që qytetarët tanë duan të marrin vetëm botën në sy e t'i shfrytëzojnë rrugët e këtij vendi, sepse fabrikat janë shitur. E kur dëshirojmë të ndërtojmë kapacitete të reja gjeneruese për energjinë, atëherë marrim ndonjë fond investiv privat, i cili e do shkallën e kthimit në kapital të brendshëm +18,5% me treg të garantuar, me tatim të paguar, e ku 15 hektarë i japim për 10 euro, ndërkaq tash natyrisht që gëzohemi për këtë kredi të butë për asfalt, se ne kemi ditur të bëjmë edhe më keq se kaq. Me para kesh, të gatshme të buxhetit, ia kemi dhënë gati dy miliardë euro

“Bechtel&Enka”-s dhe kur ta krahasosh me të, njëmend që kjo del mirë, po të krahasohesh me diçka që është tepër keq, është kollaj të dalë mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Po e shoh insistimin e Milaimit, si replikë ndaj Bilall Sherifit.

MILAIM ZEKA! Faleminderit, kryetar! Në radhë të parë, pak njerëz në këtë botë mund ta përdorin humorin si medikament kundër kancerit në një Parlament që fare nuk është serioz. Po unë humorin e kam përdorur edhe në luftë, kështu që është një farë shkalle e inteligjencës të flasësh me humor edhe për gjëra serioze.

Unë e kuptoj fort mirë, di nga pak ekonomi, që kjo hua do të kthehet nga Kosova dhe, e tha edhe ministri, me kamatë 1%, do të thotë sillu-pështillu, janë para të popullit të këtij vendi.

Unë kisha vetëm si këshillë dhe plotësisht Albini ka të drejtë kur thotë që i kemi dhënë dy miliardë “Behtel&Enka”-s, e shikoni si po shembet asfalti çdo ditë, çfarë autostrade kemi ndërtuar.

E keni te rrethi këtu, te rrethi është shembur autostrada që një vit dhe askush nuk merr përgjegjësi. Ishte këshillë, ndërtoni spitale e çerdhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë debatin. Rexha nuk e ka marrë fjalën, a do replikë?

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Unë isha në bufe kur dëgjova kryeministrin, kam të drejtën, besoj, që kryeministri më ka kuptuar më shumë se sa e kuptova unë për atë çka tha, por një gjë dua të them.

Që është evidente që pas marrëveshjes së pardjeshme, në këtë rast, rruga deri në Mal të Zi është shkurtuar më shumë, madje është shkurtuar për disa kilometra.

Dhe dua ta konfirmoj edhe një herë që unë nuk i jam gëzuar kësaj, nëse dikush i është gëzuar, i janë gëzuar ata që atë ditë në këtë sallë pas ratifikimit duartrokitën dhe u përqafën, madje, me njëri-tjetrin.

Kurse sa i përket t’i nxjerrim rrugët, rrugët që na i kanë marrë ndoshta i nxjerrim, por rrugët që i japim vetë kurrë më s’do të mund t’i nxjerrim.

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shikoni, s'ka gjë më keq kur njerëzit e një shtëpie flasin për diçka që mund të ndreqet brenda shtëpisë së vet, e nuk dinë ta zgjidhin, nuk është në rregull. Por, ka diçka që është shumë interesat që dua ta them. Rexha është djalë shumë i mençur, prej që i ka nisur lëvizjes për liri është aktiv, po therë nuk i ka hyrë, përnjëmend s'i ka hyrë një therë diku Rexhep Selimit. Ka shpëtuar vetë, djali i mençur, edhe pas luftës ka shpëtuar mirë, as s'e ka bërë një ditë burg, asnjë problem s'i ka ndodhur, veç një sekondë, dëgjo deri në fund.

Ti po thua që për pak ditë në pushtet, Rexhep, e kam shitur tokën, ti je rrenacak i madh, ti ke qëndruar nëpër Shqipëri, je shëtitur në 15-katëshe para luftës, gjatë luftës e gjithë kohën.

KRYETARI: Kryeministër, të lutem, fjalorin...

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E di që nuk është ashtu, ti e di që nuk është ashtu, Rexhep Selimi, ti je duke bërë atë për pak vota t'i qëndrosh afër atij burri, do ta lësh shpejt, ky do ta shohë që do ta lësh shpejt.

KRYETARI: Armend Zemaj, të lutem!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë po mendoj që Kosova është e vogël që të kemi aso lloj logjike të ndarjes regjionale dhe të klasifikimit të investimeve, por besoj që kur janë serioze dhe janë të rëndësishme, mbi të gjitha, kur janë të kapshme qoftë për buxhetin, qoftë për raportet me institucionet financiare ndërkombëtare, mendoj që duhet të përkrahet në bazë të nevojave që kanë qytetarët e pjesëve apo rajoneve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

Çdo kush që e di dhe që jeton në Kosovë dhe që i shfrytëzon këto rrugë të Kosovës, e di që rruga për Pejë ka nevojë për zgjerimin e saj dhe sigurisht, sigurimi i mënyrës së financimit duhet të jetë real, është i domosdoshëm, por mbi të gjitha duke ruajtur seriozitetin në punë dhe në sigurinë e atyre investimeve. Për këtë arsye edhe personalisht mendoj që Kuvendi duhet t'i japë përkrahje pa dallime politike, sepse është interes i Republikës së Kosovës dhe i qytetarëve që jetojnë në atë pjesë, e cila për shumë vjet duket që ka mbetur e ndarë nga investimet apo nga pjesët e tjera investuese.

Ajo çka është me rëndësi që Kuvendi, edhe sot kur debatuar për Rregulloren e Punës së Kuvendit, po që të hartojmë edhe mekanizma mbi të gjitha komisionet që janë mbikëqyrëse qoftë për përzgjedhjen, por mbi të gjitha, qoftë edhe për mbikëqyrjen e këtyre kredive, edhe pse kjo u takon autoriteteve të tjera, siç është Ministria e Financave.

Kështu që besoj që ajo çka është brenda e rëndësishme, që e kam parë brenda kësaj marrëveshjeje është që banka e cila jep këto para e zgjedh mbikëqyrësin, mbikëqyrësi është

autoriteti, i cili e kontrollon edhe kualitetin e punimeve dhe sigurisht kjo nuk do të ndodhë siç ka ndodhur me rrugën për Mitrovicë, e cila akoma edhe sot e asaj dite ka mbetur duke u zgjeruar herë një metër, herë dy metra, herë në njërën pjesë dhe herë në pjesë të tjera.

Kështu që mendoj që ne duhet t'i lëmë regjionalizmat, duhet t'i lëmë pjesët e inateve politike, por duhet t'i japim përkrahje investimeve që janë serioze dhe të cilat kanë ndikim zhvillimor dhe përfitojnë qytetarët dhe rajoni, sidomos që po flasim sot për pjesën e Dukagjinit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe një herë potencoj arsyen pse kjo marrëveshje këso lloj marrëveshjeje për infrastrukturë janë një ecje në drejtim të duhur, ndonëse po e them prej vitit 2008 ne jemi duke ndërtuar infrastrukturë, kontrata për të cilat nuk i kemi parë ende.

I nderuar kryeministër,

Është një vendim i gjykatës, i cili e obligon ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, që të bëjë publike kontratën me "Bechtel&Enka"-s për ndërtimin e autostradës dhe në përputhje ose, të themi, në krahasim me këtë lloj kontrate, kontrata të cilën na e keni sjellë këtu, marrëveshja për hua me BERZH-in është një ecje cilësore sa i përket financimit të infrastrukturës.

Pra, autostrada Zahaq-Kijevë na jep së pari një marrëveshje, të cilën mund ta lexojmë dhe të kuptojmë koston për ndërtimin e saj dhe, e dyta, po shpresoj shumë që edhe procesi i prokurimit për ndërtimin e kësaj autostrate do të përcjellë po këtë logjik që të shohim saktë dhe në detaje se sa na kushton dhe si janë këto implikime buxhetore.

Sa i përket kontratës për ndërtimin e autostradës Prishtinë- kufiri me Shqipërinë dhe Prishtinë - kufij me Maqedoninë, me anë të vendimit të gjykatës do të ishte tashmë edhe e lehtë edhe e arsyeshme që t'i bëni publike këto kontrata dhe të shohim se cili është implikimi edhe buxhetor, e cilat janë edhe obligimet kontraktuale që i ka secila palë.

Po e them edhe një herë, hiq më larg se javët e ardhshme do të na riparaqitet, rishfaqet problemi i 63 milionë eurove, pra kërkesat e "Bechtel&Enka" për vonesa apo për punë shtesë, dhe me që nuk i kemi parë këto kontrata, gjithsesi është edhe problematike të diskutojmë për shpenzimet e parave të buxhetit.

Pra, në këtë drejtim mendoj që e kemi një ecje të mirë dhe në këtë drejtim, me marrëveshjes e huas me BERZH-në, mendoj që është mënyra më e mirë për të financua projekte, qofshin ato edhe spitale, qofshin ato edhe projekte të tjera infrastrukturore.

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë e kisha bërë një ndërhyrje me mirëkuptimin tuaj, aktualisht i kemi mbi 60 deputetë, po na duhet një vendimmarrje.

Blerta Deliu-Kodra e ka një propozim, unë paraprakisht jam konsultuar me të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka të bëjë me Agjendën Evropiane të Reformave. Zonja Blertë, fjala për ju.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Ashtu siç e diskutuam edhe sot, kur e kishim pikë të rendit të ditës Planin e Punës së Kuvendit. Dje me kërkesën e kryetarit të Kuvendit, zotit Veseli, janë ftuar kryetarët e komisioneve të Kuvendit për të diskutuar për përshejtimin e Reformës së Agjendës Evropiane.

Kemi diskutuar detajisht lidhur me projektligjet që ne duhet t'i kryejmë, në mënyrë që t'i mbërrijmë afatet kohore. Ashtu siç jeni të informuar, në javën e dytë të muajit prill publikohet edhe Raporti i progresit për Kosovën dhe si Kuvend e kemi për obligim ta përshejtojmë këtë fazë të legjislacionit, në mënyrë që miratimi i ligjeve të bëhet me procedurë të përshejtuar.

Në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integritet, në pajtim me rekomandimet të cilat kanë ndalë nga takimi i djeshëm me kryetarin e Kuvendit, zotin Veseli, unë kam një propozim.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, me qëllim të përshejtimit të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve të parapara me Agjendën për Reformë Evropiane dhe raportin për vendin, e cila duhet të miratohet deri më datën 31 mars 2018, në seancën plenare të mbajtur më 23 mars të viti 2018 e merr këtë:

V E N D I M

Shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve të parapara me Agjendën për Reformë Evropiane, ERA dhe raporti për vendin, e cila duhet të miratohen deri më 31 mars 2018, të bëhen me procedurë të përshejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7, neni 57, paragrafët 3, 8, 9 dhe neni 64, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit si në vijim:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 06/L-032 për kontabilitet e raportim financiar dhe auditim do të bëhet në seancën plenare më 23 mars të vitit 2018.

Shqyrtimi i dytë i projektligjeve: Projektligji numër 06/L-011 për parandalim të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Projektligji numër 06/L-025 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit numër 03/L-225 për prokurorin e shtetit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin numër 05/L-034, Projektligji numër 06/L-021 mbi kontrollin e brendshëm të financave publike,

Projektligji për azilin, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt, Projektligji mbi mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, Projektligji për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, Projektligji për metrologji si dhe Projektligji për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit do të bëhen në seancë të veçantë plenare më 30 mars, në orën 14:00.

Amendamentet në Projektligjin nga pika 1.1 e këtij vendimi në Projektligjin numër 06/L-037 për metrologji dhe në Projektligjin numër 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit mund t'u adresohen komisioneve funksionale deri më datën 27 mars të vitit 2018.

Komisionet funksionale projektligjet nga pika 1.2 e këtij vendimi deri më 28 mars 2018 duhet t'i shqyrtojmë projektligjet dhe raportet me rekomandime t'ua paraqesin komisioneve të përhershme të Kuvendit të Kosovës.

Komisionet e përhershme deri më 29 mars 2018 duhet t'i shqyrtojnë projektligjet dhe raportet me rekomandime t'i paraqesin te komisionet funksionale dhe komisionet funksionale deri më 30 mars duhet t'i paraqesin raportet me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e përsëris edhe një herë, propozim-vendimi i Komisionit për Integritet Evropian bëhet vetëm me qëllim që t'i mbërrijmë afatet kohore, në mënyrë që këto projektligje të mos na adresohen si sfida të papërbushura në Raportin e Progresit për Kosovën, i cili publikohet në prill. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Kodra Deliu!

I falënderoj edhe deputetët për durimin.

A të shkojmë në votim të drejtpërdrejtë të këtij propozimi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë plenare.

Përgatitemi për votim, votojmë tani.

Dy deputete s'kanë kartela.

Atëherë, 67 deputetë kanë votuar, 66 për, një kundër, a ka ndonjë pa kartelë?

Konstatoj se Kuvendi vendosi që shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve të parapara me Agjendën për Reformë Evropiane ERA dhe raportin për vendin të bëhet me procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara në Rregulloren e Kuvendit.

Naser Rugova e ka fjalën, e vazhdojmë debatin.

NASER RUGOVA: Faleminderit! Unë dua të kthehem në pikën e rendit të ditës që e kemi përpara dhe paraprkisht dua të shpreh mbështetjen tim për kredinë për rrugën Kijevë-Zahaq.

Nën një, është një praktikë e mirë dhe më gëzon fakti që Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet kompetente të vendit kanë filluar një praktikë të tillë që në një farë forme të ndërtojnë infrastrukturën e nevojshme jo me para nga buxheti, jo edhe aq i pasur i shtetit të Kosovës, por të shkojnë me kredi të buta, të cilat në një ose në një formë tjetër, e lehtësojnë përmbushjen e nevojës së vendit tonë që të ketë një infrastrukturë konform trendëve bashkëkohorë që i kërkon edhe zhvillimi ekonomik, edhe ekonomia e tregut, besa edhe konkurrenca.

Nganjëherë më habit fakti se si njerëzit mund të vlerësojnë që një projekt i tillë të mos përkraket. Ju lutem, ende po na përcjell një mentalitet ballkanik dhe një logjikë provinciale.

Sa iu kemi gëzuar të gjithë autostradës Prishtinë-Tiranë, Rrugës së Kombit, Prishtinë-Shkup që gjithashtu është një arterie strategjike jo vetëm për Kosovën, por për komplet botën shqiptare. Sa iu kemi gëzuar fillimit të ndërtimit të autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë, i cili po ashtu lidh më tepër se Gjilanin dhe Anamoravën me kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, këtyre projekteve besoj që duhet t'u gëzohemi, duhet t'i mbështesim fuqishëm dhe duhet ta krijojmë një kulturë dhe logjikë tjetër, më emancipuese, në aspektin politik dhe nacional që në këto projekte, edhe pse shumë gjëra, koncepte, oferta politike dhe programe mund të na ndajnë, për aspekte zhvillimore dhe të interesit nacional duhet të jemi bashkë.

Andaj, ne që vijmë nga Rrafshi i Dukagjinit kur u nisim për atë drejtim dhe që bëhet fjalë për mbi 500 mijë banorë të shtetit tonë, kur vinim deri në Kijevë ishte çdo gjë në rregull, por disi çdo gjë na u ngushtonte kur arrinim të udhëkryqi i Kijevës dhe tani uroj që ky projekt të fillojë sa më shpejt dhe të ndërtohet në mënyrën më cilësore, sepse është nevojë imediate në interes shtetit, të atij regjioni, por edhe të zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

KRYETARI: Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar,
Kryeministër,
Kolegë të nderuar,

Po më duket që ka ardhur koha që tani të flasim për zhvillimin ekonomik, shyqyr që u krye ajo pjesa problematike, shumë politike dhe është një moment i lumtur që ne i jemi kthyer zhvillimit.

Ne fuqishëm e përkrahim këtë projekt, aq më shumë kur është në një kredi të butë, duke marrë parasysh, unë si qytetar i periferisë së Prishtinës që ka 6 kilometra prej Prishtinës ju betohem që sot nëse nisesh deri në Hajvali bën rrafsh 40 minuta të mbërrish dhe e kuptoj rëndësinë e një rruge, aq më shumë të një rruge shumë të rëndësishme, e besoj që edhe rrugë të tjera, dhe i bëj thirrje Qeverisë në përgjithësi, infrastrukturës, të gjitha rrugët që janë të nevojshme t'i përkrahim, këtu duhet të bisedojmë.

Me të vërtetë është e mirë, shpresoj që edhe ato planet e tjera të mos mbesin apo të mos ngadalësohen. Ne do t'u japim përkrahje të fuqishme dhe sigurisht nëse bëhen edhe kontratat publike, do ta ndajmë kohën ne si deputetë t'i përcjellim këto punë a janë duke shkuar mirë dhe përkrahja jonë do të jetë. Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Kjo marrëveshje ndoshta ishte dashur të kalojë në një frymë tjetër, por nuk po e kuptoj pak a shumë ndërhyrjen e kryeministrit në këtë temë dhe në këtë formë.

Unë seriozisht nuk po e kuptoj pse në vend që sot të kishte festë, që Dukagjini po lidhet me një autostradë, po duket që goxha nervoz paska ardhur në Kuvend, përkundër meje që goxha i qetë jam në këtë rast, edhe për çka jam i gatshëm të diskutoj edhe për ato që i përmendi kryeministri.

Por, dua t'i them Ramushit, keq e ke, e ke keq edhe kur përmende 15-katëshen, sepse unë e ti kurrë nuk jemi takuar në 15-katëshe, jemi takuar në Gllogjan, Jabllanicë e nëpër luftë.

Po ashtu, sa i përket asaj se s'më ka hyrë asnjë therë në këmbë, unë besoj që nuk të vjen keq për këtë punë, mua s'më ka hyrë asnjë therë, po shumë thera i kemi kaluar bashkë, ama.

Nuk e di sa thera i kanë hyrë Hashimit, me të cilin tash je në koalicion ti, por thera kemi kaluar bashkë unë e ti.

Kurse sa i përket në jam mençur, po, po duket se goxha i mençur jam, e sidomos në momentin kur unë nuk e kam votuar Qeverinë tënde, sepse po ta kisha votuar Qeverinë tënde, do të ndihesha përgjegjës për ato çfarë ka ndodhur, e më së shumti përgjegjës për ato çka kanë ndodhur pardje.

Kryetari po më bënë me shenjë që të kthehem në temë, edhe unë do të doja të isha në temë, por gjithsesi kjo temë edhe një herë, me që mori gjithë mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, me që mori gjithë mbështetjen e Parlamentit dhe besoj që ta ketë mbështetjen edhe këtij projekti i

gëzohen të gjithë banorët, unë mendoj që sot kryeministri do të duhej të ishte më në disponim dhe t'i gëzohej këtij projekti, e jo të vinte me kaq nervozë në Parlamentin e Kosovës.

Megjithatë, kryeministër, urime për këtë projekt për Dukagjinin.

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër, u kthjem në temë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Nëse bën, Rexhë, të kishe thënë që ky fitoi këtë, ky fitoi këtë, e Ramushi marrën, nuk kisha reaguuar sot. Po ti ke thënë për pak ditë pushtet, Rexhë, nuk di pse të ka shkuar mendja veç te pushteti. Po, s'di pse ke thënë, ke mund të thuash marren, diçka tjetër, çka të duash.

Ti e di, Rexhë, nëse s'e di, ndoshta atëherë unë nuk jam në rregull.

KRYETARI: Kryeministër, po të ndërhyj, a të kthehem në temë, të lutem.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: A je i sigurt që për pak ditë pushtet e kam bërë atë, Rexhë. Jo, nëse je, a je i sigurt?

KRYETARI: Kryeministër, me respektin e luftës bashkë, të kthehem në temë, të lutem. Faleminderit!

Shqipe Pantina, të lutem, jemi në përfundim.

SHQIPE PANTINA: Unë e kam lidhur me temën, do të thotë, lidhur me kontratën për ndërtimin e rrugës, gjegjësisht autostradës Kijevë-Zahaq.

Përveç publikimit të kontratës, do të ishte mirë dhe po më vjen keq që nuk është ministri Lekaj këtu të publikohej edhe projekti, gjegjësisht drejtimi nga do të kalojë ndërtimi i autostradës, sepse besoj edhe vetë ministri është informuar, se ka pasur pakënaqësi të mëdha të banorëve të disa fshatrave, nëpërmes të cilëve do të kalojë ndërtimi i kësaj autostrade, me shqetësimin se rruga e re do të marrë një numër të tokave bujqësore, përderisa ka pasur mundësi të kalonte përmes një shtegu tjetër, e ku do të kishte më pak dëme sa u përket tokave bujqësore.

Kështu që po besoj se ministri Lekaj i ka parasysh të gjitha këto kërkesa, por edhe vërejtjet e qytetarëve dhe për sa është e mundur, të merren parasysh kërkesat e tyre dhe ne, edhe ashtu kemi pak tokë bujqësore, pa dashur tash t'i kthehem temës se sa kemi humbur apo s'kemi humbur, kjo është një temë tjetër, po të paktën që këtë pjesën që e kemi brenda kufijve, e që është tokë bujqësore, të mos e kthejmë të gjithën në beton e asfalt, sepse do të humbin edhe gjenerata që vijnë pas nesh.

Kështu që unë edhe një herë i lutem kryeministrit, por edhe ministrit Lekaj që ta kenë parasysh, t'i kenë parasysh vërejtjet e banorëve të disa fshatrave mes Kijevës dhe Klinës, të cilët janë të shqetësuar me humbjen e tokave bujqësore. Faleminderit!

KRYETARI: Lumir Abdixhiku, ndërkohë ministri e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Po drejtohem në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, meqenëse u ngritën në disa çështje rreth kredisë.

E para punë, kjo kredi është punë e disa qeverive, e disa ministrave dhe ka kulmuar sot dhe bën shembullin më të mirë se si duhet të ndërtohen rrugët në Kosovë, po në qoftë se deri tash kemi pasur kritika për mënyrën e financimit të rrugëve është sepse ato rrugë janë ndërtuar prej parave të buxhetit, ndërkaq kredia në fjalë e liron buxhetin prej kostove të tilla.

Të keni parasysh, bëhet fjalë për një kredi me kosto të interesit prej 1% dhe për secilin ekonomist 1% është inflacion. Pra, për 15 vjet do të transferohet kosto shtesë në inflacion.

Por çështja që del prej kësaj marrëveshjeje është e ndërlidhur me autostradat e mëparshme të ndërtuara në Kosovë.

Pra, autostrada Kijevë-Zahaj do t'i ketë 33 kilometra dhe kosto totale do të jenë rreth 200 milionë euro. Pra, do të paguajmë rreth 200 milionë euro për 33 kilometra, sa e mbaj mend 71 milionë euro janë nga BERZH-i, 80 milionë euro nga Banka Investive, 6 milionë euro janë procesi i Berlinit edhe 30 milionë euro do të jenë nga Qeveria e Kosovës, nga buxheti i vendit.

Dhe një autostradë e re, e ndërtuar me 6 milionë euro për kilometër, kur vihet në krahasim me autostradat e deritanishme, është përgjysmë më e lirë.

Pra, në qoftë se autostradën për Shkup dhe autostradën për Morinë e kemi ndërtuar në kosto totale prej 1.5 miliardë eurove dhe në kosto për kilometër prej 12 milionë eurosh, pyetja që duhet bërë në është çfarë ndodhi tash që paguajmë një kilometër 6 milionë euro apo përgjysmë?

Pra, kur marrim kredi prej institucioneve financiare ndërkombëtare, kosto e kilometrit është 6 milionë euro, kur e ndërtojmë me para të buxhetit të Republikës, kosto e kilometrit është 12 milionë euro. Pra, po flasim për një shpërputhje të theksuar.

Përndryshe, edhe një herë po themi, edhe si Lidhje Demokratike e Kosovës, por edhe si komision e kemi mbështetur një qasje të tillë dhe inkurajojmë Qeverinë që të vazhdojë me kredi të tilla

edhe për autostrada të tjera që duhet të përfundohen, edhe atë për Mitrovicë, edhe për Podujevë, e kështu me radhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë Vetoni e ka një sqarim, me aq sa po e shoh reagimin dhe ministër, menjëherë fjala për ju. Te Vetoni, Emilija Rexhepi e ka kartelën, ta keni parasysh.

VETON BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj falje, po ne si grup i vogël kështu po i përziejmë edhe kartelat nganjëherë.

Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Normalisht çështje në fjalë, pa dashur të reflektojmë lokalizëm, po ne që reflektojmë këtë rrugë vërtet po i gëzohemi këtij vendimi, kësaj marrëveshjeje, sepse është një segment jashtëzakonisht i rëndësishëm qoftë ekonomik, qoftë për çfarëdo fushe tjetër dhe përnjëmend e lehtëson qasjen tonë, Dukagjinin në raport me kryeqendrën.

Dhe, më vjen mirë që ka gjetur rrugë dhe aq më tepër kur nuk preket buxheti i Kosovës dhe ka zgjidhje të tjera të mira.

Shpresoj që sa më parë të fillojë dhe të gjejmë zgjidhje.

Po në të njëjtë kohë, nuk e di se deri në çfarë mase ka shkuar pjesa e segmentit Zahaq-Pejë, pjesa e vazhdimit, sepse vërtet ajo rrugë tash është në një gjendje të pezulluar, ka 3-4 vjet që vetëm në këtë segment punohet dhe vërtet punohet në tempo shumë të vogël dhe, me sa e di unë, e kemi pasur edhe ministrin Zharku se ka qenë ministër kemi pasur shpesh debate rreth planit të përdorimit të asaj rruge dhe qasjes të banorëve në këtë rrugë, domethënë kemi pasur shumë probleme rreth hyrjes dhe qasjeve dhe besoj që ky segment Kijevë-Zahaq dhe Zahaq-Pejë do të jetë në publik dhe të diskutohet me publikun për ecurinë e kësaj rruge.

Kështu që edhe një herë e falënderoj kryeministrin, ministrin, për marrjen e këtij vendimi dhe besoj që e lehtëson shumë jetën tonë atje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri i Financave e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'ju falënderoj për mbështetjen për këtë projekt të rëndësishë së veçantë, mund të jetë e ditur, por vetëm po e jap si informacion shtesë se të gjitha procedurat e prokurimit do të bëhen në përputhje me rregullat dhe kërkesat e IBRD-së, gjë që garanton që do të ketë transparencë dhe do të jetë në përputhje me standardet që i rregullon kjo fushë. Prandaj, edhe sa i përket dizajnit teknik edhe studimit të fizibilitetit, është bërë sipas kërkesave të IBRD-së dhe besoj që është një risi në raport me të gjitha projektet paraprake.

KRYETARI: Faleminderit!

Do të futemi në procedurën e votimit, ku duhen 2/3 e gjithë deputetëve, se është për marrëveshje ndërkombëtare, në momentin kur ta kemi numrin e deputetëve.

Vazhdojmë me pikat e radhës, projektligji të cilin tani do ta paraqes para jush është ai i cili e votuat pak më herët për lexim të parë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontabilitet dhe raportim financiar dhe auditim

Ky projektligj ndërlidhet me Agjendën e Reformave Evropiane.

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Financave, zoti Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Për Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, në qoftë se nuk je i gatshëm, për arsye se tani ndodhi menjëherë. Driton, a po e merr fjalën? Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 i Rregullores të Kuvendit, Komisioni Funkcional për para shqyrtimit të parë në mbledhjen plenare e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime. Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 56 të Rregullores së Kuvendit për procedim dhe shqyrtim të parë, si dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Po ashtu, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike vlerëson se ky projektligj, bazuar në qëllimin dhe fushëveprimin e tij i takon për shqyrtim dhe amendamentim Komisionit për Buxhet dhe Financa. Prandaj, ne ju rekomandojmë që ta miratoni në parim, por pas këtij leximi ky projektligj të shkojë dhe të trajtohet si Komision Funkcional të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, ta keni parasysh e futëm tani befasisht...

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Është një prej projektligjeve që garanton rritjen e disiplinës financiare, garanton rritjen e transparencës, avancimin e kësaj fushe dhe prezantimin e pasqyrave financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, por mbi të gjitha është i rëndësishë së veçantë, sepse është pjesë edhe e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe besoj që pas diskutimeve dhe kontributit që do të ndodhë në Kuvend, ne do të kemi një ligj i cili i plotëson standardet dhe është në përputhje me rregullat e direktivat e BE-së dhe ‘acquis communautaire’. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina, në emër të grupeve parlamentare, e vetmja ka kërkuar fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Edhe ne e kemi shqyrtuar Projektligjin dhe në parim e mbështetim, por unë e mora fjalën po ashtu për ta mbështetur kërkesën e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrje Financiare, ku kam qenë anëtare, sepse ky projektligj do të duhej të shqyrtohej nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse ata janë më të thirrur sa i përket kësaj fushe, kështu që e mbështes dhe ne e mbështetim edhe kërkesën e kryetarit të komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në proces votimit, pasi nuk ka të tjerë për deklaram. Do ta votojmë, presim që të rikthehen kolegët deputetë janë dhjetë deputetë, të cilët tani vijnë janë në takim me homologët e tyre nga një vend përëndimor, dhe menjëherë e vëmë në votim.

Do të presim, pasi jemi veç në proces të votimit, se është shqyrtimi i dytë që ta kemi numrin e nevojshëm brenda sallës. Nuk po bëjmë fare pauzë, po presim këtu brenda sallës.

Administrata, kisha kërkuar, ju lutem mirëkuptim! A është në rregull? Shkojmë te shqyrtimi i raportit.

11. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015-2016

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015-2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, urdhëro ministër, fjala për ju! Ministri Lluka e paraqet raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015-2016.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot i keni për shqyrtim dokumentet që e japin një pasqyrë për gjendjen e një fushe tejet të rëndësishme që është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, pra për ndërmarrjet publike.

Shumica nga këto ndërmarrje janë me rëndësi të veçantë, meqenëse ofrojnë shërbime vitale për popullatën, siç është sektori i ujërave, mbeturinave, energjia, telekomi dhe çdo gjë tjetër. Por, fatkeqësisht, pothuajse të gjitha ndërmarrjet ballafaqohen me probleme serioze dhe domosdoshmërisht duhet të bëhen ndryshime. Ndonëse këto raporte i takojnë një të kaluarë jo shumë të largët, meqenëse paraqesin gjendjen për vitet 2015 dhe 2016, megjithatë ofrojnë mjaft të dhëna për trendet, të cilat fatkeqësisht kanë vazhduar edhe në vitin 2017, ngjashëm.

Më duhet të them se raportet kanë qenë të gatshme brenda afatit ligjor, mirëpo për shkak të zhvillimeve të përgjithshme në vend, ato nuk kanë mundur të miratohen deri më tani.

Të nderuar,

Më lejoni që në pika të shkurtra ta paraqes një pasqyrë të gjendjes së ndërmarrjeve publike. Në përgjegjësinë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik janë 16 ndërmarrje publike të nivelit qendror dhe regional. Performansa e tyre është në rënie në përgjithësi, përpos për pesë prej tyre, kanë munguar masat adekuate për ndryshimin e saj, përkatësisht që duke reduktuar shpenzimet, e duke e rritur vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve ta përmirësojnë edhe efikasitetin e vet.

Në vitin 2016, në total shpenzimet kanë qenë për 29 milionë euro më të larta se të hyrat, dhe pikërisht në ndërmarrjet me probleme, përkatësisht me humbje është rritur numri i punëtorëve dhe i shpenzimeve. Në vitin 2015, me humbje kanë punuar nëntë kompani, ndërsa në vitin 2016 dhjetë kompani. Përkundër kësaj situate, nëpër këto ndërmarrje ka vazhduar komoditeti normalisht dhe anëtarët e Bordit vazhdimisht kanë pasur shpenzime të ndryshme, duke u shpërblyer edhe me bonuse.

Të nderuar deputetë,

Brenda këtyre pak muajve jemi munduar të ndërmarrim masa me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme. Po ju them sinqerisht që nuk është lehtë për shkak se problemet janë shtresuar me vite të tëra. Pasi e kemi analizuar gjendjen, fillimisht kemi marrë disa vendime për reduktimin e shpenzimeve, kemi marrë masa në ndalimin e bonuseve nga anëtarët e Bordit dhe shpenzimeve pa ndonjë arsyetim të duhur.

Të nderuar deputetë,

Nga kjo seancë pres që të miratohen këto raporte, por edhe propozimet, sugjerimet do të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes të këtyre ndërmarrjeve. Ndërkaq, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, brenda kompetencave që kemi, do të intervenojmë me masa aty ku është e

nevojshme. Po ashtu, brenda afatit ligjor para jush do të gjendet edhe raporti i performansës për vitin 2017. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Bilall Sherifi, të lutem!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Por, meqë asnjë anëtar tjetër i komisionit nuk qenka këtu, më lanë fjalën mua, por komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka përcjellë në seancë dhe i rekomandon seancës ta kalojë këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit Hykmete Bajrami, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Zoti ministër,

Të nderuar qytetarë,

Raporti i performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015 së bashku me raportin e performansës për vitin 2016 është trajtuar në Qeveri më 20 dhjetor 2017, dhe siç po e shohim sot, më 23 mars të vitit 2018, po trajtohet në Kuvend, pra në të dyja rastet me shumë vonesë.

Sipas raportit që e kemi përpara dhe sipas raporteve respektive për secilën ndërmarrje nga Auditori i Përgjithshëm, performansa e ndërmarrjeve publike, siç e tha edhe vetë ministri, nuk është aspak e kënaqshme. Nga 16 ndërmarrje publike, dhjetë prej tyre operojnë me humbje, ndërsa Aeroporti i Gjakovës nuk është fare funksional. Raporti që e kemi para vetes, ndër të tjera, paraqet performansën edhe sipas sektorëve, ku shihet se gjatë periudhës raportuese, është sektori i energjisë i cili ka pasur një rritje të lehtë në gjenerim dhe rritje të nxjerrjes së limitit dikur rreth 7%, sektori i telekomunikacionit është sektori që prin me gjenerim të humbjeve prej rreth 31 milionë euro, e kjo sipas të dhënave që kemi marrë nga menaxhmenti, sepse këtu nuk kemi raport të Auditorit të Përgjithshëm për shkak se Bordi nuk ka qenë funksional dhe si të tillë Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk e ka marrë parasysh raportin e Auditorit, pasi ky raport nuk ka mundur të aprovohet nga Bordi i Drejtorëve.

Faktet tjera që ne i kemi para vetes, e që në fakt nuk janë pjesë e raportit, është që Telekom i Kosovës me rreth 3 000 punëtorë, ka vetëm 76 milionë euro të hyra dhe ka diku rreth 60% të tregut, ndërsa operatori privat IPKO vetëm me rreth 450 punëtorë dhe 35% të tregut i ka po të njëjtat të hyra. Domethënë shihet qartë se kemi të bëjmë me keqmenaxhim të kësaj ndërmarrjeje. Kur jemi te Telekom, i cili ka gjeneruar humbjen më të madhe, duhet të theksohet se kemi rënie të vazhdueshme të numrit të konsumatorëve shfrytëzues të telefonisë fikse dhe mobile, të internetit dhe të shërbimeve të tjera.

Kjo është gjendja e Telekomit në vitin 2015 dhe në vitin 2016. Sot gjendja në Telekom është edhe më e rëndë dhe ne edhe si anëtarë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik kemi kërkuar nga ministria që të reagohet sa më shpejt. Gjendja nuk është aspak më e mirë as në Postën e Kosovës. Ne e kemi parë menaxhmentin e Postës, i cili para disa ditëve ka dalë publikisht dhe ka thënë se ata nuk do të jenë në gjendje që brenda një periudhe të shkurtër kohore t'i paguajnë as pagat e punëtorëve. Atë çfarë ne e dimë është që Posta e Kosovës pjesën më të madhe dhe stabile të të hyrave e ka nga qiraja që merr nga Telekom i Kosovës, ndërsa rreth 90% e shpenzimeve operative të Postës janë pagat e punëtorëve. Pagat sikur te Telekom i dhe te Posta e Kosovës janë mbi mesataren e secilës ndërmarrje publike, por edhe private në Kosovë, ndërsa performansa e të dyjave është tepër e dobët.

Sipas raportit që e kemi para vetes te sektori i ujit, siç e dini janë shtatë kompani rajonale, prej të cilave marrin shërbime rreth 1,5 milion banorë, apo rreth 91% e popullsisë. Pjesa tjetër janë ujësjellës ruralë, të cilët thuhet që po planifikohet që së shpejti të inkorporohen në ujësjellësit rajonalë. Edhe faturimi dhe menaxhimi i ujërave në përgjithësi është tepër shqetësues. Faturimi i ujit është 44%, ndërsa inkasimi është 86%, që me një kalkulim të thjeshtë i bie që vetëm 38% e qytetarëve të Kosovës, të cilët shërbehen nga ujësjellësit rajonalë, në fakt paguajnë për shërbimin që e marrin, në këtë rast për ujin të cilin ata e shpenzojnë.

Mbulimi me ujëmatës për konsumatorët shtëpiakë ka mbetur në 92% dhe në këtë aspekt prin Prishtina me 97%, ndërsa Mitrovica mbetet vetëm me 64%. Kur jemi te Mitrovica duhet të theksojmë se është problematik i Ujësjellësi i Mitrovicës, sepse diku rreth 40% e ujit që prodhohet nga Ujësjellësi i Mitrovicës distribuohet në Veri dhe për atë ujë nuk paguhen fare faturat. Në fakt, këtu ndodh e njëjta situatë sikur ndodh me energjinë elektrike. Qytetarët e Veriut të Mitrovicës nuk e paguajnë ujin, siç nuk e paguajnë as energjinë elektrike, e cila doli të jetë komplet jashtëligjore, por kjo pagesë bëhet nëpërmjet subvencioneve nga Buxheti i Shtetit, gjë për të cilën duhet të reagojmë shpejt. Sikur edhe në rastin e energjisë, sepse edhe tek energjia kryeministri vetëm e ka marrë një vendim që në fakt ajo çka e kemi hequr nga faturat e qytetarëve, që ishte komplet joligjore, tanimë të paguhet nga Buxheti i Kosovës, që në fakt është e njëjta gjë.

Ne si grup parlamentar jemi në përgjithësi të pakënaqur me performansën e ndërmarrjeve publike dhe jemi të pakënaqur me masat e munguara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, mungesa e përgjegjësisë totale të bordeve, menaxhmentit ndaj bordeve dhe mungesa e bordeve, në përgjithësi. E kemi një numër të ndërmarrjeve tani që nuk kanë borde dhe kërkojmë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që plotësimi i bordeve të bëhet sa më shpejt, në mënyrë që ato t'i zgjedhin menaxhmentet, sepse ka mungesë dhe me ushtrues detyre performansa vetëm sa do të bjerë.

Me këtë trend të performansës, brenda një periudhe të shkurtër kohore nuk do të ketë asnjë ndërmarrje publike në fakt, e cila do të jetë e vetë qëndrueshme. Të mos flasim këtu për ndërmarrjet publike profitabile dhe njëkohësisht duke i subvencionuar nga Buxheti i Shtetit këto shërbime po bëhen shumë të shtrenjta për qytetarët e Republikës së Kosovës. Janë dy arsye për çka duhet të ekzistojnë ndërmarrjet publike. E para, që shërbimi t'u ofrohet qytetarëve më lehtë sesa nga operatorët privatë dhe arsyeja e dytë është aty ku nuk ka interes që të hyjë kapitali privat, e në shumicën nga këto faktikisht kanë humbur këto dy arsye.

Ne kërkojmë nga Qeveria, respektivisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik që ta sjellë sa më shpejt një strategji për nxjerrjen nga situata të gjendjes në të cilën janë ndërmarrjet publike dhe gjithashtu kërkojmë që të zgjidhen sa më shpejt bordet dhe të mos politizohen ato. Është mirë që të angazhohemi të gjithë së bashku që faktikisht ta ruajmë vlerën që ka mbetur në ndërmarrje publike, por edhe të kujdesemi që ta kthejmë vlerën që ato dikur e kanë pasur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Besoj njëjtë, sikur edhe grupet tjera parlamentare, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe pas debateve të gjata dhe të diskutimeve të detajuara dhe të thukëta për këto raporte të viteve 2015 dhe 2016 ka vendosur që ta mbështesë këtë raport dhe ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,
Ministra të Qeverisë,

Ndërmarrjet publike në Kosovë e kanë pasur një menaxhim, i cili sikur e ka dashur bankrotimin e tyre. Vetë raportet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e tregojnë këtë gjendje të rëndë, ku shihet që kompanitë të cilat dikur qarkullonin qindra miliona euro, sot janë në një rënie të lirë drejt kolapsit. Duke pasur parasysh këtë gjendje të rëndë, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar e pati ofruar një asistencë për zgjedhjen e bordeve profesionale, të cilën e nënshkroi kryeministri dhe e përkrahu publikisht kryeparlamentari.

Mirëpo, tre muaj pasi filloi ky proces i përzgjedhjes së bordeve, britanikët u tërhoqën. Ky pushtet vazhdon të na i çajë veshët për marrëdhëniet e mira me miqtë tanë ndërkombëtarë, por kur ata eventualisht propozojnë ndonjë masë që prek interesat e këtyre, pushtetarët kosovarë i sabotojnë këto marrëveshje. Marrëveshjen që e nënshkruan ambasadori britanik Ruairi O'Connell dhe kryeministri Haradinaj, e kanë sabotuar në terren struktura të përbashkëta të partive në pushtet.

Zyrtarët e Ambasadës Britanike, në janar të këtij viti, kanë pranuar se janë tërhequr nga Komisioni për emërimin e anëtarëve të Bordit të “Trepçës” me kërkesë të Qeverisë së Kosovës.

Në anën tjetër, bordeve të kompanive tjera kryesisht u vazhdohej mandatet për anëtarët që janë përfaqësues direkt të partive në pushtet, ose thjesht plotësohen me anëtarë që përfaqësojnë partitë që rishtazi hynë në Qeveri. Prandaj, në themi se pushteti në shtetin e kapur nuk është qeveri, por regjim. Këto borde nuk punojnë sipas praktikave të mira dhe as s’emërohen sipas principeve të OECD-së, një organizatë që kërkon pavarësi dhe profesionalizëm në menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Këto borde i kanë shndërruar kompanitë publike në kompani të farefisit e të bashkëpartiakëve të qeveritarëve. Mbi punësimet partiake i kanë rënduar tejet shumë këto kompani dhe po i shpijnë ato drejt implodimit.

Që prej se kompanitë publike kanë kaluar në kompetenca të plota të Qeverisë së Kosovës, ato nuk kanë parë përparim dhe janë gërryer e rrjepur me shpejtësi. Në emër të këtyre kompanive janë nënshkruar kontrata dhe firmat e grupet e interesit që kanë gjymtuar mundësitë e ndërmarrjeve publike. Shembulli më tipik për këtë është imponimi i kontratës me Z-Mobile, për llogari të Devollëve, të cilët e kontrollojnë një pjesë të mirë të politikës dhe medias së afërt me pushtetin.

Bordet e kompanive publike sot janë tërësisht të orientuara, jo në përmirësimin e performancës së bizneseve që u prijnë, por në përdorimin e këtyre ndërmarrjeve për llogari të partive që u takojnë, ose grupeve të interesit që u shërbejnë. Për shembull, dikur kompania më fitimprurëse në Kosovë, Telekomit i Kosovës, e ka të vështirë t’i paguajë pagat, e Buxheti i Kosovës dikur vilte fonde prej dhjetëra miliona eurosh dividendë për buxhet. Mandati i drejtorit menaxhues të Telekomit ka kaluar, e Bordi dhe as Qeveria nuk kanë qenë në gjendje t’i përcjellin procedurat për zëvendësimin e tij, sepse janë duke u përplasur ndërmjet vete se kush do t’i punësojë anëtarët e partisë së vet.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues në PTK u emërua Nuredin Krasniqi para një jave, një njeri i njohur për manipulimet me Bankën Kreditore dhe me fondet e 3%-shit. Të tillë njerëz prijnë në kompanitë tona sot. “Trepçën” e kontrolloi për një kohë të gjatë Ferat Shala, që ishte një zëvendësues i SHIK-ut, Aeroportin e ka menaxhuar për një kohë të gjatë, po ashtu një njeri i afërt me SHIK-un dhe deri më tani drejtor i Telekomit, Agron Mustafa. Këta njerëz shkëmbehen nga një kompani te tjetra, kurse përgjegjësi nuk guxon t’u kërkojë kush, sepse janë më të fortë se bordet.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës u proklamua se u bë aeroporti më modern dhe për këtë u bënë përpjekje të ngjarje festive. Mirëpo, shumë vjet pas dhënies së tij me koncesion, me një terminal të ri, Aeroporti deklaroi të ardhura më pak se në kohën kur ishte i përmirësuar. Këtu ashiqare janë duke u fshehur të ardhurat, sepse ka raste kur Aeroporti deklarohet se merr qira 30

euro në muaj për lokalet që bëjnë biznes në hapësirat e kësaj ndërmarrjeje. Kjo kompani, sipas kontratës për koncesion, është supozuar të paguajë një përqindje që fillon në 27% dhe ngrihet deri afro 40%, por me një manipulim klasik kontabiliteti, sot të hyrat e kësaj kompanie pas koncesionimit deklarohen si shumë më të ulëta se kur ishte në pronësi të plotë publike.

Është për të të ardhur keq fakti që ne sot diskutojmë për raportet e performancës së ndërmarrjeve publike qendrore për vitet 2015 dhe 2016, sot që data është 23 mars 2018. Pra, po flasim për realitetet e para dy, respektivisht tre vjetëve. Megjithatë, në qoftë se kalon nëpër raporte vërehen mosarritjet financiare, të performancës menaxheriale dhe shkatërrim i pasurisë publike. Me fjalë të tjera, shumica e ndërmarrjeve publike kanë përfunduar në saldo negative, humbje të pasurisë apo zhvlerësim të aseteve dhe male aferash në aspektin e menaxhimit. E për të qenë edhe më keq se kaq, edhe shërbimet e ofruara të këtyre ndërmarrjeve që në thelb është edhe misioni i tyre parësor, karakterizohen me plot dështime apo ulje drastike të nivelit të shërbimeve. Këto dështime ndodhin në vazhdimësi edhe në ditët e sotme kur këto shërbime ndërpriten apo ulen në minimum, për shembull para një kohe u ndërpre transporti i udhëtarëve në Hekurudhat e Kosovës, Telekomit i Kosovës prej ndërmarrjes shumë profitabile tash rrezikon rrogat e punëtorëve etj.

Gjendja në këto ndërmarrje, funksionimi i tyre është shëmbëlltë e realitetit ekonomik në Kosovë. Këtë më së miri e pasqyron vetë raporti në fjalë i përpiluar nga MZHE-ja, i cili në një mënyrë e vlerëson performancën si negative për shumicën e ndërmarrjeve publike. Ne vetëm mund ta paramendojmë çfarë këto raporte nuk thonë. Qytetarit të Kosovës nuk i interesojnë raportet e stërvonuara të MZHE-së, por i interesojnë shërbimet dhe të mirat e përgjithshme që duhet të vijnë nga këto ndërmarrje. Problemet me furnizim me energji elektrike, të furnizimit me ujë, ndërprerja e sinjalit telefonik, shërbimet e dobëta të transportit “TrainKos” janë pasqyrë e saktë e gjendjes faktike që mbizotëron.

Ne e dimë edhe prej medieve, edhe prej proceseve gjyqësore, se e gjithë puna e këtyre ndërmarrjeve përfshin skandale pa fund. Raportet e MZHE-se vetëm sa konfirmojnë qasjen e institucioneve ndaj ndërmarrjeve publike në përgjithësi që nga mbarimi i luftës e deri tash, e që është eksploatim i egër i pasurive dhe potencialeve të tyre deri në arritjen e qëllimit final, që është shkatërrimi i publike e kalimi në private për hir të privatëve me emra të përveçëm. Raportet nxjerrin në pah mangësi të shumta në planifikimet dhe raportimet operative dhe financiare. Por, shkakut që ndodhin këto mangësi është se në pozita kyçe udhëheqëse nuk janë njerëzit në bazë të kualifikimeve dhe përgatitjeve profesionale, por janë kandidatë që janë pranuar në punë “pa kurrë”, kandidatë që janë përzgjedhur me biseda telefonike ndërmjet protagonistëve të aferës “Pronto”, e disa prej këtyre aktorëve i kemi edhe tani këtu në Parlament.

Nga raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2015, shihet se nga 16 ndërmarrje publike, vetëm 2 prej tyre kanë shënuar përmirësim, 8 kanë vendnumëruar, ndërsa 6 kanë degraduar nga viti

paraparak. Sa u përket të hyrave në ndërmarrjet publike për vitin 2016, ato janë 7% më pak se në vitin 2015, kurse shpenzimet janë rritur për 1,9%. Të hyrat më të vogla, shpenzimet më të mëdha, e dëshmojnë qartë që qëllimi është futja në greminë e ndërmarrjeve publike dhe bankrotimi i tyre para privatizimit të tyre.

Katër pyetje janë themelore për këto raporte:

1) Raportimi është me vonesë, një vit respektivisht 2 vjet. Normalisht edhe korporatat multimiliardëshe raportojnë 3-4 muaj pas mbylljes së vitit. Pse nuk është përpiluar edhe raporti për vitin 2017?

2) Gati të gjitha bordet e ndërmarrjeve qendrore e kishin shpërblyer veten me bonuse. Mbi çfarë baze ndajnë bonuse bordet e kompanive, të cilat e mbyllin vitin me humbje, e në anën tjetër kërkojnë subvencione nga Qeveria, si puna e Postës e Telekomit?

3) Përderisa neto fitimi i KEDS-it dhe KESCO-s arrin 30 milionë euro në vit, pse KEK-u ka vetëm 8 milionë euro fitim? Si është e mundur që prodhuesi fiton më pak se tregtari?

4) A është shkarkuar deri më tani ndonjë anëtar Bordi për mospërbushje të detyrave, e është më se e qartë që kemi mospërbushje të tyre kur shumica e kompanive punojnë me humbje? Është qesharake se si në fund raporti rekomandon që të themelohet një institut që do të merrej me trajnimin e anëtarëve të bordeve.

Përveç veprave penale, zgjidhja është strukturore, për bindjen time të fuqishme është kjo: ta krijojmë Fondin Sovran, që e lidhim me Kuvendin e Republikës, me ç'rast ndërmarrjet publike ia marrim Qeverisë, ndërmarrjet shoqërore ia marrim Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Bordi emërohet dhe i jep llogari Kuvendit të Republikës, ndërkaq kryeshefi i një fondi të tillë sovran, i cili e ndërpret privatizimin dhe mundëson shitjen e aksioneve është një person profesionalist, apartiak, apolitik, i cili ka përvojë në tregjet globale e në financat ndërkombëtare. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Kuvendit.

KADRI VESELI: Faleminderit!

Unë po e marr fjalën, pak është si reagim Albin, por po e shfrytëzoj edhe fjalën në të njëjtën kohë. Armik nuk të kam, as nuk dua të të kem kurrë, të respektoj në çdo aspekt, por nuk më pëlqen se nganjëherë tepër shumë e ke profesionalizuar metodën e luftës politike në kuptimin pozitiv-opozitiv. Nuk duhet çuar në skajshmëri se njerëzit mendojnë se çdo gjë është veç bardh e

zi. Edhe po të jetë krejt zi nga ne, e të jetë te ti veç bardh, për besë nuk është e mirë. Edhe të arrish goxha me absolutizëm në fitoren tënde politike, nuk është e mirë. Ka një legjitimitet kontestimi i të arriturave. Pastaj edhe përdorimi i figurave, nganjëherë përdoren disa figura në kuptimin e asaj për ta goditur kundërshtarin, por ka edhe një moral edhe në atë aspekt.

Ajo që është morali më i madh është të preket pak realiteti dhe të qenën më afër gjërave të vërteta. Kjo ishte arsyeja, do të dal nga fundi, që më nxiti në kuptimin e këtij reagimi për të qenë i drejtpërdrejtë ndaj jush, në kuptimin e fjalimit tuaj, jo ndaj jush, kërkoj falje. Është i vërtetë një fakt, situata ekonomike, të cilën e kemi trashëguar, edhe sociale, por pas shekujve robëri, Kosovën s'e ka bërë një vend të zhvilluar që të jetë sikur Zvicra e Gjermania për të hyrë të gjithë në punë. Edhe kjo e ka krijuar një presion. Ti Albin duhet ta pranosh që sikur te ne, sikur në LDK kur kemi qenë bashkë, sikur tash në Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, në "Nismë", ka një presion nga të gjithë ne. Problemin më të madh e kemi papunësinë. Edhe te çështja e rekrutimit të njerëzve të papunë.

Pastaj, kjo krijon pakënaqësi, bukur shumë te njerëzit, e cila është e gjerë, për arsye se jo çdoherë ia qëllojmë dhe pastaj, është keq të flas, por as Lëvizja "Vetëvendosje", për aq sa as Partia Demokratike e Kosovës, as Lidhja Demokratike, as Aleanca, as "Nisma", nganjëherë nuk janë aq immune ndaj këtij tundimi. Ta kini parasysh! E keni përmendur shumë "Pronton", por nuk duhet të hyj te klanet, nuk dua të bëj shaka me ato klane tash, se kanë edhe klane të mira, "O" dhe "M", por ajo çka dua të them është kjo: Ne e kemi pasur një realitet prapë të punësimeve, të cilat kanë qenë rreth 350 veta, krejt fanatikë politikë, auditori i ka nxjerrë që krejt kanë qenë të Lëvizjes "Vetëvendosje". Edhe kjo është, si janë punësuar këta njerëz? Janë punësuar se kanë qenë fanatikët tuaj dhe i keni punësuar në mënyrë ndoshta edhe të paligjshme, shumë më shumë sesa që ka bërë Partia Demokratike e Kosovës për këto dhjet vjet në pushtet. Nuk ke 350 veta në asnjë ministri, nuk i ke 350 veta në asnjë ndërmarrje, nuk ke në asnjë agjenci.

Shiko, ato janë... po bëjmë fjalë për miliona para. A mund t'i zgjidhim këto çështje? Mundemi, veç të kemi pak sinqeritet më shumë ndërmjet vete. Problemi i papunësisë është plaga më e rëndë që e kemi sot. Kjo mund të arrihet me zhvillim ekonomik, e zhvillimin ekonomik mund ta arrijmë kur të kemi stabilitet. Stabiliteti, në rend të parë politik, që të mos kemi situata të cilat i kemi parë edhe dy ditë më herët. Kanë për të ikur të gjithë investitorët. Imagjino, edhe sikur ta marrësh nesër pushtetin ti, dhe ne ta bëjmë të njëjtën gjë, sa i ndihmojmë këtij populli.

Liberalizimi i vizave mund të ndodhë. Është lajm shumë i mirë, por nuk është entuziazëm për ne. Qytetarët e Kosovës po pakësohen. Viti 1981 me vitin 2021, unë frikohem se do ta kemi numrin e njëjtë të popullatës, si për mua, si për ty, është njësoj. Në të njëjtën kohë, po vjetërsohemi, po plakemi, s'ka natalitet. Në të njëjtën kohë, ka pak investitorë që po vijnë në vendin tonë. Të gjitha këto tash mund të përkthehen me argumente e akuza, por megjithatë dhjetë vjet, vetëm dhjetë vjet ka që jemi shtet. Për këto dhjetë vjet që jemi shtet duhet ta pranojmë edhe një fakt.

Shtetet që i kemi këtu përreth, prej shtetit shqiptar, të cilin e respektojmë për atë sa Republikën e Kosovës, për besë kurrgjë më mirë se na s'i ka punët ekonomikisht. Papunësinë e ka të njëjtë... Dil dhe shiko me tregues konkretë, infrastrukturën e ka shumë më llogarë se ne, korrupsionin e ka dy herë më të fuqishëm se ne, në të njëjtën kohë, për besë, nuk dua ta akuzoj kurrkënd, por po të na ndodhte neve si shtet që i kemi këto probleme ende mosanëtarësimi në OKB me gjithë ato afëra, në kuptimin e trafikimit të drogës, bën vaki na e kishin kërkuar edhe njohjen ndërkombëtare. Janë probleme të cilat nuk është mirë ta godasin këtë shtet, se ka suksese, për arsye se në çdo aspekt punonjësi i shërbimit publik aktualisht Republikën e Kosovës ka status më të mbrojtur, ka status social më të mirë se çdo punonjës publik në Republikën e Shqipërisë dhe të Maqedonisë, edhe në nivelin e pagave, edhe në të mbrojtjes.

Te ne në Kosovë nuk nxjerrin njerëz prej punës sikur të dalë një parti, as s'i ka nxjerrë Lidhja Demokratike e Kosovës, as s'i ka nxjerrë Partia Demokratike e Kosovës, as nuk është duke e bërë tash Aleanca me "Nismën". Nuk i nxjerrin. Unë edhe një herë, më pëlqen entuziazmi për opozitarizëm, është i mirë, është mirë me qenë pak më i përhirtë, edhe kjo çka dola dhe një aspekt - kur flet në publik është mirë të kesh informacione.

Unë sot konsistoj të bashkëpunimi të cilin e ka Kuvendi me britanikët, sot ka ardhur ky raport. 23 mars e kishte datën brenda, pikërisht të asaj marrëveshjes të cilën e kemi bërë. Sot është. Ja, vetëm nuk është mirë publikisht të thuhet se ka përfunduar. Edhe një, i nderuar kryetar i Lëvizjes "Vetëvendosja", ne e kemi thirrur. Ne e kemi thirrur për arsye se po kemi probleme të cilat janë reale. Shpeshherë nuk po mund të zgjedhim njerëz të cilët janë më adekuatë për shkak të këtyre presioneve, të cilat i kemi krejt brenda partive tona, e pranuar s'e pranuar. Nganjëherë po kemi probleme dhe kjo ka qenë arsyeja kur me kryeministrin Isa Mustafa e kam biseduar dhe e kemi nënshkruar marrëveshjen në Kuvend. Mund të bësh kritikë dhe ia vlen, ja edhe mediet qenkan, e marrin këtë pjesë, është mirë të respektohet deri në fund, se ka filluar në raste të caktuara. Nuk po respektohen konkludimet të cilat i nxjerrë ky institucion të cilin ne e kemi ftuar vetë. Më herët e kemi respektuar 100%, kur kemi qenë në partneritet me Lidhjen Demokratike të Kosovës, tash ta kemi parasysh mund të them 95%, ka pasur disa emërime të cilat kanë qenë kundër asaj, e që e ka rekomanduar kompania angleze, por s'e ka përfunduar bashkëpunimin me ne. Kjo nuk qëndron. Jemi duke e vazhduar. Është mirë të jetë pjesëmarrja edhe e opozitës më shumë në disa pozicione, por krejt zi mos të mos e bëjë. Të mos e bëjë, se ka edhe pozitivitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albin Kurti ka kërkuar replikë!

ALBIN KURTI: Nuk ka bardh e zi, por këtu raportet tregojnë që ka zi e më zi. Pra, prej vitit në vit janë duke shkuar gjithnjë e më keq këto ndërmarrjet publike. Ndoshta, nga pozita juaj nuk duket kështu!

Tjetra? Unë nuk besoj që zhvillohet Kosova pa atë që e kemi propozuar ne, Fond Sovran dhe Bankë Zhvillimore. Raportet e Progresit nga viti në vit thonë se problemi i të bërit biznes në Kosovë nuk është burokracia, është qasja e vështirë në kapital. Me banka komerciale me këto kamata të larta, nuk ka mundësi të zhvillohet ekonomie. Nuk mund ta shesësh shtëpinë për të hapur shitore! E “Vetëvendosja” e ka këtë program që e nxjerr vendin nga kriza dhe e sjell punësimin, e mandej ua zvogëlon edhe juve presionin që e keni prej anëtarësisë për t’i punësuar. Veçse, mos harroni, ju po flisni për punësim, por këtu e kemi fjalën për bordet. Pse duhet të punësohen anëtarë bordi në një ndërmarrje publike aq lart! Nuk jeni duke punësuar shtresat e varfra, jeni duke i punësuar militantët besnikë, si shpërblim për punën që kanë bërë në fushata zgjedhore.

Nuk është e vërtetë që janë 350 të “Vetëvendosjes” të punësuar në Komunën e Prishtinës. Kjo është demantuar edhe nga Komuna e Prishtinës disa herë, por mos harroni, ata të “Vetëvendosjes” që kanë shkuar aty, ata e kanë ndaluar mafinë ndërtimore, diçka që s’është bërë pas luftës në Kosovë. E paraprakisht ajo mafi ndërtimore e ka vrarë Rexhep Lucin. E ka vrarë Rexhep Lucin në vitin 2000, e ne e kemi ndalë atë mafie ndërtimore. Dhe nuk është e vërtetë që nuk na trajtoni si armiq. Ju Listën serbe e trajtoni 100 herë më mirë, se “Vetëvendosjen”. Dhe, jo vetëm kaq. Ju neve na keni sharë në seancën e pardjeshme. Po, kjo tregon se si kryetar i Kuvendit s’e keni as kulturën elementare, e as minimumin e edukatës. Na keni sharë publikisht në mikrofon “Vetëvendosjen”, bëjani Listës serbe ashtu!

KRYETARI: Unë Listën serbe e respektoj shumë. Qytetarët e Republikës së Kosovës që e njohin shtetin e pavarur e sovran i respektoj shumë. Me Serbinë më shumë s’mund bëj, Albin! Edhe ti nuk je larg meje. Ia kam kthyer pushkën prej 1990-tës deri në ‘99-tën, kështu më shumë nuk mund të bëj, dhe kurrë s’i bie pishman. Thjesht, për këtë dhe këqyr sot, a po i sheh diku? Ti e di vetë çka të kanë bërë, pa keqkuptim, se edhe ti je pjesë e asaj sakrifice, por unë e kam bërë timen. A këtë pjesë të qytetarëve të Republikës së Kosovës i respektoj jashtëzakonisht shumë, për aq sa e respektoj shumë edhe shtetin e pavarur, i cili është jashtë Kosovës, Serbinë. Preshevën, Medvegjën, Bujanocin po të na jepnin, është ofertë e hapur, i marrim, i marrim në administrim.

Ministri i Financave për disa probleme ekonomike e ka çështjen e kamatave, të cilën unë desha edhe vetë ta bëj dallimin ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës, edhe te kamatat.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Jo, u tha këtu zi e më zi. Kurrkush nuk ka tentuar apo as nuk do të tentojë që t’i minimizojë dhe t’i fshehë problemet. Kosova ka probleme. E ka deficitin e lartë tregtar, e ka normën e lartë të papunësisë, ka probleme strukturore në ekonomi. Mirëpo, Kosova e ka borxhin më të ulët publik. Nëse do ta merrni shembull Irlandën, shumë ekonomistë e kanë marrë si shembull pozitiv zhvillimin e Irlandës, por e kanë harruar veç një element. E kanë harruar veç elementin edhe nivelin e borxhit publik. Edhe ai borxhi publik dhe niveli i borxhit

publik, qe po e marrim edhe Slloveninë si një shtet që themi është i zhvilluar edhe është shtet i BE-së, po borxhin publik e ka rreth 80% edhe Sllovenia në vit është e detyruar t'i paguajë rreth 800 milionë euro vetëm në emër të interesit të borxhit publik.

Nëse niveli i borxhit publik në Kosovë arrin 80% Kosova kalon në një nivel tjetër të zhvillimit ekonomik, po pastaj do të paguajë kosto të borxhit publik edhe pjesa e investimeve kapitale nga aktualisht ku është sot, si përqindje në totalin e buxhetit, ka me të ra ndoshta në 10%, siç është në shumicën e vendeve të regjionit.

Do të thotë, Kosova ka trend të rritjes ekonomike, pozitive, viteve të fundit. A është e mjaftueshme? Nuk është. A ka mundur të jetë më e lartë? Ka mundur. Mirëpo, nuk është për t'u injoruar, sepse e ka rritjen më të madhe ekonomike në regjion. Kosova ka stabilitet makrofiskal. Deficitin buxhetor e ka vetëm 0,7%. Kosova ka bilanc bankar pozitiv dhe kjo i ka mundësuar të ketë likuiditet.

Kosova ka rritje të pagave për njerëz që i realizojnë pagat nëpërmjet Buxhetit të Kosovës, por kjo ndikon edhe në ekonominë e Kosovës vazhdimisht dhe sot, edhe pse jemi shteti më i ri, e kemi mesataren e pagave nëse krahasohemi me vendet e Ballkanit Perëndimor, jemi ndër më të lartat. Kam dëgjuar këtu ide lloj-lloj, kam dëgjuar edhe prej jush, zoti Kurti, edhe ju kam dëgjuar me kujdes e me respekt, mirëpo besomëni, disa prej ideve tuaja që i kam dëgjuar, bash në asnjë vend të Botës nuk i gjen. Disa ide mund t'i hasësh në ekonominë e Venezuelës, në kohën e Çavezit dhe të Naturës.

Sa i përket sektorit bankar nuk ka rëndësi çka them unë si ministër i Financave, të lutem referoju raporteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, raporteve të Bankës Botërore dhe raporteve të Komisionit Evropian. Thotë, sektori bankar në Kosovë është i kapitalizuar, është likuid, është solvent, normat e kredive joperformuese janë në nivel 3,1% dhe normat e interesit, për informatën e juaj, zoti Kurti, nga 3 - 14% që kanë qenë para 4 - 5 vjetëve, sot në mesatare janë rreth 6%. Ndërsa, bankat akordojnë kredi prej 3 - 5 a 6%, varësisht prej klientit, varësisht prej historikut të klientit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e definoi ekonominë e Kosovës si ekonomi të tregut të lirë dhe ne nuk mund të veprojmë ndryshe. Nuk ka instrument, nuk ka organ, që mund t'i detyrojë bankat komerciale t'ua rregullojë normën e interesit, këtë e rregullon ekonomia e tregut të lirë, këtë e rregullon raporti ofertë – kërkesë.

Sa i përket Bankës Zhvillimore, po ka raste të tilla, mirëpo bankë zhvillimore, bankë investive në pronësi publike, vetëm sa e kritikove, zoti Kurti, me shumë të drejtë, ndërmarrjet publike që nuk kanë një qeverisje të mirë. Po, llogarite nëse një bankë publike i lejon të mbledhin depozita edhe kemi një mosmenaxhim të mirë të asaj banke me bord publik, me menaxhment publik, çka kishte me ndodhë me sektorin bankar. Prandaj, pa e pasur një përvojë, pa e pasur një përvojë të paktën nga një herë në qeverisjen e një kiosku, një kiosk me e qeverisë, është problem të flasësh për

probleme ekonomike, sidomos financiare, sidomos do të ishte problem edhe për mua të flas për probleme jashtë fushës sime. Prandaj, Kosova ka të arritura, Kosova ka probleme dhe Kosova problemet të cila i ka të identifikuar, se ka diagnozën me terapi adekuate, në mënyrë graduale, se nuk ka qeveri, nuk ka njeri, që më bind se problemet që i ka Kosova, një pjesë të trashëguar, një pjesë që s'i kemi adresuar në mënyrën e duhur, mund të zgjidhen në një periudhë shumë afatshkurtër. Faleminderit!

KRYETARI: Albin Kurti, urdhëro!

ALBIN KURTI: Së pari, unë e kuptoj qasjen tuaj. Stabilitet makro-financiar, makro-fiskal, borxhi i ulët publik, deficitit buxhetor i ulët... Ju e keni pikëpamjen e një nëpunësi të IMF-it, të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që i shikon rreshtat dhe kolonat e fundit në exel-sheet-a në mënyrë që me dalë ato në rregull. Unë i përkas një orientimi tjetër, atij socialdemokrat. Gjon Mainhard Keins ka thënë: Shikoje punësimin e buxheti e shikon vetveten. Ju nuk e keni prioritet punësimin. Nuk është e rastësishme, që në Qeverinë e Kosovës Ministria e Financave është shumëfish më e rëndësishme se ajo e Zhvillimit Ekonomik. Ne kemi nevojë për një qeveri tjetër, ku ministri i Zhvillimit Ekonomik është ministri më i mirë e pastaj vjen ai i financave.

Punësimi në epiqendër, jo stabiliteti makro-financiar. Po, ky është dallimi midis Gjon Mainhard Keinsit dhe Fridrih Fon Hajegut, unë e di që u përkasim shkollave të ndryshme unë dhe ju, po shkollës suaj ua kemi pa rezultatet, këtë s'e keni parë ende.

Tjetra, unë jam për ndërmarrjet publike, ama nuk është problemi te ndërmarrja publike. Problemi është çka keni bërë ju si qeveri me ndërmarrjet publike. Unë jam për ndërmarrjet publike, sepse në tregun e lirë nuk ke nevojë paraprakisht për privatizim. Ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet private mund të garojnë në tregun e hapur. Unë jam për ekonomi të tregut, po ku tregu është në shërbim të ekonomisë e ekonomia në shërbim të shoqërisë. Në këtë aspekt, zoti ministër, nuk ka veç një lloj të kapitalizmit, bre! Ka disa lloje të kapitalizmit, ka kapitalizëm amerikan, ka kapitalizëm japonez, ka kapitalizëm të Evropës kontinentale, ka kapitalizëm skandinav. Këto janë të ndryshme. Nuk është veç një lloj i kapitalizmit. Nuk është në rregull të vendosësh ti për të zgjedhur veç një supermarket produktet finale të kapitalizmit, çfarë lloji të keksëve do, por edhe çfarë tipi të kapitalizmit do. Për atë bëhet politika, për atë është Parlamenti, për atë fiton një qeveri e caktuar.

Dhe, krejt në fund, prej Polonisë te Sllovenia e Norvegjia kanë fonde sovrane, kanë politika të tilla industriale, në të cilat e ndihmojnë prodhimin vendor duke e pasur punësimin në epiqendër, kanë banka zhvillimore investive dhe shteti nuk është spektator në ekonomi. Unë nuk po them që shteti ta dirigjojë ekonominë, jo shteti të jetë regjisor ose skenarist, po mos me qenë as spektator në audiencë. Shteti të jetë aktor dhe faktor. Këto janë mësimet e kapitalizmit përëndimor.

KRYTARI: Faleminderit! Ministër, po e shoh reagimin, ka të bëjë me çështje që janë ekonomike, pasi nuk është politikë, mirë është.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Në çështje të caktuara ne nuk kemi dallim. Nuk kemi dallime rreth fondit sovran, nuk kemi dallime që duhet të ketë dhe mund të ketë banka zhvillimore dhe ka raste të tilla nëpër vende tjera, mirëpo po, është e vërtetë që konceptualisht dallojnë. Por, ka edhe mendime të ndryshme edhe sa i përket çështjeve ekonomike. Një parim i kënaqësisë thotë që me ua rritë njerëzve rrogat është mirë, u jep kënaqësi, shpenzojnë më shumë, konsumojnë më shumë, ndikon në rritjen ekonomike, por automatikisht pas parimit të kënaqësisë është parimi i nacionalitetit, që thotë: për t'i dhënë dikujt rroga më të mëdha ti duhet t'i ngrisësh tatimet pas një kohe. Prandaj, zoti Kurti, nëse të pyes ty a je për t'i rritur tatimet në Kosovë? Vështirë e ke politikisht ti të thuash po. Jo, jo, ti thua të jetosh në shtet të barabartë, në shtetin e barabartë të të varfërve.

KRYETARI: Faleminderit. Lutfi Zharku, fjala për ju!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Edhe unë do të vazhdoj në vijën e koncepteve tona për ekonomi.

Më lejoni në fillim të konstatoj atë që edhe ministri e prezantoi, se ndërmarrjet publike karakterizohen tash me një përkeqësim të vazhdueshëm të performansës së tyre. Ky përkeqësim shihet në rritjen e humbjes neto prej 16,5 milionë në afër 41 prej vitit 2015 në 2016. Është rritur numri i ndërmarrjeve publike që afarojnë me humbje, nga 9 që kanë qenë më 2015, janë bërë 10 më 2016. Ndërmarrjet edhe ato ndërmarrje që kanë performuar pozitivisht ato nuk kanë performuar pozitivisht prej se kanë punuar mirë, por që në realitet për shkak të subvencioneve të Qeverisë, të cilat i kanë regjistruar si të hyra të tjera, e që në realitet nuk është esenciale, apo nuk është pjesë e punës së tyre.

Përkeqësimi i performansës operative në veçanti e kemi parë Telekomit i Kosovës dhe në fund është përkeqësim edhe i llogaridhënies dhe transparencës, që shihet në bazë të raporteve të auditimit apo opinioneve të auditimit për mbajtjen e librave të kontabilitetit.

Mendimi im personal është se ky përkeqësim i performansës rrjedh nga koncepti ynë i menaxhimit të ndërmarrjeve publike. Pavarësisht asaj se sa mundohemi në koncepti që e kemi të vendosur për ndërmarrjet publike se si i menaxhojmë, mendimi im personal është se është i dëmshëm apo nuk është i vënë mirë. Unë do të mundohem shkurt ta sqaroj atë koncept. Së pari po e marrim Qeveria, jemi 9 borde të ndërmarrjeve publike, borde drejtuese. Bordet drejtuese pastaj i emërojnë menaxherët ekzekutivë apo drejtorët e ndërmarrjeve, tash bordet e

ndërmarrjeve publike i raportojnë Komisionit Ndërministror për Ndërmarrje Publike, i cili themelohet nga ministria, kurse në realitet pastaj bordet e ndërmarrjeve publike i raportojnë njësisë për monitorim të ndërmarrjeve publike, që është në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ministritë i hartojnë politikat sektoriale, por pa kompetenca direkte në ndërmarrjet publike. Asnjë ministri nuk ka kompetenca në ndërmarrje publike. Kurse në anën tjetër, kemi edhe zbatimin e politikave që e bëjnë zyrat apo agjencitë ndryshme, sikurse kemi rastin e ZRE-së, e kemi Autoritetin Hekurudhor, Autoritetin Rregullator të Hekurudhave, e kemi Autoritetin për Ujëra, për Mbeturina, etj.

Ky koncept i menaxhimit natyrisht se ka krijuar papërgjegjësi totale në menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe i ka krijuar, fatkeqësisht, pronarë në hije në ndërmarrje publike. Ato pronarë në hije të ndërmarrjeve publike janë bordet drejtuese dhe menaxherët ekzekutivë, që është shumë normale dhe monitorimin në ndërmarrje publike ua ka lënë Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, ku janë zyrtarët e ulët që i monitorojnë ndërmarrjet publike. Tash, kolegë të nderuar, mendojeni, një zyrtar, pa keqkuptim, që ne e shtyjmë me të njohshëm, që e ka kryer fakultetin bachelor edhe ai e monitoron Telekomin apo e monitoron, ta marrim KEK-un, një zyrtar që dje e kemi shti në punë, ai merret me atë se si apo çka punon një ndërmarrje publike e përmasave epo e rëndësisë nacionale.

Këtë koncept që e kemi vendosur ne e kemi përkeqësuar, besoj, vitin e kaluar kur e kemi shti KOST-in, e kemi bartur Bordin drejtues të KOST-it me e emërua Kuvendi. Krejt jemi dëshmitarë, dikush që u përgjigjet 100 vetëve s'i përgjigjet kurrkujt. Ne e kemi një shprehje shumë të rëndomtë në shtëpi, thonë "kali i dy shtëpive heq keq", e lëre më një ndërmarrje publike me e lënë të ju përgjigjet 100 vetëve. Si funksionon në praktikë, unë do të mundohem atë si ka funksionuar në rastin e Ministrisë së Infrastrukturës, ku e kam udhëhequr ministrinë. Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për hartimin e politikave për zhvillimin e transportit hekurudhor, ku përfshihet edhe aprovimi i ekspozesë së rrjetit apo tarifave për shfrytëzimin e rrjetit hekurudhor.

"Infrakosi" kërkon apo e harton ekspozenë e rrjetit dhe ia dorëzon Ministrisë së Infrastrukturës për aprovim. Tash "Trainkosi" gjatë diskutimit publik i kundërshton tarifën që i ka propozuar infrakosi si të larta dhe që s'mund t'i bartë në çmime të udhëtarëve apo në çmime të mallrave dhe shërbimeve. Tash, Ministria e Infrastrukturës i merr parasysh edhe ankesat e "Trainkosit" i merr parasysh edhe ankesat e "Infrakosit" dhe çka bën në fund? E shkel Infrakosin për shkak se e ka më lehtë që ta shkelë "Infrakosin", kurse me i mbajt biletat e lira për udhëtarë apo për ta përkrahur transportin e mallrave. "Infrakosit2 si operator i infrastrukturës hekurudhore i thuhet, shko në Ministri të Zhvillimit Ekonomik edhe le t'i subvencionon Ministria e Zhvillimit Ekonomik humbjet që i shkaktohen për shkak të tarifave të ulëta. Tash, Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka çka bën vetë, e mbledh Komisionin Ndërministror të Ndërmarrjeve Publike dhe Komisioni Ndërministror i propozon Qeverisë për ta financuar apo subvencionuar

ndërmarrjet publike. Dhe në fund çka mbetet, mbetet humbja e “Infrakosit”. “Trainkosin” prapë me tarifata që i ka pak ndoshta nuk mundet të fitojë, kështu që edhe “Infrakosi” edhe “Trainkosi”, të dyja në humbje, të dy ndërmarrjet që s’mund t’u bëjë zgjidhje Qeveria.

Tash, qëllimi i këtij koncepti, po pajtohem në krejt, themi ka qenë për partitë politike, që jemi të gjithë këtu bashkë, ky koncept ka filluar në 2008-ën. Personalisht unë e kam kundërshtuar atë koncept, po më ka mundur Ahmeti me ndërkombëtarë, LDK-ja s’më ka ndihmuar edhe ka mbetur ky koncept këtu prej 2008-ës, kur kemi qenë bashkërisht.

Prej këtij koncepti krejt përfitojnë, në realitet përfitojnë menaxherët ekzekutivë dhe Bordi i Drejtorëve me paga të larta, punëtorët me paga të larta, sikur që e kemi rastin e PTK-së ku janë njëmijë euro rrogat, partitë politike krejt përmes punësimit të njerëzve tanë dhe natyrisht, ministrat sikurse rasti im që ka qenë, për t’i ikur përgjegjesisë sepse s’kanë kompetencë. Asnjë ministër drejtpërdrejtë nuk mund ta marrësh në përgjegjësi, sepse nuk e ka kompetencën e drejtpërdrejtë në një ndërmarrje publike. Natyrisht, të gjithë duhet të pajtohem që humbës është Qeveria e Kosovës, humbës është Buxheti i Kosovës. Në gjithë literaturën ekonomike humbjet e ndërmarrjeve publike konsiderohen deficite të fshehura të buxhetit, për shkak se Qeveria është pronare, Qeveria është aksionare. Në rast të likuidimit, falimentimit të çdo ndërmarrjeje, çfarëdo ndërmarrjeje publike, në fund Qeveria është ajo që duhet t’i paguajë ato borxhe apo duhet t’i paguajë të gjitha obligime që i kanë mbetur.

Unë konsideroj se si zgjidhje afatshkurtër ministri duhet urgjentisht të bëjë ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike. Atë çështje e kemi pas diskutuar edhe në Qeverinë e kaluar me kryeministrin Mustafë dhe me ministrin Stavileci. Unë besoj se ai ka pas filluar ndryshimin e ligjit me këtë konceptin, i cili mundëson së pari ndarjen e ndërmarrjeve publike apo kalimin e ndërmarrjeve publike në ministri të linjës, jo me konceptin tash siç e kemi, në një vend të koncentruara, por në ministrinë e linjës dhe natyrisht, ministrat me përgjegjësi shumë më të mëdha për performancën e ndërmarrjeve publike.

Zgjidhje për ndërmarrjet publike, prapë mendimi imi personal është, është kyçja e kapitalit privat në ndërmarrjet publike. Tash unë nuk mund të ju them se cilën formë, çfarë mënyre, a 30%, a 40%, a 50%, a tjera, por që e vetmja zgjidhje është kyçja e kapitalit privat apo fillimi i privatizimit të ndërmarrjeve publike. Unë po e mbështes këtë mendim timin në rastin e PTK-së. Po e marrim Telekomin e Kosovës, themi me rroga të mëdha që i ka jemi munduar në vitin 2009 a 2010 për ta bërë privatizimin e Telekomit. Nuk kemi mundur ta bëjmë e Qeveria apo Komisioni Ndërminstros ka pas propozuar 75%, e kemi prurë në Kuvend, Kuvendi ka propozuar, nuk e di ku e ka pas marrë atë shifër 56,75%, diçka asisoji, kryesorja ka rënë Qeveria, është shpërndarë Kuvendi dhe ka mbetur pa u privatizuar.

Në kohën e atij Komisioni Ndërministror, këshilltari i transaksionit e ka vlerësuar Postën dhe Telekomin e Kosovës minimum 400 milionë deri në 600 milionë për t'i marrë. Nuk e kemi privatizuar. Ka ardhur Qeveria tjetër, PDK me AKR, kanë filluar në 2012-ën që ta privatizojnë, e kemi pasur rastin tjetër me 277 milionë ofertë me Axosin, por që ajo kompani ka kërkuar që 35 milionë t'i ketë Posta në llogari, se s'ka pasur para tjera, logjika e thjeshtë e biznesit është që i ka kërkuar me i pas paratë në llogari. Tash, krejt jemi... sot e kemi situatën e PTK-së ku 31 milionë euro i ka pasur humbje në 2016, nuk e di në 2017-ën, por nga ana tjetër sa kemi ndikuar ne për PTK-në, PTK-së për pesë vjet nga 2009 - 2013 ia kemi marrë 450 milionë euro dividendë. Ne ia kemi marrë 450 milionë euro dividendë, nuk e kemi lënë të zhvillohet PTK-ja, ato 450 milionë euro dividendë, 192 milionë ia kemi dhënë KEK-ut. Edhe KEK-u s'di a i ka kthyer 10 milionë, po sot KEK-u do të ishte, po të mos ishte kjo hua e Qeverisë, më zi se ndërmarrjet tjera publike.

Kështu që, unë personalisht e shoh vetëm privatizimin si formë e menaxhimit më të mirë të ndërmarrjeve publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përderisa vazhdojmë, kisha kërkuar nga kolegët deputetë, e kemi këtë projektligjin që jemi tash duke e shqyrtuar, na duhet votimi që t'i kemi 61 deputetë, përndryshe do të jemi të imponuar vetëm për shkak të këtij projektligji të thërrasim një seancë pothuajse të jashtëzakonshme të hënën. 56 deputetë aktualisht jemi në sallë. Edhe 5-6 deputetë na duhen. Veç në ndërkohë derisa kemi diskutime kisha kërkuar se pastaj e kemi edhe leximin e dytë, këta që janë për diskutime e kemi edhe leximin e dytë, ditën e premte. Kisha kërkuar, ju lutem, në ndërkohë mundohuni edhe shefat e grupeve parlamentare, kolegë deputetë, që të bëhemi 61 e ta votojmë bile këtë projektligj për shkak që të mos e mbajmë edhe një herë një seancë vetëm për të.

Ka të bëjë me Agjendën e Reformave Evropiane.

Raportin e Progresit e kemi në javën e dytë të prillit. Faleminderit!

Zonja Shqipe Pantina, pasi reagoje, në emër të Grupit Parlamentar.

SHQIPE PANTINA: Unë nuk reagoja, veç le të respektohet Rregullorja, të bëhen një herë deklaratimet e grupeve parlamentare, mandej të vazhdojmë me debatin, sepse dukej sikur jemi në një amfiteatër të Fakultetit Ekonomik, e jo në sallë të Kuvendit, ku shprehen qëndrime për temën e caktuar.

E tash nuk po dua ta zgjas rreth raportit të ndërmarrjeve publike, por vetëm ta jap qëndrimin tonë si grup parlamentar.

E pranoi edhe ministri Lluka, që është ai me të cilin duhet të diskutohet dhe të debatohet për këtë pikë të rendit të ditës, që shumica e ndërmarrjeve publike janë duke punuar me humbje, dhe natyrisht se në një ndërmarrje fajin kryesor, pse ajo nuk i ka punët si duhet, i ka menaxhmenti më i lartë. Në disa prej këtyre ndërmarrjeve janë bordet, e në disa prej këtyre janë ato që quhen borde ekzekutive, apo menaxhment.

Por, ministri nuk na tregoi se cilat janë masat që janë ndërmarrë për këto ndërmarrje. Sa borde janë shkarkuar, sa drejtorë menaxhues janë shkarkuar, për shkak se kompanitë që ata i drejtojnë janë duke punuar me humbje. Pra, këto borde, të cilat për arsye se janë krejtësisht politike dhe joprofesionale, i kanë sjellë këto ndërmarrje pothuajse para falimentimit. Pasojat i mbajnë fillimisht qytetarët e vendit, të cilët gëzojnë pastaj shërbime jocalësore dhe pastaj punëtorët, shumica e të cilëve ose nuk janë duke i marrë pagat e tyre, për më keq rrezikojnë t'i humbin edhe vendet e tyre. Dhe, kjo mandej mund të na çojë lirisht edhe në një krizë, e cila edhe ashtu ekziston - krizë ekonomike me rritje të papunësisë dhe rritje të varfërisë.

Dhe, ministri vetëm na informon sa keq është situata në ndërmarrjet publike, por edhe pse është Qeveri e re, e do të duhej ta sillnin të paktën një ndryshim, nuk na e dha asnjë propozim se çka duhet bërë që të dilet nga kriza.

Cili është plani juaj? A ka plan konkret për t'i nxjerrë nga kriza sidomos këto kompani të cilat janë pothuajse para falimentimit, e një prej më të mëdhave është Telekom i Kosovës, e cila nga një ndërmarrje fitimprurëse, tashmë po duket se është një ndërmarrje, e cila rrezikon edhe punëtorët e saj të mbeten pa punë.

Pra, unë mendoj se ky duhet të jetë debati i sotshëm, të diskutojmë se si të mund t'i shpëtojmë këto ndërmarrje, e të mos i çojmë drejtë falimentimit si arsye pastaj për t'i privatizuar ato.

Prandaj, këtë raport Grupi ynë Parlamentar nuk mund ta mbështesë si të tillë, veçanërisht pasi nuk ka ndonjë propozim për nxjerrjen e këtyre ndërmarrjeve nga kriza. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Disa sqarime pasi që u shtrua disa pyetje.

E para sa i përket raportimit me vonesë, duhet të them që është raporti i viteve 2015 dhe 2016, afati për raportin e vitit 2017 është shtatori i këtij viti.

Arsyeja pse bëhet me vonesë duhet të pyetet Qeveria e kaluar, sepse normalisht e ka pasur një kohë të gjatë se Komiteti Ndërmintor për Ndërmarrje Publike nuk është mbledhur bashkë dhe nuk i ka aprovuar raportet dhe në momentin që jam marrë me këtë punë, i kam dërguar në Qeveri dhe Parlament, pra rrjedhimisht në nëntor apo dhjetor të vitit të kaluar.

Sa i përket bonuset të bordeve, bonueset përcaktohen me ligj. Deri në 50% të të ardhurave, anëtarët e bordit mund t'i marrin si bonuse.

Një gjë e tillë nuk është e drejtë, nuk përcaktohen kushtet kur merren bonuset dhe kjo duhet të rregullohet.

Prandaj, në momentin që e kam marrë vendimin e parë në tetor, apo nëntor të vitit të kaluar, ka qenë ndërprerja e menjëhershme e shpërndarjes së bonuseve.

Kemi pasur kompani publike që kanë pasur 15 mijë euro fitim dhe Bordi ka vendosur të gjithën ta shpërndaj si bonuze.

Prandaj, gjëra të tilla nuk duhet të tolerohen dhe ne me vendimin që e kemi marrë, vendimi nuk mund të jetë mbi ligjin, vendimi e ka suspenduar përkohësisht pjesën e ligjit dhe tash me ligjin e ri parashihet që bonuset faktikisht të eliminohen tërësisht, sepse unë mendoj që ndërmarrjet publike shërbyese për vendin, siç janë ujërat, e kanë obligim ofrimin e shërbimeve, siç e kam obligim unë punën time dhe nuk marr bonus. Prandaj, për çdo punë të tillë nuk duhet të parashihen bonuse. Mund ta kuptoj bonusin në kohën kur ndërmarrjet publike kanë konkurrencë nga ndërmarrja...

(Duartrokitje)

Gjithashtu u përmend fitimi i KEK-ut. Është shumë mirë të qartësohet...

U përmend pse KEK-u ka fitim 7 milionë, kurse KEDS ka më shumë. Duhet të dihet që KEK-u është një ndërmarrje publike e rregulluar, sa më shumë që fiton KEK-u, ajo tariforet të konsumatorët. Prandaj, KEK-ut nuk mund t'i japim pafundësi në fitim, sepse do të reflektonte gjithashtu në tarifa më të larta të energjisë elektrike. Prandaj, rregullohet si gjenerator i energjisë elektrike.

Gjithashtu anëtarët e Bordit do të vlerësohen. Tashmë i kemi filluar procedurat për rekrutimin e një kompanie të pavarur të jashtme nëpërmjet donatorëve, të cilët do ta bëjnë vlerësimin e performansës edhe të anëtarëve të Bordit, por gjithashtu edhe të Menaxhmentit.

Ligji për ndërmarrjet publike është në rishikim e sipër, do të jetë në debat publik besoj në muajin që vjen, dhe shumë shpejt do të vijë edhe në Parlament. Aty kemi mundësi që të bëjmë ndryshime të mira për t'i ndihmuar ndërmarrjet publike për një ristrukturim, sepse me të vërtetë ka ndryshime.

Ne kemi filluar tash gjithashtu një grup punues për qeverisje të mirë korporative, i cili do të vijë me rekomandime konkrete se çfarë duhet të bëjmë, sepse nuk është vështirë të dihet se çfarë duhet të bëjmë. Problem kemi me mbipopullim, problem kemi me rroga të larta mesatare.

Sot të Telekom, rroga mesatare është 1 000 euro, në Postën e Kosovës rroga mesatare është 850 euro. Në vazhdimësi ka pasur rritje të rrogave, në vazhdimësi ka pasur punësim, edhe pse ka pasur normalisht dalje në pension, prapëseprapë ka filluar dhe ka pasur rritje të punësimit, ditë më ditë, në ndërmarrje publike.

Si e tillë, duhet të ndërmerren masa, të paktën të ndërpritet punësimi dhe ta bëjmë një ristrukturim, pra një vogëlim të kostove operative, e sidomos në këto dy ndërmarrje që i përmenda, në Telekom dhe në Postën e Kosovës, sepse nëse vazhdojmë kështu do të vijë koha kur duhet të subvencionohen nga Qeveria e Kosovës, e normalisht me taksapaguesit nuk mund t'i subvencionojmë ndërmarrjet publike.

Është tepër me rëndësi që së bashku të punojmë që ndërmarrjet publike t'i kemi me performansë më të mirë.

Unë personalisht, normalisht do të punoj jashtëzakonisht shumë. Është një ndër prioritetet e mia, sepse ndërmarrjet publike nuk mund të jenë në pafundësi në humbje e sipër.

Telekomi i Kosovës në vitin 2017, në gjendjen e paaudituar ka pasur një humbje rreth 15 milionë euro. Në vitin 2016 ka qenë edhe më keq.

Prandaj, kjo gjë duhet të ndryshojë dhe duhet të ndalet. Faleminderit!

KRYETARI: Ndërkohë 58 deputetë janë në sallë, kisha kërkesë që edhe 3 deputetë na duhen, ju kisha lutur. Po vazhdojmë ne me debatin.

Jo, jo, ju kemi kalkuluar edhe ju që jeni në bufe, ta keni parasysh.

Atëherë, Arben Gashi e ka fjalën. Të përgatitemi për votim, janë edhe 6 deputetë, mund edhe për diskutim në pjesën e dytë, nëse duan.

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Tema për të cilën po e flasim është ndër temat e rëndësishme me të cilat duhet të merret Kuvendi dhe elementet kryesore për të cilat ne po diskutojmë sot këtu janë konceptet e ekonomisë, konceptet e shtetit, konceptet e ndërmarrjeve publike dhe konceptet e agjencive shtetërore.

Pra, meqenëse po flasim për konceptin e ekonomisë, meqenëse ne i përkasim grupit të partisë popullore evropiane si parti e qendrës së djathtë, koncepti bazë për ekonominë të cilën ne e bazojmë është koncepti i ekonomisë sociale të tregut. Pra, ku ekonomia është e barabartë për të gjithë dhe kujdeset po ashtu edhe për shtresat sociale, të cilat janë në pamundësi të kujdesit për vetveten.

Meqenëse nuk kemi ndonjë interes madhor për t'u thelluar mbi konceptet bazë në të cilat funksionon ekonomia e tregut të lirë, e paraparë me Kushtetutën e Kosovës, apo ekonomia sociale e tregut, e paraparë në kushtetutën e LDK-së, që është Statuti i LDK-së dhe Programi i LDK-së, ne sot po flasim për konceptin e organizimit dhe funksionimit të shtetit tonë.

Ne kemi disa probleme mbi bazën dhe të cilat funksionojnë.

Problemi i parë është koncepti i mentalitetit të ndërtuar në shoqërinë e Kosovës dhe ky mentalitet i ndërtuar në shoqërinë e Kosovës është i drejtuar dhe i udhëhequr nga politikëbërja në përgjithësi në Kosovë, ku sot me secilindo që flet nuk e konsideron veten të punësuar nëse nuk është i punësuar në sektorin publik. Pra, ideja e konceptit të punësimit është e bazuar kryesisht mbi bindjen nëse je i punësuar në sektorin publik konsiderohesh i punësuar, ndërsa nëse je i punësuar në sektorin privat konsiderohesh i papunësuar për disa arsye.

Arsyeja e parë, sepse në shumicën e ndërmarrjeve pritave, pra në sektorin privat, ekziston një problem shumë i madh lidhur me kontratat e punës, të drejtat e punës e të tjerë dhe po ashtu beneficionet dhe përfitimet që arrihen në sektorin publik janë ato elementet tjera, të cilat e disbalancojnë nivelin ndërmjet konceptit të sektorit publik dhe sektorit privat.

Nëse e shohim sektorin publik, më së pari duhet parë shtetin, pra të punësuarit në Administratën shtetërore, dhe këtu flasim për shërbimin civil dhe të punësuarit tjerë të profesioneve, të cilat marrin buxhet dhe paga nga sektori publik.

Dhe, problemi kryesor është me tejngopjen e Administratës shtetërore dhe me mentalitetin e administrimit, pra udhëheqjes me Administratën shtetërore.

Dhe, elementi i dytë ka të bëjë me ndërmarrjet publike. Si janë konceptuar ndërmarrjet publike në Kosovë dhe si funksionojnë ndërmarrjet publike në Kosovë?

Ideja e parë kur ti flet për ndërmarrjet publike në Kosovë krijohet përshtypja që janë disa institucione, të cilat kanë për detyrë të punësojnë njerëz, kryesisht militantë partiakë, dhe të cilat nuk konsiderohen si ndërmarrje të cilat duhet të jenë konkurrenca në treg.

Pra, ndërmarrja publike funksionon mbi bazën e parimit të interesit publik së pari, por normalisht funksionon mbi bazën e profitit, dhe ndërmarrja publike duhet të funksionojë mbi bazën e profitit, por nuk e ka prioritet absolut profitin, prioritet absolut e ka përfitimin e publikut.

Dhe, edhe nëse nuk ka profit, ndërmarrja publike duhet të funksionojë, sepse ofron shërbime bazike për publikun, siç mund të jetë ujësjellësi, rrugët, kanalizimet, ndriçimet publike e tjerë e tjerë. Pra, interesi kryesor primarë është përfitimi i publikut.

Dhe, çka ndodh këtu? Ka ndodh në këto 20 vjetët e fundit në Kosovë që ndërmarrjet publike janë parë si institucione mbi bazën e cilave arrihet përfitimi personal dhe grupor politik, e jo si konkurrenca në tregun e lirë, në ekonominë e tregut të lirë, të cilat kanë për qëllim interesin e publikut. Në këto rrethana, mendoj se ne duhet ta mendojmë konceptin e shtetit se si e kemi ndërtuar, se si koncepti i shtetit merret me ndërmarrjet publike dhe me të përgjithshmen, interesi me publik dhe si interesi publik përfiton nga këto ndërmarrje.

Duke e parë këtë element vjen edhe elementi i tretë i rëndësishëm në konceptin e organizimit të shtetit, që janë agjencitë dhe institucionet shtetërore. Institucionet e pavarura shtetërore, institucionet e pavarura kushtetuese dhe agjencitë qeveritare, që janë mbi 80 institucione të pavarura kushtetuese, institucione shtetërore dhe agjenci të pavarura në kuadër të ministrive.

Gjithë ky sistem konfliktuon herë pas here ndërmjet veti dhe krijon disbalanca dhe tash lind problemi. Si funksionojnë këto ndërmarrje publike, këto agjenci dhe institucione shtetërore, Administrata shtetërore ku jep llogari? Në esencë ku japin llogari? Në esencë, llogari duhet t'i japin Kuvendit, sepse Kuvendi është vendimmarrja kolektive, e cila e përfaqëson drejtpërdrejt interesin e publikut. Por, në këtë vendimmarrje kolektive, në interesin e publikut lindin probleme. Dhe, ne me vendimmarrjen tonë, këtë përgjegjësi e delegojmë te Qeveria, por Qeveria pastaj hyn në një marrëdhënie individuale dhe krijon konfliktin e vet, sepse prioritetin e parë e ka prioritetin e përfitimit politik.

Ne duhet të ulemi dhe t'i zgjidhim tri probleme bazike.

Problemi i parë është koncepti i organizimit të shtetit dhe Administratës publike dhe administrimi me Administratën publike. Pra, Administrata publike në konceptin e shërbyesve civilë që u tha këtu më herët që janë goxha shumë të garantuar me sistemin që kemi, Ligji për shërbimin civil, Komisioni i Pavarur Mbikëqyrës, Shërbimi Civil e të tjerë.

Administrimin politik, pra funksionarët politikë, të cilët janë të caktuar, dhe mënyra se si funksionojnë.

Ndërmarrjet publike kujt i japin llogari dhe si funksionojnë? Ne sot mund të mos e përkrahim raportin për funksionimin e ndërmarrjeve publike. Raporti, në fakt, po thotë që ndërmarrjet performojnë keq. Nëse ne e përkrahim, po e vërtetojmë që ndërmarrjet funksionojnë keq. E nëse e rrëzojmë, themi s'po e përkrahim raportin, çka po themi - që ndërmarrjet funksionojnë mirë?

Nëse ne nuk e përkrahim raportin. Kurrfarë konsekuence nuk prodhojmë për ndërmarrjet. Pra, ne duhet ta rregullojmë sistemin. Nuk e rregullon vetëm Rregullorja sistemin, po duhet parë në tërësi se si e kemi të ndërtuar sistemin e qeverisjes në Kosovë.

Pra, administrimin nga kapacitetet e funksioneve shtetërore dhe mënyrën se si funksionojnë ndërmarrjet publike, agjencitë shtetërore, institucionet e pavarura kushtetuese dhe institucionet tjera qeveritare.

Ne kemi agjenci shtetërore për mbrojtjen nga rrezatimi bërthamor, agjenci pyjore, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, agjenci pas agjencie, ministri pas ministrie, dhe janë bërë kryesisht për të punësuar njerëz, jo për të ofruar kualitet dhe për ta kontrolluar dhe balancuar pushtetin.

Pra, në këto rrethana, mendoj se kemi për detyrë si shoqëri, por edhe si politikë, që në platforma tona politike, por edhe në realitetin e qeverisjes, ta shohim se si funksionojnë këto tri shtylla kryesore.

Shteti dhe Administrata publike, ndërmarrjet publike dhe interesi publik, agjencitë dhe institucionet e pavarura, duke filluar prej atyre të pavarura kushtetuese, institucionet e pavarura që i japin llogari Kuvendit dhe deri te institucionet e pavarura në kuadër të Qeverisë, apo të ministrive.

Dhe, kur e balancojmë këtë sistem, i cili është në interesin publik, pastaj e shohim se si e kemi interesin e ekonomisë së tregut të lirë dhe ekonominë sociale të tregut dhe mbi bazën e këtyre e ndërtojmë një shtet funksional dhe llogaridhënës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar koleg deputetë,

Unë ju kisha falënderuar për mirëkuptim.

Ka disa deputetë për respekt të votimit të kësaj pike të rendit të ditës kanë mbetur deri tani. Po shkojmë drejt në votim.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Ju kisha lutur kolegë deputetë, zini vendet!

Aktualisht, të pranishëm në sallë janë 63 deputetë. Ka të bëjë me Agjendën Evropiane të Reformave.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

61 deputetë kanë votuar, 52 për, asnjë kundër dhe 9 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Ngarkohen Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

E ftoj Enver Hotin ta marrë fjalën. Ok-ej! Në rregull! Nga Lëvizja “Vetëvendosje” Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne po diskutojmë për ndërmarrjet publike dhe kishte gjëra të ndryshme, e unë po ju them juve që në fillim se mënyra e personalizimit të diskutimit nga ju personalisht nuk më pëlqeu.

Ne jemi duke biseduar për çështje shumë të mira dhe unë për dallim nga disa kolegë të mi sot, për herë të parë në këtë Kuvend, kam dëgjuar diskutime thelbësore për dallime ideologjike në nivel intelektual, dhe kjo më ka pëlqyer shumë.

Hiqini personalizimet dhe këto diskutime i kanë hije Kuvendit nëse nuk teprohen dhe i bëjmë katedra universitare, por unë po them është ndër diskutimet e ralla që më ka pëlqyer mua që t'i tregoni dallimet ideologjike dhe politike që kanë, e kjo është ajo e drejta e partive politike.

Tash po koncentrohem te çështja.

Ne diskutoam këtu për ndërmarrjet publike edhe dalëngadalë po dalin në shesh disa çështje.

Të votohet raporti është paradoks, sepse po dëshmohet se po performojnë keq. Të votohet kundër, çka po votojmë kundër?

Na është sjellë një raport që në të vërtetë e përmban një paradoks në vete, që njerëzit i nxjerr para dilemës: votuan për, për çka votuan, votuan kundër, për çka votuan? Ky është një problem numër një.

Çështja tjetër që u hap, që unë megjithatë dua të kapem për të, është çështja e ndërmarrjeve publike. Dolën investimet, dolën bankat, doli gjithçka.

Unë, megjithatë, e bëj një pyetje: Pse asnjë bankë investive ndërkombëtare serioze nuk vjen në Republikën e Kosovës? Ndoshta mirë është ta diskutojmë këtë njëherë.

Edhe unë po e them vetëm një arsye, që po e di saktësisht, sepse kemi një Gjyqësor të shkatërruar dhe asnjë ndërmarrje asnjë investim direkt të huaj, asnjë bankë serioze investive nuk do të vijë në Republikën e Kosovës derisa ta kemi një gjendje të tillë të Gjyqësorit në Republikën e Kosovës. Por, nuk është shkatërruar vetëm Gjyqësori.

Ky performim i ndërmarrjeve publike ka të bëjë edhe me shkatërrimin e sistemit arsimor që e kemi ne. Edhe ky është një problem shumë i madh.

Pastaj, e kemi edhe çështjen tjetër. Ne themi se ka një dallim shumë të madh në atë çka është sektor publik, e çka është sektor privat.

Pse njerëzit po e konsiderojnë veten të punësuar vetëm në sektorin publik. Po ajo është një punë shumë e thjeshtë.

Ne e kemi një Ligj të punës, të cilin e diskriminojmë ne vetë drejtpërdrejt, sepse Ligji i punës në themel i trajton si ndërmarrjet publike, si ato private krejt njëjtë. Ne e kemi një treg të lirë, por që e shkelim me të dy këmbët tona.

S'kanë faj njerëzit që e konsiderojnë veten të punësuar vetëm kur janë në sektorin publik, për shumë arsye.

Një arsye është se plot 18 vjet në Republikën e Kosovës në sektorin publik është kultivuar një klientelizëm i drejtpërdrejtë i ashpër, partiak, që ka filluar nga LDK-ja në këtë ekonomi tonën, dhe është vazhduar nga PDK-ja, dhe sot kemi krijuar absurde tilla, dhe absurdi më i madh është kjo Administrata shtetërore, të gjithë njerëzit që paguhen nga Buxheti i Shtetit.

Në kundërshtim edhe me kërkesën e partive djathta, ne sot kemi 84 000 njerëz që paguhen nga Buxheti i Shtetit në Republikën e Kosovës.

Tash cili është dallimi? 40 126 paguhen në nivelin qendror, që kanë edhe paga më të larta, edhe nja 43 800 në nivelin komunal.

Prej vitit 2017, me Buxhetin e vitit 2017 dhe 2018 kemi një dallim, në nivelin qendrorë janë shtuar mbi 1 000 vende të punës, kurse në nivelin komunal kemi një rënie të vogël, për rreth 20 njerëz.

Tash çka do me thanë kjo? Kjo domethënë, në gjithë botën që e synojmë ne, të civilizuar e demokratike, të zhvilluar ekonomikisht, raporti i të punësuarve në nivel qendror, edhe në nivel komunal është shumë më i madh. Vetëm në Kosovë ka arritur gati të bëhet një me një.

Raporti normal është një i punësuar në nivelin qendror, katër në nivelin lokal.

Ne në Kosovë kemi arritur t'i barazojmë këto shifra. Çka do të thotë? Nuk kemi as Ligj për Qeverinë, nuk kemi as ligj për si shtohen ministritë, ndërmarrjet publike, si bëhet punësimi në mënyrë profesionale. E kjo do të thotë se çdo Qeveri që ka ardhur në Republikën e Kosovës prej vitit 2000 e këndeje ka qenë fabrika më e mirë për punësimin e militantëve partiakë, edhe atë në nivelin qendror, për arsye se në nivelin lokal së pari janë kontrolluar nga buxheti qendror, edhe e dyta në nivelin lokal partitë e ndryshme e kanë pasur pushtetin për disa vjet dhe nuk kanë lejuar ashtu lehtë të rritet Administrata, edhe pse edhe aty është e rritur shumë.

Asnjëherë nuk është biseduar, as në këtë Kuvend nuk është biseduar, as diku tjetër, njëherë për matjen e efijencës dhe efikasitetit të punës së administratës në nivel qendror. Nga hulumtimet e ndryshme në nivel qendror efijenca nuk del mbi 1 orë e gjysmë punë efektive brenda orarit 8-orësh. Natyrisht ky përgjithësim është shumë i dëmshëm për punëtorët që punojnë dhe nuk kanë kohë ta ngritin kokën. Po kjo i fut aty edhe njerëzit që janë të punësuar në nivelin qendror dhe nuk e dinë ku e kanë vendin e punës, por paga marrin, e sidomos marrin paga në ndërmarrjet publike që janë mbushur me militantë partiakë.

Prandaj, synojnë njerëzit të futen në ndërmarrjet publike dhe jo në ato private, sepse në private i mban 12 orë, për 200 euro në muaj, e nuk ka as sigurim, asnjë garanci, as kontratë pune, as kurrjë. Kurse, po hyri në administratën shtetërore, edhe po ta zëmë duke vjedhur, e janë zënë njerëzit duke vjedhur, janë zënë njerëzit me korrupsion dhe janë kthyer në vendin e punës, prandaj siguria është e madhe. Po të merret hollë-hollë, të llogariten domethënë orët e efijencës, punës efijente në administratën shtetërore, në nivelin qendror, unë e them lirisht Kosova i humb 150 deri në 200 milionë euro për çdo vit për shkak të punësimit të militantëve partiakë edhe për shkak të mosefijencës.

Prej 40 mijë njerëzve, vetëm 10 mijë po të punojnë do të arrinim një efikasitet më të madh se sot që arrihet me 40 mijë njerëz, ky është problemi më i madh i burokracisë, i rritjes, i kultivimit të

militantizmit partiak me paranë e qytetarit e të taksapaguesit. Ky është problemi më i madh, kjo është kërkesa për ndryshim në sistem. Ne jemi socialdemokratë, natyrisht, po socialdemokracia nuk do të thotë t'i futësh militantët që nuk punojnë, nuk e dinë ku e kanë vendin e punës, por e marrin një pagë të madhe. Pyetja e fundit është: si është e mundur që ndërmarrjet publike udhëhiqen nga buxheti publik, e bordet e tyre të kenë të ardhura shumëfish më të mëdha se çdo post tjetër publik në Republikën e Kosovës, kur këto ndërmarrje publike punojnë me humbje të mëdha, shkaktojnë humbje.

Ne nuk guxojmë, momentalisht në këtë përbërje politike, nuk duam e nuk mund t'i shtrojmë këto pyetje, prandaj një ndryshim kualitativ në këtë drejtim, sipas mendimit tim, është i pamundur, e pa reformën e tillë nuk do të ketë ndonjë përparim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë po vazhdojmë me rrjedhën, Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Përshëndetje, qytetarë!

Kolegë të nderuar,

Pasi që po flasim për ndërmarrjet publike, më lejoni që fillimisht edhe një herë të ritheksoj nevojën që çështja e furnizimit me energji elektrike të adresohet një herë e përgjithmonë, por aq më tepër të ndalohet diskriminimi i hapur që po u bëhet qytetarëve të komunës së Podujevës. Pavarësisht a janë blloqet duke operuar apo jo, në vazhdimësi ka ndërprerje selektive, posaçërisht në këtë anë të Republikës së Kosovës. Kështu që, ju lus, edhe reduktimet t'i bëni, nëse veç janë të nevojshme, t'i bëni në mënyrë fer, e jo të targetohen dhe të diskriminohen qytetarët tanë që jetojnë në komunën e Podujevës.

Sot u fol për ndërmarrjet publike dhe raportet e tyre dhe u përmendën shumë arsye pse ato janë në gjendjen në të cilën janë e pse operojnë me humbje. Unë kisha dashur sot që, në fakt, të përmend një lloj ilaçi që mund të përdoret për t'i parandaluar, jodomosdoshmërisht për t'i shëruar tërësisht ndërmarrjet publike, mirëpo gradualisht për të ndalur derdhjen e mjeteve, që aktualisht po ndodh nga ndërmarrjet publike. Besoj edhe ministri Hamza do të ishte shumë falënderues, sepse disa nga këto fonde, të cilat veç po dalin, do t'i ktheheshin në buxhet dhe do të kishte kapacitet pak më të madh për të investuar.

E kam fjalën për atë që ndërmarrjet publike operojnë në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike, mirëpo me referencë përfshin edhe Ligjin për shoqëritë tregtare, pasi që ato janë të regjistruara si shoqëri aksionare. Të gjithë anëtarët e bordeve në këto ndërmarrje publike, përfshirë edhe ekzekutivin e lartë, kanë disa obligime të besueshmërisë, të cilat ligji ua vesh atyre. Ato janë, për shembull, detyrimi i kujdesit, i lojalitetit dhe moskonkurrencës. Në pjesën dërrmuese të ndërmarrjeve publike dhe pjesa dërrmuese e anëtarëve të bordit dhe ekzekutivit të këtyre ndërmarrjeve e shkelin veçanërisht detyrimin fiduciar të kujdesit.

Tash, pse po e përmend këtë? Po e them këtë, sepse çka mund të ndërmarrë Qeveria karshi atyre personave, të cilët kanë shërbyer ose janë duke shërbyer nëpër borde dhe në postet të larta menaxheriale, nëse ata kanë vepruar në asi mënyre që i kanë shkaktuar dëm të vogël ose të madh ndërmarrjes publike, të cilën e kanë menaxhuar. Çka mund të bëjnë është të bëjë padi për kompensim dëmi, sepse ndërmarrjet publike, në fakt, kanë për aksionarë qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës kompetencat që i kanë si aksionarë ia kanë deleguar shtetit të Kosovës që t'i mbikëqyrin këto si aset ose si pasuri të Kosovës.

Dhe, nëse veç po dëmtohet prej menaxhmentit, nëse doni të hyni në histori si ministri që ka bërë një kthesë të madhe, atëherë unë në këtë moment, do të thotë prej sot e tutje do të filloja të hulumtoj se kush kanë qenë përgjegjësit për këto humbje të ndërmarrjeve publike dhe natyrisht do të parashtroja padi për kompensim dëmi. Po ju garantoj që në rastet kur ju keni disa aktgjykime në dorë, me të cilat keni siguruar dhe keni kërkuar prej personave përgjegjës kompensim dëmi, do të keni shumë të vështirë të gjeni militantë partiakë për t'i mbushur bordet, sepse shumica prej tyre nuk do të kenë guximin që të marrin aso përgjegjësish mbi supet e tyre.

Kështu që unë ju kisha inkurajuar shumë që të shqyrtoni këtë mundësi dhe të eksploroni mundësinë e parashtrimit të padive derivateve në emër të shtetit të Kosovës, pra nëpërmjet ndërmarrjeve publike për të gjithë ata menaxherë, sepse vetëm në Kosovë kemi menaxherë ku shkon prej ndërmarrjes publike në ndërmarrje publike, e falimenton të fundit, vazhdon tutje, e falimenton edhe një dhe shkon tutje dhe kështu me radhë bëhen dëme të jashtëzakonshme për qytetarët dhe për buxhetin e Republikës së Kosovës. Kështu që, ju lus, si Qeveri që seriozisht ta shqyrtoni këtë mundësi dhe të kërkonte përgjegjësi nga ata që po i shkaktojnë këto dëme, përgjegjësi personale, e kam fjalën, dhe nëse veç e kërkonte këtë, atëherë edhe do të vijmë në pozitë ku për të emëruar persona në borde të drejtorëve dhe në pozita të larta menaxheriale do të keni nevojë të hapni konkurs dhe të kërkonte vërtet menaxherë të shkathtë biznesorë, të cilët dinë të menaxhojnë qoftë me Telekom, qoftë në energjetikë, apo ndonjë ndërmarrje tjetër publike, e jo vetëm militantë partiakë, të cilët nuk ndejnë asnjë kokërr përgjegjësie as ndaj shtetit, as ndaj qytetarëve të këtij vendi, vetëm përgjegjësi ndaj vetvetes dhe partisë të cilës i përkasin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Dëgjuam edhe këtu, por po ashtu edhe paraqitet në këtë raportin e performansës shumë devijime, dështime në performansës, po ashtu edhe shkelje dhe papërgjegjësi të ndërmarrjeve publike. Pak më herët deputeti Albin Kurti i bëri një pyetje ministrit se a është shkarkuar deri më tani ndonjë anëtar bordi për mospërbushje të detyrave, por nuk morëm përgjigje dhe unë do të doja që pikërisht këtë pyetje ta vazhdoj pastaj edhe me një pjesë të ligjit që rregullon kërkimin e përgjegjësish dhe shkarkimin.

Pra, nuk është e rrallë kur Kuvendi i Republikës së Kosovës nxjerr ligje, por që pastaj ato nuk zbatohen, njësoj besoj ndodh edhe me Ligjin për ndërmarrjet publike që është me rëndësi ndoshta edhe ministri ta ketë fjalën e tij në këtë drejtim. Çka thotë neni 7.2 nëse performansa e ndërmarrjeve publike devijon nga caqet e përcaktuara në planin e biznesit të miratuar nga Bordi i drejtorëve për vitin përkatës financiar, aksionari do të kërkojë nga Bordi i drejtorëve që të përgatisë dhe t'u dorëzojë atyre një raport, i cili shpjegon arsyet për performansën e dobët dhe aksionari apo aksionarët do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.

Dhe, tjetra, sido që të jetë, nëse një ndërmarrje publike dështon në arritjen e caqeve të saj të performansës për dy vjet financiare radhazi, personi apo personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit janë të detyruar që të marrin parasysht shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të drejtorëve ose shumicës të anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse aksionari apo aksionarët konstatojnë se performansa e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit do t'i raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij neni 7.3 dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi Kuvendit, ndërmarrjeve publike qendrore ose Kuvendit përkatës Komunal, apo ndërmarrjeve publike lokale.

Pra, këta janë paragrafë të nxjerrë nga ligji, të cilët në fakt nuk janë zbatuar asnjëherë, nuk po flasim këtu për raporte apo për raportet ditore, javore, por po flitet për raportet dhe për shkelje që ndodhin me vite të tëra, sepse sa herë ne në këtë Kuvend diskutojmë për raportet e performansës të ndërmarrjeve publike, ne gjendemi përballë këtyre shkeljeve dhe përballë këtyre dështimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mimoza Kusari-Lila, fjala për ju!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë, mendoj se në aspektin e prezantimit të fakteve u tha krejt çfarë është për t'u thënë për ndërmarrjet publike, për 17 prej tyre, në pronësi të Qeverisë. Ajo çka i mungon këtij raporti, natyrisht dhe ajo çka do të kishim dashur të kishim nga ministri në raportin e vitit 2017 janë rekomandimet dhe hapat konkretë për përmirësimin e situatës, nëse ka hapësirë përmirësimi.

Do të ndalem në disa pika, të cilat ishin edhe pjesë e debatit.

E para, mendoj se vetëm të flasim për vullnetin apo dëshirën për të hequr politikën nga pozitat e larta të shtetit, është një dhe, e dyta, të sillemi është tjetër. Kryetari i Kuvendit e di se raportet vijnë me emra të kryeshefave dhe anëtarëve të bordit ose drejtorëve të bordit dhe të gjithë e kanë thujse një vull në ballë me emërtimin e partisë politike, të cilës i përkasin. Dhe mendoj se hapi i parë dhe shumë më i rëndësishëm se sa diskutimi financiar është vendimi politik i krerëve të

shtetit t'i mbajnë duart larg nga këto ndërmarrje, edhe pse do të jetë shumë vështirë, duke marrë parasysh se edhe Qeveria e fundit ka dërguar lista të militantëve politikë në ndërmarrjet publike.

Këto ndërmarrje asnjëherë prej vitit 2008 nuk e kanë pasur në formën e mirëfilltë një qeverisje korporative, e cila i ka marrë përgjegjësinë për performancën e cila bazohet në vlerat e ekonomisë së tregut, në të kundërtën, e kemi parë në vazhdimësi që prej kohës kur janë tërhequr ndoshta mjete prej 200 milionë eurosh prej Telekomit ose Postës dhe Telekomit, si dividende të Qeverisë, si pronare kryesore e kësaj shoqërie aksionare, te dita kur ne duhet të mbulojmë humbjet te kjo ndërmarrje. Nga 17 ndërmarrje sa janë, mund të themi se 4 maksimumi mund të jenë duke performuar si duhet sot. Një element tjetër, i cili nuk është pjesë e diskutimit sot dhe duhet të jetë, ka të bëjë me politikën, të cilat po ndikojnë në të paktën dy ndërmarrje me masa drastike të çështjes së pazgjidhur të bisedimeve Kosovë - Serbi.

E kemi një situatë të rënduar në Kosovë, ku një ndërmarrje publike, fatmirësisht profitabile deri para disa muajve, KOST-i ose Transmisioni i Energjisë në Kosovë, në këto vitet e fundit komplet i ka 52 milionë euro të humbura, si rrjedhojë e mosimplementimit të marrëveshjes së energjisë dhe vetëm për një vit i ka 9.7 milionë euro të humbura. E kemi KRU Mitrovica, e cila faturon vetëm për pjesën jugore, ndërsa furnizon 39% të kapaciteteve të veta edhe në pjesën veriore. Nuk ka debat në këtë Parlament, ku nuk shtyheni mes vete pozitë-opozitë, kryesisht burrat, për patriotizëm e për tradhti, për gënjeshtër e për të vërteta. Po unë sot sinjerisht kisha dashur ta di se si e shihni ju krejt së bashku zgjidhjen e problemeve, të cilat po i kushtojnë shtetit të Kosovës, qytetarëve të Republikës së Kosovës, miliona e miliona euro në baza ditore, përse ne nuk mund të shkojmë përtej urës së Ibrit.

Të dy çështjet, edhe KOST-i 52 milionë euro, edhe KRU Mitrovicës 40%, të ujit që furnizon pjesën veriore nuk faturohen dhe këto janë miliona të humbura. Dhe, ju po ktheheni 18-19 vjet më herët se çka ka ndodhur, kur ne para syve milionat po na qarkullojnë, humbjet e Kosovës janë si rrjedhojë e mosmundësisë as faturimit, as të qasjes në infrastrukturë të Republikës së Kosovës, investimeve që janë mjete të popullit të Kosovës. Gjithashtu, njëjtë flasim për mungesë të qeverisjes korporative, ne kemi privatizuar, unë pajtohem gjithashtu që elementi i privatizimit e ka sjellë deri në një masë stabilizimin financiar, vërehet në KEDS, edhe pse po i kushton të tjerëve, vërehet gjithashtu edhe tek koncesionimi i aeroportit të Prishtinës, por në anën tjetër ia lidhim vetit duart dhe këmbët për funksionalizimin e aeroportit të Gjakovës. Ndryshon Shqipëria kontratën e koncesionimit të Rinasit ose të aeroportit "Nënë Tereza", nuk mundet Kosova as të diskutojë në dy nivelet e qeverisë, edhe Qeveria Thaçi edhe Qeveria Mustafa as nuk e kanë hapur diskutimin në aspektin serioz me koncesionarin për funksionalizimin e aeroportit të Gjakovës.

Nuk ka pasur aeroport, i cili ka pozitë më strategjike se ky, ndërsa këtu në raportet financiare është, paraqitet, por si rrjedhojë ose si mungesë e çfarëdo aktiviteti, natyrisht se nuk ka as punësim, por vetëm merr mjete nga buxheti i Kosovës për siguri minimale. Nëse flasim për

funksionim të mirëfilltë të këtyre ndërmarrjeve duhet të flasim për rend dhe ligj. Ne në asnjë mënyrë, në asnjë formë nuk ka as edhe një të vetmen qoftë hetim ose në mënyrë të mirëfilltë analizë e asaj se çfarë ka ndodhur me humbjet milionëshe të këtyre ndërmarrjeve dhe të kemi një proces prej fillimit deri në fund që ka shkuar dhe është gjykuar ose ka pasur në formën e mirëfilltë një proces si duhet. Ajo nënkuptohet, se përderisa të gjithë njerëzit që janë emëruar qoftë kryeshef ose qoftë në anëtarë të bordit janë njerëz politikë dhe ka ndikim të politikës në rendin dhe ligjin që nuk do të ketë rezultat të mirëfilltë. Ajo çka ne na duhet sot është që në aspektin e strategjisë së zhvillimit të shtetit të zënë shtyllë të veçantë qasja ndaj ndërmarrjeve publike, të cilat kështu-ashtu, dita-ditës do të vijnë në pikën ku prej 17 kanë mbetur vetëm 4, e prej 4 mund të mos kemi as edhe 1, duke përfshirë këtu funksionimin e shtyllave të mirëfillta të shtetit.

Unë nuk e mendoj se ky raport është sot për t'u politizuar në kuptimin e votimit apo mosvotimit, se në fund të fundit nuk ka asnjë reperkusion për vitin 2015-2016 nëse nuk votohet, që ka përfshirë një qeveri tjetër, jo kjo që është sot në pushtet, por është shumë e rëndësishme që nga ky diskutim sot të dimë se çfarë na vjen me raportin e ndërmarrjeve publike 2017 dhe cilët janë hapat që duhet t'i ndërmarrim për t'i shpëtuar ato pak ndërmarrje që kanë një qeverisje të mirëfilltë korporative dhe sot kanë një bilanc pozitiv. Të paktën, për atë që është duke funksionuar të mos e shkatërrojmë ashtu siç janë shkatërruar të gjitha të tjerat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Sala Berisha-Shala dhe bëhet gati debatuesi i fundit, Lumir Abdixhiku.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje, ministra prezentë,

Të nderuar deputetë,

Dhe ju të tjerë të pranishëm,

Në rend dite e kemi shqyrtimin e raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2015-2016, ndërkohë që jemi në vitin 2018. Procedurat ashtu e rregullojnë që ne duhet ta shqyrtojmë dhe çuditërisht këtu një deputet e përmendi edhe Trepçën, edhe menaxhimin, edhe menaxhmentin e saj.

Trepça ende nuk ka status të ndërmarrjeve publike, po pritet ta ketë atë status sapo të fillojë të zbatohet Ligji për "Trepçën". Dëshiroj të theksoj një çështje si përgjigje ndaj atyre deputetëve ose atij deputeti që foli këtu gjatë kohës sa s'isha këtu, ndoshta e ka kaluar pak aktualitetin. Etiketimet ndaj disa figurave të dëshmuara nga disa persona të dështuar tashmë janë refrene bajate. E përmendi ish-drejtorin e SHIK-ut, zotin Ferat Shala, s'ka gjë. Është mësuar ai me e ndjekjet dhe persekutimet nga ana e Serbisë edhe gjatë kohës kur ishte i burgosur si student, edhe gjatë kohës së luftës kur ishte ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e pse jo etiketimet edhe gjatë kohës sa ishte në SHIK.

A e di pse ka shkuar Ferat Shala në “Trepçë”? Ta shpëtojë prej njerëzve të “Vetëvendosjes” këtë gjigant strategjik, ka shkuar ta shpëtojë nga falimentimi dhe shitja që e kishin planifikuar njerëzit e tu, Albin dhe ia ka arritur qëllimit, e ka shpëtuar nga falimentimi dhe shitja, duke qenë pjesë e grupit të punës edhe për Projektligjin e “Trepçës” sa ishte ministër në Qeverinë e kaluar. Dhe, gjatë kohës sa ka qenë ministër kurrë zëri nuk t’u ka dëgjuar këtu, e ke pasur përpara. Pse nuk e ke pyet çka ke bërë në “Trepçë”? Edhe ai e ka durimin të të tregojë pikë për pikë, e di që edhe ti i di sukseset e tij dhe të njerëzve të tij, por nuk të lë smira dhe xhelozia, apo ndoshta ndonjë mision yti për t’i pranuar, edhe veç njerëzit e lig flasin për ata që s’janë këtu.

Është e vërtetë që Ferati ka qenë në SHIK, po dihet “Trepçën” e ka shpëtuar nga UDB-a. Sa për rikujtim tëndin dhe të qytetarëve që na dëgjojnë, kur ka shkuar Ferat Shala në Trepçë, në dhjetor të vitit 2008, e ka marrë “Trepçën” në prag të falimentimit, e ka marrë në minus 4 milionë euro, gjashtë rroga borxh punëtorëve të mbetur, e ka marrë me një moshë të vjetruar të minatorëve dhe gjatë menaxhimit të tij ka arritur t’i punësuar shumë të rinj shaljanë, ta përtërijë moshën e minatorëve, t’ua rritë për qindra herë pagat e minatorëve, edhe në momentin kur e ka lënë Trepçën, e ka lënë në pozitiv plus 9 milionë.

Edhe mua më vjen shumë çudi, çka e ke kaq shumë këtë aversion ndaj disa figurave, e jo ndaj procesit. Ndërroje qasjen! Në fund, vetëm një ta pranoj, edhe është e vërtetë, ia ke qëlluar, pse PDK-ja është gjithmonë konstantja? A e di pse? Pse nuk merret me ty, edhe dije, as variabël nuk do të jetë në të ardhmen, sepse je lider i një gjysmë partie, e cila është rritur vrullshëm si zjarri me kashtë, edhe është drejt fundosjes dhe as hiri s’ka për t’u mbetur. Faleminderit!

KRYETARI: Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Tash dy herë që po dua ta marr fjalën, po vijnë disa tema që po na qesin prej fokusit kryesor, edhe më herët për kredi, edhe tash me temën, unë në fakt, desha të ndërlihem me debatin që e nisën zoti Kurti dhe zoti Hamza, më pas u përcjell me kolegët e mi, Zharku edhe Gashi dhe tash ne kemi bindje të ndryshme politike. Unë i takoj një partie të qendrës së djathtë, bindjeve dhe orientim programor dhe çështjen e të djathtës kundër të majtës s’besoj që do ta zgjedhim këtu, as që duhet ta zgjedhim, me siguri do ta mbajmë si platformë qeverisëse në gara zgjedhore, më pas qytetarët do të vlerësojnë cila është më e mbarë dhe më e mirë.

Por, po besoj se ka disa çështje që mund të pajtohemi të gjithë bashkë edhe ndoshta pika kryesore që duhet pajtuar është se ndërmarrjet publike sot në Kosovë më së paku janë ndërmarrje, pra më së paku funksionojnë në konceptin e funksionimit të ndërmarrjeve. E para, sepse ato shërbejnë më tepër si strehimore sociale, pra jo si ndërmarrje që kanë qëllim maksimizimin e fitimit, punën e eficientës dhe të njëjtat kanë prodhuar edhe rritje të punësuarve, por edhe rritje të pagave në vazhdimësi. Kujtoj rastin e PTK-së paga mesatare në PTK, në qoftë

se nuk e dini, është 1 100 euro, prandaj natyrisht se përcillet me rënie të të hyrave dhe e tëra përcillet me rënie të vlerës. Në çdo rrethanë ekonomike të tillat do të ishin të falimentuara, në qoftë se nuk do të ndihmoheshin nga strukturat e tregut ku operojnë. Pra, arsyeja pse operon sot PTK-ja është sepse ekziston në Duo-pol, jo pse ka rezon ekonomik. Pra, keqpërdor një strukturë të dhënë të tregut dhe kostoja e keqpërdorimit të kësaj strukture, natyrisht se përkthehet për të gjithë qytetarët. Arsyeja pse operon RTK-ja në anën tjetër, ose KEK-u, është sepse kanë monopol. Tani, unë nuk pajtohem me idenë që banka zhvillimore do të duhej të jepte zgjidhje, as për ambientin ekonomik në Kosovë, për dy arsye. E para, sepse qasja në financa dhe kosto e financave nuk janë një gjë e njëjtë, siç u prezantuan këtu. Dhe, nuk është e saktë, madje me asnjë raport ndërkombëtar, po as vendor, se kosto e financave është barrierë kryesore për biznesin.

Në tre vitet e fundit kosto e financave ka arritur diku rreth 6%, në normat e interesit që variojnë prej 3% deri në 9%, por në mesatare janë 6%, por qasja në financa është diçka tjetër. Qasja në financa është barrierë në vete dhe jo për shkak të mosvullnetit të sektorit bankar në Kosovë, sepse janë mbi 600 milionë euro depozita të tepruara, pra nuk është se s'ka para në bankat e Kosovës, ka para. Dhe, një bankë zhvillimore nuk do të zgjidhte ofertën monetare në sektorin financiar. Do ta bënte një gjë të tillë, në qoftë se do t'i ulte kriteret për dhënie të kredisë, por në qoftë se një bankë zhvillimore do të duhej të operonte në logjikën e një ndërmarrjeje standarde, atëherë nuk ka arsye pse ta bënte një gjë të tillë, sepse i gjithë sektori financiar i ka shterur të gjitha filtrat dhe nuk ka dhënë një kredi të tillë. Pra, do të duhej të kishte një kosto shtesë për dhënien e një kredie, që nuk ka kaluar nëpër sektorin komercial.

Dhe e dyta, unë shpesh kam dëgjuar propozimin e tatimit progresiv, që e majta në Kosovë e jep shpesh, dhe mund të jetë ose të rrumbullakohet si deklaratë politike, por në thelb nuk bën ndryshim, sepse po i shikuar të dhënat e Trustit, janë vetëm katërmijë veta në Kosovë që paguhen mi 2 000 euro dhe po të bënim një llogari në bazë të formulës që e keni prezantuar në programet e juaja, do të gjeneroheshin më tepër 12 milionë euro në Kosovë në vit me gjithë tatimin progresiv në modelin që e keni dhënë. Dhe këto 12 milionë euro, thënë të drejtën, nuk bëjnë ndryshim të madh sa për të konsideruar tatimin progresiv si shtyllë kryesore të ndryshimit të strukturës ekonomike në Kosovë. Janë tri barrierat ku duhet fokusuar dhe këto barrierat na vijnë prej sektorit privat dhe të tri barrierat, fatkeqësisht, nuk janë aty ku s'ka shteti dorë, po janë barrierat ku ka shteti dorë. Pra, nuk lindin ku ka mungesë të mekanizmit të shtetit, po aty ku ka shtet. E para, barrierat kryesore që vazhdon të jetë me intensitet të njëjtë dhe për vite në Kosovë, është konkurrenca e padrejtë e cila stimulohet prej dy proceseve, i pari është prokurimi publik, tenderat. Pra, ka ndërhyrje të shtetit në zhvillimin e sektorit privat, bizneset që marrin para nga prokurimi publik kanë tendencë të rritjes më tepër se sa të tjerat dhe kjo krijon një cikël disfunksional të rritjes dhe zhvillimit të biznesit dhe e dyta ka të bëjë me trajtimin e pabarabartë prej institucioneve të shtetit ndaj sektorit privat. Për shembull, Administrata Tatimore që vendos disa biznese t'i taksojë e disa të tjera jo, ose doganat apo inspeksionet tjera që janë në Kosovë.

Barriera e dytë është gjyqësori, e dimë që vetëm 3% e bizneseve në Kosovë merren me gjykata, vetëm 3%. Krahasuar me mesataren e rajonit, që është diku rreth 38% është normë alarmante, që na tregon se bizneset ose s'kanë besim në sistemin gjyqësor, ose s'llogarisin fare, është anarki totale. Është prapë një mekanizëm i shtetit, që do të duhej të jepej prej shtetit.

Dhe e treta, më e rëndësishmja, që s'e diskutojmë asnjëherë, s'ka të bëjë fare me anën e kërkesës, ka të bëjë me anën e ofertës supply-side, ka të bëjë me fuqinë punëtore dhe fakti që fuqia jonë punëtore fatkeqësisht është edukuar por s'është aftësuar. Besoj se, në qoftë se ne si shtet do të kishim mjete në dispozicion ne s'do të duhej t'i përdorim ato për të bërë biznes, se ka kush bën biznes, në fakt ne shtetin duhet ta mbajmë larg biznesit dhe çfarëdo mjeti financiar që kemi do të duhej t'i përmirësonim këto tri elemente, tri shtyllat kryesore, ku shteti ka mekanizma të vetët që po prodhojnë barriera dhe disfunksionalitet ekonomik. Pra, të forcojmë konkurrencën e drejtë, të forcojmë gjyqësorin dhe të forcojmë fuqinë punëtore nëpërmjet sistemit tonë arsimor-edukativ.

Sa u përket ndërmarrjeve publike, unë nuk pajtohem që kemi dështim të konceptit të djathtë. Në fakt, asnjëherë koncepti i djathtë s'është dhënë i plotë në këto trajtime. Ndërmarrjet publike do të duhej të privatizoheshin, po privatizimi s'është hapi i parë dhe i fundit i një procesi të tillë. Një privatizim pa liberalizim të tregut, pa konkurrencë tutje, është i pandryshueshëm, siç e kemi rastin e KEDS-it. Pra, s'bën ndonjë ndryshim në qoftë se ti privatizon një ndërmarrje dhe më pas e mban monopol, ose duopol. Në qoftë se, arrijmë të liberalizojmë tregun dhe fusim konkurrueshmërinë, atëherë do të zgjidhim probleme të shumta ekonomike në vend, por edhe do të ulim koston për të gjithë qytetarët, se mund të humbim disa para në Buxhet, por do t'i shtonim shumë shërbime tjera, ose mjete jofinanciare përfituese për qytetarët kosovarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A t'u përmend emri? Urdhëro, Albin Kurti për fund.

ALBIN KURTI: Se, një herë në fillim u kritikova që po flas për platformën e fushatës elektorale, por në fund veçse kjo u bë edhe prej kritikuesit.

Unë besoj që 6% është shumë e lartë e besoj se në fakt është edhe më e lartë se 6%. Banka zhvillimore investive do të duhej të ishte maksimalisht 3%, por edhe më poshtë se aq, në mënyrë që ne përnjëmend të besojmë se do të ketë investime në ekonomi, e para. E dyta, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ne e kemi BERZH-i në Kosovë, BE-ja ka bankë zhvillimore në Kosovë e Kosova s'ka për vete. Kjo është absurd. Ne duhet ta kemi një bankë të tillë zhvillimore investive në Kosovë.

Po, unë besoj në shtetin e mirëqenies që është koncept me tri dekada të arta, prej 1945 - 1975, ku kombinohen zhvillimi ekonomik me drejtësinë sociale, që do të thotë para së gjithash, tatim progresiv dhe sigurime shoqërore e te sigurimet shoqërore pensionet dhe ai shëndetësor. Ne, për

shembull, kemi sigurime për automjetin kur bëjmë aksident, por jo për njerëzit që aksidentohen brenda automjetit. Politika përfundon te disa bindje, pra unë besoj se duhet të zbuten pabarazitë. Zbutje e pabarazive nuk do të thotë që do të na bëjnë njerëz identikë, uniformë, por do të na bëjnë më të barabartë dhe besoj në tezën e Keinsit, që edhe ekonomisë i konvenon zbutja e pabarazisë, sepse rritet kërkesa agregate. Sa më e vogël pabarazia në një shoqëri, aq më e madhe kërkesa agregate e asaj shoqërie. Pra, nuk i ndihmon vetëm barazisë midis njerëzve si qytetarë të Republikës, po i ndihmon edhe vet ekonomisë.

Edhe tjetra është, po pajtohem plotësisht, nuk është fare e thënë që të kemi privatizim për liberalizim të tregut si parakusht. Mund të jenë në konkurrencë edhe ndërmarrjet publike edhe ndërmarrjet private dhe besoj, që barrën e provës duhet ta ketë ai që do të privatizojë, e jo ai që do ta mbajë ndërmarrjen si publike.

KRYETARI: Faleminderit! Lumiri, prapë e ka kërkuar fjalën, po e marrim si kundër-replikë.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Unë veç shumë shkurt do të them, se nuk duhet të ndërtojmë institucione veç pse dikush tjetër i ka, por duhet të ndërtojmë institucione, sepse na sjellin rezultate të reja. Në qoftë se, banka zhvillimore nuk sjell rezultate të reja në sektorin financiar për arsye që i përmenda, atëherë nuk duhet bërë sepse kemi një bankë evropiane në vend.

E dyta, unë besoj se ne duhet të targetojmë sektorin social në Kosovë dhe LDK-ja e ka edhe në program të vetin sigurimet shëndetësore të orientuara dhe të organizuara sipas sistemit të tregut, madje e kemi edhe sistemin e fondeve pensionale, sërish të orientuara dhe të organizuara sipas sistemit të tregut, të cilat në thelb do të përmirësonin jetën e qytetarëve në Kosovë.

Tashti, në konkurrencë, në aspektin e konkurrencës, nuk besoj se ka ndërmarrje publike në Kosovë që ka funksionuar në sistem konkurrencial, sepse s'kemi pasur një rast të tillë ta shohim. Por, të tilla çfarë vendet tjera kanë treguar, siç është rasti i Sllovenisë së fundmi, kanë prodhuar rezultat të krizës së rëndë financiare në konkurrenca të tilla, kur kanë ekzistuar në sektorin privat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më debatues nga radhët e deputetëve. Përfaqësuesi i Qeverisë, ministri i Financave.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Vetëm disa korrektive, sa i përket qasjes në financa, nëse i shikojmë indikatorët e raportet e të bërit biznes prej Bankës Botërore, Kosova është mjaft lart e ranguar, është diku kah vendi i 23-të.

Sa i përket bankës zhvillimore, logjikisht dalin disa pyetje. Kah kapitali për këtë bankë? A do të punojë kjo bankë veç me kapital të vet? Cila do të jetë kosto e këtij kapitali që do t'i jepet bankës zhvillimore? Cilat do të jenë strukturat e qeverisjes së kësaj banke zhvillimore? A do të ketë të drejtë kjo bankë zhvillimore të marrë depozita? Nëse i merr depozitat, sa do të jetë besueshmëria e depozitarëve në një bankë, ku duhet pasur kujdes çfarë strukture qeverisjeje ka? Prandaj, janë pyetje që në aspektin teorik mund t'i diskutojmë, por në aspektin praktik për të ndodhur nuk është e thjeshtë dhe nuk është Paris.

Ne flasim këtu për sistemin bankar dhe gjithmonë flasim për kredimarrës. Por, nuk ka bankierë që nuk ka bankë qendrore, që te sistemi bankar nuk i ka në prioritet depozitarët, sepse nëse rrezikohen depozitarët jo që do t'i paguhet kosto për vendin. Një prej arsyeve pse borxhi publik i Sllovenisë është rreth 80%, pse Sllovenia paguan 800 milionë euro kamata në vit në emër të interesit, është se është dashur ta bëjë kapitalizmin e sektorit bankar. Dhe veç kapitalizmi i sektorit bankar nuk e zgjidh në vetvete problemin, eliminon një problem, por nuk e zgjidh problemin.

Prandaj, kur flasim për këto çështje duhet ta shikojmë cilat janë strukturat qeverisëse? Cila është siguria? Kah është burimi i kapitalit? A dëshirojmë ta lëmë veç me kapital? A të lejohet edhe të mbledh depozita edhe sa do të jetë siguria e depozitarëve që t'i depozitojnë paratë e veta në një bankë, ku nuk ka ndoshta, nëse e marrim si analogji me ndërmarrjet tjera, siguri të madhe. Ndërsa, sa i përket prezencës së bankave të fuqishme në sektorin bankar është mjaft banka të fuqishme që janë të ranguara mjaft lartë edhe në sistemin bankar evropian. E ke Raifaisenin, s'po dua t'i bëj reklamë kurrkujt, e ke NLB-në, e ke ProCreditin, e ke Ish-Bankosi, e ke TEB-in si pjesë e paribas-grupit dhe del që janë krejt pjesët e grupacioneve të fuqishme bankare. Dhe, normat e interesit, po e ripërsëris, ka norma të interesit dhe ka kredi që merren me norma të interesit prej 3 ndoshta edhe duke shkuar lartë, varësisht prej llojit të kredisë, prej kualitetit të kolateralit dhe prej historikut të klientit në bankë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albini prapë, po, po, janë çështje që u interesojnë edhe qytetarëve. Kisha pasur dëshirë bile të shihja më shpesh kësi lloj debati. Urdhëro, Albin!

ALBIN KURTI: Qasja e ministrit të Financave është qasje e mosbesimit në shtetin tonë. Pra, ky flet për bankat e huaja private sa të mira, sa të sigurta janë, e sa rreziqe do të kishim nëse e marrim fatin tonë në duart e tona, e është ministër i Financave. Pra, kjo është absurde! Në vend se të kemi ministër të Financave, që ndoshta dikë tjetër ta shikojë më me dyshim e të besojë në shtetin e Kosovës, në Republikën e Kosovës, në financat e Kosovës, në ekonominë e Kosovës, ky bën të kundërtën. Ky mbjell pesimizëm për veten tonë dhe optimizëm për ata të tjerët që kanë ardhur këtu. Ky është... asnjë ministër i financave në Evropë nuk guxon të flasë kështu. Çdo ministër i financave që shpreh mosbesim në vete kësisoj, s'mund të qëndrojë asnjë ditë në atë vend pune.

Kjo është gabim, zoti ministër. Është gjëja më absurde, që dëgjova unë sot. Natyrisht, që banka zhvillimore investive nuk është zbulim imi, kanë bërë shtetet tjera, por porsa na tha ministri që ne qenkemi me numra më mirë se Sllovenia. Pra, ky është një ministër, i cili shikon numrat nëpër fleta e jo jetët e njerëzve. Më mirë është t'i kemi numrat si Sllovenia e jetën si sllovenët, se sa t'i kemi numrat si Kosova e jetën si kosovarët. Atë borxh që e ka marrë Sllovenia e ka marrë për qytetarët e vet. Po, banka zhvillimore investive do të ishte me kapital të Republikës dhe me bonët, ama ne po kemi para për disa gjëra të tjera. Ia ke dhënë gati 2 miliardë "Bechtel"-it, bre! Me 10% të parave që ia ke dhënë "Bechtel"-it ke mundur ta bësh bankën zhvillimore investive. Me 10%, me 200 milionë ke mundur ta nisësh edhe ta thërrasësh edhe diasporën. Po, ty s'po të vjen as diaspora jote. Qysh të të vijë investitori i huaj, kur Diaspora jote po të ikën, e thërret investime të huaja!

KRYETARI: Faleminderit! Po e shoh se u hap debat i cili është, gjithsesi edhe zonja Mimosë, do ta jap fjalën. Po ministrit, a e lëmë në kuadër të debatit? Nuk janë... urdhëro!

LUTFI ZHARKU: Zoti Kurti,

Është e vërtetë që kemi dallime konceptuale. Unë i besoj ekonomisë së tregut të lirë, unë u besoj bankave dhe sistemit bankar në Kosovë. Bankat e Kosovës janë banka të Kosovës, ka edhe banka me kapital vendor, po ka edhe banka që janë të Kosovës me kapital të huaj. NLB-ja është bankë e Kosovës me kapital të huaj.

Po, ne kemi dallime. Unë i besoj ekonomisë së tregut të lirë. E di që ekonomia e tregut të lirë nuk është perfekte, por është e vetmja e qëndrueshme. Ndërsa, ju i besoni një ekonomie të planifikuar, të centralizuar, e cila ka përfunduar në sirtarët e arkivave. Harrojeni ekonominë, harrojeni tipin e ndërmarrjeve, ku kemi punuar në sistemin klering, ku kemi eksportuar plumb dhe kemi importuar "bellarusa". Ajo ekonomi është treguar e paqëndrueshme. Është e vërtetë që ne duhet ta synojmë zhvillimin e ekonomik të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI! Faleminderit! Zonja Mimosë, po e bëj një tejkalim, për arsye sa ka shumë. Janë lajmëruar me dhjetë. Përfundoje, por të lutem mos e ço...

MIMOZA KUSARI-LILA: Jo, kryetar, po e vazhdojmë. S'po e përfundoj shpejt, se po shihet që ju ka marrë malli të flasim për ekonomi, se veç për politikë duke folur dhe duke u shtyrë. Mirë që kemi diçka përmbajtjesore.

Albinit kisha dashur veç t'i tregoj që ministri i Financave, ju të dy në fakt nuk po dallon në koncepte ekonomike, këtu sa po shoh unë. Vetëm, ministri i Financave është shumë i sinqertë me realitetin. Sot e diskutuam, ose e trajtuam, ky debat u hap kur e diskutuam raportin e

ndërmarrjeve publike qendrore. Prej 17 ndërmarrjeve vetëm 4 sot i kemi ndoshta që mund të mbijetojnë. Edhe ministri po niset prej kapacitetit shtetëror edhe human, që s'kemi mundësi dhe s'kemi formë se si ta menaxhojmë një bankë, se kur kemi arritur ta falimentojmë një Postë-Telekom të Kosovës, që ia kemi marrë dividendën 200 milionë, paramendoni se çfarë do t'i bënim një banke!

Domethënë, ky është vetëm real. Nuk jemi duke folur për koncepte të ndryshme ekonomike. Ne po flasim për një ministër, i cili është duke parë që numrat... jemi duke e shteruar rezervën e shtetit, nuk kemi asnjë plan për menaxhim të mirëfilltë të këtyre ndërmarrje, ose për kthesë të këtyre ndërmarrjeve. Për t'i pasur numrat edhe jetën si të Sllovenisë do të duhej të punojmë si sllovenët, ose me qenë në kohën e ish-Jugosllavisë kur ata kanë përfituar e neve dikush tjetër na ka qeverisur, ose na i ka marrë mineralet e të tjerat, ta krijojmë atë standard, përndryshe standardet dallojnë ekstremisht. Edhe Sllovenia ka dështuar në masë të madhe me numër të privatizimit, por nuk e kanë pasur dëmin dhe nivelin e ekonomisë që e ka pasur Kosova e vitit '99.

E ne në vitin 2008, përkundrajt faktit që kemi pasur ndërmarrje me mundësi të jenë profitabile, si faktorë vendor, mos të harrojmë, po flasim për vitin kur e kemi shpallur pavarësinë, i kemi parë vetëm si ndërmarrje si lopë që mund t'i mjelim e bile-bile tash u ka ardhur vakti disa prej tyre edhe për t'i prerë dhe për t'i bërë mish, kurr gjë tjetër mbas.

Ministër, unë ty të falënderoj, se ti nuk po jep këtu premtime, për të cilat mund të themi, po...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Unë ju falënderoj për debat të shëndosh, në rend të parë edhe për durimin. Ju kisha lutur vetëm pak. Ta bëj një rekapitullim, a ka mundësi?

Vazhdimi, në ndërkohë derisa po debatoni, kam kërkuar pajtueshmëri nga kryetarët e grupeve parlamentare që ishin të pranishëm, që të premtenta kemi seancën për Agjendën Evropiane të Reformave, në ora 14:00. Në orën 10:00 ta vazhdojmë këtë seancë, se i kemi rekomandimet për rastin "Dehari", Rregulloren e Kuvendit, tri projektligje - marrëveshje ndërkombëtare. Duhet minimum të votojnë 80 deputetë, 5 ligje në lexim të dytë dhe dy votime të fshehta. Pra, të premtën, në orën 10:00 e vazhdojmë këtë seancë me këto pika që i kemi tani, pastaj vazhdojmë në orën 14:00 me atë vendimmarrje për të cilën patëm unanimitet të plotë.

Gjatë javës pastaj e shohim, po megjithatë është një punë që po bëhet në Kuvend. Faleminderit!

Të premtën në orën 10:00, këto që i përmenda, e vazhdojmë këtë seancë. Sot një javë, të premtën, në orën 10:00 të ditës. Urdhëro, Memli!

MEMLI KRASNIQI: Kryetar, faleminderit!

Debati ishte shumë interesant. Desha të flas për debat, por s'po flas. Ishalla s'i biem mësysh këtij Kuvendi, se hera e parë, së paku në këtë legjislaturë, që folëm për diçka shumë me rëndësi konkrete, pavarësisht dallimeve që mund t'i kemi konceptualisht.

E kam një çështje për kolegët deputetë, këta që janë në sallë e që i falënderoj, por ne duhet definitivisht, kemi folur sot për Rregulloren, ta kemi një rregull për deputetët që nuk janë në sallë. Për secilin grup parlamentar vlen, unë sot e falënderoj secilin deputet, pavarësisht grupeve, që janë këtu. Por, nuk është në rregull që të ketë trajtim të njëjtë me ata që s'janë këtu pa arsye.

Unë nuk e di çfarë sanksionimi tjetër të gjejmë, po e di që secilin deputet e prek sanksionimi financiar dhe propozimi im është, nëse pajtohen të tjerët, ta shikojmë mundësinë, ose me vendim të Kryesisë, ose me Rregullore, që deputetët të cilët nënshkruhen në fillim të seancës të nënshkruhen, edhe kur të vazhdojë pauza, edhe kur të përfundojë seanca. Ndoshta, pa hiri tuten që s'i marrin mëditjet dhe vijne e rrinë deri në fund, siç po rrimë edhe ne të tjerët, sepse s'janë duke e përmbushur detyrën e vet, mandatin e vet, s'janë duke e përmbushur obligimin që e kanë prej qytetarëve. Kur po janë në fushata zgjedhore nëpër parti politike, i thejnë këmbët kush të hyjë në lista, pastaj i thejnë këmbët se kush po zgjidhet, e kur po vijne në Kuvend të Kosovës duhet të kenë përgjegjësi më të madhe, prej deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës, që s'janë këtu sot, e deri te deputetët e Pavarur, të cilët mund të mos jenë, e që e kanë marrë mandatin e qytetarëve.

Sinqerisht, nuk është hera e parë, është ndoshta hera e dhjetë, që ne s'ia dalim ta përfundojmë seancën për shkak se s'kemi deputetë për të votuar. Kjo duhet të përfundojë dikur dhe duhet të gjejmë forma të cilat, një formë ose tjetër, do t'i obligojnë këta deputetë të rrinë në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është iniciativë e mirë, por ju e vendosni. Kur ta vendosni ju, mund ta fillojmë, kur të jenë 80 deputetë, ashtu edhe e bëjmë. Faleminderit!

Mirupafshim të premtën e ardhshme, në orën 10:00!

* * *

E premte, më 30 mars 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16 dhe 23 mars 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 74 deputetë, ndërkohë po vijnë edhe kolegë të tjerë.

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më datat 2, 16 dhe 23 mars 2018.

Jemi në pikat e papërfunduara të rendit të ditës.

Ndërkohë Avdullah Hoti dhe Sasha Milosavleviq e kanë kërkuar fjalën, edhe Sami Kurteshi.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

KRYETARI: Kryetar i grupit, më fal, një sekondë! Do tA lejoj nga një prej grupeve parlamentare, se do të futemi në seancë. Pastaj për çdo temë në qoftë se dëshirojmë, mund të futemi në bazë të procedurave, se po shoh që shumë po lajmërohen.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Çështja që dëshiroj të ngre sot është skandali institucional që u krijua dje në vend me deportimin e gjashtë shtetasve turq, është parë dje qartë se hierarkia institucionale nuk është respektuar në Kosovë. Të gjithë bartësit e institucioneve janë deklaruar publikisht që nuk kanë njohuri për këtë çështje, kryeministri i vendit, presidenti gjithashtu, ministri i Brendshëm gjithashtu dhe të gjithë të tjerët, gjithë hierarkia dhe zinxhiri komandues. Është tani e qartë edhe për njohësit e fushës dhe procedurave ligjore që këto procedura nuk janë respektuar në deportimin e këtyre personave.

Sipas informatave të bëra publike, ata njerëz kanë pasur leje të rregullt qëndrimi në Kosovë, nuk kanë qenë të akuzuar për shkelje të ligjit në Kosovë ose në procedura të tjera.

Ne si grup parlamentar nuk do të pajtohemi me këtë situatë, ne do të kërkojmë përgjegjësi institucionale dhe personale për njerëzit, për strukturën komanduese, në këtë rast.

Është më se e qartë për mënyrën se si janë zhvilluar ngjarjet dje që kryeministri i vendit, si shef i ekzekutivit, nuk ka kontroll mbi Qeverinë, mbi policinë dhe mbi institucionet e tjera.

Është gjithashtu e qartë që presidenti i vendit ka tejkalluar kompetencat e veta në këtë rast dhe ky nuk është rasti i vetëm që ai tejkallon kompetencat kushtetuese.

Ne do të kërkojmë përgjegjësi morale dhe ligjore nga kryeministri, dorëheqja tani që u bë publike, në fakt shkarkimi i ministrit të Brendshëm nuk është i mjaftueshëm, sepse përgjegjësia në fund i bie kryeministrit të vendit dhe bartësve të tjerë të institucioneve.

Kryeministri e ka të qartë nëpër procedurat ligjore që ka kaluar në Francë sa ka qenë, për tre muaj të tërë shteti i Francës është kujdesur për të që të përfillen të gjitha procedurat ligjore që ai të mos deportohet vetëm se një shtet tjetër kërkon deportimin e tij. Ndërkaq dje gjashtë shtetas turq u deportuan pa asnjë bazë ligjore.

Ne nuk do të lejojmë që shteti i Kosovës, institucionet e Kosovës, të komandohen nga Turqia, kjo është skandaloze për shtetin e Kosovës.

Sot është një seancë, vazhdimi i seancës, një seancë tjetër e rregullt pasdite, por nga sot institucionet e vendit dhe shteti i Kosovës hyn në një situatë të re. Nga sot ne duhet të ulemi të dakordohemi si forca kryesore politike në vend për datën e zgjedhjeve, rrugë tjetër nuk ka.

Të gjithë kemi qenë të qartë se kjo Qeveri nuk mund të vazhdojë gjatë, por që e sjell vendin para kolapsit, para rënies komplet të strukturës institucionale të vendit, kjo nuk është pritur nga asnjë qytetar për këtë Qeveri.

Prandaj, unë kërkoj që ne sa më parë të ulemi bashkë, forcat politike në këtë Kuvend, të dakordohemi për hapa që duhet të ndërmarim për të caktuar datën e ardhshme të zgjedhjeve, si proces i kontrolluar, i përgatitur mirë si duhet dhe gjithëpërfshirës për të gjitha forcat politike.

Ne shpejt do të dalim edhe me qëndrim të Lidhjes Demokratike të Kosovës, grupit tonë parlamentar, për hapat që duhet të ndiqen në këtë drejtim dhe unë ju ftoj të gjithëve që të ulemi së bashku sa më parë dhe të mbyllim këtë kapitull të keq gjashtëmujor të qeverisjes në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kolegë, edhe një herë, vetëm nga një prej grupeve parlamentar.

Lëvizja “Vetëvendosje” njëri, janë dy. Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Fatkeqësisht dje kemi parë në praktikë kolapsin e çdo strukture shtetërore në Republikën e Kosovës. Si është e mundshme që në një aksion, për të cilin dalin tri figurat kryesore të shtetit, presidenti e dënon, kryeministri thotë nuk kam pasur informacion, edhe ju,

kryeparlamentar, e keni dënuar këtë aksion që ka ndodhur dje, i cili ka pasoja fatale për shtetin e Kosovës.

Si është e mundur që në shtetin tonë të ketë struktura paralele shtetërore, të cilat veprojnë pa e ditur politika vendimmarrëse? Kjo është sfida të cilën e kemi përjetuar në ditën e djeshme.

Sa u përket të drejtave të njeriut, është një kthim i paimagjinueshëm mbrapa për shtetin e Kosovës, për arsye se konventat më të rëndësishme evropiane, drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë, janë shkelur në ditën e djeshme, janë shkelur prej institucioneve shtetërore të sigurisë me deportimin e gjashtë shtetasve turq prapa në Turqi.

Si është e mundshme që aeroporti ynë i privatizuar nga turqit të shndërrohet në një farë piste të Erdoganit, të vijë këtu aeroplanë shtetërorë sekretë, për të cilët nuk di askush, e qytetarët me thes në kokë t'i kthejë prapa në Turqi. Qysh është e mundshme të ndodhë kjo në Republikën e Kosovës?

Në aspektin e integriteteve evropiane, mos harroni që kjo është një goditje e pariparueshme, nuk ndreqet kjo kollaj. Leni ju kalimin e demarkacionit, e "Zajednicën". Akti i djeshëm është i pakthyeshëm sa i përket dëmtimit të procesit të integriteteve evropiane.

Nuk mund të bëhesh shtet evropian, kjo nuk ndodh në asnjë shtet evropian t'i kthesh njerëz, të cilët akuzohen në shtetet e tyre vetëm pse mendojnë ndryshe prej regjimit, prej të cilit ata kanë ikur. Përmes këtij akti Kosova mund të bëhet drejtpërdrejt pjesëmarrëse në atë çka do t'u ndodhë atyre qytetarëve në Turqi. Duke filluar prej keqtrajtimit e torturës, e deri te dënimet drakonike politike, vetëm për shkak të bindjeve të tyre politike. Ju jeni bërë përgjegjës të drejtpërdrejtë, edhe si Qeveri, se çka do t'u ndodhë atyre, edhe kjo regjistrohet prej institucioneve evropiane.

Kështu që, me të vërtetë, unë nuk mendoj që kjo mund të mbyllet vetëm me shkarkimin e ministrit të Punëve të Brendshme, apo me atë të drejtorit të Inteligjencës. Kjo shkon drejtpërdrejt larg, deri te udhëheqja e Qeverisë, për shkak se çfarë shteti ne, çfarë Republike po ndërtojmë, nëse figurat më të larta shtetërore thonë se ne nuk kemi ditur asgjë. Këtu dikush arrestohet me dhunë, kthehet prapa në Turqi dhe secili prej figurave të larta politike dëshiron t'i lajë duart prej kësaj ngjarjeje. Kjo nuk është e mundshme, nuk mund të kalojë kaq kollaj.

KRYETARI: Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani premijeru,

Članovi Vlade,

Dragi kolege,

Želim da vam kažem da je dana 26. marta u mitrovačkom domu u severnoj Mitrovici održan sastanak najviših legalno i legitimno izabраниh predstavnika Srba ovih institucija.

Na tom sastanku smo pričali o dugotrajnom miru, pričali smo o toleranciji, pričali smo o suživotu, pričali smo o pomirenju.

Međutim, posle određeno vremena na tom sastanku je upala do zuba naoružana sa metkom u cevi policijska formacija, koje primenila protiv pravnu brutalnu silu, i pri tom ničim izazvani, ničim izazvani bili su pretučeni naših ministri, poslanici, odbornici, gradonačelnici, novinari, kažem ničim izazvani. Svi smo na tom sastanku mirno sedeli i razgovarali o već pomenutim stvarima.

Žalosno je što tog dana niko od vas nije našao dva minuta vremena da nas pozove i da nas pita kako smo i šta radimo, žalosno je. Sram vas bilo zbog toga.

Tražimo da se na odgovornost pozovu i podnesu ostavke ministar unutrašnjih poslova i direktor policije. A počinoci koji su počinili protiv pravnu silu bude adekvatno kažnjeni.

I na kraju želim da vam kažem da je Srpska lista od danas u opoziciji, i želimo da vidimo ko je još u opoziciji od ovde prisutnih poslanika. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti Sasha,

Unë nuk desha të ndërhyj, fjalorin duhet pasur kujdes. Turp është të hysh pa leje në Kosovë, e duhet ditur çdo kush se pa leje s'lejohet. Ankesat të cilat janë, merrni përsipër, por turp është të hyjë çdo kush pa leje në Kosovë e të mos marrë përgjegjësi për këtë.

Kështu që, ai është turp i më i madh dhe askush nuk do të tolerohet të hyjë në Kosovë qysh do e të sillet me Kosovën qysh do, për aq sa edhe këto veprime të cilat kanë ndodhur dje.

Ky është shtet i pavarur sovran, kështu do të sillemi deri në fund, ta keni parasysh, për fyerje s'ka nevojë.

Nga një prej grupeve parlamentare, s'do ta marrë fjalën më shumë se një, për arsye se keni të drejtë të thirrni seancë të jashtëzakonshme në qoftë se ka kaq zell të madh.

Sasha Milosavleviq e ke fjalën për replikë, në qoftë se do. Po, po, merre për replikë. Vazhdojmë me të tjerët: Ahmet Isufi, Bilall Sherifi, Memli.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Reka sam da je sramota što nas niko nije pozvao od kolega da nas pita kako smo i šta radimo.

KRYETARI: Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën, le të bëhet gati Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Myfera Shinik.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që edhe ne këtu, por besoj edhe qytetarët e Republikës së Kosovës janë të shqetësuar nga zhvillimet e djeshme. Unë besoj që janë dy arsye kryesore, të cilat realisht na kanë shqetësuar të gjithëve.

E para ndërlihet me respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe gjashtë qytetarët turq, të cilët janë të deportuar dje nga Kosova dhe po ashtu me respektimin e procesit të rregullt në një situatë të tillë, për çka ka ende pyetje pa përgjigje.

Dhe, arsyeja tjetër është paqartësia në vendimmarrje në lidhje me aksionin, gjë që besoj nuk e ka bërë të ndihet mirë askënd dje, kur kemi parë aq shumë udhëheqës institucionalë, të cilët kanë deklaruar se nuk janë të informuar dhe nuk dinë se si ka ardhur te ky aksion apo te përfundimi i tij.

Unë besoj që përtej deklarimeve politike, por edhe veprimeve institucionale, ne sot dhe ditët në vijim kemi nevojë për informacione të sakta dhe për një qartësim të kësaj situatë.

Më duhet të them që është e tepërt që edhe ne si përfaqësues në institucione të mbetemi peng, ndoshta vetëm i raportimeve mediale dhe spekulimeve të ndryshme që janë të shumta në 24 orët e fundit.

Besoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të njoftohet për zhvillimet e djeshme në detaje, të njoftohet për arsyet, por edhe për efektet e këtij aksioni, sepse efektet e këtij aksioni pa dyshim që mund të jenë të shumta. Ne duhet ta dimë se si do të ndikojnë, pozitivisht apo negativisht, edhe në raportet tona me partnerë të ndryshëm.

Në anën tjetër, unë besoj që përgjegjësia e secilit zyrtar është e përcaktuar dhe konform kësaj përgjegjësie institucionale duhet të kërkohet edhe llogari prej tyre. Por, besoj se sot është e hershme, në mungesë të këtyre informacioneve, së paku ne si deputetë të Republikës së Kosovës të kemi veprime dhe vendime pa e pasur qartësinë e duhur. Nga Qeveria dhe instancat përkatëse kërkojmë veprime të shpejta që ndërlihen me informimin e plotë të institucioneve të Kuvendit

të Kosovës, por edhe të qytetarëve të Kosovës sa i përket kësaj çështjeje, ndërsa, po ndërlidhem me atë që e thatë ju, zoti kryetar, nëse ka interesim edhe nga përfaqësuesit tjerë që të diskutohet më në detaje kjo çështje, ne absolutisht, besoj që i kemi instrumentet që na i lejon Rregullorja e Kuvendit, për të thirrur seancë, interpelancë apo diçka tjetër. Por, konsideroj se kjo duhet të ndodhë, pasi ta kemi një qartësim në lidhje me zhvillimet dhe veprimet e djeshme dhe pasi ta kemi një fotografi të plotë të arsyeve pse ka ardhur deri te aksioni i djeshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan Molliqaj, në emër të Grupit të Pavarur të Deputetëve.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Dua të ngre shqetësimin, siç e ngrenë dhe të tjerët sa i përket veprimit të djeshëm, që për mendimin tonë shpërfaq disa momente edhe problematike, po edhe të cilat japin sinjale për shtetin tonë. Pra, është hera e dytë gjatë javës që kemi dy aksione të shtetit të Republikës së Kosovës, përkatësisht organeve të rendit, që në opinionin publik në vazhdimësi është duke u folur se kush qëndron prapa tyre.

E kemi një reagim të Policisë së Kosovës në veriun e Kosovës, ku në medie, e jo vetëm në to, u deklarua që prapa këtij vendimi qëndron Presidenti i Republikës së Kosovës. Ende sot e kësaj dite nuk e kemi të qartë nëse ky veprim ishte i vendosur nga Presidenti i Republikës. Kemi po ashtu problem për shkak se ndonëse në shikim të parë kemi një zbatim të ligjit sa i përket ndalimit të një zyrtari të shtetit serb që hyn pa leje në Kosovë, dhe që ne si grup e kemi mbështetur, por po ashtu me të drejtë kemi thënë po atë ditë që llogaritet që shteti të ketë nevojë të veprojë në mënyrë të organizuar ndaj çdo cenimi të aspektit territorial dhe të sovranitetit të shtetit. Dhe, një ditë pas, kemi një mbledhje të një grupacioni politik në Kosovë, që është Lista serbe, e cila e shpall stemën e Asociacionit njëanshëm në veri, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës, e nuk kemi asnjë veprim nga institucionet e Republikës së Kosovës. Pra, ose hera e parë ka qenë gabim, ose ka qenë një akt, i cili ka qenë krejtësisht për aspekte mediale, sepse edhe hera e dytë - shpallja e njëanshme e stemës së Asociacionit të Komunave me shumicë serbe paraqet cenim të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës.

Momenti i dytë është ky i djeshmi, kur e kemi depërtimin e gjashtë shtetasve turq, të cilët kanë pasur leje qëndrimi nga institucionet e Republikës së Kosovës në Kosovë. Ajo që mua më shqetëson shumë është se kemi për herë të parë, ndonëse në shikimin e parë mund të duket një moment sinqeriteti, kryeministri i Republikës së Kosovës deklaroi publikisht, e pastaj edhe Presidenti, thonë se nuk dinë për një veprim të tillë. Ose është i pasinqertë deklarimi i të dyve dhe ka pasur plan për largimin e dikujt, ose nëse është i sinqertë, është edhe më problematik, për shkak se unë jam i bindur që nuk mund të ketë depërtim të gjashtë personave drejt shtetit të Turqisë pa e ditur personat përgjegjës në institucione, sepse nuk ka as polici, as AKI, që guxojnë ta marrin një vendim të tillë, pa u thënë dikush bëje. E nëse s'është ai Presidenti, e nëse s'është ai

kKryeministri, e nëse s'është ai kryetari i Kuvendit, shtrohet pyetja: Kush qëndron prapa këtij vendimi, i cili ka peshë dhe institucionet e sigurisë e dëgjojnë, e madje as nuk e informojnë asnjërin prej përgjegjësve të shtetit. Pra, ose jeni duke na mashtruar që po thoni se nuk e dini, ose nëse jeni të sinqertë në këtë, atëherë problemi vetëm sa thellohet, sepse ne e kemi dikë, i cili i urdhëron institucionet e shtetit për të deportuar shtetas të një shteti tjetër që kanë leje qëndrimi në Kosovë, pa e ditur shteti ynë, pra pa e ditur institucionet e Republikës.

Dhe, këtu duhet të kemi patjetër informacione. Ajo që u pa deri më sot nuk është informacion dhe nëse nuk ka diçka të re, të paktën i kemi dy probleme. Kemi institucione të cilat nuk i kontrollojnë as institucionet tjera në zinxhirin komandues, pra kemi Kryeministër, kemi President dhe kemi kryetar Kuvendi veç sa për t'i pasur, se qenka dikush i cili po i marrka disa vendime ku as nuk po e ditshi ju, e lëre më ne të tjerët, që jemi deputetë. Kështu që pres së pari një deklaram nga institucionet për këtë çështje.

Unë e kuptoj se tash mund të ketë një veprim të shkarkimit, por kjo për mua, nuk e zgjidh problemin, ndonëse nuk po them se s' duhet të ketë, por kjo nuk e zgjidh problemin, se sipas meje pyetja më e madhe mbetet: Kujt ata i thanë për ta bërë një veprim të tillë? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Unë besoj që jemi në një seancë, që është vazhdim i seancës, dhe nëse këtu shkelet Rregullorja, atëherë nga shkeljet e vogla bëhen edhe shkeljet e mëdha, që po ndodhin në vazhdimësi në Kosovë.

Në Kuvendin e Republikës së Kosovës, që është institucioni më i lartë i shtetit, nuk respektohet rendi i ditës, por shkelet, duke lejuar hapje të debatit për tema, të cilat mund të diskutohen në seanca të rregullta, siç është seanca e paraparë për orën 14:00 - seancë e re, qoftë në deklarime jashtë rendit të ditës, qoftë nëse ka nevojë deputetët të thërrasin seancë të jashtëzakonshme. Por, konsideroj se shkelja e Rregullores në vazhdimësi në Kuvendin e Republikës së Kosovës është pasojë e veprimeve, të cilat vërtet i nxitin pastaj edhe shkeljet e mëdha.

Ju lutem, respektojini Rregulloren, respektojini ligjet, respektojini Kushtetutën, pastaj dalim shtet serioz, e jo siç po ndodh edhe në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pak do të kisha pasur çfarë t'i shtoj kësaj që u tha nga kolegët para meje. Unë desha vetëm t'i them disa fjalë.

Nëse do të më kishte thënë dikush t'i numëroj tri gjëra që s'ma merr mendja kurrë se do të ndodhnin, do të kisha thënë se azilkërkuesit e djeshëm, të strehuarit e djeshëm, të ikurit e djeshëm nga një regjim totalitar kurrë nuk do t'i dorëzonin njerëzit në një shtet tjetër, pa marrë parasysh raportet bilaterale të shtetit tonë me të. Nuk do ta bënin. Të parën do ta kisha radhitur këtë. Se, kur në krye të shtetit tim janë tri personalitete, të cilët e kanë pasur fatin në jetën e tyre që jo vetëm të strehohen, por nga at je edhe të veprojnë në të mirën e çështjes kombëtare, do të kisha thënë kjo është e para që nuk mund të ndodhë, pastaj do t'i kisha radhitur disa të tjera, por kjo do të ishte e para.

Nuk di a jemi ende të vetëdijshëm se çfarë ka ndodhur dje. Ne jemi mjaftueshëm të vetëdijshëm se çka dje ka ndodhur në këtë vend. Nuk do të hyj në analizën e asaj, "e kanë ditur, s'e kanë ditur fare". Nuk më bën fare përshtypje kjo, sepse kush nuk e di çka i ndodh në vendin e tij, ai është në vendin e gabuar. Unë mendoj se këtu më shumë e kemi një situatë, në të cilën, po dikush e di, dhe ne të gjithë në këtë sallë e dimë se kush e ka ditur. Madje, e dimë edhe se kush e ka bërë. E dimë edhe se kush e ka urdhëruar, por jo me shkrim. Jo, nuk ka lënë gjurmë. Në kafe diku, apo në një skaj diku, në një objekt të këtij Parlamenti, a të Qeverisë, a ku di unë, në një vend e ka thirrur dhe ka thënë bëjeni këtë punë se po kërkohet, po e kërkon interesi i madh i Kosovës, apo interesi i madh, që në fakt këtu kemi të bëjmë veç me interesa personale.

Të gjithë e dimë, pra. Çështja është vetëm se nuk po na e konfirmon askush dhe presim që dikush nga "kokat turke" të konfirmojë se si ka ndodhur kjo, të na tregojë se si ka ndodhur kjo. Kjo është e papranueshme për një shtet, i cili aspiro integritet evropian, është totalisht e papranueshme. Ky Parlament e ka tash për detyrë të mos thotë që "e po, u bë...", "nuk u desh, por u bë, e lëmë, ecim, vazhdojmë më tej...". Gjashtë njerëz janë dorëzuar bash, ama bash si në kohën e fashizmit që njerëzit i dorëzoheshin Hitlerit. Edhe atëherë ka pasur arsyetim aspekti i sigurisë, aspektet e interesit të shtetit, aspektet e interesave të ndryshme, edhe atëherë po të njëjtat argumente kanë qenë. Nuk kanë pasur as atëherë të tjera, por jemi të dobët, nuk mund të rezistojmë. Madje, Zvicra ka qenë një nga shtetet kampione që radhë me radhë ka dëbuar njerëz prapa me ligj e pa ligj, me gjyq e pa gjyq, madje nuk i ka lënë të hyjnë as në Zvicër duke i kthyer nga kanë ardhur dhe të gjithë e dimë pastaj fatin e tyre.

Nuk po flas për vendet që kanë qenë të okupuara në atë kohë dhe nuk kanë qenë sovraane, kanë qenë të okupuara dhe qeveritë kuislinge i kanë bërë depërtimet. Unë po flas për vendet të cilat i kanë pasur qeveritë e tyre, por nga frika, nga arsyetimet e ndryshme se e kemi interesin shtetëror,

se ajo është fuqi e madhe, nuk mund të rezistojmë, prandaj edhe i bëjmë lëshimet... Këto janë të papranueshme, sepse ta kini parasysh, aspirata jonë nuk është integrimi në Lindje, aspirata jonë është integrimi në Perëndim dhe dje është atakuar vlera themelore, mbi të cilën është ngritur ajo shoqëri, të drejtat e njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, mbi të gjitha, sundimi i ligjit.

Dje nuk kemi pasur akt të ekstradimit, të kuptohemi. Aktet e ekstradimit bëhen nëpërmjet gjykatave. Kërkesa formale pastaj trajtohet nga institucione formale dhe gjykatat marrin vendim, ashtu siç ishte rasti me zotin Haradinaj në Kollmar, kishte një kërkesë për ekstradim. Gjykatat në Francë vendosën që arsyet janë të pamjaftueshme për t'u kryer ekstradimi.

Dje e kemi pasur një akt rrëmbimi dhe të dëbimit të gjashtë qytetarëve të huaj. Pra, sikur të kishte qenë rast ekstradimi do t'u ishte nënshtruar procedurave gjyqësore, por meqë po t'u ishte nënshtruar procedurave gjyqësore sigurisht se nuk do të kishte kaluar, atëherë e kanë zgjedhur rrugën e rrëmbimit dhe të dëbimit, pa asnjë procedurë gjyqësore. Kjo është, për mendimin tim, dhe besoj që shumë nga politikanët e këtyre vendeve të Bashkimit Evropian, sidomos të atyre 12 vendeve themeluese, zemra e Bashkimit Evropian, janë duke e kapur kokën me duar dhe duke thënë "Kujt i paskemi ndihmuar? A është e mundur kjo, që një vendi që vetëm para 18 vjetësh ne iu gjetëm në ndihmë, e bën sot këtë?". Kjo ka ndodhur sot. Kjo është duke ndodhur nëpër shumë zyra të vendeve të Bashkimit Evropian, duke thënë "Si është e mundur kjo të ndodhë në zemër të Evropës?"

Unë shpreh indinjatën time të thellë, edhe timen personale, edhe të kolegëve të mi deputetë dhe shpresoj shumë, edhe të shumë bashkëqytetarëve të Republikës së Kosovës dhe të shumë shqiptarëve anekënd rruzullit tokësor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Myfera Serbica Shinik, pastaj është kryeministri.

MÛFERRA SIRBICA-ŞINİK: Faleminderit, kryetar!

Sayın Başkan, Meclis Başkanı, bakanlar, milletvekilleri. Dün Kosova'da FETÖ terör örgütüne karşı yapılan Kosova sorumlularının tutuklanmaları, Kosova ve Türkiye Cumhuriyeti Kurumları arasında yapılan ortaklaşa bir çalışmadır. Kosova Demokratik Türk Partisi milletvekilleri olarak bu durumda hiç kimsenin bunun hukuki bir ihlal olduğunu iddia edemez düşüncesiyle bu tutuklamalar gerekçe üzerine yapılmışlardır. Bu kişiler sadece Türkiye'ye değil, ama Kosova'yu da uzuz vadede tehdit edebilecek örgüt üyeleridir. Bu durumda İçişleri Bakanı ve İstihbarat şefinin haksız yere suçlu duruma düşürülmeleri bizleri üzmektedir. Öyle ki iki dost ülke arasındaki ilişkilerin, Türkiye Cumhuriyeti ve Kosova Cumhuriyeti arasındaki ilişkilerin, bundan sonra da devam edeceğinin ve hatta en iyi bir şekilde devam edeceğine inancımız tamdır. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Të nderuara medie,

E para, Republika e Kosovës ka respekt për Republikën e Turqisë, është një vend që na ka njohur që në nisje të pavarësisë sonë, na përkrah në planin ndërkombëtar, po ashtu në Turqi jetojnë miliona shqiptarë, me origjinë nga vendi ynë dhe kemi interes për një partneritet sa më të mirë me Republikën e Turqisë.

Këtë besoj që askush prej nesh nuk e konteston.

E dyta, që është me rëndësi të shpjegohet, dje, diku rreth mesditës, prej mediave edhe prej palëve të treta kam mësuar se ka ndodhur deportimi i gjashtë shtetasve turq. Kanë qarkulluar në lajme dje ditën se janë në aeroport ose diç tjetër, nga informatat që kam unë, ata dje në mesditë kanë qenë në Turqi, transporti e çdo gjë ka qenë paraprakisht i organizuar.

Po tani ta elaboroj para jush, nëse më lejoni, për 2-3 minuta zhvillimin e djeshëm.

Duke qenë kështu, kam kërkuar shpjegime, ashtu si e parasheh procedura me shkrim prej drejtorit të AKI-së, pra informatat inteligjente prej ministrit të Drejtësisë, ministrit të Brendshëm dhe prej drejtorit të Policisë.

Nga informatat dhe nga raportimet me shkrim ka dalë që ky operacion ka qenë bilateral, vetëm i dy organizatave në Kosovë, dy institucioneve kosovare, i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe i Policisë, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, e inicimi i kësaj procedure u bë nga AKI-ja, pra për revokim të lejeve të qëndrimit për shkak se personat e caktuar, sipas AKI-së dhe të dhënave që ka pasur, paraqesin rrezikshmëri për Kosovën.

Në bazë të këtij vlerësimi, AKI-ja ka bazë ligjore t'i kërkojë atëherë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Departamentit për Refugjatë ose Azil, si quhet ai, që të ndodhte deportimi i tyre, deportimi ishte i menjëhershëm, pra proceduralisht me automatizëm po ndodhte.

Në pamje të parë ky deportim nuk ka shkelje ligjore, pra në pamje të normave që i ka paraparë Kosova, por ekzistojnë disa shkelje të tjera që janë shumë të rëndësishme dhe bazuar në ato çka kam mundur të nxjerr mbrëmë, është një gabim i madh që ky veprim i tillë, pa hyrë në substancë, në përmbajtjen, që vërtet a kanë qenë këta të rrezikshëm e sa ka qenë shkalla e rrezikshmërisë, është një problem, nuk janë informuar vendimmarrësit në këtë rast në bazë të Kushtetutës së vendit, AKI-ja, drejtori i AKI-së i raporton kryeministrit dhe presidentit të vendit.

Kuptohet, kryeministri informohet edhe nga numri tri i AKI-së, që është inspektori, mirëpo informimi i inspektorit është më shumë për aspekte të tjera të natyrave tjera të punës, ndërsa drejtori i AKI-së raport në bazë të përgjegjësisë që ka.

Njëkohësisht ministri i Rendit, që tani do të flas për të dytë nga pak, AKI është një storie e suksesit të Kosovës, nëse e shohim luftën kundër terrorizimit, rreziqeve për vendin, në këtë drejtim nuk është ky veprimi që tash do ta lajmëroj dhe që besoj e keni dëgjuar, për shkak se mendohet që në aspektin e përgjegjësive kushtetuese AKI-ja është avancuar në punët e veta sa i përket mbrojtjes së Kosovës nga rreziqet, si terrorizmi, e të tjera.

Duke qenë kjo gjendje e krijuar, të cilën nuk kam arsye t'ju a fsheh, kam shkuar menjëherë në konsultim te presidenti i vendit e ta pyes si është gjendja. Kam zhvilluar konsultime me kryetarin e Kuvendit, po ashtu, dhe pas konsultimeve që i kam marrë e pas këtyre raportimeve me shkrim, kuptohet nga përgjegjësia që kam, jam i detyruar të veproj. Kjo është një farë shkelje, ta quaj ashtu, e hierarkisë vendimmarrëse e kushtetuese dhe më obligon, e bazuar në këtë obligim që buron nga kjo që thashë më herët, unë kam kërkuar lirimin e ministrit të Punëve të Brendshme, zotit Flamur Sefaj, sepse në sektorin e tij ka ndodhur puna, dhe të atij që e ka iniciuar këtë rast, drejtorit të AKI-së, zoti Driton Gashi. Këto dy vendime nuk i kam pasur të përgatitura, as të menduara, as që drejtohen kundër këtyre dy individëve si individë, apo çfarëdo përkatësie tjetër, qoftë kundër ndonjë subjekti politik apo lideri politik, po janë vendime që e mbrojnë shtetin e Kosovës, demokracinë, krijojnë një precedent institucional, nga i cili duhet të kemi kujdes në të ardhmen, dhe bazuar në këtë kërkoj përkrahjen e të gjithëve, po kthim mbrapa s'ka. Pra, kërkesa për lirim të këtyre dyve është e përvokueshme nga ana ime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Para se të kthehem në seancë, pasi u përmenda disa herë, kisha pasur dëshirë si deputet dhe si kryetar i Kuvendit ta qartësoj pozicionin tim lidhur me këtë rast.

Faleminderit!

Dikush mund ta marrë shkelje të Rregullores, por në këtë aspekt qytetarët kanë pasur të drejtë të dëgjojnë nga ne informim rreth kësaj çështjeje, e kjo është arsyeja pse kërkoja që vetëm nga një të flasë nga grupet parlamentare.

Unë dëshiroj të qartësoj pozicionin tim si kryetar i Kuvendit, s'kemi pasur bash asnjë informatë.

Së pari e kam marrë vesh në orët e hershme të mëngjesit nga familjarët, përkatësisht bashkëshortet e këtyre, për arsye se janë të gjithë mësimdhënës.

Kemi të bëjmë me mësimdhënës, te të cilët janë shkolluar shumica e fëmijëve bartës të institucioneve, përfshirë edhe fëmijët e mi. Do të thotë terrorizmi, ku të gjithë fëmijët e shumicës së bartësve të institucioneve shkollohen, kjo është e para.

Gabimi i parë institucional, në qoftë se kanë qenë terroristë, është dashur t'i tërheqim për 2 vjet, me procedura të ngadalshme, para dy vjetësh, pra një viti, para gjashtë muajve, këtë pjesën të cilën po e them. Kam bërë çka ka qenë e mundshme, i kam thirrur të gjithë, e kam thirrur kryeministrin, e kam thirrur çdo institucion që ka qenë e mundshme. Kam qenë në gjendje të shkoj në aeroport, por fatkeqësia e tyre ka qenë se vonë kanë lajmëruar familjarët, kanë lajmëruar pas orën 9:30-10:00, në kohën kur ata tashmë ishin gatuar të gjitha ato dhe ata kishin ikur jashtë.

Veprimet pa precedent, për shkak se, po e them edhe një, publikisht, kurrë nuk kisha besuar se një ditë, si dita e djeshme, do të isha aq i turpëruar, jo për shkak të pafuqisë si institucion, si kryetar i Kuvendit, se i forti bash nganjëherë të shtinë të përulesh, jemi mësuar ne, i kemi përjetuar të gjitha ato. Po nga ajo se çka po ndodh në një shtet, ku unë kam përgjegjësi, në një popull i vuajtur, kemi qenë të pambrojtur, 50% të popullatës na kanë larguar. Imagjinoni të na kishin degdisur qysh kishin dashur e kush kishte dashur. Se më së shumti, më së rëndi është kur je i pambrojtur qysh vepron, ne të gjithë krenohemi e mundohemi t'i përmendim çdo kund se s'i kemi dorëzuar çifutët gjatë Luftës së Dytë Botërore.

E çka bëjnë tash? I dorëzua njerëzit që nuk e dimë ku i kemi dorëzuar, çfarë standardi. Mirë është, mund ta deportojmë dikë, mund ta çojmë a ta ekstradojmë, unë i pranoj ato, po pak me dinjitet, jo të merren si të ishin kidnapuar e të barten atje duke mos ditur si do të trajtohen. Imagjinoni nesër të dalë dikush prej tyre i pafajshëm. Ku mbetet shteti i pavarur i Kosovës, imagjinoni në qoftë se i mbysin, ku mbetet shteti i pavarur i Kosovës. Pastaj po flasim për procedura, po flasim për sjellje të shtetit, po falim se në mes të Evropës ndodh diçka e tillë. Cili është mesazhi që e dërgojmë?

Unë kisha dëshiruar në emër të popullit tonë të vuajtur, t'u kërkojmë falje familjarëve, në rend të parë, s'kemi mundur të bëjmë më shumë, përgjegjësi kemi të gjithë, përgjegjësi kam unë, si kryetar i Kuvendit, përgjegjësi ka kryeministri, përgjegjësi ka presidenti, e ata të dy që janë shkarkuar, me të drejtë janë shkarkuar dhe duhet të ecin.

Veç nuk është pjesa e fundit e përgjegjësisë.

Thashë edhe një herë, nuk është pjesa e fundit, jam shumë i vetëdijshëm për këtë çka po flas, për arsye se gjëra të tilla nuk guxojnë. Zonja Myfera, nuk do t'i bëjnë shërbim as raporteve me shtetin mik turk, s'do t'i bëjnë shërbim të mirë. S'do t'i ndihmojnë as këtij partneriteti, i cili do ta mbante Kosovën në partneritet me shtetin mik turk, as këtij aspekti nuk do t'i ndihmojë. Kjo

është ajo që e dje Kosovës ia ka ulur kokën bukur shumë, të jemi të vetëdijshëm të gjithë. Faleminderit!

3. *Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari*

Nënkryetar, unë e kam thënë një fjalë, më duhet ta mbaj, je nënkryetar i Kuvendit, vetëm të kesh parasysh, në qoftë se ju e merrni fjalën, nuk do t’ua mohoj të drejtën as Arbenit e Samiut, moralisht nuk e bëj këtë, se Samiu e ka kërkuar nga fillimi, tash edhe Armendi u lajmërua.

Je vetë nënkryetar, llogarite si të ishe këtu, atëherë do t’ua jap edhe këtyre kolegëve të tjerë. U bënë 10 veta tash.

Nënkryetarët e udhëheqin seancën, unë nuk ua ndali fjalën asnjërit, le ta marrë Kujtimi si nënkryetar, po i ka edhe këta që lajmërohen t’ua japë fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne jemi para një problemi tepër të madh, tepër të rëndësishëm dhe para dëshmimeve ose rrëfimeve që janë krejt paradoksale, sepse para nesh po dëshmojnë drejtuesit e shtetit për një çështje thelbësore të funksionimit të shtetit dhe si dje, edhe sot thonë që asnjëri prej tyre s’ka asnjë informacion, që i bie se nuk dinë asgjë për atë çështje.

Tash problemi është ky, nëse s’e dinë ata që e drejtojnë, kush e di? Dhe, nëse nuk vendosin ata që kanë të drejtën, kompetencën dhe detyrimin kushtetues, kush po vendos në Kosovë, jo vetëm për këto çështje, po edhe për çështjet e natyrave të tjera?

Ky është problem i rëndësishëm, sepse lidhet me raportet e Kosovës me vendet e tjera, jo në këtë rast vetëm me Republikën e Turqisë dhe është problem i rëndësishëm, sepse e tregon formatin e sjelljes së Kosovës në raport me politikën themelore që ndjek Bashkimi Evropian, kur kemi parasysh të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, e të tjerë.

Unë nuk do të flas për rrëfimet personale për refugjatët e ish-refugjatët, sepse ne këtu jemi përfaqësues, të cilët duhet të mbrojmë, të shpjegojmë dhe të interpretojmë ligjin dhe kjo i bie që ne duhet të jemi neutralë. Po të ishte ashtu, do të thoshte që ata s’e kanë pasur kurrë përvojën e refugjatit, s’duhet t’i kuptojnë ato, kjo nuk është fushë e kuptimit ose moskuptimit, është fushë e implementimit, e zbatimit të ligjit, të Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare.

Kryeministri tha që në informacionet që ka marrë ai me vonesë, me vonesë, po më mirë vonë se sa asnjëherë, e ka kuptuar apo është i bindur që procedura ka qenë konform ligjit, do të thotë që s'ka shkelje ligjore. Nëse s'ka shkelje ligjore, pse kryeministri kërkon lirimin e dy drejtuesve, të cilët janë të këtij sektori, të atyre dy resorëve. Thotë unë s'e kuptoj, kjo e ngatërron punën edhe më tutje.

Po problemi themelor, a përpos asaj kush i deportoi, problemi themelor është pse? Sepse ajo nuk po thuhet.

A e ka kërkuar Turqia, nëse e ka kërkuar Turqia, problemi rritet dhe duhet të sqarohet. Nëse jo, nëse është problem procedural, pse nuk ka ndodhur në rastet e tjera?

Këto duhet t'i thonë drejtuesit e shtetit, nuk mund të shkojë kryetari i Kuvendit e të ndalojë procedurën në aeroport. Këto funksione ecin ndryshe, funksionojnë ndryshe. Nuk duhet që drejtuesit e shtetit të informohen për këto çështje nëpërmjet medieve a rrëfimeve të tjera.

Po në esencë, unë e kuptoj një diçka. Sepse ne kemi tërhequr vëmendjen vazhdimisht për ato që i kemi quajtur 'vendime arbitrare' të Qeverisë dhe vendimet arbitrare janë vendime të kundërligjshme, janë vendime që bëhen pa vlerësime të ligjshme, duke shkelur procedurat dhe normat. E tani vetë institucionet, institucionet themelore të vendit, në radhë të parë Qeveria dhe kryeministri, po përballen me fytyrën e tyre përbrenda institucionit. Nuk kanë çka të çuditen, ato institucione nëse janë sjellë kundërligjshëm dhe kjo është themelorja që ta shpjegojmë ne dhe ta shpjegojë dhe kryeministri pse po i shkarkon, pse s'e informuan, nëse kanë qenë të ligjshme, kjo nuk është themelorja. Nëse veprimet kanë qenë të ligjshme, ata s'kanë detyrim të informojnë askënd, unë besoj që nuk kanë qenë të ligjshme.

Por, vendimet arbitrare për nga natyra janë të kundërligjshme dhe ato njerëzit i bëjnë jo pse kanë të drejtë, jo pse respektojnë ligjin, jo pse ndjekin procedurën, por sepse në atë rast janë aty dhe këto janë veprime tipike për institucionet e Kosovës gjatë këtyre muajve.

Për çështje të tjera ne duhet t'i shohim me kujdes, po nëse shteti nuk ka njohuri, nëse shteti funksionon kështu dhe ne nuk e dimë kush e drejton, askush s'ka legjitimitet të vazhdojë më tutje, as të kërkojë përgjegjësi, as të japë shpjegime.

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës, urdhëro!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Kujtim, në Parlament nganjëherë po ju them, po i mësoj procedurat, vërtet po i mësoj edhe në qeverisje, jam duke mësuar, duke i kuptuar qysh shkojnë ato punë, nuk kam pasur përvojë në këto aspekte qysh shkojnë, nuk i fsheh hiq. Unë as

s'e kam formuar vetë AKI-në, në opozitë kam qenë 12-13 vjet, e besa krejt institucionet e tjera i kam gjetur aty.

Çka është me rëndësi mund t'ju them që përpos shkeljes, e cila është shkelje ligjore fakti që nuk është informuar dikush mbi të, në rastin konkret te drejtori i AKI-së, sikur ai të më kishte informuar mua a presidentin, në këtë rast, megjithatë ai do ta kishte hequr një pjesë të përgjegjësisë, atëherë ka qenë informim edhe ndërinstitucional që njëri nga ne ta informojmë njëri-tjetrin. E vërteta është që unë s'kam marrë informatë nga askush për këtë temë, dhe bazuar në këtë, për mua këtu është shkelja, procedurat e tjera unë nuk jam ai gjykatësi i parë menjëherë që i gjej. Nga ajo çka kam mundur të kuptoj, është ndjekur një procedurë që nuk kam gjetur unë në atë shpejtësinë time prej dje deri sot shkelje ligjore, dua të jem i sigurtë para jush këtu. Problemi është se ministri ka mundur të besojë që unë e di, ministri Sefaj, se ka qenë e supozuar që drejtori i AKI-së më tregon, por prapëseprapë ai e ka ditur prej të premtës. Dy takime të Qeverisë i kemi mbajtur, kemi mbajtur takim të premtën, e ka ditur ai ngjarjen se operacioni ka filluar atëherë, pra ministrin Sefaj e kam takuar dy-tri herë dhe s'më ka treguar. Tani pa marrë parasysh, unë kam shumë respekt për personin Flamur Sefaj, por një ministër që kam pasur dy takime me të, kam biseduar disa tema të tjera të parëndësishme, s'më ka treguar kurrgjë.

Çka t'i bëj unë tjetër? Tani, sa jam unë fajtor që kemi këtë mentalitet qeverisës në vend dhe sa ka ndikuar ndonjë veprim imi arbitrar në të, nuk besoj. Besoj që e kemi krijuar bashkë këtë në afat të gjatë, tani po shpërfaqet kjo, po na del në lëndinë, por mund të marrim mësim edhe nga ky moment, kuptohet me pasoja, se pa pasoja s'ka mësim, por mirë do të ishte çdo mësim të na shërbente, jo veç mua e kësaj Qeverie, por cilësdo në të ardhmen që komunikimi ndërinstitucional, dhënia e llogarisë së ndërsjellë, pastaj edhe marrja e vendimeve që kanë peshë më të madhe, që mund të jenë gjeostrategjike, të mos jetë ndonjë individ. Duke qenë kështu, domethënë dje unë jam kyçur në temë, kryetari Veseli më vjen mirë që e shprehu ashtu përkrahjen e qartë. Unë besoj që është në interesin e Kosovës, po them kështu, pa marrë parasysh të cilit grup parlamentar jemi, ose partie politike, që ta dërgojmë një porosi të qartë që nga vendi ynë disa vendime s'mund t'i marrin individët. Ka vendime të caktuar që nuk m'ërzitem po të m'i vjedhë dikush, ka ndonjë vendim, le të ma vjedhë dikush, s'bëhet kiameti, se nuk i bëhet dëm një vendi, por përfiton njëri, humb ai tjetri, prapë. Ama, janë do vendime që nuk bën të vidhen.

Edhe nëse ne e krijojmë vendin tonë që të mund të vjedhë gjithkush vendime, ndonjë ditë ku ta dimë çka do të na ndodhë! Për këtë arsye është qasja e këtillë, edhe ju kisha lutur që ta lëmë në këto dimensione këtë, kemi plot tema të tjera që mund t'i diskutojmë bashkë në aspektet çfarë i kemi, të brendshme, politike. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, nënkryetar, por do t'i kërkoj seancës, për arsye se për pak po hyjmë në seancë të re, nëse doni të hyni, hyni, po vendosni vetë. Urdhëro, replikë!

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Zoti kryeministër, unë po e përsëris, sepse më keqkuptuat. Ky është veprim arbitrar, por jo juaji, sepse ju po e dëshmoni që s'keni pasur asnjë njohuri, ky është problemi i parë. Problemi tjetër që është shumë më i thellë e që s'kanë pasur njohuri tre drejtuesit e shtetit dhe unë po pyes: kush po e drejton shtetin? Nëse ju s'e dini dhe jeni në krye të Qeverisë, si jeni kryeministër? Këto duhet të na i thoni, sepse ai rast, edhe po të sqarohet, nuk mund të zhbëhet, domethënë ka hyrë në një rrugë, në të cilën më s'mund të kthehet. Tani problemi themelor është në funksionimin e shtetit. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, kryeministër? Jo!

Situata po merr drejtim tjetër, unë kisha kërkuar nga ju si seancë ta ndalim këtu, ose përndryshe kërkonte 40 nënshkrime, për një minutë e bëjmë seancë të jashtëzakonshme dhe po futemi në seancë të re.

Deri tash janë 9 vetë, po ju garantoj, që në qoftë se fillojnë diskutimet janë 10 aktualisht, do të dalin nja 30 vetë dhe asnjë vendim s'e marrim. A ka mundësi kryetarët e grupeve, çka po duan të vendosin për seancë?

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, a dëshironi ta vazhdojmë debatin, për arsye se u bënë 15 vetë, e vazhdoni debatin, merrni përgjegjësinë, po s'ka nevojë të më thoni se e keni shkelur Rregulloren a s'e ke shkelur. U mbush tash, a ka mundësi qëndrimin e grupeve parlamentare, futemi në seancë për këtë çështje, tash mbi 21 vetë duhet të jenë, aktualisht.

Lidhja Demokratike e Kosovës, Armend, a dëshironi ta vazhdoni këtë debat, e në fund e nxjerr në votim? Urdhëro, Armend Zemaj, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që ngjarjet e fundit kërkojnë trajtim apo debat parlamentar. Është më se evidente që deputetët jo që kanë nevojë, por kanë mendime, janë përfaqësues të qytetarëve të vendit dhe përfaqësojnë interesa sublimë, ajo çka është më madhorja, siguria në Kuvend. Kështu që edhe me paraqitjen e fjalës, ju po e shihni që janë 24 deputetë që janë paraqitur për fjalë, ne nuk jemi kundër debatit, duhet të lejohet debati, të mundësohet ose në këtë formë ose kërkonte si kryesuesi i seancës nga Kryesia që ta thërrisni një mbledhje tash urgjente dhe ta caktoni edhe brenda ditës një seancë për këtë çështje. Nuk është kjo kurtuazi të kalohet në këtë formë, apo edhe të gjuhet debati, sepse kur të lejohet një individ apo një deputet ta ketë fjalën, duhet të lejohen të gjithë. Kështu që thirrja ime në emër të grupit është që ta mblidhni Kryesinë menjëherë dhe ta caktoni një seancë, e vazhdojnë dy seanca të tjera.

KRYETARI: Faleminderit! Mbledhje nuk do të thërras, për arsye se jeni organ më i lartë ju, as Kryesia s'mund t'ju përfaqësojë, e votoni, atëherë Memli Krasniqi, e nxjerrim në votim, qëndrimi është ky.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Unë besoj që ishte vendim i drejtë që secili grup parlamentar, me një përfaqësues, me shefat e grupeve të shprehë qëndrimet, deklaratimet e veta. Edhe në fjalën time thashë, nëse duan deputetët, është krejt legjitime për këtë çështje të ketë debat, mund t'i mbledhim 40 nënshkrime. E kemi Rregulloren e Kuvendit, të mos bëjmë këtu veprime, jemi duke i kritikuar shkeljet potenciale dhe, e po kërkoni të bëni shkelje sot, Kuvendi i Kosovës.

40 nënshkrime, kush do, le ta iniciojë, ia japim edhe ne nënshkrimet, e bëjmë kur të doni seancën, nesër mund ta mbajmë. Sot i kemi dy seanca, kjo seancë është e papërfunduar, bile pika e parë është e zvarritur nga 3-4 seanca. E kemi seancën për ligjet që sot e kemi afatin e fundit për ERA, tash çka doni të thoni?! Po doni të bëni debat, se është më i rëndësishëm se sa ato ligje, të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura edhe me Raportin e Progresit. Ky është veprim absolutisht politik, krejt është në rregull, unë jam për të debatuar 100%, por për çka doni të debatoni? Kush di këtu diçka? Ju dolën këtu udhëheqësit e institucioneve edhe thatë "s'dimë kurrigjë", çka kemi të flasim ne këtu? Çka dimë ne? Ne mund të bëjmë veç pyetje, ne as konstatime s'mund të japim.

Unë e përsëris kërkesën time për ta informuar Kuvendin, të informohen deputetët me krejt detajet e zhvillimeve të djeshme, çka ka ndodhur. Kur t'i kemi ato detaje, kur të kemi një informacion, kur të kemi një raport, normalisht që duhet të diskutojmë. Po çka doni të flasim sot, në ajër! Me spekulime, me paramendime, hamendësime, paragjykime, edhe këto pak informata që i kemi. Ne nuk e dimë çka ka ndodhur, s'po e dinë udhëheqësit e vendit, ku e dimë ne deputetët. Kurrkush s'di kurrigjë, ne dhe e kemi shikuar televizorin sikur të ishte film, njëjtë qysh e keni shikuar edhe ju, e sot po kërkoni debat. Jam 100% për debat, por pasi t'i kemi disa informata, e jo t'i anashkalojmë krejt planifikimet që i kemi bërë. Ju e dini që atë ditë kemi marrë vendim në seancë të thirret kjo seancë pa procedurë, në fakt, me tejkalim të procedurave për seancën e orës 14:00. Unë mendoj që ajo është prioritet sot. Por, pas asaj seance, po doni, e bëjmë një seancë tjetër, por jo të shkelet sot Rregullorja e të kërkohet seancë tash. Përndryshe, po e lëmë krejt, vijmë një ditë tjetër, edhe ashtu nga 20-30 ditë janë mbajtur seanca ose ditë pune në këtë Kuvend në dy muajt e fundit, edhe këtë seancë e lëmë në gjysmë, e lëmë edhe atë të orës 14:00, s'ka lidhje për Raport të Progresit, dhe bëjmë qysh kemi bërë deri më tash, që nuk është, besoj, ndonjë shembull fort i mirë.

Ne nuk jemi për të vazhduar në këtë seancë debatin, jemi për një seancë të jashtëzakonshme, nëse do dikush ta marrë iniciativën. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lëvizjes "Vetëvendosje", Albulena Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, kryeministri shpesh po thotë që nuk i njeh procedurat, por s'qenka këtu, megjithatë po e them, ka shumë këshilltarë, me sa e di, të ngarkuar për çështje të këshillave, qoftë edhe procedurale. Asnjëri s'është prej tyre që do të mund ta këshillonte që ky të respektonte ligjet që janë në fuqi dhe përgjegjësitë që ka si kryeministër i vendit. Pra, për çka po i mban ata këshilltarë dhe po ashtu rogat i kanë goxha të larta. Madje edhe ka pasur tendencë që të rriten ato.

Sa i përket çështjes që po diskutojmë, nuk është çështja thjesht te deportimi, çështja është se kush ka dhënë urdhër ose plotfuqishmëri që të bëhen dosje nga AKI-ja për këta persona? Për shkak se kjo nuk mund të bëhet pa dijeninë e presidentit, në këtë rast, pa dijeninë e Hashim Thaçit. Unë jam e bindur që për këtë gjë e ka ditur shumë mirë presidenti i vendit, madje ka shfrytëzuar fuqinë që ka prej presidenti për të bashkëpunuar me AKI-në që ata njerëz të rrëmbehen. Dhe, sigurisht që kjo çështje është tepër e rëndësishme, prandaj është mirë të dëgjohet, për shkak se sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, deputeti apo grupi parlamentar në çdo seancë parlamentare ka të drejtë të propozojë një çështje urgjente për t'u diskutuar, prandaj kjo çështje duhet të votohet në Kuvend. Në qoftë se Kuvendi vendos që të radhitet sot si pikë e rendit të ditës, natyrisht që këtë e lejon edhe Rregullorja e Kuvendit, s'ka çka mblidhet Kryesia e Kuvendit në qoftë se është vullneti i deputetëve të Kuvendit për ta diskutuar këtë çështje sot në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Pikërisht, jemi duke e bërë këtë, por po e ndjekim procedurën. Urdhëro, Dardan Sejdiu nga Grupi i Deputetëve të Pavarur.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, janë 53 ligje, të cilat po presin që të vijnë në Kuvend. Kemi caktuar seancë sot për të trajtuar tema, të cilat lidhen me Agjendën Evropiane, për të cilën tash e 10 vjet shumë prej këtyre dhe juve flisni për. Në anën tjetër, jemi duke diskutuar mbi një temë, për të cilën asnjëherë prej udhëheqësve të shtetit s'e ka asnjë informacion, e prej asaj çka dëgjova sot, edhe prej juve, kryetar, por edhe prej kryeministrit, duket se vetëm presidenti e ka ditur çka ka ndodhur.

E, pra meqë është kjo situatë kështu, ata që duan që këtë temë ta trajtojmë sot me urgjencë mendoj se procedura e rregullon këtë çështje fare lehtë, le të mblidhen nënshkrimet, po vazhdojmë me punime për seancën që e kemi tash, t'i votojmë rekomandimet të cilat i kemi në rend të ditës, mblidhen nënshkrimet apo vendosni si çështje urgjente të rendit të ditës dhe përsëri me procedurë e trajtojmë. Ajo çka është tepër problematike për neve si grup, është që po trajtojmë një çështje në Kuvendin e Kosovës pa asnjë lloj informacioni, po trajtojmë në bazë të raportimeve mediale dhe në bazë të një, të themi, konstrukti të ndërtuar publik mbi situatën e cila mund të jetë komplet çështje sigurie apo mund të jetë komplet tjetër. Arbitrariteti i vendimeve është problemi, dhe këtë arbitraritet të vendimeve të presidentit Thaçi, nëse kështu është situata

qysh po e thoni ju, mund ta trajtojmë me seancë dhe mund ta trajtojmë me anë të procedurave që i kemi. Pra, le të thërrasin seancën e jashtëzakonshme dhe të kemi ndonjë lloj informacioni prej dikujt që di diçka, sepse kështu veç po flasim mbi, po e them edhe një herë, mbi konstruktet që secili prej nesh po i ndërton mbi atë që nuk po dini ju.

Pra, as kryeministri nuk po e di, as kurrkush nuk doli për të na treguar këtu, për të na raportuar se çka ka ndodhur dje, ne do të flasim mbi çka kemi parë në televizor dhe çka po thoni ju. Pra, ne jemi që ose të bëhet kjo punë si seancë e jashtëzakonshme, ose të vendoset, por t'u rrimë procedurave, të mos dalim kështu prej procedurës, kryetar, sepse e keni thënë edhe vetë që do t'i rrini në germë procedurës.

KRYETARI : Faleminderit! Në qoftë se doni, shkojmë drejt në votim, fundi do të jetë votimi, kini parasysh. A dëshironi të deklaroheni ende? Armend, shkojmë në votim, pastaj qëndrimi juaj ishte i qartë, shkojmë në votim në fund, përgatituni. Ahmet Isufi, nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Bilall, a do ta marrësh ti fjalën?

AHMET ISUFI: Zoti kryetar, interpretuesi i Rregullores brenda seancës jeni ju, prandaj zbatoheni Rregulloren, është vazhdim i seancës dhe është seanca tjetër që pret aprovimin e ligjeve në leximin e dytë. Nëse ka nevojë për seancë të jashtëzakonshme, i mbledhim nënshkrimet, por po ju them që angazhimi për të folur sa më shumë e sa më shpejt është me njerëz me zemër në fytyrë. Qysh e kanë bërë ata punën keq, shpejt e shpejt, për të kallëzuar që janë dikush që mund të kryer punë edhe të paligjshme, edhe të pandershme, edhe duke e përlurur imazhin e Kosovës, kështu i kanë bërë veprimet, e kështu i bëjmë edhe ne në seancë duke kërkuar patjetër të bisedojmë tash kur s'kemi as informatë nga Qeveria, as nuk e dimë saktë çka ka ndodhur.

Nëse do të ishin ata duke u deportuar tash, ne do të kishim reaguar normalisht, edhe kishim bërë përpjekje t'i ndalim, por është një akt i kryer, e që kërkon kokë më të kthjelltë, logjikë, kërkon informata të plota, pastaj normalisht diskutojmë ashtu siç duhet, si deputetë të këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Bilall Sherifi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të "Nismës".

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Që të flasim sot për shkelje të Rregullores, kur ende nuk kanë kaluar 24 orë nga shkelja flagrante e Konventës më të rëndësishme për të drejta të njeriut, është më shumë se hajgare, një.

E dyta, kanë rëndësi të gjitha këto ligje që kanë të bëjnë me Raportin e Progresit, mbajeni mend, veç pjesën më të rëndësishme të Raportit të Progresit e kemi shkruar dje, do ta shihni kur të vijë. Dakord jam që të vazhdojmë këtë seancë e ta mbyllim. Unë propozoj sapo të përfundojë seanca e papërfunduar deri më tani, menjëherë kushdo që organizon një mbledhje të nënshkrimeve të 40

deputetëve, unë i pari do ta nënshkruaj dhe vazhdojmë debatin. Nuk mund të bëhemi sikur s'ka ndodhur asgjë, sepse ne mund ta fusim kokën në rërë si struci, por të tjerët janë duke na parë tërë trupin. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Damka, nga Grupi Parlamentar "6+" e keni fjalën!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar "6+" kërkon që të shkojmë sipas rendit të ditës, të cilën jemi thirrur për sot, edhe në ora 10:00 seanca e parë, dhe seanca e dytë në orën 14:00. Ju lutem të mos dalim prej agjendës.

KRYETARI: Zoti Simiq, e keni fjalën, nga Grupi Parlamentar Lista serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

Poštovani kolege,

Narodni poslanici,

Parlamentarna grupa Srpske liste poštuje turske državljane i želim da kažem da razumem svačiju poziciju da je osramočeno oko ovog pitanje i ovog problema, ali zaista ne razumem poziciju institucije i poziciju kolega poslanika da nisu osramočeni zato što neko tukao goloruke građane, zato što neko tukao i ponižavao i ministre i poslanika u ponedeljak, i želim da kažem da to nije, dakle nismo niti osramočeni mi, niti osramočen gospodin Marko Đurić. Želim da kažem da je osramočena institucija, da je ponižen dijalog, da je poniženo poverenje i da je poniženo institucija kao što je Ministarstvo unutrašnje poslove Kosova. Dakle želim da kažem da je za nas zaista nebitno ovom trenutku ova tema i pozicija institucije kao što je Skupština po pitanju onog što se dešavalo juče. Za nas je primarna tema ono što se dešavalo u ponedeljak, i očekujem od institucije i od poslanika da budu jasni po ovom pitanju, ovom problemu, dakle problem iživljavanja nad poslanicima i nad građanima Srpske nacionalnosti na severu Kosovo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të shkojmë në votim, Kuvendi nëpërmjet komisionit mund të informohet saktësisht, përmes Komisionit të Inteligjencës, ta keni parasysh, një mekanizëm i Kuvendit. A ka mundësi të shkojmë drejt votimit? Ju lutem, kolegë deputetë, të votoni kush, vendimmarrja do të jetë e seancës, a dëshironi të vazhdohen diskutimet? Në qoftë se është po, vazhdohen diskutimet për këtë çështje, në qoftë se është jo, vazhdojmë me rendin e ditës. Shumë e qartë, vendimmarrja është juaj në këtë seancë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Kush është për vazhdim të debatit, kush është për vazhdim të rendit të ditës?

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Votoni kush është për vazhdim të debatit ose jo, kjo e qartëson.

90 deputetë kanë votuar. 57 janë për vazhdimin e seancës, 34 janë për vazhdimin e debatit.

(Reagime nga salla)

Më duket se nuk më dëgjuat mirë.

(Sërish reagime në sallë)

57 deputetë janë për të mos vazhduar debati, 34 deputetë janë për të vazhduar debati, 3 janë abstenime. Kjo e qartëson krejt situatën. Vazhdojmë me votimet:

3. *Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari*

Diskutimet për këtë interpelancë kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 16 mars 2018, por për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje është shtyrë. Andaj, sot vazhdojmë me votimin e tekstit të mocionit të propozuar.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

83 deputetë kanë votuar, 31 janë për, 45 janë kundër, 7 abstenime.

Kuvendi nuk e miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

5. *Votimi në parim i Projekt-Rregullores së Kuvendit*

Diskutimet për Projekt-Rregulloren e Kuvendit kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 23 mars 2018, por për mungesë të kuorumit për vendimmarrje nuk është proceduar për votim.

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 81.3 të Rregullores së Kuvendit, Rregullorja e Kuvendit miratohet me 2/3-at e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Pra, miratimi i saj kërkon 80 vota për. E ripërsëris, kërkohen 80 vota për.

Konstatohet se në sallë janë të pranishëm 99 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për të proceduar me votimin, në fakt tani janë 107 deputetë. Vazhdojmë me votimin në parim të Projekt-Rregullores së Kuvendit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

98 deputetë kanë votuar, 88 për, 8 kundër, 2 abstenime.

Kuvendi miratoi në parim Projekt-Rregulloren e Kuvendit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projekt-Rregulloren dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 2 mars 2018, por gjatë procesit të votimit nuk ka pasur kuorum. Ju lutem, mos bëni debat. Nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Të nderuar kolegë deputetë, para se të vazhdojmë me votimin, duhen 80 vota për, ta kini parasysh, 2/3-at e deputetëve. Konstatohet se në sallë janë aktualisht të pranishëm 107 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

103 deputetë kanë votuar, 66 për, 25 kundër, 12 abstenime.

Kuvendi nuk e ka miratuar Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica

- Votimi i i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)

Diskutimet edhe për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 2 mars 2018, por gjatë procesit të votimit nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje. Edhe për këtë projektligj duhen 80 vota, do të thotë 2/3-at.

Aktualisht janë 108 deputetë në sallë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

103 deputetë kanë votuar, 57 për, 27 kundër, 19 abstenime.

Kuvendi nuk e miratoi edhe këtë projektligj.

6. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin e autostradës Kijevë-Zahaq

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar më 23 mars 2018, por ka qenë mungesë e kuorumit për vendimmarrje. Duhet 2/3-at e deputetëve për votim.

Të nderuar kolegë deputetë, 106 deputetë janë aktualisht në sallë, 2 kolegë deputetë janë lajmëruar me dorë. Do të votoni ndaras pastaj. Në rend të parë le të votojnë këta që janë në sallë, në mënyrë elektronike.

Regjia, përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Atëherë, 105 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, 2 deputetë me dorë, 107. Për janë 86 deputetë në mënyrë elektronike, plus 2 deputetët me dorë, 88 gjithsej. 8 janë kundër, 11 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-063 për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BERZH-it.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij.

Zonja Albulena Haxhiu, në cilësinë e kryetares së komisionit, le ta arsyetojë dhe paraqesë raportin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ndoshta është mirë që të dyja t'i bëjmë në një pikë. Unë po i lexoj rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, që kanë të bëjnë me emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore, por po ashtu edhe të anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave. Ne për Presidentin e kemi përfunduar, tash ka mbetur vetëm votimi. Apo jo? Dakord, ama Komisioni për Legjislacion e ka përfunduar edhe shqyrtimin e atij projektligji. Komisioni i ka rekomanduar seancës që të përkrahet ky projektligj. Kundërshtime ka pasur vetëm nga Grupi Parlamentar i

Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe natyrisht që ne do të votojmë kundër edhe në këtë seancë, për faktin se për ne janë të papranueshme privilegjet e Presidentit në përgjithësi, por edhe të zyrtarëve të lartë.

Duke u bazuar pikërisht në këtë projektligj, Komisioni për Legjislacion e ka organizuar një dëgjim publik. Në këtë dëgjim publik janë diskutuar të gjitha privilegjet e zyrtarëve të lartë, sepse ky projektligj në fakt ka qenë pikënisje për t’i diskutuar edhe privilegjet e tjera. Kemi rënë dakord si komision që t’i heqim të gjitha privilegjet që janë në shpërputhje me standardet socio-ekonomike në vend. Sigurisht që ne do ta vazhdojmë punën si komision pas përfundimit të pakos ligjore për sistemin e drejtësisë edhe në këtë pikë.

Pra, komisioni ka rekomanduar që tash ky projektligj të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, në këtë projektligj nuk është propozuar asnjë amendament. Vazhdojmë me votimin e projektligjit.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

78 deputetë kanë votuar. 41 për, 30 kundër, 7 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj zotin Fatmir Xhelili që në emër të Komisionit për Punë të Brendshme ta marrë fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për deputetët e nderuar!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë, në pajtim me nenet 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit Funkcional, në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2018, e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, i propozuar nga Qeveria, vendosi që Kuvendit t’i rekomandojë votimin e këtij ligji me amendamentin e përkrahur nga Komisioni Funkcional, që është 1 amendament, dhe komisioni është përcaktuar kundër 6 amendamenteve tjera, që janë

pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Lus deputetët që ta votojnë këtë plotësim-ndryshim të ligjit.

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj është propozuar një amendament nga Komisioni FunkSIONAL dhe 6 amendamente nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Lus Listën serbe, a dëshironi t'i vini të gjitha në votim përnjëherë? Deklarimin, urdhëro Lista serbe! Urdhëroni, koleg!

ZORAN MOJSILOVIĆ: Zahvaljujem gospodine predsedavajući!

Predsedniče,

Lista srpska u okviru ovog nacrta zakona je predala 6 amandmana, i mi bi trebali da iskoristimo pravo danas da predstavnicima, odnosno poslanicima predstavimo naše amandmane u okviru ovog nacrta zakona, nakon čega bi se oni i sami izjasnili dali naši amandmani mogu da se napokon prihvate u ovoj Skupštini. Znaete, ja sam svestan toga da je to retkost, ali evo i mi imamo možda pravo da to predstavimo i nakon toga neka ide na glasanje.

Vratitću se na amandmane. Srpska lista je predala 6 amandmana u okviru kojih se 5 amandmana, amandman broj 2, 3, 4, 5 i 6 odnose na olakšice za kretanje interno raseljenih lica. Mi smo hteli ovim amandmanima da omogućimo i olakšano kretanje interno raseljenih lica, međutim Funkcionalna komisija smatrala je da to nepotrebno, očigledno je smatrala pa samim tim i nije podržala.

Amandman broj 1 Srpske Liste odnosio se na...

KRYETARI: Më fal, po të ndërhyj. A ka mundësi ta merrni përkthimin. Në qoftë se edhe ju pajtoheni, atëherë shkojmë një nga një dhe ju e merrni fjalën, jua jap mundësinë, një nga një.

ZORAN MOJSILOVIĆ: Nemam prevod!

KRYETARI: OK! A keni përkthim? Unë do të shkoj kështu. Do të shkojmë një nga një. Ju e merrni fjalën, u kërkoni kolegëve deputetë përkrahjen. Shkojmë një nga një, me radhë. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme.

Amendamenti 1. Grupi Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, i nderuar koleg!

ZORAN MOJSILOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Predsedniče,

KRYETARI: Kërkoj falje, ka ndodhur një gabim! Më fal, kërkoj falje prapë, ke të drejtë Glauk. Kërkoj falje!

Amendamenti 1 është me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Kërkoj falje!

Do të thotë, amendamenti 1 është me përkrahjen e Komisionit funksional. Kam problem në procesverbalin që ma kanë shkruar, sepse ma kanë shkruar se amendamentet në vazhdim prej 1 - 4 janë të propozuara, unë mendova se edhe ky. Do të thotë, shkojmë te amendamenti 1, i cili është me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Amendamenti 1

86 deputetë kanë votuar, 76 për dhe 2 kanë votuar me dorë, 7 kundër, 3 abstenime.

Tani kemi të bëjmë me 6 amendamentet që janë propozuar nga Grupi Parlamentar Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

I nderuar koleg nga Lista serbe, për çdo amendament shkojmë një nga një. Ju e arsyetoni, e pastaj shkojmë në votim. Urdhëroni, fjala për ju për amendamentin e parë, të përkrahur nga ju si Listë serbe.

ZORAN MOJSILOVIĆ: Zahvaljujem se predsedniče!

Prvi amandman Srpske liste u okviru ovog nacrtu zakona odnosio se na međunarodnom obavezom Kosova proisteklom iz Briselskih pregovora, koja se odnosi na neisticanja simbola jurisdikcije na prelazima prema Republici Srbiji. U skladu sa tom međunarodnom obavezom, u skladu sa onim što je primenljivo i primenjuje se na terenu, to možete svi gospodo poslanici da vidite, tamo se ne ističu simboli jurisdikcije ni sa jedne, ni sa druge strane. U skladu sa svim tim mi, smo želeli da međunarodna obaveza koja je primenljiva da se uvrsti u Zakon, i ništa više od toga. Iz tog sporazuma proističe, samo želim da vam kažem da proističe iz to da se prema centralnoj Srbiji izgrade još par prelaznih tačaka, neke su počele sa izgradnjom. Ukoliko mi danas ne bismo podržali ovaj amandman koji proističe iz istog paketa odluka vezane po pitanju administrativnih prelaza prema centralnoj Srbiji, mi ne bismo dali podršku ni ministru Unutrašnjih poslova, ma ko god bio on, danas ili sutra, da nastavi sa radom i izgradnjom administrativnih prelaza koje radi.

Znači, on bi možda nastavio da radi protivzakonito, da ne kažem možda bolji izraz, ne bi bilo u skladu sa zakonom, pa samim tim, ako ne bismo podržali ovaj amandman, mi bismo odmah poslali poruku i gradonačelnicima koji žive i rukovode tim opštinama, da nemaju nikakve

zakonske obaveze da potpomognu i daju svoj doprinos u uspostavljanju tih prelaza. Hvala, gospodine predsedavajući!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Kemi qëndrimin e Komisionit FunkSIONAL dhe qëndrimin e Listës serbe.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 9 janë për, 66 kundër, 1 abstenim.

Nuk kalon amendamenti i parë i përkrahur nga Lista serbe.

Amendamenti 2. Urdhëro, koleg zoti Mojsilović!

ZORAN MOJSILOVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Gospodine predsedniče,

Da ne bi se sada za sve ostale amandmane javljao, u smislu da stalno govorim da se ovaj amandman Srpske liste je predložen u cilju olakšavanja kretanja interno raseljenih lista, ja predlažem da se za ostale amandmane Srpske liste, koje se odnose na olakšice kretanja interno naseljenih lica glasa u paketu. Samim ovim ja mislim da sam objasnio zapravo o čemu se radi i šta smo mi želeli da uvrstimo u ovaj zakon i damo svoj doprinos.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, dëshirojnë që këto pesë projektligje në paketë të shkojnë. Janë të përkrahura nga Lista serbe, por jo nga Komisioni FunkSIONAL. A shkojmë në votim drejtpërdrejtë?

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë për amendamentet 2, 3, 4, 5, 6, propozuar nga Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar, 9 janë për, 62 kundër dhe një abstenim.

Nuk kalojnë pesë amendamentet e propozuar nga Lista serbe.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

79 deputetë kanë votuar. 70 për, 8 kundër dhe një abstenim. Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin numër 04/L-214.

9. Shqyrtimi i dytë i projektligjit numër 06/L-014 për infrastrukturën kritike

Komisionet përkatëse e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Zoti Xhelili, fjala është për ju, në emër të komisionit, të na e paraqitni dhe arsyetoni raportin me rekomandime.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Punë të Brendshme Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë në pajtim me nenet 57, 67, 68 të Rregullores së Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura shqyrtoi Projektligjin numër 06/L-014 për infrastrukturën kritike të propozuar nga Qeveria.

Ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2018 vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë votimin, përkatësisht aprovimin e këtij ligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Lus deputetët që ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në këtë projektligj janë propozuar 21 amendamente.

Ne në qoftë se kemi pajtueshmërinë e seancës, i votojmë 21 amendamentet, për arsye se janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

I votojmë të gjitha bashkë, 21 amendamentet, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

85 deputetë kanë votuar, 76 për, 9 kundër, nuk ka abstenime.

Kalojnë të gjitha amendamentet prej 1 deri 21.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

83 deputetë kanë votuar, 76 për, 7 kundër, nuk ka abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-014 për infrastrukturën kritike.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjin numër 06/L-015 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, të paraqesë dhe të arsyetojë raportin me rekomandime.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa si Komision FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka propozuar amendamentet me të cilat janë bërë ndryshimet dhe plotësime të nevojshme përmbajtjesore, gjyqësore dhe të harmonizimit me terminologjinë juridike.

Komisioni ka propozuar gjithsej 12 amendamente dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara.

Pra, janë vetëm 12 amendamente dhe të gjitha kanë përkrahjen e komisionit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në qoftë se seanca pajtohet, do të vazhdonim edhe me 12 amendamentet e propozuara, për arsye se të gjitha e kanë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë për 12 amendamentet e propozuara me përkrahjen e Komisionit funksional. Votojmë tash!

86 deputetë kanë votuar, 74 për, 10 kundër dhe 2 abstenime. Janë miratuar 12 amendamentet e propozuara.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

82 deputetë kanë votuar, 73 për, 8 kundër dhe një abstenim.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-015 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

11. Votimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016

Diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 23 mars 2018, por për mungesë të kuorunit, nuk është proceduar për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

89 deputetë kanë votuar, 45 për, 42 kundër, 2 abstenim, në rrethana të tilla kur janë dy gjysma.

Kuvendi e miratoi raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

E ftoj kryetarin e Komisionit, zotin Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision Funkcional, e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka propozuar amendamentet, me të cilat janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme përmbajtjesore, gjuhësore dhe të harmonizimit me terminologjinë juridike.

Komisioni ka propozuar gjithsej 20 amendamente dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

Komisioni i ka shqyrtuar edhe amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar Lista serbe dhe të njëjtat nuk i ka përkrahur.

Ftojme deputetët që të votojnë 20 amendamentet e përkrahura nga komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-034 janë propozuar këto ndryshime me gjithsej 30 amendamente.

Unë do t'i hedh në votim në tri procedura.

Amendamentet 1 deri 18 i votojmë të gjithë, në qoftë se seanca pranon, janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Amendamentin 19 e votojmë veçmas, për arsye se ka dy propozime.

Amendamentin 20, po ashtu qenkan dy propozime, edhe kjo votohet veçmas, në fakt, katër procedura.

Amendamentet 21 deri në amendamentin 30 Lista serbe deklarohet a i votojmë të gjithë bashkë, a po do të shkojmë një nga një, pra veç e veç. Janë të propozuar nga Lista serbe.

Amendamentet 1 deri në amendamentin 18, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

87 deputetë kanë votuar, 69 për, 8 kundër dhe 10 abstenime, kalojnë 18 amendamentet.

Amendamenti 19, janë dy propozime:

Ta kini parasysh, çdo herë unë i hedh dy herë në votim dy propozimet, të parën edhe të dytë, a dhe b, cila fiton më shumë ajo kalon automatikisht.

Shkojmë me propozimin e amendamentit 19 nga Komisioni FunkSIONAL, në rend të parë votojmë vetëm për Komisionin FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

88 deputetë kanë votuar, 72 për, 9 kundër dhe 7 abstenime. Kjo mbahet në protokoll.

Tani shkojmë për variantin e dytë. Propozuar nga Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. Votojmë tash!

84 deputetë kanë votuar, 10 për, 70 kundër dhe 4 abstenime.

Kaloi amendamenti 19, në variantin e propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Amendamenti 20.

Dy propozime. Shkojmë në votim, dy propozimet, a dhe b.

Në rend të parë shkojmë për propozimin e Komisionit FunkSIONAL.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

86 deputetë kanë votuar, 71 për, 8 kundër dhe 7 abstenime. Mbahet për protokoll.

Shkojmë në propozimin b, propozuar nga Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.
Votojmë tash!

84 deputetë kanë votuar, 8 për, 75 kundër dhe 1 abstenim. Kalon amendamenti i propozuar nga Komisioni FunkSIONAL, amendamenti 20.

Amendamentet 21 deri 30. Të deklarohet Lista serbe për mënyrën e votimit, a do të shkoni në paketë, apo një nga një?

Kolegët e Listës serbe, në paket. A ka një deklaram Saša, a mund të na ndihmosh, një deklaram nga Lista serbe ta kemi. Sasha Milosavljeviq e ka fjalën. A dëshiron në paketë, apo dëshironi një nga një.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Nek se glasa u paket.

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamentet 21 deri në amendamentin 30 janë propozime të Grupit Parlamentar Lista serbe, të cilat nuk kanë marrë përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, pajtueshmëri të plotë. Shkojmë në votimin e të gjithave në paket.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

85 deputetë kanë votuar për amendamentet nga 21 deri 30.

8 për, 75 kundër dhe 2 abstenime. Nuk kalojnë amendamentet 21 deri 30.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Përgatitemi për votim, votojmë tash!

89 deputetë kanë votuar, 62 për, 22 kundër dhe 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-034 për AKP-në, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin numër 04/L-115 dhe me Ligjin numër 05/L-080.

Janë dy votime të fshehta. Në qoftë se pajtohet seanca mund të shkojmë në votim të përbashkët të dyja bashkë.

Nuk ka deklaram kundër, po e shoh, po shkojmë të dyja bashkë:

12. Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave

13. Emërimi i një (1) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Procedurat janë të njëjta.

Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar emërimin e dy anëtarëve në Komisionin për Verifikimin dhe Vendosije të Pronave, prej katër kandidatëve të propozuar për Komisionin për Verifikimin dhe Vendosije të Pronave.

Në të njëjtën kohë, Komisioni për Legjislacion i ka rekomanduar përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore prej dy kandidatëve të propozuar për kërkesa pronësore.

E ftoj në të dy rastet kryetaren e Komisionit për Legjislacion, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2018 i shqyrtoi propozimet e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve në Komisionin për Verifikim dhe Vendosije të Pronave.

Por, po ashtu edhe shqyrtimet apo propozimet për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Rekomandimi i Komisionit është që të emërohen anëtarët e Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave dy nga kandidatët e propozuar.

Pra, ata të cilët janë propozuar për Komisionin për Verifikim dhe Vendosije të Pronave janë:

1. Betim Shala,
2. Sylejman Nuredini,
3. Avdullah Aliu dhe
4. Shpëtim Sadiku.

Mandati i anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave është tre vjet.

Pra, nga këta katër, duhet të votohen dy kandidatë.

Dhe, në anën tjetër, komisioni, siç e theksova, më 27 shkurt 2018 shqyrtoi edhe propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa

Pronësore dhe i rekomandon Kuvendit që të emërohet anëtari i Komisionit për Kërkesa Pronësore njëri nga kandidatët e propozuar që janë:

1. Rrustem Qehaja dhe

2. Lule Bilalli-Ymeri.

Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore është tre vjet. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë i thërras grupet parlamentare që të propozojnë anëtarët e komisionit.

Grupi Parlamentar i LDK-së, kë e propozon? Zoti Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon doktor Haxhi Avdylin.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Krasniqi, kë e propozoni në komision?

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne e emërojmë deputeten Luljeta Veseli-Gutaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, kë e propozoni?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e propozon deputetin Arbër Rexhaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetët e pavarur, kë e propozoni? Zoti Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur e propozon Shqipe Pantinën.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon Rasim Selmanajn.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe, kë e propozoni?

IGOR SIMIĆ: Zoran Mojsilović ispred Liste srpska.

KRYESUESI: “Nisma për Kosovën”?

HAXHI SHALA: Grupi Parlamentar “Nisma” e propozon Albulenën.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+” propozon deputetin me përvojë Danush Ademi.

KRYESUESI: Faleminderit! Lus anëtarët e komisionit që t’i zënë vendet e tyre.

Faleminderit! Zoti Haxhi Avduli, Luljeta Veselaj, Arbër Rexhaj, Shqipe Pantina, Rasim Selamanaj, Zoran Mojsilović, Albulena Balaj-Halimaj dhe Danush Ademi, ju lutem që t’i zini vendet tuaja.

Atëherë, po fillojmë. A është gati komisioni?

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviq, Shëmsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Mitroviq, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri,

Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviq.

KRYESUESI: Faleminderit! Komisioni e ka fjalën.

LULJETA VESELI-GUTAJ:

Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Sylejman Nuredini,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Sylejman Nuredini,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Betim Shala,
Abdullah Aliu,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Betim Shala,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Betim Shala,

Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Betim Shala,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Betim Shala,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
Shpëtim Sadiku,
Betim Shala,
Sylejman Nuredini,
E pavlefshme,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,

Shpëtim Sadiku,
Betim Shala,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Sylejman Nuredini,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Sylejman Nuredini,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Betim Shala,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,

Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Sylejman Nuredini,
Shpëtim Sadiku,
Sylejman Nuredini,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
Shpëtim Sadiku,
E pavlefshme,
Abdullah Aliu,
Shpëtim Sadiku, dhe
Shpëtim Sadiku.

KRYETARI: Faleminderit! Regjia...

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Komisioni votues për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosi të Pronave paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatet e votimit për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave, në mbështetje të neneve 65 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 9 dhe 10.2 të Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit, më 30 mars 2018, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar: Haxhi Avdyli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Arbër Rexhaj, Shqipe Pantina, Rasim Selmanaj, Zoran Mojsilović, Albulena Balaj-Halimaj, Danush Ademaj dhe Arbër Rexhaj, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave, në seancën plenare, e mbajtur më 30 mars 2018, konstaton se:

- Në votim kanë marrë pjesë 104 deputetë,
- të pavlefshme janë 11 fletëvotime,
- votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave janë:

1. Betim Shala i ka fituar 8 vota;
2. Sylejman Nuredini i ka fituar 7 vota;
3. Abdullah Aliu i ka fituar 30 vota dhe
4. Shpëtim Sadiku i ka fituar 59.

Anëtarët e Komisionit vlerësojnë se fitues në këtë garë është Shpëtim Sadiku me 59 vota, kurse për anëtarin e dytë duhet të përsëritet edhe një herë votimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Sa për sqarim, në pjesën e dytë të votimit shkojnë në garë Betim Shala dhe Abdullah Aliu.

KRYESUESI: Regjia, komisionit fjalën, ju lutem!

* * *

HAXHI AVDYLI: Po fillojmë me numërimin e rezultateve për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore:

Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavleshme,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,

Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
E pavlefshme,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,

Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
Lule Bilalli-Imeri,
E pavlefshme,
Lule Bilalli-Imeri,
Rrustem Qehaja.

KRYESUESI: Regjia, fjalën zotit...

HAXHI AVDYLI: Komisioni votues për emërimin e një anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatet e votimit të anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në mbështetje Kushtetutës dhe të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës, si dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 30 mars 2018, në përbërje nga secili grup parlamentar: Haxhi Avdyli, LDK; Luljeta Veseli, PDK; Arbër Rexhaj, “Vetëvendosje”; Shqipe Pantina, Grupi i Pavarur; Rasim Selmanaj, AAK; Zoran Mojsilović, Lista serbe; Albulena Balaj-Halimaj, “Nisma”; Danush Ademaj, “6+”; dhe pas

procedurës së fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve për emërimin e një anëtarit të Komisionit, në seancën e sotshme konstaton se:

- në votim kanë marrë pjesë 105 deputetë;
- të pavlefshme janë 13 fletëvotime;
- votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Rrustem Qehaja i ka fituar 26 vota;
2. Lule Bilalli-Imeri i ka fituar 66 vota.

Fituese është Lule Bilalli-Imeri.

KRYESUESI: Faleminderit Komisionit! Urime atyre që janë zgjedhur. Votat i përsëritim në fillim të seancës prapë për dy kandidaturat që kanë mbetur pa u zgjedhur. Pauzë diku deri në 14:30, s'është mirë të vonoheni. Parimisht në 14:00 e kemi filluar gjithnjë, por sot në 14:30...

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja deputet,
Zotëri deputetë,
Ju lus që t'i zini vendet.

E dini që ka mbetur edhe një votim në mes të dy kandidatëve që kanë mbetur me vota më shumë njëri me tjetrin Avdullah Aliu dhe Betim Shala.

Lus Komisionin që ta zërë vendin e vetë dhe të fillojmë menjëherë procedurën e votimit.

Atëherë po fillojmë:

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut

Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekaliu, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliq, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviç, Shëmsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviç, Sërgjan Mitroviç, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniq, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

KRYESUESI: A ka dikush që s'ka votuar akoma? Në qoftë se dikush nuk ka votuar, ju lus që të votoni!

KRYESUESI: Regjia!

HAXHI AVDYLI: Po fillojmë numërimin edhe të një anëtarit të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronave:

Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,

Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Betim Shala,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme
Betim Shala,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,

Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
Betim Shala,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu,
E pavlefshme,
Avdullah Aliu,
Avdullah Aliu.

KRYESUESI: Faleminderit!

HAXHI AVDYLI: Komisioni votues për emërimin e një anëtari të ri të Komisionit për Verifikim dhe Vendosi të Pronave paraqet këtë:

R a p o r t

për rezultatet e votimit të emërimit të një anëtari të Komisionit për Verifikim dhe Vendorsje të Pronave.

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës dhe Ligjit për Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 30 mars, në përbërje: Haxhi Abdyl, LDK; Luljeta Veseli, PDK; Arbër Rexhaj, “Vetëvendosje”; Shqipe Pantina, Deputetët e Pavarur; Rasim Selmanaj, AAK; Zoran Mojsilović, Lista serbe; Albulena Balaj, “Nisma për Kosovën” dhe Danush Ademi nga Grupi “6+” tregon që në votim kanë marrë pjesë 84 deputetë dhe rezultati për këtë votim është kështu:

1. Avdullah Aliu i ka fituar 54 vota,
2. Betim Shala i ka fituar 15 vota dhe
3. Të pavlefshme janë 15 fletëvotime.

Kështu që, anëtari i dytë i këtij komisioni është zgjedhur Avdullah Aliu.

KRYESUESI: Faleminderit! Të zgjedhurve u uroj sukses! Konsideroj që seanca e planifikuar për paraditen e sotme ka përfunduar. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*